

**“TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE NË REPUBLIKËN  
E SHQIPËRISË PËR PERIUDHËN 2001-2014; TRAJTIM  
NË KËNDVËSHTRIMIN JURIDIKO-PENAL,  
KRAHASUES DHE KRIMINOLOGJIK TË FENOMENIT.”**

Naim Tota

Dorëzuar:

Universitetit Europian të Tiranës  
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Fakultetin  
Juridik, me profil e Drejta Penale, për marrjen e gradës shkencore  
“Doktor”.

Udhëheqës shkencor: Prof. As. Dr. Shefqet Muçi

Numri i fjalëve: 78.000

Tiranë, Maj, 2015

## **DEKLARATA E AUTORËSISË**

© E drejta e Autorit: Naim TOTA

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky studim është punuar prej meje sipas kërkesave të Shkollës Doktorale të Universitetit European të Tiranës.

Deklaroj se ky studim as nuk është prezantuar para ndonjë institucioni tjetër dhe as nuk është botuar.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

## **ABSTRAKTI**

Tema e këtij studimi është “Trafikimi i qenieve njerëzore në Republikën e Shqipërisë për periudhën 2001-2014; Trajtim në këndvështrimin juridiko-penal, krahasues dhe kriminologjik të fenomenit.” Trafikimi i qenieve njerëzore në Shqipëri është njohur si fenomen vetëm pas ndryshimeve të thella politike, sociale dhe ekonomike në vitin 1990 ku shteti shqiptar për shkak të mungesës së ligjeve, fuqisë institucionale dhe përballjes me botën e jashtme, u bë pre e kriminalitetit, ndër të tjera edhe të trafikimit njerëzor, duke u konsideruar vend “origjine dhe tranziti”. Kjo përbën edhe problematikën që ky studim ngre dhe trajton. Trafikimi i qenieve njerëzore në Shqipëri dhe jo vetëm, është studiuar në këndvështrimin statistikor dhe viktimologjik, si fenomen i njohur e i përhapur botërisht, i ndikuar nga kushtet ekonomiko-sociale. Në qendër është studimi i disa momenteve kyçe si etapat e trafikimit njerëzor, llojet kryesore të shfrytëzimit si dhe karakteristikat bazë që përbëjnë profilin autorit dhe të viktimës së trafikimit në Shqipëri për periudhën kohore të caktuar. Në kuadër të dimensionit të fenomenologjisë së kriminalitetit të trafikimit të qenieve njerëzore, janë përfshirë të dhëna nga fusha e fenomenologjisë kriminale, vëllimit, dinamikës dhe statistikës së kriminalitetit. Ndryshimet dhe përmirësimet ligjore, institucionale, strukturore dhe organizative për të luftuar këtë fenomen dhe bashkëpunimi institucional si dhe koordinimi, do të jenë mjete efikase në këtë drejtim. Kujdesi për viktimat e trafikimit, programet për riintegrimin e tyre, si dhe politikat socio-ekonomike për parandalimin e faktorëve që gjenerojnë këto krime, duhet të jenë në qendër të politikave publike për parandalimin e fenomeneve të tilla kriminale. Metodatat e përdorura mbi të cilat mbështeten përfundimet e punimit, janë kryesisht ato historike, juridike, krahasimore, statistikore dhe të studimit të rasteve individuale bazuar në vendimet gjyqësore të formës së prerë. Në burimet shkencore të përdorura, përveç literaturës vendase dhe të huaj, vend të rëndësishëm zënë edhe raportet e organizmave ndërkombëtare.

## ABSTRACT

The theme of this study is "Trafficking in human beings in the Republic of Albania for the period 2001-2014; The treatment of this phenomenon by the criminal law, and its comparative and criminological perspectives." Human trafficking, in Albania, is a known phenomenon only after profound political, social and economic changes in 1990 where the Albanian state due to the lack of laws, institutional strength and confrontation with the outside world, became victim of crime, *inter alia* of human trafficking. In this way Albania is considered country "of origin and transit". Human trafficking in Albania, as a widespread phenomenon, is studied based on viktimologic and statistical viewpoints, and influenced by economic and social conditions. Some of the main topics of the study are the stages of human trafficking, the main types of exploitation as well as basic characteristics that make up the profile of the author of the crime and the profile of the victims of trafficking in Albania. Within the phenomenologic aspect of the crime of trafficking in human beings, data in the field of criminal phenomenology, volume, dynamics and crime statistics, are all taken into account. Effective tools to fight this phenomenon and to enhance institutional cooperation and coordination are considered to be the legal changes and other institutional, structural and organizational measures. Reintegration programs for the victims of trafficking, as well as socio-economic policies for the prevention of the factors that generate these crimes, should be at the center of public policies to prevent such criminal phenomena. Researching methods used in this study, are mainly historical, legal, comparative, statistical and individual case studies based on final court decisions. Reports of international organizations are an important part of the scientific resources used, in addition to domestic and foreign literature.

**Dedikim Klestës sime të vogël.**

## **FALENDERIME**

Falenderim i veçantë në finalizimin me sukses të këtij studimi shkencor i shkon Kryetarit të Gjykatës për Krimet e Rënda Z. Sandër Simoni, Kancelarit të kësaj Gjykate Z. Saimir Shyti, Prokurorit për Krime të Rënda, Z. Eugen Beçi, si dhe Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë, Z. Ardian Çipa për këshillat dhe ndihmesën e tyre lidhur me burimet e vjera që i shërbyen cilësisë së punimit.

Falenderim i vecantë i shkon edhe Universitetit Europian të Tiranës, për përkushtimin dhe korrektësinë gjatë programit të doktoraturës, si edhe udhëheqësit shkencor të punimit Prof. As. Dr. Shefqet Muçi.

Falenderoj gjithashtu, kolegët dhe miqtë e mi si dhe Avokaten Gledina Mecka për editimin dhe redaktimin

Në përfundim, falenderim i përzemërt dhe mirënjohje i shkon familjes sime, bashkëshortes dhe fëmijëve të mi për durimin dhe mbështetjen e tyre të pakushtëzuar.

## **STRUKTURA PËRMBAJTËSORE E PUNIMIT**

HYRJE.....	1
1. Interesi shkencor dhe qëllimi i hulumtimit.....	3
2. Objekti i punimit.....	4

## **PJESA E PARË: VËSHTRIM JURIDIKO-PENAL DHE KOMPARATIV I TRAFIKIMIT TE QENIEVE NJERËZORE.**

### **Kapitulli I**

#### **VËSHTRIM JURIDIKO-PENAL I TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE**

1. Trafikimi i qenieve njerëzore.....	7
1.1.Sfondi historik i trafikimit në nivel ndërkombëtar.....	7
1.2. Sfondi historik i trafikimit në Shqipëri.....	13
1.3. Kuptimi i trafikimit të qenieve njerëzore.....	16
1.4. Fazat e procesit të trafikimit të qenieve njerëzore.....	21
2. Shtysat dhe llojet e trafikimit të qenieve njerëzore.....	27
2.1. Faktorët që karakterizojnë trafikimin.....	27
2.2. Llojet e trafikimit të qenieve njerëzore.....	29
3. Legjislacioni shqiptar në evolucionin e tij për veprën penale të trafikimit.....	31
3.1.Kushtetuta.....	31
3.2. Kodi Penal.....	32
3.3. Zhvillime të tjera në legjislacion.....	45
3.4. Problematikat e praktikës gjyqësor lidhur me ndryshimet legislative.....	50
3.5. Procesi i të provuarit të krimit të trafikimit.....	51
4. Elementët e veprës penale të trafikimit.....	52
4.1. Çështja e dhënies së pëlqimit nga viktimi.....	55
4.2. Trafikimi dhe kategori të veçanta të personave të trafikuar.....	56
4.3. Trafikantët dhe mënyrat e rekrutimit.....	57

5. Trafikimi i njerëzve.....	59
5.1. Elementet e veprës.....	59
5.2. Trafikimi i njerëzve – preferencë e krimit të organizuar.....	60
5.3. Trafikimi si pjesë e krimit të organizuar ndërkombëtar.....	62
6. Trafikimi i femrave.....	64
6.1. Analiza ligjore dhe të dhëna sasiore.....	64
6.2. Rrethanat cilësuese në veprën penale të trafikimit të femrave.....	68
7. Trafikimi i fëmijëve.....	69
7.1. Analiza juridike.....	69
7.2. Nocioni “trafikimi i fëmijëve”.....	73
7.3. Cilët janë viktimat e trafikimit të fëmijëve dhe faktorët që ndikojnë në trafikim....	76
7.4. Veprimtaritë kryesore ku shfrytëzohen të miturit e trafikuar.....	78

## **Kapitulli II**

### **SHIKIM I PËRGJITHSHËM I KUADRIT LIGJOR NDËRKOMBËTAR PËRKATËS LIDHUR ME TRAFIKIMIN**

1. Traktatet ndërkombëtare për krimin e organizuar ndërkombëtar, trafikimin e qenieve njerëzore dhe kalimin kontrabandë të migruesve.....	85
1.1. Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC).....	85
1.2. Protokollin e OKB-së kundër trafikimit.....	87
1.3. Protokollin e OKB-së kundër kontrabandës.....	89
1.4. Marrëdhëniet midis UNTOC-së dhe Protokolleve të OKB-së për Trafikimin dhe Kontrabandën.....	89
1.5. Traktatet specifike rajonale për trafikimin e qenieve njerëzore dhe kalimin kontrabandë të migruesve .....	90
1.6. Traktatet për të Drejtat e Njeriut.....	91
1.7. Traktatet e së drejtës penale / traktatet e mbajtjes në kontroll të krimit.....	92
1.8. Instrumente që nuk janë në formën e traktatit.....	93
1.9. Konventa dhe akte të tjera ndërkombëtare që mbështesin konventat mbi trafikimin.....	94



### **Kapitulli III**

#### **VËSHTRIM KOMPARATIV I TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE**

1. Trafikimi dhe prostitucioni. Prostitucioni “i lirë” dhe i “forcuar”.....	98
1.1. Ndryshime ndërmjet prostitucionit dhe trafikimit.....	99
1.2. Ndryshimi midis kontrabandimit të njerëzve dhe trafikimit të tyre.....	100
2. Trafikimi i qenieve njerëzore sipas disa Kodeve Penale bashkëkohore të disa shteteve.....	101
2.1. Legjislacioni Penal Italian.....	102
2.2. Trafikimi i qenieve njerëzore në Kosovë.....	109
2.3. Kodi Penal Polak.....	113
2.4. Kodi Penal Zvicëran.....	113
2.5. Kodi Penal Austriak.....	114
2.6. Kodi Penal Gjerman.....	114
2.7. Trafikimi i qenieve njerëzore në Amerikë. ....	114
2.8. Kodi Penal Belg.....	116
2.9. Kodi Penal Hollandez.....	116
2.10. Trafikimi i qenieve njerëzore në Finlandë.....	116
2.11. Trafikimi i qenieve njerëzore në Afrikë.....	117

#### **PJESA E DYTË: VËSHTRIM KRIMINOLOGJIK I TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË GJATË PERIUDHËS 2001-2014 DHE MASAT ME QËLLIM TË LUFTIMIT TË TYRE**

### **Kapitulli IV**

#### **DISA KARAKTERISTIKA FENOMENOLOGJIKE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË GJATË PERIUDHËS 2001-2014**

1. Vëllimi dhe dinamika e trafikimit të qenieve njerëzore.....	120
--	-----

2. Disa karakteristika të autorëve të trafikimit të qenieve njerëzore për periudhën 2001-2014.....	130
2.1. Moshë dhe kriminaliteti.....	132
2.2. Gjinia ose përkatësia seksuale.....	134
2.3. Arsimi dhe kriminaliteti.....	135
2.4. Gjendja martesore, statusi familjar dhe regjional.....	137
2.5. Statusi gjyqësor i autorëve.....	139
2.6. Gjendja sociale, statuti social.....	140
3. Disa karakteristika të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.....	140
3.1. Moshë.....	140
3.2. Niveli arsimor.....	141
3.3. Gjinia e viktimave.....	142
3.4. Statusi familjar dhe regjional i viktimave.....	142

## **Kapitulli V**

### **DISA FAKTORË KRIMINOGENE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE GJATË PERIUDHËS 2001-2014**

1. Etiologjia kriminale.....	144
1.1. Faktorët kriminogjenë.....	144
1.1.1. Faktorët shtytës dhe tërheqës të trafikimit të qenieve njerëzore.....	144
1.1.2. Faktorët shtytës.....	145
1.1.3. Faktorët tërheqës.....	145
2. Faktorët objektivë e subjektivë të trafikimit të qenieve njerëzore gjatë periudhës 2001-2014.....	146
2.1. Faktorët objektivë të trafikimit.....	146
2.2. Faktorët subjektiv të trafikimit.....	149
2.2.1. Karakteri dhe sjellja kriminale e trafikantëve.....	150
2.2.2. Motivët sociale.....	151

## **Kapitulli VI**

### **MASAT ME QËLLIM TË LUFTIMIN DHE PARANDALIMIN E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE GJATE PERIUDHËS 2001 – 2014.**

1. Parandalimi i kriminalitetit.....	153
1.1. Parandalimi i përgjithshëm dhe i veçantë.....	153
1.2. Mjetet e parandalimit të kriminalitetit.....	153
2. Aktorët që ndikojnë në parandalimin e kriminalitetit.....	158
3. Masat preventive (parandaluese) të trafikimit.....	160
3.1. Parandalimi parësor dhe dytësor.....	161
3.2. Parandalimi shoqëror i trafikimit.....	162
3.3. Parandalimi juridiko-penal.....	163
4. Kuptimi i masave të luftimit të trafikimit të qenieve njerëzore; Llojet e masave me qëllim luftimin dhe parandalimit e trafikimit të qenieve njerëzore gjatë periudhës 2001 – 2014.....	164
4.1. Korniza Ligjore Kombëtare.....	166
5. Vënia në zbatim e ligjeve anti trafikim.....	172
5.1. Parandalimi dhe ndërgjegjësimi.....	172
5.2. Mbrojtja dhe asistenca.....	174
5.3. Roli i prokurorisë në anti-trafikim.....	176
6. Masat represive (ndëshkuese).....	177
7. Arrestimi i menjëhershëm, ruajtja e vendit dhe mbledhja e evidencave.....	178
7.1. Kontrolli dhe kapja.....	179
7.2. Hetimi pro-aktiv.....	179
7.3. Hetimi financiar.....	180
7.3.1. Hetimi reaktiv.....	182
8. Rehabilitimi dhe riintegrimi i viktimave të trafikuar.....	183
8.1. Profili i viktimës së trafikuar dhe shfrytëzuar.....	183
8.2. Çështjet e sigurisë dhe vlerësimi i rrezikut.....	186
8.2.1. Vlerësimi dhe plani i riintegritimit.....	186
8.2.2. Plan i riintegritimit.....	187
8.2.3. Vlerësimi i procesit të riintegritimit, vetëvlerësimi dhe vlerësimi i jashtëm.....	188

9. Standardet ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e viktimave.....	189
9.1. E drejta për informim.....	190
9.2. E drejta për ndihmë ligjore.....	190
9.3. E drejta për mbrojtje/siguri fizike.....	192
9.4. E drejta për rehabilitim e viktimave.....	194
10. Të dhëna lidhur me viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore bazuar në monitorimin e çështjeve penale gjyqësore (mbi trafikimin e qenieve njerëzore) në Shqipëri për periudhën 2004 -2014.....	195
10.1. Format e ndjekura nga trafikantët për tërheqjen e viktimës në trafik.....	197
11. Dëmshpërblimi i viktimave të trafikimit.....	201
11.1. Një vështrim i përgjithshëm i dëmshpërblimit të viktimave të trafikimit.....	201
12. Rasti i Shqipërisë.....	203
12.1. Kuadri ligjor dhe institucional.....	203
12.2. Skemat e dëmshpërblimit dhe të dëmeve.....	204
12.3. Ndihma për viktimat.....	210
12.3.1. Masa ligjore në drejtim të ndihmës ekonomike dhe sociale të viktimave të trafikimit.....	210
12.3.2. Masa të tjera ligjore.....	212
12.3.3. Strategjitë antitrafik.....	213
<b>PËRFUNDIME</b> .....	225
<b>LITERATURA</b> .....	234

## **HIPOTEZA.**

Trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen kriminal që kërkon zbatimin e masave/ndëshkimeve penale dhe ndërhyrje institucionale për frenimin e kësaj forme të krimit dhe marrjen e masave ndaj viktimës:

1. Trafikimi i qenieve njerëzore implikon bashkëpunimin institucional mes agjencive të zbatimit të ligjit dhe marrjen e masave për parandalimin e shkaqeve dhe pasojave të tij.
2. Respektimi i të drejtave të viktimës dhe dëmshpërblimi i tyre është një mjet efikas për drejtësinë penale.

## **PYETJET KËRKIMORE.**

1. Si paraqitet fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri për periudhën 2001-2014 nga këndvështrimi ligjor, praktik gjyqësor dhe statistikor?
2. A është në përputhje legjislacioni shqiptar me aktet ndërkombëtare në këtë fushë dhe sa efektiv është ai në luftën ndaj trafikimit?
3. Sa kanë ndikuar masat ligjberëse dhe ligjzbatuese, si dhe studimi i faktorëve kriminogjenë në parandalimin e trafikimit dhe pasojave të tij?
4. Si paraqiten masat në kuadër të rehabilitimit të viktimave?

## **METODOLOGJIA E PUNËS.**

Metodologjia e përdorur në këtë studim është e larmishme. Ajo përfshin analizën e standardeve ndërkombëtare dhe ligjeve kombëtare, monitorimin e çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Krimeve të Rënda, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Lartë, asistencën për viktimat dhe konsultime me aktorë të ndryshëm që punojnë për adresimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

Nga pikëpamja teknike, u përdor metoda e studimit të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës për Krime të Rënda të Republikës së Shqipërisë.

Për mbledhjen e informacionit nga çdo vendim u përdor një skedar, i përpunuar nga autori, në bashkëpunim me specialistë prokurorë dhe gjyqtarë të tjerë.

Skeda e çdo vendimi përmban një numër të konsiderueshëm treguesish, si:

- Gjinia, mosha, arsimi, statusi gjyqësor, familjar dhe rajonal i autorëve të veprave penale;
- Rrethanat lehtësuese e rrethanat rënduese që kanë ndikuar në dhënien e vendimit;
- Kërkesa e prokurorit dhe dispozitivi i vendimit të formës së prerë të gjykatës;
- Lloji dhe masa e dënimit;
- Ekstrakte të arsyetimit të vendimeve të gjykatës;

Pas kësaj, treguesit e skedarëve janë integruar në një bankë të dhënash dhe u përpunuan, si nga pikëpamja sasiore, statistikore, ashtu edhe nga ajo cilësore.

Interpretimi, akti i analizimit të të dhënave do të shpjegohet hollësisht në pjesët e punimit në vijim. Statistikat e nxjerra përbëjnë bazën e evidentimit të të dhënave dhe nxjerrjes së përfundimeve, si dhe të përcaktimit të rekomandimeve që përmban ky punim.

Për plotësimin e skedarëve u bashkëpunua me udhëheqësin e temës si dhe pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë, Tiranë. Gjithashtu është përdorur metoda e studimit të rasteve individuale, gjë që nënkupton analizimin nga këndvështrimi i kërkesave të punimit, i të gjitha rasteve gjyqësore për periudhën 2001 – 2014. Janë studiuar gjithashtu, raportet dhe dosjet e Prokurorisë gjatë viteve 2001 – 2014. Pra, informacioni i marrë për këtë punim është 90% nëpërmjet skedarëve dhe 10% nëpërmjet vëzhgimit të dosjeve të Prokurorisë. Për informacionin e marrë nga skedarët do të theksoja se është shumë teknik dhe për saktësinë e tij nuk mund të ketë opinione nga persona të tjerë, apo që kjo

saktësi të ndikohet nga shkaqe të jashtme. Gjatë studimit dhe hulumtimit të veprave penale të trafikimit janë përdorur metoda të caktuara shkencore. Si metoda hulumtuese të përdorura në këtë punim janë: metoda historike, metoda juridike, metoda deduktive, metoda induktive, metoda komparative, metoda e studimit të rasteve individuale, metoda e vrojtimit, metodat statistikore etj. Përmes këtyre metodave dhe teknikave hulumtuese kam arritur që të njoh dhe trajtoj aspekte të shumta të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore. Pjesë e rëndësishme e këtij studimi ka qenë edhe analiza e akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti Shqiptar në lidhje me parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit, detyrimet që burojnë nga këto akte ndërkombëtare për shtetin shqiptar, evolucioni i legjislacionit tonë të brendshëm në përputhje me standardet ndërkombëtare, situata faktike dhe nevoja për përmirësime. Studimi i përjasjes së legjislacionit dhe praktikave me standardet ndërkombëtare, kanë ndihmuar në analizën krahasimore dhe në nxjerrjen e problemeve e rekomandimeve. Përfundimet e arritura dhe rekomandimet përkatëse kanë shoqëruar gjithë materialin dhe janë ndërthurur sipas problematikave në çdo kapitull.

Eksperienca prej afër dy dekadash si prokuror në hetimin dhe gjykimin e veprave të ndryshme penale, ka përbërë gjithashtu një garanci për cilësinë e këtij studimi.

Raportet e përgatitura nga organizata të tjera kombëtare shqiptare, raportet e organizatave ndërkombëtare, si dhe ato të përgatitura nga institucione të ndryshme shtetërore, kanë përbërë një pikë referimi për studimin dhe kanë ndihmuar në cilësinë e tij. Si përfundim, për realizimin dhe për qëllimet e këtij punimi, janë përdorur përveç literaturës vendase dhe asaj botërore, edhe raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit për Shqipërinë, raportet e Këshillit të Europës, raportet e EUROPOL-it, të INTERPOL-it, UNICEF-it, IOM-it etj.

## HYRJE.

Trafikimi i qenieve njerëzore është një dukuri masive e skllavërisë moderne, ku miliona individë janë të privuar nga liria dhe e drejta për të zgjedhur, shfrytëzohen me mjete shtrënguese dhe abuzive, për qëllime nga më të ndryshmet që nga shfrytëzimi seksual apo për punë deri te detyrimi për të kryer veprimtari kriminale dhe heqja e organeve apo formë tjetër shfrytëzimi me përfitime të mëdha.<sup>1</sup> Ky fenomen u rishfaq me përmasa të shtuara pas rënies së kampit socialist në Europën Lindore. Për mjaft arsye, që tashmë janë bërë të njohura nga shumë studime e vëzhgime të autorëve të ndryshëm, kjo dukuri preku në mënyrë të veçantë vende me ekonomi të pazhvilluara dhe në pozicione kufitare me shtetet perëndimore, ashtu si Shqipëria. Dukuria e trafikimit të qenieve njerëzore, shpesh manifestohet e shoqëruar me elementë agresivë dhe për këtë arsye është vlerësuar si një nga format moderne të skllavërisë njerëzore.

Përfitimet e mëdha që vinin si rezultat i kësaj veprimtarie kriminale, e cila i kishte qendrat kryesisht në qytetet bregdetare apo kufitare, të paprekura nga ndërhyrja e shtetit dhe nga faktorë të tjerë ekonomikë, politikë dhe socialë, krijoi rrethana të përshtatshme për trafikantët për fillimin dhe lulëzimin në një masë të konsiderueshme të trafikut të femrave për prostitucion apo të trafikut të të miturve jashtë vendit.

Shkalla e këtij lloj krimi është bërë tashmë shqetësuese për institucionet shtetërore, opinionin publik në Shqipëri si dhe për organizatat ndërkombëtare. Shqipëria konsiderohet vend “origjine dhe tranziti për trafikimin e femrave” nga ana e organizmave të specializuara ndërkombëtare që monitorojnë këtë dukuri. Veprimtaria e institucioneve të drejtësisë dhe të zbatimit të ligjit në luftën kundër trafikantëve është vlerësuar si e pamjaftueshme, joefektive dhe pa ndikim në uljen e këtij kriminaliteti. Për një kohë të gjatë, numri i personave të dënuar për trafikimin e njerëzve ka qenë relativisht i vogël. Ndërkohë që Raporti i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës i vitit 2002 për trafikimin, shprehej se “...*Shqipëria është vend burimi dhe tranziti për trafikimin*”.

Shumë pak prej viktimave marrin ndihmë dhe mbrojtje si viktime të një krimi të rëndë; më shpesh, ata arrestohen, ndalohen dhe akuzohen për shkelje të rregullave të

---

<sup>1</sup>ILO, *Vlerësimi Global i Punës së Detyruar* (Gjenevë, 2012): Në vitin 2012, ONP vlerësonte se 20.9 milionë njerëz janë viktime të punës së detyruar, në shkallë botërore.



imigracionit, për prostitucion, apo përfshirje në punë të paligjshme, për deklarime të rreme, apo gjobiten për shkelje të ligjeve dhe rregullave administrative. Gjithashtu, rritja në shkallë globale e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore për të kryer veprimtari kriminale, i ekspozon viktimat e trafikimit edhe për kryerjen e shumë veprave të tjera penale të tilla si, po jo të kufizuara vetëm te vjedhja, vjedhja e xhepave, trafikimi i drogave, kultivimi i kanabisit dhe mashtrimi. Shpesh, është strategji e qëllimshme e trafikuesve që t'i ekspozojnë viktimat ndaj rrezikut për t'u ndjekur penalisht dhe t'i manipulojnë dhe shfrytëzojnë për veprimtari kriminale. Ndaj, nuk është e pazakonshme që viktimat e trafikimit të kryejnë vepra penale apo shkelje të tjera të ligjit të lidhura drejtpërdrejt apo që rrjedhin nga situata e trafikimit të tyre. Në këto situata, ata shpesh vihen në vëmendjen e autoriteteve së pari si shkelës dhe mund të mos dallohen lehtë si viktima aktuale të një krimi të rëndë. Prandaj, shtetet duhet të jetë plotësisht të vetëdijshme për këto zhvillime për të mundësuar identifikimin e saktë të viktimës dhe hetimin e efektshëm të krimit të trafikimit, si dhe për të siguruar mbrojtje të efektshme të të drejtave të viktimës, përfshirë mosdënimin për ato shkelje të shkaktuara apo të lidhura drejtpërdrejt me faktin që ata janë trafikuar.

Parimi i mosdënimin të viktimave vihet re në një numër standardesh ndërkombëtare, përfshirë instrumente me fuqi detyruese ligjore dhe politike. Shtetet anëtare të OSBE-së, janë angazhuar të kenë një qasje të veprimeve anti-trafikim të mbështetur në të drejtat e njeriut dhe me viktimat në qendër, qasje kjo që respekton në çdo kohë dinjitetin dhe të drejtat e njeriut për viktimat e trafikimit.<sup>2</sup> Kjo qasje e mbështetur te të drejtat e njeriut u bën thirrje qeverive dhe parlamenteve të marrin rol udhëheqës në juridiksionet e tyre kombëtare për të siguruar që legjislacioni dhe politikat të mos ndikojnë negativisht mbi mbrojtjen e personave të trafikuar.<sup>3</sup>

Angazhimi dhe sensibilizimi i shtetit dhe organizmave ndërkombëtare, i organizatave joqeveritare kombëtare ose ndërkombëtare, kanë ardhur vazhdimisht në rritje për të luftuar këtë fenomen. Këtij angazhimi i është përgjigjur edhe përmirësimi i situatës ligjore dhe organizative.

---

<sup>2</sup> OSCE Ministerial Council, Declaration on Trafficking in Human Beings, MC(10) JOUR/2 (Porto, 7 December 2002), Annex 2, Section II, para. 6 (Këshilli Ministerial OSBE-së, Deklarata për Trafikimin e Qenieve Njerëzore).

<sup>3</sup> OSCE Permanent Council, Decision No. 557/Rev. 1 OSCE *Action Plan to Combat Trafficking in Human Beings*, PC.DEC/557/Rev.1 (Vienna, 7 July 2005), Chapter IV, para. 5.2 (Këshilli i Përhershëm i OSBE-së, Vendimi Nr.557/Rev 1 *Planveprimi i OSBE-së për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore*).

Kështu Qeveria Shqiptare ka hartuar Strategjinë e Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, si dhe ka krijuar mekanizma që mundësojnë realizimin e saj. Pranë Ministrisë së Rendit Publik ndodhet Njësia Anti-Trafikim, e cila koordinon punën e saj me Policinë e Kufirit, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe me struktura analoge në vende të tjera, apo me agjenci të ndryshme shërbimesh.<sup>4</sup>

Gjithashtu, gjatë kësaj kohe, u ndryshua legjislacioni në përputhje me konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe u krijua Gjykata e Krimeve të Rënda, kompetente për gjykimin e veprave penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore.

Unë besoj se të gjitha këto masa kanë ndikuar dhe do të ndikojnë në përmirësimin e situatës së luftimit të trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, por nga ana tjetër kjo nuk do të thotë se beteja është fituar përfundimisht.

Në mënyrë të veçantë ky studim ka për qëllim të verifikojë se si është luftuar trafikimi nëpërmjet procedimeve penale dhe të zbatimit të ligjit nga gjykata. Mendoj se këto të fundit kanë një rol të rëndësishëm në luftimin e kësaj dukurie, pasi, nëpërmjet vendimeve të formës së prerë mund t'i jepet goditje krimi të organizuar.

Duke qenë i ndërgjegjshëm, që trafikimi është një dukuri shumë komplekse dhe se faktorët që krijojnë premisa për zhvillimin e tij janë të shumtë, nëpërmjet këtij punimi, çështjet penale do të trajtohen edhe në aspektin kriminologjik.

## **1. Interesi shkencor dhe qëllimi i hulumtimit.**

Problemet që trajtohen në këtë punim kanë si bazë juridike kërkesat e Kodit Penal, bazuar në standartet ndërkombëtare dhe kryesisht të konventave, të cilat janë trajtuar me hollësi në pjesët e këtij punimi.

Aspektet e analizuara dhe të evidentuara janë shumë komplekse dhe të gjera. Ato lidhen kryesisht me amendimet aktuale, përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit shqiptar në çështjet e trafikimit, me përfaqshjen e tij me aktet ndërkombëtare të cilët kanë vendosur standarde të reja për parandalimin dhe luftën ndaj kësaj dukurie, me çështje të zbatimit të ligjit penal në veprat me këtë objekt, me çështjen e rritjes së forcës goditëse të gjykatës ndaj veprave penale të këtij spektri dhe autorëve të tyre, etj.

---

<sup>4</sup> *Raporti alternativ* i prezantuar nga QNL, përpara KKT-së të OKB-së, me 12 Maj 2005 në Gjenevë. Botuar në revistën e QNL-së "Ligji, mundësi zhvillimi për gratë".

Qëllimi i këtij punimi është paraqitja, njohja dhe trajtimi i veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore gjatë periudhës së hulumtuar.

Evidentimi në këtë punim i të dhënave statistikore që pasojnë, si dhe identifikimi i problemeve të ndryshme në kuadrin e veprimtarisë gjyqësore krijon mundësi jo vetëm për të dhënë informacion, por dhe të arrihet në disa përfundime të rëndësishme, madje të rekomandohen përmirësime, jo vetëm brenda kuadrit ligjor, por edhe sa i takon praktikës së ndjekur nga gjykatat.

Studimi do të kontribuojë për një akses më të madh të viktimave të trafikimit përmes njohjes dhe gëzimit të të drejtave të tyre ligjore.

Në këtë kuadër, mendoj se kuptimi dhe zbatimi me i drejtë i legjislacionit tonë penal dhe i akteve ndërkombëtare në këtë fushë, të njohura nga Republika e Shqipërisë, do të kërkonin veprimtari më të kualifikuar nga gjyqtarët e prokurorët, si dhe trajtim më të gjerë doktrinal të kësaj fushe.

Gjithashtu punimi u ofron ndihmë modeste të gjitha strukturave shtetërore që hartojnë dhe zbatojnë politikat në luftën kundër trafikut, që kryejnë reformat ligjore dhe japin ekspertiza të ndryshme në këtë fushë.

## **2. Objekti i punimit.**

Objekt studimi dhe hulumtimi në këtë punim janë veprat penale në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore në Republikën e Shqipërisë gjatë periudhës 2001 – 2014. Në këtë punim është bërë përpjekje që të vihen në pah studimi dhe hulumtimi i veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore në aspektin juridiko-penal, aspektin krahasues, kriminologjik si dhe politikës së luftimit dhe parandalimit të tyre. Studimi i këtyre aspekteve ofron njohuri të duhura në drejtim të luftimit dhe demaskimit të veprave penale të kësaj fushe për periudhën e hulumtuar.

Duke qenë të ndërgjegjshëm, se trafikimi është një dukuri shumë komplekse që e skllavëron viktimën dhe e bën atë të paaftë për të përballuar jetën, menduam që analiza e masave ligjore, administrative, praktikave gjyqësore dhe politikave shtetërore të shihet nga një këndvështrim i ri dhe konkretisht, përmes garantimit të të drejtave të viktimave të trafikut, në kuadrin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në mënyrë të veçantë, ky studim synon të analizojë rezultatet që ka sjellë zhvillimi dhe përmirësimi i legjislacionit që lidhet me trafikimin e qenieve njerëzore, si dhe zbatimin e tij, nëpërmjet praktikave hetimore dhe gjyqësore për këto vepra.

**Së pari**, studimi ka si objekt studimin e vendimeve të gjykatave dhe të praktikave të mbajtura nga ana e organeve të drejtësisë në lidhje me këto vepra për periudhën 2001-2014.

Ai vjen në vijim të studimeve të mëparshme të kryera në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore për vitet 2001-2005 dhe sjell disa risi në analizën e kryer dhe në konkluzione e rekomandime.

**Së dyti**, punimi zgjeron fushën e studimit duke përfshirë Gjykatën e Krimeve të Rënda e cila gjykon të gjitha veprat penale objekt hulumtimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

**Së treti**, në studim paraqiten gjetje të rëndësishme në lidhje me karakteristikat kriminale të trafikantëve, statusin e viktimës dhe personin e dëmtuar.

**Së katërti**, ky studim e zgjeron rrethin e veprave të monitoruara. Ai është mbështetur në studimin e praktikave në lidhje veprat penale të parashikuara nga Kodi penal, shqyrtimi i të cilave është në kompetencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda, sikurse vijojnë:

“Trafikimi i personave” (neni 110/a i K.P.);

“Trafikimi i femrave”(neni 114/b i K.P.);

“Trafikim i të miturve” (neni 128/b i K.P.),

Studimin dhe trajtimin e këtij punimi është ndarë në dy pjesë kryesore së bashku me hyrjen dhe përfundimet, si dhe literaturën e përdorur. Pjesa e parë është e përmbledhur në dy kapituj, ku në kapitullin e parë i është kushtuar vëmendje aspektit juridiko-penal të trafikimit të qenieve njerëzore, i cili ka të bëjë me kuptimin dhe llojet e veprave penale të trafikimit si dhe analizën e dispozitave përkatëse të parashikuara në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë për trafikimin e njerëzve, trafikimin e femrave për prostitucion dhe trafikimin e fëmijëve. Ndërsa në kapitullin e dytë trajtohet trafikimi i qenieve njerëzore, krahasuar me këto vepra sipas disa kodeve penale bashkëkohore të Europës dhe më gjerë. Një vëmendje e posaçme në këtë kapitull i është kushtuar trafikimit të qenieve njerëzore sipas disa konventave të njohura ndërkombëtare. Në

kapitullin e tretë paraqiten ndryshimet midis trafikimit dhe prostitucionit dhe kontrabandimit, si dhe jepen parashikimet ligjore të trafikimit të disa shteteve.

Pjesa e dytë e punimit ka si objekt vështrimin kriminologjik të trafikimit të qenieve njerëzore në Republikën e Shqipërisë për periudhën 2001 – 2014. Kjo pjesë është e ndarë në tre kapituj dhe kapitulli i parë trajton karakteristikat fenomenologjike të këtyre veprave penale që kanë të bëjnë me vëllimin, dinamikën, strukturën dhe karakteristikat e tyre. Kapitulli i dytë trajton faktorët kriminogjen të këtyre veprave penale dhe kryesisht, faktorët objektiv dhe subjektiv të trafikimit të qenieve njerëzore.

Kapitulli i fundit i cili plotëson tablonë e këtij punimi, trajton masat me qëllim luftimin dhe parandalimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore. Ky kapitull përqëndrohet në kuptimin e këtyre masave dhe llojet e tyre të cilat janë masat preventive dhe represive.

Punimi nuk do të ishte i plote, po që se nuk do t'i kushtohej një rëndësi e posaçme viktimave të trafikimit dhe kryesisht rehabilitimit dhe ri-integrimit të tyre në shoqëri.

Pjesa kryesore dhe finalizuese e tërë punimit është dhënia e konkluzioneve. Këto konkluzione dhe përfundime janë rezultat i hulumtimit të këtij punimi dhe do të kenë karakter të theksuar kritik.

## **PJESA E PARË**

# **VËSHTRIM JURIDIKO-PENAL DHE KRAHASIMOR I TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE**

## **Kapitulli I: Vështrim juridiko-penal i trafikimit të qenieve njerëzore.**

### **1. Trafikimi i qenieve njerëzore.**

#### **1.1. Sfondi historik i trafikimit në nivel ndërkombëtar.**

Vështrimin historik do ta fillojmë me periudhën më të hershme të shfaqjes së trafikimit të qenieve njerëzore dhe pikërisht me tregëtinë e skllëve, duke vazhduar më tej me trafikimin dhe prostitucionin si dy fenomene të lidhura ngushtë me njëri tjetrin.

Tregëtimi i skllëve<sup>5</sup> është një dukuri e lindur në periudha të hershme dhe ka ardhur duke u zhvilluar deri në ditët tona. Tregëtia e skllëve në lashtësi, ishte mjaft e përhapur, duke i shndërruar skllëverit në një prej burimeve kryesore për realizimin e punëve të ndryshme. Skllëverit duke u parë thjesht si objekte pune dhe duke mos gëzuar as statusin e njerëzve të lindur të lirë nga natyra përbënin krahun kryesor të punës së detyruar. Duke mos u njohur atyre asnjë të drejtë skllëverit shiteshin dhe bliheshin sikur të ishin sende dhe jo qenie njerëzore. Tregtimi i skllëve ka njohur zhvillimin më të madh duke filluar nga shek XV deri në shekullin XIX.

Periudha e lashtë ku u shfaq tregëtia e skllëve nis me krijimin e Romës, viti 754-753 p.e.s deri në shek. II p.e.s. Në periudha shumë më të hershme kategoria e personave me statusin “skllav” nuk ekzistonte, kjo dukuri filloi të shfaqej për shkak të luftimeve të shumta të realizuara në Romë, si rjedhojë e të cilave kjo e fundit pasurohej me robër lufte duke i kthyer ata më pas në skllëvër. Përmendëm më sipër se skllëverit nuk kishin të drejta pra konsideroheshin si sende që flasin, të cilët u gjendën në pushtetin e pakufizuar të padronit, përcaktim ky i bërë në bazë të së drejtës romake.

Skllëverit e kësaj periudhe ndaheshin në disa kategori, të cilat ishin:

- Fëmijët e lindur nga një nënë skllave në çastin e lindjes.
- Robërit e luftës.

---

<sup>5</sup>Prof.Asoc.Dr. Arta Mandro, *E Drejta Romake*, Ribotim i Trete, Emal, Tirane 2011.

- Personi që i përkiste një komuniteti të huaj (ose edhe qytetar romak) dhe që bënte në Romë ndonjë shkelje ligjore.
- Kur një qytetar romak nuk shlyente borxhin, ai kthehej në skllav prej një romaku apo të huaji.
- Kur dezertonte në mënyrë të vullnetshme nga fronti i luftës.
- Ai person që nuk pranonte ose nuk paraqitej për t'u rregjistruar në rregjistrat e popullsisë.

Tre kategoritë e fundit u shiteshin në skllavëri të huajve me pretekstin se një qytetar romak nuk mund të bëjë skllav në Romë.

Lashtësia ishte periudha ku skllavëria arriti kulmin duke e përdorur këtë kategori njerëzish për punë të ndryshme, ku mund të përmendim dhe prostitucionin por jo në një kuptim të mirëfilltë. Pasi përdorëshin për shërbimeve të ndryshme skllavet femra ofronin edhe shërbime seksi për padronët e tyre. Nga ky fakt lehtësisht mund të kuptojmë se prostitucioni ka një origjinë mjaft të hershme.

Prostitucioni në vetvete nënkupton një formë sjelljeje shoqërore të kryer në kundërshtim me normat e sjelljes morale dhe etike të çdo shoqërie. Fjala “prostitucion” e ka origjinën e saj nga gjuha latine dhe e përkthyer në gjuhën shqipe do të thotë “çoj në rrugë të keqe”<sup>6</sup>. Në një kuptim më të plotë do ta cilësonim si dhënie e nderit për qëllime fitimi jo vetëm prej atyre që e ushtrojnë por dhe e atyre që e organizojnë. Sipas historianëve të njohur rezulton se prostitucioni është shfaqur herët në formë riti, zakoni në shumë shtete të shoqërisë së lashtë. Por pavarësisht se është konsideruar si zakon jo të gjithë janë pajtuar me këtë përcaktim. Në historinë e Kinës dhe të Greqisë së lashtë, deri vonë thuhet se ishte detyrim dhe normë e pranuar që një vajzë e re e pamartuar, duhet të hynte në marrëdhënie seksuale, me të huaj miq e kalimtarë pastaj të martohej<sup>7</sup>. Kjo mënyrë jetese është konceptuar si një formë e prostitucionit.

Një tjetër formë prostitucioni është “e drejta e natës së parë” të martesës me bashkëshorten e ardhshme të bujkërobërve që përfshiheshin në feudin e tij. Nga e ashtuquajtura “e drejta e natës së parë” e ka origjinën edhe prostitucioni religjioz, kjo lloj formë ka një farë ngjashmërie me atë të ritualit por dallon sepse ai religjioz ushtrohet nëpër tempuj, në vende të shenjta. Pas rilindjes europiane, këto lloj ritesh u çmuan si të

<sup>6</sup> Fjalori latinisht-shqip, viti 1966.

<sup>7</sup> Jani Papandile, Prof. Asoc. Dr Ilir Mandro, *Kriminologji-Penalogji*, 2002.

pamorshme dhe nuk u lejuan në shumë shtete europiane. Një tjetër formë është prostitucioni profesional shumë i përhapur edhe në ditët e sotme, historianët japin fakte se në Romë dhe në Athinën e lashtë kanë ekzistuar shtëpi publike të llojeve dhe të formave të ndryshme.

Edhe “tradhëtia” bashkëshortore, kryerja e marrëdhënieve intime jashtë martese, si pasojë e mungesës për një kohë të gjatë e njërit prej bashkëshortëve është konsideruar si formë prostitucioni. Kjo lloj formë ishte e justifikuar si për burrat dhe për gratë. Duhet të theksojmë se ky lloj profesioni nuk ushtrohet vetëm nga femrat për qëllime të përfitimeve materiale por edhe nga meshkujt të ashtuquajtur “zhigolo” të cilët kryejnë marrëdhënie intime me gra më të mëdha në moshë.

Nga interesi shkencor për të studiuar dukuritë e prostitucionit, mund të përfitohet edhe për të nxjerrë përfundime rreth mënyrave të rekrutimit të grave dhe vajzave, përgjatë historisë. Ata që janë marrë me historinë e Romës, për shembull, me shkëlqimin dhe rënien e saj, kanë theksuar edhe aspekte të trajtimit e të skllavërimit të grave, pra në gjuhën e sotme, aspekte të veçanta të trafikimit.<sup>8</sup>

Të dhëna interesante për rregullimin ligjor të prostitucionit femëror në Romë, gjenden afërsisht në vitet 200 para Krishtit deri në 250 vjet pas Tij, dhe na i jep studiuesi Thomas McGinn (2003), në një libër mbi prostitucionin, seksin dhe ligjin.<sup>9</sup> Në të pasqyrohet hartimi dhe përmbajtja e saktë e normave ligjore mbi prostitucionin, porë në kontekstin social. Studimi, ndoshta unikal, i McGinn-it eksploron “përkimin” nepërmjet sistemit ligjor dhe realitetit socio-ekonomik dhe hedh dritë mbi një varg çeshtjesh të rëndësishme lidhur me shfrytëzimin social, grupet sociale, martesën, sjelljen seksuale, familjen, skllavërinë dhe trafikimin e grave, statusin si qytetarë, veçanërisht statusin e gruas etj.

Ende më i studiuar është, nga kjo pikëpamje, antikiteti Grek. Studiuesit socialë kanë argumentuar se lindja e prostitucionit, pra edhe skllavërimi i grave për shfrytëzim seksual, lidhet, së pari, me përmbysjen e raporteve midis burrave e grave, pikërisht me kalimin nga e drejta amëtare (matriarkati), në të drejtën atërore (patriarkati).

Ky hap shënoi, siç thotë Engelsi, disfatën e madhe historike të seksit femëror. Gruaja humbi kështu pozitën e vet të respektuar, u kthye në shërbetore, në skllave të epsheve të

---

<sup>8</sup> Lekë Sokoli, Ilir Gërdeshi, “*Trafikimi Rasti i Shqipërisë*”, Tiranë, 2006, fq.18.

<sup>9</sup> Thomas McGinn, “*Prostitucion, Sexuality, and the Law in Ancient Rome*”, Oxford University Press; January 2003.



burrit. Shembujt përgjatë historisë janë të shumtë. Për një kohë të gjatë prostitucioni është konsideruar si veprimtari që bie ndesh me moralin social të kohës. Megjithatë, në sisteme të ndryshme juridike në këndvështrimin historik, kanë ekzistuar dhe ekzistojnë norma juridike që nuk lidhen aspak me moralin, dhe këtu padyshim hyjnë normat që rregullojnë ushtrimin e prostitucionit<sup>10</sup>.

Trajtua zhvillimin e formave të prostitucionit dhe konceptin e skllavërisë, si dy elemente që kanë bashkëjetuar deri në ditët tona.

Më tej, trafikimi është shndërruar në një problem social në fazat e vonshme të zhvillimit të shoqërisë, në kohën e shembjes së skllavërisë në përgjithësi, në fazat e qytetërimit e të iluminizmit, të shndërrimit të lirisë në një aspiratë universale njerëzore, sidomos me daljen në skenë të shtetit të së drejtës, me theksimin e të drejtave themelore të njeriut dhe me mbrojtjen dhe garantimin e tyre si në planin e brendshëm ashtu edhe atë ndërkombëtarë. Reagimi ndaj trafikimit mori tiparet e një veprimi kolektiv e të organizuar sidomos gjatë shekullit XX, me krijimin e institucioneve ndërkombëtare, si Lidhja e Kombeve (më pas OKB-ja), apo ato Evropiane (Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian etj), pas Luftës Dytë Botërore.

Nga të gjitha format e trafikimit, ai për shfrytëzim seksual është më i përhapuri, më i zakonshmi dhe më i studiuar. Prej tij mund të nxjerrim, drejtpërdrejt apo edhe tërthorazi, përfundime edhe mbi trafikimin në përgjithësi.

Në skenën ndërkombëtare, trafikimi me njerëz u bë një brengë ndërkombëtare në fund të shekullit 19-të. Gjatë asaj periudhe u organizuan shumë konferenca që merreshin me këtë problem, ndërsa u nënshkruan edhe një numër traktatesh me qëllim rregullimin e kësaj çështje apo praktike.

Konferenca e parë u mbajt në Paris në vitin 1895, e dyta në Londër më 1899, ndërsa e treta në Budapest më 1904. Konventa e parë për goditjen dhe eliminimin e trafikimit u nënshkrua në Paris në vitin 1904.

Në vitin 1937, Lidhja e Kombeve hartoi një konventë, ku shtetet palë ranë dakort që të dënojnë çdo person, i cili me qëllim kënaqjen e pasionit të të tjerëve:

- *Punëson, tërheq apo mashtron me qëllim prostitucioni një person tjetër, pavarësisht nga pëlqimi i tij/saj;*

- *Shfrytëzon prostitucionin e një personi tjetër pavarësisht nga pëlqimi i tij/saj.*

---

<sup>10</sup> Luan Omari, “Parime dhe Institucione të së Drejtës Publike”, Botim i tetë, Botimet “Elena Gjika”, Tiranë, 2004, 1949.

Gjithashtu, palët e kësaj Konvente ranë dakort që të dënojnë çdo person i cili:

*„- Mban, udhëheq, financon apo kontribuon me vetëdije në financimin e një shtëpie publike;  
- Jep me qera me vetëdije, tërësisht apo pjesërisht një ndërtesë apo ndonjë vend tjetër, me qëllim që të tjerët të kryejnë prostitucion.“*

Të gjitha palët e kësaj Konvente u zotuan të ndërmarrin masa legjislative dhe masa të tjera të domosdoshme, për të mundësuar implementimin e Konventës.

Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, me vetëdije për të promovuar të drejtat e njeriut, trafikimi i njerëzve fitoi më shumë vetëdije. Një shembull për këtë është Konventa e Kombeve të Bashkuara e vitit 1949, e cila i unifikoi të gjitha traktatet e mëparshme nën Ligën e Kombeve, në një traktat të vetëm “Konventa për Parandalimin e Trafikut të personave dhe të shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve”.<sup>11</sup>

Konventa në preambulën e vetë dënon:

*“...Prostitucionin dhe ligësinë e trafikimit me persona që e shoqëron atë me qëllim të prostitucionit janë të papajtueshëm me dinjitetin dhe vlerën e qenies njerëzore dhe e rrezikojnë mirëqenien e individit, të familjes dhe të bashkësisë...”*

Konventa e vitit 1949 kërkoi zhdukjen e shtëpive publike, ku ushtrohej prostitucioni, si dhe çdo gjë që e shoqëronte atë. Por ishte një përpjekje që nuk pati efekt për ndalimin e prostitucionit, pasi ajo nuk pati shumë ndikim në zhdukjen e prostitucionit por u kthye në një shtysë për inkriminimin e këtyre shërbimeve. Në praktikë rezultatet mbeten shumë të diskutueshme në nivel kombëtar, sepse shtetet shfaqën mungesë vullneti për t'u marrë me këtë çështje.

Megjithatë një ndryshim shohim kohët e fundit, ku bashkësia ndërkombëtare në mënyrë aktive filloi të punojë në çështjen e luftimit të kësaj forme të krimit të organizuar. Kombet e Bashkuara, Këshilli i Evropës, OSBE-ja, ASIAN-i dhe BE-ja dhe disa organizata të tjera, u përfshinë në shqyrtimin e çështjes në planin global. Bashkësia ndërkombëtare ndërmori disa hapa të rëndësishëm në luftën kundër trafikimit të femrave në mbarë Paktin e Stabilitetit.

Në Dhjetor të vitit 1998, Asambleja e Përgjithshme e OKB-se formoi një Komitet *Ad-Hoc* që duhej të merrej me përpunimin e Konventës kundër krimit të organizuar ndërkombëtar.

Këtu, u hartuan tre Protokolle:

---

<sup>11</sup> “Konventa për Parandalimin e Trafikut me persona dhe të shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve” OKB, 1949.

- Për parandalimin e tregtisë së grave dhe fëmijëve.
- Kundër tregtisë jolegale dhe transportit të emigrantëve.
- Kundër prodhimit dhe trafikimit të armëve të zjarrit.

Pas lidhjes fillestare me të drejtat e njeriut, Kombet e Bashkuara pranuan se me qëllim të trajtimit të këtij problemi me efektshmëri, ai duhej ndërlidhur me krimin e organizuar. Në Korrik të vitit 2000 u hartua Konventa dhe po në të njëjtin vit më vonë u hartua dhe Protokollin, për parandalimin e tregtisë së grave dhe fëmijëve dhe kundër tregtisë ilegale dhe transportimit të emigrantëve.

Në Nëntor të vitit 2001, Kombet e Bashkuara miratuan Konventën kundër Krimit të Organizuar Transnacional dhe Protokollin e tij shtesë për Parandalimin, Ndalimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave sidomos në gra dhe fëmijë. Neni 3 i Protokollit thotë:

*“...trafikimi në njerëz përfshin rekrutimin, transportimin, fshehjen dhe pranimin e individëve përmes kërcënimit, forcës apo përdorimit të formave të tjera të detyrimit apo mënyrave të tjera të dhunës, rrëmbimit, mashtrimit me anë të autoritetit apo pozitës në punë, bërja e fitimit me qëllim të arritjes së marrëveshjes me një person të ngarkuar për njerëzit e trafikuar”.*

Këtu iu dha një kuptim më i gjerë trafikimit dhe u futën shumë elementë si: rekrutimi, kërcënimi, mashtrimi, rrëmbimi, dhunimi, etj. Këto i dhanë formë luftimit të këtij fenomeni duke e forcuar më shumë këtë luftë kundër trafikimit, për rrjedhojë dhe minimizimin e tij. Ky Protokoll pati shumë sukses sidomos me faktin se nuk bëri dallim midis trafikimit të brendshëm dhe atij transnacional. Edhe pse pati shumë sukses dhe bëri një hap shumë të rëndësishëm para drejt njohjes së aspekteve komplekse, duhet theksuar se fenomeni i trafikimit radhitet akoma ndër bizneset ilegale me fitimprurëse në të gjithë botën.

Instrumenti më i fundit ligjor për luftimin e trafikimit të femrave është Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Konventa e Këshillit të Evropës u miratua nga Komiteti i Ministrave në 3 Maj 2005 dhe u hap për nënshkrim në Varshavë më 16 Maj 2005.

## 1.2. Sfondi historik i trafikimit në Shqipëri.

Në studimet e disa autorëve shqiptarë është pohuar se në Shqipëri trafikimi për qëllim prostitucioni apo forma të tjera shfrytëzimi për përfitim material “nuk ka histori”. Të paktën ai nuk është kurrsesi një fenomen tipik shqiptar<sup>12</sup>. Nuk rezulton që ky fenomen të ketë patur përhapje të krahasueshme me shumë vende të tjera europiane, siç është për shembull, Greqia apo Italia fqinje, vende të tjera mesdhetare, Anglia etj., në të cilat trafikimi, sidomos ai i femrave, ka lulëzuar në çdo fazë të qytetërimit të tyre. Të paktën trafikimi nuk përmendet në librat mbi historinë e Shqipërisë, në të drejtën zakonore të shqiptarëve, në libra kronikash, gjeografësh, albanologësh, në folklorin shqiptar etj. Ky përjashtim lidhet, para se gjithash, me njëfarë puritanizmi karakteristik, përgjithësisht me jetën tradicionale të shqiptarëve, jetën e mbyllur e familjen e mbyllur patriarkale, në të cilën gjithçka, përfshirë edhe jeta seksuale e pjestarëve të saj, ishte rreptësisht e koduar dhe e kontrolluar.

Shqipëria, përgjithësisht, nuk ka prodhuar të tilla dukuri “së brendëshmi”<sup>13</sup>. Megjithatë, Shqipëria ka qenë në udhëkryqe historike e gjeografike dhe është populluar nga pushtues të kulturave të ndryshme; kristiano-romake, turko-islame, austro-hungareze, sllavo-bullgare apo sllavo-malazeze, greke, italiane, gjermane etj. Rruga “Egnatia”, për shembull, që përshkon Shqipërinë, mbart një histori mbi 23 shekulle dhe siç është logjike apo edhe siç theksohet në burime të ndryshme, përgjatë saj ka patur motele e hane në të cilat edhe seksi është ofruar si shërbim. Pohohet madje, se në hanet e udhëtarëve këtë prostitucion e kanë ushtruar kryesisht vajza jetime, të cilat e bënin këtë shërbim veç punës së tyre. Por ato mund të kenë qenë edhe objekt trafikimi, në kuptimin që ka marrë sot kjo fjalë. Shqipëria ka qenë, madje për shumë kohë, arenë luftrash të të tjerëve apo një vend i pushtuar, megjithatë shqiptarët kanë ruajtur identitetin e tyre, gjuhën, zakonet, kodin e tyre etiko-moral etj. Falë imunitetit kulturor të shqiptarëve dhe paraardhësve të tyre, pushtimet nuk kanë lënë gjurmë të qenësishme, megjithë ndikimin e pamohueshëm. Këtë pohim e gjejmë edhe lidhur me pushtimin pesëshekullor osman. Por kjo periudhë, edhe për sa i perket trafikimit të grave, nuk ka kaluar pa lënë gjurmë. Në forma të ndryshme është pohuar se ka patur njerëz, të

---

<sup>12</sup>Per me tej shih, Lekë Sokoli, 2005. *Prostitucioni profesionist në Shqipëri dhe debatet rreth (keq) vlerësimit ‘prostitucioni është një fenomen tipik shqiptar’*. Revista “Të drejtat e njeriut”. Nr. 2(42), fq. 55-72.

<sup>13</sup> Lekë Sokoli, Ilir Gërdeshi, “*Trafikimi Rasti i Shqipërisë*”, Tiranë, 2006, fq. 21.

vlerësuar si të “degjeneruar”, që trafikonin gra dhe vajza të reja shqiptare apo i bënë ato “dhuratë” për haremet e Stambollit.

Nuk vërtetohet që trafikimi i grave dhe vajzave adoleshenteve të ketë ekzistuar si fenomen as në gjysmen e parë të shek. XX, kohë në të cilën vërtetohet përhapja e prostitucionit në Shqipëri, madje edhe legalizimi i tij (vitet 1920-1944), në atë kohë e vlerësuar si masë për ruajtjen e shëndetit dhe moralit publik.<sup>14</sup> Lidhur me këtë çështje ka patur disa hulumtime, kryesisht arkivore, dhe nga dokumentacioni i arkivuar, del se në Shqipërinë e kësaj periudhe, tregu legal i prostitucionit plotësohej vetëm ose kryesisht nga prostituta “vullnetare”. Pra, nuk njihej trafikimi i grave dhe vajzave për shfrytëzim seksual apo qëllime të tjera fitimprurëse. Një gjë e tillë konfirmohet edhe nga burime zyrtare.

Në një letërkëmbim të Ministrit të Punëve të Brendshme, të datës 11.09.1935, thuhet:

*“Kam nderin t’ju parashtroj se, në Shqipëri, nuk ekziston tregëtia e të bardhëve, qoftë për gra ose për djem”.*

Për më tepër, në Tetor 1937, Shqipëria ka aderuar edhe në Konventen Ndërkombëtare për Zhdukjen e Tregtisë së Grave dhe Fëmijëve.

Krejt ndryshe nga çfarë ndodh sot, edhe kahja e lëvizjes së prostitutave të asaj kohe ishte “nga jashtë-brenda” dhe jo e kundërta. Pra, tregu shqiptar i prostitucionit plotësohej edhe nga femra të huaja. Por as ato nuk rezultojnë të kenë qenë të trafikuar, por vullnetare. Kështu, në një urdhër të Ministrit të Punëve të Brendshme, më 20 Korrik 1936, thuhet:

*“Kemi konstatuar se kohët e fundit një numër grash të huaja kanë ardhur në vendin tonë me pasaporta të rregullta, me viza të përfaqësive tona diplomatike, të cilësime si turistë. Këto gra, më shumë greke e hungareze, në realitet nuk janë turistë, por prostituta dhe vijnë në Shqipëri për të ushtruar profesionin e kurvërisë”.*

Më tej, vendosja e regjimit komunist në Shqipëri, i dha fund epokës së prostitucionit profesionist të krijuar deri në atë kohë. Gjithashtu, ai nuk lejoi kurrëfarë trafikimi të grave, adoleshenteve apo përgjithësisht, të qenieve njerëzore. Madje edhe lufta kundër këtij lloj trafikimi që konsiderohej si “plagë e kapitalizimit”, vlerësohej si pjesë e luftës së klasave, ndërsa të trafikuarit, të droguarit, prostitutat etj., konsideroheshin si “të hedhurit tej të shoqërisë”. Regjimi komunist e evitoi trafikimin “me mënyrën e vet”,

---

<sup>14</sup> Ibid.

madje pa patur ndonjë ligj antitrafik. Këtë e pohon edhe akademiku Luan Omari, i cili thotë:

*“Para viteve 1990, në Shqipëri nuk njihej koncepti i trafikantëve dhe i trafikimit dhe Kodi Penal parashikonte të dënohej, madje ashpër, vetëm ushtrimi i prostitucionit”.*

Në Shqipëri trafikimi i grave dhe adoleshenteve filloi pas vitit 1990, në kushtet e mungesës së një “ligji antitrafik”. Gjatë viteve 1992-1995, pothuajse mungonte legjislacioni për trafikimin e qenieve njerëzore. Në vitin 1995 hyn në fuqi Kodi i ri Penal, por edhe ai nuk e specifikon trafikun e qenieve njerëzore si figurë të veçantë të veprës penale. Vetëm në Janar 2001 miratohet Ligji nr.8733, date 24.1.2001 “Per disa shtesa e ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton si vepra penale të veçanta trafikimin e qenieve njerëzore, trafikimin e femrave për shfrytëzim për prostitucion si dhe trafikimin e fëmijëve me qëllim abuzimi e përfitimi.

Për nga sanksionet që parashikon ligjvënësi, këto krime konsiderohen vepra penale të rënda, edhe nëse nuk sjellin pasoja të rënda për shëndetin. Për autorët parashikohen gjithashtu dënime të rënda që variojnë nga 5 deri në 20 vjet burgim, ndërsa kur kanë ardhur pasoja, si vdekja e personit të trafikuar, dënimi jepet me burgim të përjetshëm.

Në Shkurt 2004, u miratuan disa amendamente të Kodit Penal. Kuptohet që, deri në reagimin e shtetit shqiptar u desh shumë kohë. Kjo kohë ishte e mjaftueshme për trafikantët dhe rrjedhimisht trafikimi mori përmasa të mëdha. Nga ky parashtrim del se trafikimi i njerëzve nuk lidhet aq me faktorë historikë e të traditës, me psikologjine sociale dhe vetjake të shqiptarëve apo me karakterin e temperamentin e tyre.

Dukuritë e reja sociale të tranzicionit postkomunist shqiptar duhen parë si dukuri të lidhura jo me komunitetet e vogla e jetën tradicionale, por përkundrazi, me shembjen e këtyre komuniteteve dhe komercializmin e marrëdhënieve shoqërore. Me disa përjashtime, thuajse e njëjta tablo historike vërtetohet edhe në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Aktualisht, krahas fenomeneve të reja të vërejtura pas viteve 1990, trafikimi mbetet një nga më shqetësueset, ku forca e shtetit ende është e dobët. Për shkak të natyrës komplekse të kësaj dukurie, të fshehtësisë në kryerjen e saj dhe të mungesës së një

informacioni të plotë, është e vështirë identifikimi i përmasave të vërteta të këtij trafiku dhe njohja e saktë e numrit të personave të trafikuar.

### **1.3. Kuptimi i trafikimit të qenieve njerëzore.**

Trafikimi i qenieve njerëzore është një krim i tmerrshëm dhe një shkelje brutale e të Drejtave të Njeriut që zhvillohet ose përmes një rrjeti të krimit të organizuar apo individualisht<sup>15</sup>. Serioziteti i këtij krimi ka pasojë në masën që kordinimi midis vendeve dhe organizatave të ndryshme është i domosdoshëm në mënyrë që ta adresojë atë në mënyrë efektive.

Trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen gjerësisht kompleks transnacional i shkaktuar nga varfëria, mungesa e kulturës demokratike, pabarazia gjinore dhe dhuna kundër grave, konflikti dhe situatat post-konfliktuale, mungesa e integritit social, mundësisë dhe punësimit, qasjes në arsim, të punës së fëmijëve dhe diskriminimit<sup>16</sup>.

Trafikimi i qenieve njerëzore mund të kryhet për qëllime të ndryshme shfrytëzuese. Viktimat në fakt mund të trafikohen për t'u shfrytëzuar në industrinë e seksit, sektorë të ndryshëm të punës (p.sh. ndërtim, bujqësi, puna në amvisëri, etj), lypjen e detyruar, aktivitetet kriminale të detyruara, martesën e detyruar, heqjen e organeve, etj.

Të dhënat mbi trafikimin e qenieve njerëzore janë të shpërndara dhe shpesh në shumë vende nuk janë në dispozicion. Megjithatë, vlerësimet janë zhvilluar nga disa organizata ndërkombëtare. Sipas shifrave të fundit, Organizata Ndërkombëtare e Punës vlerëson se 20.9 milion njerëz (rreth 3 nga 1.000 persona) janë viktimat të punës së detyruar në nivelin global, nga të cilët 5.5 milion janë fëmijë<sup>17</sup>. Sa i përket sektorëve të shfrytëzimit, ONP vlerëson se 18.7 milion (90%) eksploatohen në ekonominë private nga individë apo ndërmarrje; 4.5 milion (22% nga totali) janë viktimat të shfrytëzimit të detyruar seksual; dhe 14.2 milion (68%) janë viktimat që shfrytëzohen për punë të detyruar, në aktivitete ekonomike të tilla si bujqësia, ndërtimtaria, puna në amvisëri dhe prodhimtaria. 2.2 milion të mbetur (10%) i nënshtrohen formave të punës së detyruar të

---

<sup>15</sup> Shih "Strategjia e BE-së në drejtim të ç'rrënjosjes së Trafikimit të qenieve njerëzore 2012-2016", Qershor 2012, fq. 2.

<sup>16</sup> "Strategjia e BE-së në drejtim të ç'rrënjosjes së Trafikimit të qenieve njerëzore 2012-2016", Qershor 2012, fq.3.

<sup>17</sup> ONP argumenton se Trafikimi i qenieve njerëzore mund të konsiderohet si punë e detyruar, dhe kështu ky vlerësim do të përfshinte botën e plotë të trafikimit të qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual dhe punë. Shih Organizata Ndërkombëtare e Punës, "Vlerësimi global i punës së detyruar nga ONP-ja 2012", Qershor 2012, fq. 13.

imponuara nga shteti, për shembull në burgje nën kushte të cilat bien në kundërshtim me standardet e ONP-së mbi këtë temë, apo të punës së imponuar nga ushtria shtetërore ose nga forcat e armatosura kryengritëse.<sup>18</sup>

Sipas raportit të ZKBNK të vitit 2010, 79 për qind e viktimave të identifikuara të trafikimit të qenieve njerëzore në mbarë botën kanë qenë objekt i shfrytëzimit seksual, 18 për qind të punës së detyruar dhe 3 për qind të formave të tjera të shfrytëzimit. Prej këtyre viktimave, 66 për qind ishin gra, 13 për qind vajza, 12 për qind meshkuj dhe 9 për qind djem.<sup>19</sup>

Bazuar në të dhënat e mbledhura në Shtator të vitit 2011 nga Komisioni Evropian për periudhën 2008-2010,<sup>20</sup> “gratë dhe vajzat janë viktimat kryesore të trafikimit të qenieve njerëzore, viktimat femra përbënin 79 për qind (prej të cilave 12 për qind ishin vajza) dhe viktimat meshkuj përbënin 21 për qind (nga të cilët 3 për qind ishin djem).” Për më tepër, viktimat më së shpeshti të raportuara nga BE-ja kryesisht kanë qenë nga Rumania, Bullgaria, Polonia dhe Hungaria, ndërsa viktimat jashtë BE-së ishin nga Nigeria, Vietnami, Ukraina, Rusia dhe Kina.<sup>21</sup>

*Shqipëria është burim trafiku për për burra, gra dhe fëmijë, të cilët shfrytëzohen për qëllime seksuale dhe për punë të detyruar.* Kështu theksohet në raportin vjetor të trafikut njerëzor për vitin 2013 të Departamentit Amerikan të Shtetit, i cili thekson se viktimat nga trafiku i nënshtrohen trafikimit për qëllime shfrytëzimi seksual brenda Shqipërisë si dhe në Greqi, Itali, Maqedoni, Kosovë, Belgjikë, Hollandë, Gjermani, Zvicër, Irlandë dhe në Britaninë e Madhe.<sup>22</sup>

Pas këtij prezantimi mbi gjendjen aktuale të këtij lloj kriminaliteti në nivel global, më poshtë po fokusohemi në përkufizimet e “trafikimit të qenieve njerëzore” sipas disa konventave ndërkombëtare si dhe në përcaktimet bazë të “trafikantit” dhe “personit të trafikuar”.

Përcaktimi ndërkombëtar i të drejtave të njeriut do të thotë se megjithëse pozita juridike e popullsisë rregullohet nga legjislacioni i brendshëm i shtetit, parashikohet dhe është vendosur njëfarë bashkëpunimi midis shteteve me qëllim që të zhvillohen e të

---

<sup>18</sup> Po aty.

<sup>19</sup> Globalizimi i krimit: *Vlerësim i kërcënimit nga krimi i organizuar transnacional*, ZKBNK, 2010, fq. 40.

<sup>20</sup> Statistikat në dispozicion të grumbulluara përmes Eurostat-it ofrojnë një pasqyrë paraprake të përgjithshme bazuar në përgjigjet e marra nga të gjitha 27 shtetet anëtare.

<sup>21</sup> Shih "*Strategjia e BE-së në drejtim të çrrënjësjes së Trafikimit të qenieve njerëzore 2012-2016*", qershor 2012, fq. 2-3.

<sup>22</sup> Për më tej shih Raporti "*Trafiku i Personave 2013*" Departamenti i Shtetit Sh. B. A.



respektohen kudo disa të drejta themelore politike, ekonomike e civile të njeriut, pavarësisht nga vendi ku banojnë dhe nga shteti të cilit i përkasin. Këtë detyrë e ka marrë përsipër Organizata e Kombeve të Bashkuara. Në kartën e O.K.B-së thuhet se ajo ka për qëllim që të realizojë bashkëpunimin ndërkombëtar në drejtim të nxitjes e të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë njerëzit kudo që janë dhe pa asnjë dallim.<sup>23</sup>

Në trajtimin e kuptimit të trafikimit të qenieve njerëzore, deri kohët e fundit, ka munguar një përkufizim universal dhe me detyrim ligjor në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, por kjo situatë ka ndryshuar me botimin e Protokollit të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin, Shtypjen dhe Dënimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht të Grave dhe të Fëmijëve, duke plotësuar Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Trans-Nacional.

Kjo konventë e quajtur zakonisht “Protokollit i Palermos” ka formuluar një përkufizim definitiv ndërkombëtar për krimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

*“Me trafikim personash do të kuptohet rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës, ose formave të tjera të detyrimit, të rrëmbimit, të dredhisë, të mashtrimit, të abuzimit të pushtetit, ose të një pozite vulnerabiliteti (lehtësisht e cënueshme), ose i dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi, duke pasur kontrollin mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin në minimum, shfrytëzimin e të tjerëve për prostitucion, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, zgjedhe apo heqje organesh.”<sup>24</sup>*

Përkufizimi progresiv, modern i dhënë në Protokollin e Trafikimit ka shumë aspekte pozitive që reflektojnë realitetin e trafikimit të kohëve moderne, të pasqyruara si vijon:

- a. Ky përkufizim njeh të gjitha format e trafikimit dhe nuk e kufizon trafikimin vetëm në shërbimet seksuale. Ai fokusohet në kushtet e punës së detyruar, zgjedhjes, praktikave skllavëruese dhe skllavërisë, që janë të përcaktuara në ligjin ndërkombëtar.
- b. Nuk fokusohet vetëm tek vajzat dhe gratë në mënyrë ekskluzive, por thekson se gratë, burrat, vajzat, dhe djemtë mund të jenë të gjithë viktimat.
- c. Nuk kërkon që viktimat të kalojnë ndonjë kufi ndërkombëtarë të përcaktuar, duke marrë parasysh që personat trafikohen gjithashtu edhe nga një zonë në tjetrën, brenda të njëjtit vend.

<sup>23</sup> A. Puto, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, pjesa II. Tiranë 1986, fq. 2.

<sup>24</sup> Neni 3 i *Protokollit të OKB-së për Trafikimin*, nënshkruar me 15 dhjetor 2000 në Palermo të Italisë dhe ratifikuar me 11 Korrik 2002 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

d. Protokolli dënon forma të shtrëmbërimit të vullnetit të lirë të viktimës, p.sh. përdorimi i forcës, mashtrimi ose abuzimi me pushtetin, me qëllim për të respektuar kështu aftësinë e personave të rritur për të marrë vetë vendime për jetën e tyre, veçanërisht në lidhje me zgjedhjet për punën dhe emigracionin.

Përveç përkufizimit të bërë në Protokollin e Palermos, ekzistojnë edhe përkufizime nga organizata të tjera ndërkombëtare, të cilat janë të dobishme në raste të caktuara.

Sipas Konventës së EUROPOL-it trafikimi i qenieve njerëzore do të thotë nënshtrimi i një personi ndaj një pushteti real dhe të paligjshëm të personave të tjerë duke ushtruar dhunën ose kërcenimet, ose me anë të abuzimit me autoritetin ose me anë të intrigës me qëllim shfrytëzimi për prostitucion, të formave të tjera të shfrytëzimit seksual dhe të sulmeve mbi të miturit ose tregtimit të fëmijëve të braktisur.<sup>25</sup>

Ndërkaq sipas Këshillit të Evropës, trafikimi i grave përfshin:<sup>26</sup>

*“Trafikimi i grave dhe prostitucioni me dhunë, si çdo transportim legal apo ilegal i grave me ose pa dëshirën e tyre fillestare, për qëllime të fitimeve materiale, me qëllim nënshtrimin e mëvonshëm për prostituim, martesë të detyruar, ose për forma të tjera të shfrytëzimit seksual të detyruar. Përdorimi i dhunës mund të jetë fizik, seksual, psikologjik dhe përfshin frikësimin dhe abuzimin e autoritetit ose të një situatë varësie.”*

Kurse përkufizimi i trafikimit të qenieve njerëzore sipas BE-së, mbështetet në këto pika:<sup>27</sup>

*“Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e një personi, përfshi shkëmbimin/transferimin e kontrollit mbi atë person, kur:*

*(a) Përdoren masa detyruese, forca ose kërcënimi, përfshi rrëmbimin, ose*

*(b) Përdoret mashtrimi, ose*

*(c) Abuzohet me pozitën ose me situatën e dobësisë së personit, e tillë që për atë person nuk ekzistojnë alternativa të tjera të pranueshme, përveçse t'i nënshtrohet abuzimit, ose*

*(d) Jepen ose merren pagesa/përfitime për të arritur pëlqimin/lejen e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër.*

*Për qëllimin e shfrytëzimit të punës ose shërbimeve të personit, përfshi të paktën punën/shërbimet e detyruara/të detyrueshme, skllavërinë ose praktika të ngjashme me të, ose*

<sup>25</sup> Aneksi të cilit i referohet Neni 2 i Konventës së Europolit. *“Akti i Këshillit që parashkruan mbi Konventën bazuar në nenin K.3 të Traktatit Bashkimit Europian, mbi Hapjen e një Zyre të Policisë Europiane”*, Korrik 1995.

<sup>26</sup> Këshilli i Europës; *Rekomandimi 1325 (1997) mbi trafikun e grave dhe prostitucionin e detyruar në Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës*. Shqipëria u bë anëtare e Këshillit të Europës me 13 Korrik 1995 dhe me 2 tetor 1996 ajo bëri depozitimin e instrumentave të ratifikimit të Konventës së Këshillit të Europës mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të vitit 1950. Ky instrument mjaft i rëndësishëm i së drejtës ndërkombëtare, i cili është i detyrueshëm për të gjitha shtetet anëtare, përfaqëson hapat e parë të zbatimit të përbashkët të të drejtave të shprehura në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Këto të drejta janë parashikuar në Seksionin 1 të Konventës (nenet 2-18) dhe në Protokollet Shtesë.

<sup>27</sup> Neni 1 i Vendimi në Kuadër të Këshillit, i 19 Korrikut 2002 mbi *“Luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore”* (OJL 203, 1/8/02, p.1-4).

*Për qëllimin e shfrytëzimit të prostitucionit të tjerëve, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, përfshi pornografinë.”*

Direktiva e BE 2011/36/EU e definojnë trafikimin si “rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave, duke përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi atë person, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të detyrimit, të rrëmbimit, mashtrimit, të abuzimit të pushtetit ose të një pozite të ndjeshme ose i dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime të shfrytëzimit”.<sup>28</sup>

Në vijim të përkufizimit të “trafikimit”, më poshtë jepen përkufizimet përkatëse të termave “trafikant”, “person i trafikuar”, si dhe “viktimë”.

**“Trafikant”** është:

*“Një person ose një bashkësi personash, që kanë për qëllim të kryejnë, të bashkëpunojnë apo të japin pëlqimin për ç’do një nga aktet që përshkruhen në trafikim” (Aleanca Globale Kundër Trafikeve të Grave - GAATË, Standartet e të Drejtave të Njeriut për Trajtimin e Personave të Trafikuar, Janar 1999).*

Një **“person i trafikuar”** është:

*“Një person që është rekrutuar, transportuar, shitur, blerë, transferuar, pritur ose strehuar, siç përshkruhet në përkufizimin e trafikimit, duke përfshirë edhe një fëmijë, pavarësisht nëse fëmija ka pranuar ose jo.”<sup>29</sup>*

**“Viktima”** janë:

Deklarata e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit me Pushtetin jep një katalog që përshkruan parimet bazë për viktimat e krimit, përsa i përket të drejtës për drejtësi dhe trajtim të drejtë, rikthim, kompensim dhe asistencë. Kjo Deklaratë u miratua me konsensus në Asamblenë e Përgjithshme në vitin 1985, duke reflektuar kështu vullnetin kolektiv të komunitetit ndërkombëtar për të vendosur balancën ndërmjet të drejtave themelore të të dyshuarve, të keqbërësve dhe të drejtat dhe interesat e viktimave. Ajo bazohet në filozofinë që viktima duhet të dallohet në

---

<sup>28</sup>Shih Direktivën e BE-së 2011/36/EU, Neni 2, fq.5.

<sup>29</sup> Aleanca Globale Kundër Trafikimit të Grave; GAATW, Standartet e të Drejtave të Njeriut për Trajtimin e Personave të Trafikuar. Janar 1999.

mënyrë të saktë dhe të trajtohet me respekt për dinjitetin e tyre. Deklarata e përkufizon viktimën si më poshtë:

*“Personat, që në mënyrë individuale ose kolektive, kanë vuajtur dëme, duke përfshirë dëmtime mendore apo fizike, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose një shkelje të rëndë të të drejtave të tyre bazë, përmes veprimeve ose mosveprimeve që janë në kundërshtim me ligjet në fuqi të Shteteve Anëtare, duke përfshirë edhe ato ligje që ndalojnë abuzimin kriminal me pushtetin”.*

Ky përkufizim, gjithashtu, përfshin personat e trafikuar që shpesh vuajnë të gjitha pasojat e përmendura më lart. Një person mund të konsiderohet viktimë sipas kësaj deklarate, pavarësisht nëse autori është identifikuar, kapur, proceduar penalisht apo dënuar. Aty ku është i duhur, termi “viktimë” përfshin gjithashtu anëtarët direkt të familjes ose të varurit nga viktima, si dhe “personat që kanë vuajtur dëme në ndërhyrjen për të asistuar viktimat në dëshpërim, apo për të parandaluar viktimizimin”, të tilla si Organizata, punonjës socialë, etj. Klauzolat përbërëse duhet të jenë të aplikueshme për të gjithë personat, pa dallime të ndonjë lloji, të tilla si race, ngjyrë, gjini, gjuhë, kombësi, lindje apo status familjar, origjinë etnike apo sociale.

#### **1.4. Fazat e procesit të trafikimit të qenieve njerëzore.**

##### **Faza I: Rekrutimi i viktimave.**

Faza e parë e procesit të trafikimit është “faza e rekrutimit”<sup>30</sup> gjatë së cilës trafikuesit vendosin në shënjestër dhe tërheqin viktimat e mundshme me qëllim që t’i përfshijnë ato në skemën e trafikimit. Termi “rekrutim” merret në një kuptim të gjërë dhe i referohet faktit që viktimat rekrutohen ose rrëmbehen për qëllimet e shfrytëzimit seksual apo për lloje të tjera të shfrytëzimit nëpërmjet rrëmbimit, detyrimit me forcë, mashtrimit dhe gënjeshtërisë.

Trafikimi i grave është një nga format me të egra të dhunës ndaj grave.<sup>31</sup> Metodatat e rrëmbimit të grave dhe të vajzave nga trafikantët janë të ndryshme dhe varen nga mënyra e veprimit dhe niveli i organizimit të trafikantëve. Ato mund të jenë duke filluar

---

<sup>30</sup>Një situatë mashtrimi është konstatuar dhe në procedimin penal nr.190 të vitit 2005 të Prokurorisë së Sarandës në ngarkim të F.D. e N.K. ku i pari, pasi ka krijuar lidhje dashurore me të dëmtuarën E.SH. e ka mashtruar atë për martesë dhe një jetesë më të mirë në Itali ku më pas, nëpërmjet dhunës e presionit psikologjik të dy e kanë detyruar të ushtrojë prostitucion.

<sup>31</sup> Konferenca “Parandalimi dhe Luftimi i Dhunës ndaj Gruas”, organizuar nga OSBE në Vjenë të Austrisë, Mars 2002.

që nga rekrutë individuale që kërkojnë të gjejnë meshkuj apo femra të interesuara nëpër bare, kafene, klube dhe diskoteka, deri në rekrutim nëpërmjet rrjeteve ndërlidhëse jo formale midis familjesh apo miqsh. Njoftimet në media që ofrojnë punë apo studime jashtë shtetit, gjithashtu janë metoda që përdoren gjerësisht.

Dallojmë katër mjetet bazë të rekrutimit, që janë:

1. Nëpërmjet një detyrimi të plotë, të marrjes me forcë ose rrëmbimit. Kjo mënyrë nuk është më e pazakontë, dhe për të ka gjithmonë e më shumë prova në Shqipëri dhe në Kosovë.<sup>32</sup> Si formë ndeshet gjithashtu edhe në disa pjesë të Azisë. Një mënyrë tjetër e marrjes së viktimave është edhe shitja e një personi (më së shumti e një fëmije) nga dikush që ka kontroll mbi të, ku rasti tipik do të ishte ai i prindërve apo jetimoreve.
2. Nëpërmjet mashtrimit me anë të premtimeve për një punë të ligjshme. Gratë besojnë se ato do të punojnë nëpër zyra, restorante, bare, apo se duke hyrë në një vend të huaj do të mundin të lidhin martesë.
3. Nëpërmjet mashtrimit me anë gjysmë të vertetash, si p.sh. se do të punësohen në lokale dëfrimi, kërcimi, madje edhe striptizi.
4. Duke mos qenë plotësisht të ndërgjegjshme. Kjo do të thotë se përpos faktit që ato e dinë që po migrojnë për qëllimin e prostitucionit, ato nuk e kuptojnë se në çfarë mase do të hyjnë në detyrim, se sa do të kërcënohen, shfrytëzohen dhe kontrollohen.

Shumë shpesh trafikantët i piketojnë dhe e fitojnë kontrollin mbi viktimat e tyre nëpërmjet trillimeve për një jetë më të mirë në një vend tjetër. Grave u bëhen oferta për ç'ka tingëllon si karriera fitimprurëse. Agjencitë ndërkombëtare të martesave mund të përdoren, gjithashtu si mbulese për bizneset e trafikimit. Grave të trafikuar u premtohet se do të udhëtojnë në një vend të pasur perëndimor, do të fitojnë shumë para në një kohë shumë të shkurter, të cilat ato mund t'i përdorin për të shpëtuar veten dhe familjen e tyre nga varfëria dhe dëshpërimi. Një nga joshjet më të forta për gratë e reja që vijnë nga Europa Qendrore dhe Lindore është premtimi për një shtëpi të veten, gjë që në sytë e tyre përfaqëson një shkallë pavarësie që nuk do t'u shkonte nëpër mend sikur të ishin në vendin e tyre. Në shumë raste, tregimet e gënjeshtërtja janë akoma më të besueshme për gruan, sepse trafikuesi apo rekrutuesi është i njohur për familjen, madje shumë shpesh është edhe njeriu i familjes. Në shumë raste, këto gra vetëm kur arrijnë në vendin e

---

<sup>32</sup> Grup autorësh, "Procedurat Investigative Policore Shqiptare mbi Trafikimin e Qenieve njerëzore", botuar nga IOM, Tiranë 2002, fq.11.

destinacionit e kuptojnë natyrën mashtruese të marrëveshjes që kanë bërë me trafikantin, dhe e gjejnë veten të shfrytëzuara forcërisht si prostituta.

Sipas një vlerësimi të bërë, rezulton se më shumë se një e katërta e grave të rekrutuara e dinë që më parë se ato do të punojnë jashtë shtetit në industrinë e seksit.<sup>33</sup> Megjithatë, këto gra gënjehen në lidhje me çfarë i pret kur mbërrijnë në vend dhe kushtet e punës ku atyre do t'u kërkohet të punojnë e që kanë të bëjnë me pasaporta dhe dokumentet e identifikimit të konfiskuara, shërbime të pambrojtura seksuale që do t'u kërkohet të ofrojnë dhe nivelin e detyrimit që do të ushtrohet mbi to, në rast se refuzojnë ose kërkojnë të largohen nga këto rrethana.

## **Faza II: Transportimi dhe transferimi.**

Drejtimi origjinal i prirjes së trafikimit ka qënë që viktimat trafikoheshin<sup>34</sup> nga vendet e varfra të origjinës drejt vendeve më të pasura të destinacionit në hemisferën perëndimore. Megjithatë, kjo situatë ndryshon vazhdimisht, në varësi të evolimit të vendit të parë të origjinës apo të vendeve tranzit dhe përmirësimit të rrethanave të tyre për t'u shndërruar në vende pritëse.

Prirja me shqetësuese, siç tashmë e kemi shprehur, është ulja e moshës mesatare të viktimave të krimit të trafikimit në shumë vende, prirje kjo që çon drejt rritjes së fëmijëve viktimë. Trafikantët po përdorin për prostitucion fëmijë gjithmonë e më të vegjël, sepse klientët besojnë që seksi me fëmijë pakëson rrezikun e marrjes së sëmundjeve seksualisht të transmetueshme.

Një prirje e kohëve të fundit është edhe hasja më e shpeshtë e trafikimit të brendshëm, domethënë, e trafikimit të qenieve njerëzore për qëllimet e shfrytëzimit brenda territorit të të njëjtit shtet.

Proçesi i rekrutimit pasohet nga fazat e transportimit dhe të transferimit, të cilat mund të nënkuptojnë strehimin dhe pritjen e viktimës nëpër një numër pikash gjatë gjithë procesit, duke përfshirë pritjen e parë dhe transferimin e viktimës brenda vendit të saj të

---

<sup>33</sup> Revista "Ligji mundësi zhvillimi për Gratë", Tiranë, 2005, fq.24 .

<sup>34</sup> Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnje me datë 30.04.2011 ka bërë regjistrimin e procedimit penal nr. 125 viti 2011 në ngarkim të shtetasve A. e A. B. për veprën penale "Trafikimi i femrave" në bashkëpunim, parashikuar nga neni 114/b-3 i Kodit Penal, ku sipas këtij materiali rezulton se me datë 29.04.2011 është paraqitur pranë policisë gjyqësore shtetasia V. S. e cila ka kallëzuar penalisht shtetasit A. B. e A.B., duke i akuzuar këto shtetas se me anë të mashtrimit kanë arritur ta rekrutojnë e më pas ta dërgojnë atë me qëllim shfrytëzimin e saj si prostitutë në Itali, e më pas në Austri.

originës. Ajo mund t'i nënshtrohet abuzimeve të rënda të të drejtave të saj humane dhe abuzimeve fizike gjatë udhëtimit.<sup>35</sup> Trafikimi nuk nënkupton zhvendosjen e viktimës domosdoshmërisht përtej kufijve ndërkombëtarë. Trafikantët i zhvendosin viktimat e tyre për t'i larguar nga komunitetet e tyre, larg familjeve dhe miqve me të cilët ato janë afër, dhe i izolojnë në një vend i cili mundëson të fitojnë dhe të ruajnë sa më të fortë që të jetë e mundur kontrollin e tyre mbi viktimat.

Transportimi i grave dhe vajzave jashtë kufijve është një aspekt thelbësor i trafikimit ndërkombëtar. Në pjesën më të madhe të rasteve, të rekrutuarit bien dakort me trafikuesit në lidhje me sigurimin e dokumentave dhe transportimin. Kjo i jep trafikuesit një nivel të lartë kontrolli gjatë fazës së tranzitit.

Në vijim, trafikimi ndërkombëtar njerëzor ka linjat e tij të shtrirjes gjeografike, duke qenë se ky krim është i mirëorganizuar. Linjat kryesore botërore të transportimit janë:<sup>36</sup>

1. Linja e Balltikut. Duke filluar nga Rusia dhe shtetet e Detit Balltik, nëpërmjet rrugës tokësore drejt brigjeve, duke vijuar në rrugë ujore për në vendet Skandinave.
2. Linja e Evropës Veriore. Nëpërmjet Evropës Lindore nga Polonia, Hungaria dhe Republika Çeke, në fillim në Gjermani dhe pastaj në Gadishullin Skandinav.
3. Linja e Europës Qendrore. Nga shtetet e Europës Qendrore duke përdorur rrjetin shumë të mirë të autostradave dhe linjat për distanca të largëta të autobusave, për të hyrë më pas në Austri dhe Italinë e Veriut.
4. Linja e Ballkanit Qendror. Nga vendet e Kaukazit, të Azisë dhe të Europës Lindore, nëpërmjet vendeve të Ballkanit Qëndror, nëpërmjet Hungarisë për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
5. Linja e Ballkanit të Jugut. Nga vendet e Kaukazit, të Azisë dhe të Europës Juglindore nëpërmjet Moldavisë, Rumanisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë, për të hyrë në vendet e Bashkimit Europian nëpërmjet Italisë dhe Greqisë.
6. Linja Jugore. Nga Afrika Perëndimore nëpërmjet Algjerisë dhe Marokut, mepërmes ngushticës së Gjibraltarit në rrugë ujore, dhe pastaj për në Portugali dhe Spanjë.
7. Linja Perëndimore. Nga Amerika Qendrore dhe Jugore për të hyrë në Bashkimin Europian nëpërmjet Gadishullit Iberik. Kjo linjë përdoret, gjithashtu, edhe si etapa e

---

<sup>35</sup> Grup Autorësh, manuali.cit. fq.11.

<sup>36</sup> Europol "Vlerësimi i Krimit – Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Bashkimin Europian" (versioni i hapur); Tetor 2001.

fundit e udhëtimit të emigrantëve që mbërrijnë me rrugë ajrore nga Lindja e Largët, Afrika dhe Amerika e Jugut.

Ndërsa linjat e trafikimit të lidhura drejtpërdrejt me Shqipërinë janë:

1. Ukrainë-Jugosllavi-Kosovë<sup>37</sup>-Shqipëri;
2. Beograd-Bosnje-Mali i Zi-Shqipëri;
3. Rumani-Serbi-Kosovë-Shqipëri;
4. Kosovë ose Bosnje-Shqipëri;
5. Kosovë-Shqipëri-Greqi;
6. Bullgari-Shqipëri ose Kosovë-Shqipëri.

Nga ana tjetër, linjat kryesore të trafikut të brendshëm janë:

1. Kosovë-Mali i Zi-Liqeni i Shkodrës-Tiranë-Vlorë ose Durrës-Itali;
2. Mali i Zi-Liqeni i Shkodrës-Tiranë-Elbasan-Korçë-Greqi;
3. Pogradec-Elbasan-Vlorë ose Durrës-Itali;
4. Tiranë-Gjirokaster ose Sarandë-Greqi-Itali;
5. Nëpërmjet Aeroportit të Rinasit.

Ndërkohë, qytetet më të prekura në Shqipëri si rrjedhojë e këtij trafiku janë: Tirana, Vlora, Berati, Kuçova, Skrapari, Puka dhe Lezha.

Gjithashtu, rrugët për realizimin e trafikimit janë rrugët detare, ajrore, tokësore.

**Rruga detare**, mbetet rruga kryesore për realizimin e këtij trafiku. Duke përjashtuar lundrimin me gomone, për këtë trafik janë përdorur edhe mjete lundruese private të tonazhit të mesëm, të cilët ngarkojnë klandestinët në kalatat e porteve, në pikat natyrore të fshehta dhe shpesh në det të hapur në varësi të kushteve klimatike, mjeteve disponibël, situatës operative të forcave të rendit, raportit kërkesë-ofertë etj.

**Rruga ajrore**, ka parasysh Aeroportin e Rinasit ku hyjnë nëpërmjet linjave ajrore ndërkombëtare, klandestinë kurdë, arabë, kinezë të cilët pasi punojnë në Shqipëri në firma të ndryshme për një periudhë 2-3 mujore, kohë e mjaftueshme kjo për të siguruar

---

<sup>37</sup>Arjana Qosaj, Mustafa, Këshilltare ligjore në zyrën e OSBE-së në Prishtinë, thotë se trafikimi i qënieve njerëzore në Kosovë është problem i madh. Rrugët kryesore të trafikimit të qënieve njerëzore vijnë nga Evropa Lindore, përmes Serbisë e Malit të Zi, një pjesë mbeten në Kosovë dhe një pjesë vazhdojnë më tej, për në Greqi apo vende të tjera, thotë ajo. Një dokument i brendshëm i OSBE-së në Kosovë, thotë se zyrtarët e OSBE-së nuk mund të shkojnë në këto bare sepse dyshohet se aty bëhet prostitucion i detyruar. Radio "Zëri i Amerikës", 9 tetor 2003, Linda Karadaku.



pagesën e udhëtimit, trafikohen nëpërmjet rrugës detare. Në mjaft raste në këtë trafik kanë qenë të implikuar edhe punonjës nga Komisariati i Rinasit, të cilët i nisnin femrat për në Vlorë dhe, më pas, në drejtim të Italisë.<sup>38</sup>

**Rrugët tokësore**, përfaqësojnë pikat e kalimit kufitar tokësor ose rrugët e tjera duke shmangur këto pika kufitare. Rrugët tokësore përfaqësojnë itinerare si:

- Mali i Zi - Malësi e Madhe - Shkodër, e më pas Shëngjin, Vlorë, Durrës, Fier, Tiranë me destinacion përfundimtar Italinë.
- Kosovë<sup>39</sup> - Kukës e më pas Durrës, Tiranë, Vlorë e Itali.
- Maqedoni - Qafë Thanë, Bllatë, Tushemisht e më pas Tiranë, Fier, Vlorë, Itali.
- Maqedoni - Liqeni i Ohrit - Korçë e më pas Fier, Vlorë e në fund Itali.
- Shqipëri - Mali i Zi - Kroaci e më pas drejt Italisë ose Austrisë.

Rrugët e hyrjes së klandestinëve të huaj në drejtim të Vlorës me destinacion përfundimtar Italinë janë:

- Nga Mali i Zi nëpërmjet kufirit me Malësinë e Madhe dhe Shkodrën;
- Nga Maqedonia<sup>40</sup> nëpërmjet doganës së Qaf-Thanës, Tushemishtit, Bllatës si dhe nëpërmjet Liqenit të Pogradecit;
- Nga Greqia nëpërmjet Igumenicës dhe Korfuzit, me anë skafesh e gomonesh, në drejtim të bregdetit të Sarandës, ku strehohen dhe më pas nisen për Vlorë;
- Po nga Greqia nëpërmjet Kakavijës në drejtim të Vlorës ose Sarandës nga ku kryhet nisja

---

<sup>38</sup>Xh.Shala. *Siguria Kombëtare dhe Sfidat e Integritimit*, Tiranë, 2003, fq.43.

<sup>39</sup>Berry Fletcher, zëdhënës i policisë ndërkombëtare në Prishtinë, thotë se trafikimi i qënieve njerëzore është problem rajonal. 200 biznese në Kosovë janë identifikuar si vende ku bëhet prostitucion. Pothuaj të gjitha vajzat vijnë nga vendet e Evropës Lindore. Grupet kriminale shqiptare dhe sllave bashkëpunojnë shumë ngushtë në trafikimin e qënieve njerëzore. Radio "Zëri i Amerikës", 9 tetor 2003, Linda Karadaku .

<sup>40</sup>Guglielmo Schinina, drejtues i njësisë për ndihmën për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore në zyrën e IOM-it në Shkup, shpjegon rrugët kryesore të trafikimit të vajzave të reja nga dhe për në Ballkan.Maqedonia është rrugë kalimi dhe vend mbetjeje për vajzat e trafikuar. Qindra bare nate vazhdojnë të funksionojnë; në to, vajza të reja nga Evropa Lindore, Moldavia, Ukraina, Rumania, Bullgaria apo vende të tjera, shfrytëzohen seksualisht. Radio "Zëri i Amerikës", 9 tetor 2003, Linda Karadaku .

me skafe për në Itali. Klandestinët që kalojnë nëpërmjet këtyre linjave janë kryesisht Kurdë, që kalojnë nga Kosova me destinacion Vlorë - Itali.

### **Faza III: Destinacioni.**

Në këtë etapë realizohet plotësisht shfrytëzimi, i cili është edhe synimi i trafikuesit. Sapo mbërrinë viktimat në vendin e destinacionit<sup>41</sup> të fundit ato e gjejnë veten në kushte jetese skllavëruese, kryesisht në industrinë e seksit, por gjithashtu në kushte skllavëruese duke punuar në bujqësi, fabrika, dyqane seksi apo si punëtorë shtëpiake, me orë të zgjatura në kushte ç'njerëzore dhe shfrytëzuese.<sup>42</sup> Këto viktima gjatë punës së detyruar mund t'u nënshtrohen edhe abuzimit seksual.<sup>43</sup>

Sa i takon hyrjes në shtetin pritës (të destinacionit), ka tre metoda kryesore për hyrjen në vendin e fundit pritës:

- E fshehur. Ka të bëjë me hyrjen kontrabandë me mjete transporti, makinë, tren, traget ose edhe në këmbë.
- E hapur. Me paraqitjen e dokumenteve të fallsifikuara që të njohin të drejten e hyrjes në një vend të huaj.
- E hapur. Me paraqitjen e dokumenteve të mirëbesuara që njohin të drejtën e hyrjes, si vizë turistike apo vizë studenti.

## **2. Shtysat dhe llojet e trafikimit të qenieve njerëzore.**

### **2.1. Faktorët që karakterizojnë trafikimin.**

*Së pari*, duhet përmendur emigracioni bashkë me faktorët më të rëndësishëm shtytës si varfëria, luftrat civile, katastrofat natyrore, dhe rritja e mundësive përvoja të përkjet transportimit të lirë, të shpejtë dhe global dhe sistemet e komunikimit që lidhin apo

---

<sup>41</sup> Në procedimin penal nr. 60 të vitit 2008, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në ngarkim të Z.B. , ka rezultuar se ky i pandehur kishte mashtruar të dëmtuarën E.B. se do të martoheshin së bashku e do të iknin në Itali për të jetuar. Për arritjen e qëllimit e ka pajisur E.B. me dokumenta fallco duke kaluar kufirin e Maqedonisë e me pas kanë arritur në Greqi. Pasi kanë qëndruar disa dite aty janë larguar për Itali. Destinacioni i tyre ishte Franca, ku janë stacionuar në qytetin e Lionit.

<sup>42</sup> Grup Autorësh, manuali i cit. fq.12.

<sup>43</sup> I. Elezi, *E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme*. Tiranë 2005, fq. 149.

afrojnë kultura të ndryshme duke theksuar se kjo e fundit mund të jetë katalizatori më i fuqishëm për trafikun klandestin.<sup>44</sup>

*Së dyti*, ulja e emigracionit legal në Europë dhe në Amerikën e Veriut ka dhënë kontributin e saj në lindjen e tregut të zi për aktivitetet e emigrimit. Në këtë mënyrë shqiptarët kanë kërkuar rrugë të shpejta për të arritur mirëqenien, rrugët e trafiqeve të jashtëligjshme që tejkalojnë brigjet adriatike. Këto trafiqe kanë qenë dhe janë vepër e kriminalitetit të organizuar ndërkombëtare (Golfi Persik, Amerika e Jugut, Rusia, Iraku, Turqia, Italia), kryesisht të Mafia-s Italiane, në bashkëpunim të ngushtë me klanet kriminale shqiptare (mes të cilëve “Zani” në Vlorë, ”Kakami” në Elbasan, ”Gaxhaj” në Cërrik) etj.<sup>45</sup>

*Së treti*, shoqëritë postmoderniste dhe mënyra e jetesës individuale si dhe ndryshimet demografike dhe kulturore, kanë çuar në daljen e një lloj emigranti tregtar, një proces që është lehtësuar nga ndryshimet e strukturave tradicionale të familjeve, dobësimi i lidhjeve shoqërore e familjare dhe si rrjedhim një rritje e potencialit të emigracionit, e cila shfaqet nga shtegëtimi i emigrantëve tregëtarë dhe punëtorë në rajone në zhvillim dhe në tranzicion në njërin anë dhe emigrimin për një kohë të shkurtër në vendet e zhvilluara në anën tjetër, që çon gjithashtu në rritjen e kërkesës për birësim ndërkombëtar.

*Së katërti*, ka patur një kërkesë të madhe për krah pune të lirë, sidomos në ato vende që tregu i punës është tej i rregulluar dhe në ato vende me sektor të gjerë bujqësor. Kërkesa mund të shkaktojë lindjen e një tregu të zi pune, ose atë që është më e zakonshme në Europë ose në Amerikën e Veriut, një treg pune i cili është i bazuar pjesërisht në emigracionin ndërkufitar të krahut të punës.

Trafikimi i njerëzve ka tërhequr vëmendjen e autoriteteve të caktuara, sidomos ato të shoqëruara me incidente. Shembuj të tillë janë fundosja në Kanalin e Otrantos e anijes shqiptare “Kater i Rades” e cila u godit nga anija ushtarake italiane “Sibilla” me 28. 03. 1997, tragjedia e dyte e Otrantos date 12. 03. 2002 etj.<sup>46</sup> Vlerësohet se 60% deri 90% të

---

<sup>44</sup> Në gjykimin e çështjes ndaj të pandehurit E.A. (shtetas jo-shqiptar), akuzuar për kryerjen e veprës penale të trafikimit të njerëzve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vlerësuar faktin se vepra ishte kryer për qëllime përfitimi, ku viktimat ishin shtetas Tunizian, ka vendosur si masë dënimi për të akuzuarin 1 vit e 2 muaj burgim. Theksojme se gjykata ka aplikuar nenin 406 të K.Pr.Penale (gjykim të shkurtuar duke përfutur uljen e 1/3 së masë dënimit). Vendimi nr.587 dt. 16.06.2003.

<sup>45</sup> S. Begeja, “*Mesdheu Deti i Krimin të Organizuar dhe i Trafikimit të Jashtëligjshëm*”, ligjerata e mbajtur në Universitetin e Prishtinës, botuar në revistën E Drejta, Prishtinë 2002, fq. 129.

<sup>46</sup>S. Begeja, revista e cit. fq. 131.

emigrantëve ilegal sot janë ndihmuar nga grupet e organizuara për të udhëtuar në Europë. Ekzistojnë gjithashtu vlerësime sipas së cilave numri i plotë i njerëzve të trafikuar shkon në rreth 2 milion në vit.

Të rriturit dhe fëmijët<sup>47</sup> trafikohen për një sërë qëllimesh shfrytëzimi, nga të cilat shfrytëzimi seksual është dhe do të mbetet më i përhapuri. Shfrytëzimi i punës zakonisht ndodh në sektorët e bujqësisë, të prodhimit të veshjeve dhe në atë të shpërndarjes së ushqimeve në të cilat si viktimat e trafikuar të moshës së rritur ashtu edhe të mitur detyrohen të punojnë në kushte skllavëruese.

Duke mbetur te fëmijët, vihet në dukje se fëmijët e të gjitha moshave, janë të cënueshëm nga shfrytëzimi i tyre si agjentë kriminal, ku me “agjenci kriminale” do të kuptojmë veprimtari të tilla si kërkim lëmoshe në rrugë, vjedhje si hajdutë xhepush dhe forma të tjera të krimit për qëllime të dobëta. Sot po trafikohen djem të mitur për të vepruar si operativë kriminal, të cilët kryejnë funksione minimale që lidhen me vetë trafikimin, duke vepruar si “roje” apo si “lajmës” për llogari të trafikantëve. Gjithashtu, viktimat në moshë të rritur dhe viktimat fëmijë femra që hyjnë në industrinë e seksit detyrohen të prostitutojnë vetë nëpër rrugë, bare, agjenci shoqërimi, apo në apartamente që shërbejnë si bordello. Rezistenca e viktimave mposhtet nëpërmjet “mësimeve” të para që u jepen dhe që konsistojnë në përdhunimet në grup dhe rrahje derisa të arrihet nënshtrimi i tyre. Më pas u kërkohet që të bëjnë çfarëdo që u kërkohet nga numri i pafund i klientëve.

Shpesh, femrat i lëvizin nga një qytet tek tjetri, dhe nga një vend në një tjetër. Qëllimi është çorientimi i viktimës, në mënyrë që ato të mos jenë në gjendje të lidhin miqësi me ata që i rrethojnë, si dhe të evitojnë që policia të bjërë në gjurmë të veprimtarisë së tyre. Shumë viktimat abuzohen fizikisht dhe seksualisht dhe mbahen në kushte burgimi real. Vrasjet ndodhin shpesh, gjë që shërben edhe si paralajmërim për viktimat e tjera.<sup>48</sup> Gjithashtu, kërcënimet për hakmarrje kundër atyre apo familjarëve të tyre i pengojnë viktimat që të përpiqen të largohen. Në këto kushte, abuzimet e vazhdueshme fizike, emocionale dhe seksuale bëjnë që viktimat të mos kenë alternativë tjetër veçse të mbeten në këto rrethana.

---

<sup>47</sup> “Konventa për të drejtat e fëmijëve” i përkufizon si fëmijë të gjithë ata që janë nën 18 vjeç

<sup>48</sup>I. Elezi. *Rrethana veçanërisht e cilësuar e veprës*, vep. e cit. fq. 150

## 2.2. Llojet e trafikimit të qënieve njerëzore.

Trafikimi i njerëzve si fenomen mund të trajtohet në katër ndarje të mëdha:

1) **Trafikimi për qëllime politike**, i cili gjenerohet nga represioni policor, ushtarak apo fetar i makinës shtetërore të një shteti ndaj pakicave etnike dhe kombëtare. Arsytet e këtij trafiku janë të shumta e të thella aq sa deformojnë në mënyrë të pakthyeshme kodin shpirtëror, etik dhe moral të viktimave. Klandestinet kurdë, arabë apo afganë janë të gatshëm të paguajnë ç'do çmim për t'u larguar nga vendet e tyre, fakt ky që shfrytëzohet nga grupet kriminale për të realizuar spektrin shumëngjyrësh të veprimtarisë së tyre. Stacionet e para të qëndrimit tranzitor të klandestineve janë; Maqedonia, Mali i Zi, Kosova, Serbia, Sllovenia dhe veçanërisht Greqia. Këtu ata organizohen në kampe refugjatësh (në zona rurale të kryeqytetit Grek) të pajisur me leje qëndrimi të përkohshme dhe u premtohet statusi i azilantit politik. Pjesa e klandestineve që largohet nga Greqia pa prituri përgjigjet e aplikimit për azil politik, përfundon pjesërisht në duart e grupeve kriminale shqiptare.

2) **Trafikimi për arsye të disidencës politike**, gjenerohet nga ndryshime politike të një vendi dhe i detyron kundërshtarët t'i largohen ndëshkimit apo hakmarrjes së krahut politik që merr pushtetin. Ky trafikim është tepër sporadik dhe elitar, kështu ai realizohet në sferat e larta, por sidoqoftë kundrejt pagesave të larta nëpër linja kriminale.

3) **Trafikimi për qëllime ekonomike**, gjenerohet në përmasa globale nga diferencat e thella sociale-ekonomike midis shteteve kombëtare dhe etnive. Ky është lloji më i përhapur i trafikut të njerëzve dhe që shtron probleme komplekse për zgjidhje. Vlen për t'u përmendur ngjarja e 9 Janarit 2004 në Vlorë, ku vdiqën 21 persona dhe 7 të tjerë u zhduken në Karaburun.<sup>49</sup>

4) **Trafikimi për qëllime kriminale**, gjenerohet nga vetë natyra e krimit të organizuar dhe ka për bazë shfrytëzimin e mishit të bardhë për prostitucion dhe teknologjitë moderne të ekzibicionizmit. Aktualisht, rrënjët e këtij trafiku nisin në ish-vendet socialiste të Lindjes dhe nën patronazhin e bandave serbe, turke dhe kosovaro-maqedone-shqiptare si dhe përfundojnë në vendet e BE-se ose në tregun kolosal turk. Në kontekstin e ngushtë lokal kanë vepruar fuqishëm grupet kriminale të Fierit, Beratit, Korçës, Durrësit dhe Elbasanit në aleancë me grupet kriminale të Shkupit, Tetoves,

---

<sup>49</sup> I. Elezi, vep.cit, fq. 135

Ohrit e Malit të Zi.<sup>50</sup> Për realizimin e trafikut janë përdorur kalimet nëpërmjet pikave të kalimit kufitar (P.K.K.) dhe jashtë tyre. Në rastin e kalimit nëpërmjet P.K.K-ve tabloja e përfshirjes në trafikim merr në konsideratë implikimin në shkallë të ndryshme të punonjësve të caktuar të administratës shtetërore përkatëse në nivele lokale, veçanërisht strukturave të rendit. Në rastin e kalimit jashtë pikave të kontrollit evidentohen përfshirje të pushtetit vendor në nivel kryepleqësie, komune etj. Në të dyja rastet, krimi i organizuar kujdeset të paraqesë një dokumentacion “korrekt” të përpunuar e falsifikuar jashtë vendit për të huajt dhe brenda vendit për shqiptarët. Parë në këtë kontekst, rezulton se këto lloj veprash penale janë të përbëra dhe se me ligj është përcaktuar se ajo kryhet me ndërmarrjen e dy apo më shumë veprimeve.<sup>51</sup>

### **3. Legjislacioni shqiptar në evolucionin e tij për veprën penale të trafikimit.**

#### **3.1. Kushtetuta**

Kushtetuta e RSH-së përbën ligjin më të lartë në hierarkinë e akteve ligjore në Republikën e Shqipërisë. Ajo sanksionon disa të drejta, zbatimi dhe garantimi në praktikë i të cilave kontribuon në parandalimin dhe mbrojtjen nga fenomeni i trafikimit të qënieve njerëzore. Neni 3 i Kushtetutës sanksionon se “.....*dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij,....janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë*”.

Në pjesën e dytë të Kushtetutës disa dispozita sanksionojnë garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe mbrojtjen nga dhuna:

*“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.”<sup>52</sup>; “Jeta e personit mbrohet me ligj”<sup>53</sup>; “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, ç’njerëzor ose poshtërues”<sup>54</sup>.*

Kushtetuta sanksionon se, askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveç se në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (neni 27). Garantimi i të drejtës për të qenë i lirë, paraqet rëndësi në kushtet e përfshirjes së rrëmbimit si element i një vepre me

---

<sup>50</sup> Xh. Shala, *Siguria Kombëtare dhe Sfidat e Integritetit*, Tiranë, 2003 fq. 44.

<sup>51</sup> I.Saliu. *E Drejta Penale*, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë 2003, fq. 199.

<sup>52</sup>Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 15, pika 1.

<sup>53</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 21.

<sup>54</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 25.

rrezikshmëri shoqërore të përafërt me trafikimin. Gjithashtu, neni 26 i Kushtetutës sanksionon të drejtën e individit për të mos kryer punë të detyruar.<sup>55</sup>

Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, nën moshën minimale për punën e fëmijëve, është një parashikim i qartë në Kushtetutë, i lidhur me dëmtimin e shëndetit, moralit dhe vënies në rrezik të jetës së fëmijës dhe zhvillimit normal të tij. Sanksionimi në mënyrë të shprehur i kësaj të drejte është me rëndësi, sa kohë që shfrytëzimi i punës ose shërbimeve të detyruara, përbën një element të trafikimit të personave, grave dhe të miturve.

Një dispozitë kuptimplote e Kushtetutës është ajo që sanksionon se fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti<sup>56</sup>. Kjo, merr një rëndësi të veçantë, pasi trafikimi i personave, grave dhe të miturve mund të shoqërohet me keqtrajtim, me dhunë fizike apo psikike.

### 3.2. Kodi Penal

Trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen shumë kompleks dhe faktorët që e favorizojnë atë janë të shumtë, prandaj edhe masat parandaluese janë shumëplanëshe, duke u ndalur së pari në legjislacionin përkates dhe zbatimin e tij. Trafikimi dhe format e ndyshme në të cilat ai shfaqet konsiderohen sot si fenomen kriminal me rrezikshmëri të lartë shoqërore, i cili dënohet ashpër nga legjislacioni ynë penal.

Në këtë kuadër, legjislacioni penal shqiptar është përmirësuar vazhdimisht në përfaqje me legjislacionin ndërkombëtar dhe në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Në këto ndryshime, vlen të përmendet evoluimi i veprave penale të trafikimit. Ato janë vepra relativisht të reja në legjislacionin tonë. Me hyrjen në fuqi të Kodit Penal, në Qershor 1995, ato nuk ishin parashikuar fillimisht si vepra penale. Për më tepër që nga pikëpamja juridiko-formale Kodi Penal nuk përmbante asnjë dispozitë që ta parashikonte trafikimin si vepër penale<sup>57</sup>.

---

<sup>55</sup>Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.8417, datë 21.10.1998, Neni 26, “*Askujt nuk mund t’i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve.*”

<sup>56</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 54, pika 1.

<sup>57</sup> Ismet Elezi, “*E Drejta Penale-Pjesa e Posaçme*”, Ribotim, Shtëpia Botuese “P.SH 2015”, Tiranë, 2007.

Mund të themi se trafikimi dënohej indirekt, përmes ndëshkimit që parashikohej në veprat penale si:

- Favorizimi i prostitucionit (Neni 114 i Kodit Penal);
- Mbajtja e lokaleve për prostitucion (Neni 115 i Kodit Penal);
- Kalimi i paligjshëm i kufirit (Neni 297 i Kodit Penal);
- Dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm te kufirit (Neni 298 i Kodit Penal).

Përsa i përket sanksionit, Kodi parashikonte gjobën si minimumin e dënimit të këtyre veprave dhe 10 vjet burgim, si maksimumin e dënimit. Por gjithsesi, ky rregullim nuk ishte i mjaftueshëm. Për pasojë, u pa e nevojshme përmirësimi i mëtejshëm i legjislacionit në këtë fushë.

Kështu me Ligjin nr.8175, datë 23.12.1996, u parashikuan “Shfrytëzimi i prostitucionit i bërë në rrethana rënduese” dhe “Shfrytëzimi i prostitucionit i kryer nga organizata kriminale”. Po ashtu, ndryshime u bënë edhe në vitin 1998. Me Ligjin nr.8279, dt. 15.1.1998 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.7895, datë 27.1.1995” “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”, vepra penale e Favorizimit të Prostitucionit u konceptua e ndryshuar si Shfrytëzimi i Prostitucionit (Neni 114). Këtij neni iu bënë edhe ndryshime të tjera, duke ju shfuqizuar paragrafi i tij i dytë, i cili trajtonte kryerjen e veprës penale ndaj të miturës apo me përdorim të dhunës.

Eshtë e rëndësishme të theksojmë se ndryshoi dhe këndvështrimi gjinor i ligjvënsit. Me ndryshimet që iu bënë kësaj vepre penale, mund të trajtohen si viktimat edhe të miturit meshkuj, në ndryshim nga më parë ku konsideroheshin si viktimat vetëm femrat e mitura.

Gjithashtu, u shtua neni 114/a “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”<sup>58</sup>, parashikuar si një vepër penale më vete. Ky parashikim më vete ka dhënë mundësi të goditet më mirë kjo vepër penale, duke qartësuar figurën e krimit dhe duke e ndëshkuar me rëndë subjektin e kësaj vepre. Në këtë vepër, për herë të parë ndeshim një sanksion të tillë ku dënimi me burgim shoqërohet edhe me konfiksimin e mjeteve dhe përfitimin e nxjerrë nga vepra penale.

Kështu p.sh. Gjykata e Lartë Tiranë me vendimin nr. 615, datë 10.12.2003, ka lënë në fuqi vendimin nr.127, datë 17.02.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe



vendimin nr.376, datë 18.12.2003 të Gjykatës Apelit Tiranë ku kanë deklaruar fajtor shtetasin shqiptar I. L. për kryerjen e veprës penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese, bazuar në nenin 114/a, 4, 5 të K.Penal, pasi ai me anë të kërcënimeve dhe torturave e ka detyruar të dëmtuarën të ushtrojë prostitucion në Itali.<sup>59</sup>

Ndryshime të mëtejshme, të rëndësishme u bënë në vitin 2001-2004<sup>60</sup>. Këto ndryshime prekën si pjesën e përgjithshme ashtu dhe atë të posaçme të Kodit Penal.Gjithashtu, ndryshimet që iu bënë Kodit Penal në vitin 2001 prekën edhe dispozita që ishin shtuar në vitin 1998, si p.sh.“Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese” (Neni 114/a). Kjo dispozitë ndryshoi nga pikëpamja cilësore si më poshtë:

- U hoq pika 6, që parashikonte kryerjen e veprës penale nga organizatat kriminale;
- U shtua kryerja e veprës në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore dhe publike;
- Nga sanksioni i dispozitës u hoqën fjalët “dhe me konfiskim të mjeteve dhe përfitimeve”.

Ndërkohë, nocioni trafikim, u fut për herë të parë në Kodin Penal me ndryshimet që u bënë me Ligjin nr.8733, datë 24.01.2001. Ky ligj parashikoi në Kodin Penal veprën penale të trafikimit me tre figura veprash si “Trafikimi i personave”, “Trafikimi i femrave” dhe “Trafikimi i fëmijëve”.Kështu, u shtuan disa nene në këtë drejtim. Njëri prej tyre është neni 110/a, ku për të harmonizuar formulimin e tij me aktet juridike ndërkombëtare, u bënë ndryshimet e mëposhtme:

Pas nenit 110, u shtua neni 110/a – Trafikimi i personave, me përmbajtje:

Trafikimi i personave (Neni 110/a).

*“Trafikimi i njerëzve me qëllim përfitimi material ose çdo përfitim tjetër dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.*

*Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose me shumë se një herë ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dënuarit për të kryer veprime të ndryshme ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se 15 vjet dhe kur ka sjell si pasojë vdekjen me burgim të përjetshëm”.*

---

<sup>59</sup>Shih Vendimin nr.615, dt. 10.12.2003 të Gjykatës së Lartë Tiranë.

Gjithashtu, pas nenit 114/a, shtohet neni 114/b me përmbajtje si vijon:

Trafikimi i femrave (Neni 114/b).

*“Trafikimi i femrave për prostitucion me qëllim përfitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga 7 deri në 15 vjet.*

*Po kjo vepër, kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose shoqërohet me keqtrajtim dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarës për të kryer veprime të ndryshme ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se 15 vjet dhe kur ka sjell pasojë vdekjen, me burgim të përjetshëm”.*

Dispozitë tjetër e cila u shtua në Kodin Penal ishte neni 128/b.

Trafikimi i fëmijëve (Neni 128/b).

*“Trafikimi i fëmijëve me qëllim përfitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vjet.*

*Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarës për të kryer veprime të ndryshme ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se 15 vjet dhe kur ka sjellë si pasojë vdekjen, me burgim të përjetshëm”.*

Në kuadër të forcimit të legjislacionit penal në luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe si rezultat i ratifikimit nga Shqipëria të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar dhe të dy Protokolleve shtesë<sup>61</sup>, në vitet 2001-2004, Kodi ynë Penal iu nënshtrua disa shtesave dhe ndryshimeve, si në pjesën e përgjithshme ashtu dhe atë të posaçme të tij. Kështu për po të njëjtën arsye që është harmonizimi i formulimit me aktet juridike ndërkombëtare, Ligji nr.9188, datë 12.02.2004, në pjesën e posaçme të Kodit Penal, bëri ndryshimet e mëposhtme.

U riformulua neni 110/a, me përmbajtje:

Trafikimi i personave (Neni 110/a).

*“Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nepërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo përdorimit të formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës, ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të të ngjashme të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose të shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose të formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim të transplantimit të organeve si dhe formave të tjera të skllavërimit, dënohen me burgim nga pesë deri pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë dy milion deri në pesë milion lekë.*

*Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave, dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga katër milion deri në gjashtë milion lekë.*

*Kur kjo vepër kryhet me bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtim dhe detyrim me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja në shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtë milion deri në tetë milion lekë.*

<sup>61</sup> Shih ligjin nr.8920, datë 11.07.2002, fletorja Zyrtare 41/2002.

*Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzetë vjet ose me burgim të përjetshëm dhe me gjobë nga shtatë deri në dhjetë milion lekë.  
Kur vepra kryhet nepërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjoba shënohet me ¼ e dënimit të dhënë.”*

U riformulua neni 114/b, me përmbajtje si vijon:

**Trafikimi i femrave.**

*“Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e femrave nepërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo përdorimit të formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës, ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për tv marrë pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, me qëllim të shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, punës ose të shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantim të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetëvjet dhe me gjobë nga tre deri në gjashtëmilion lekë.*

*Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të femrave, dënohen me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga pesë deri në shtatëmilion lekë.*

*Kur kjo vepër kryhet me bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarës për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtë deri në tetëmilion lekë.*

*Kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim jo më pak se njëzetë vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga shtatë milion deri në djetëmilion lekë.*

*Kur vepra kryhet nepërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me ¼ e dënimit të dhënë”.*

Historia dhe realiteti aktual tregon që femrat nuk janë shfrytëzuar vetëm për qëllim prostitucioni, por i janë nënshtruar edhe formave të tjera të shfrytëzimit. Duke marrë këtu edhe për bazë që pjesa më e madhe e personave të trafikuar janë gra, ky përfundim bëri që ligjvënësi t'i jepte kësaj dispozite karakter më të përgjithshëm duke e titulluar “Trafikimi i femrave”. Duke pasur parasysh se trafikimi i femrave është një nga format më të ashpra të krimit të organizuar, Kodi Penal parashikon dënime të rënda edhe subjektet që kryejnë organizimin, drejtimin dhe financimin e trafikimit të femrave<sup>62</sup>.

Gjithashtu edhe neni 128 u riformulua.

**Trafikimi i të miturve (Neni 128).**

*“Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllaverimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga katër milion deri në gjashtë milion lekë.*

*Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve, dënohen me burgim dhjetë deri në njëzet vjet burgim dhe me gjobë nga gjashtë milion deri në tetë milion lekë.*

*Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja*

<sup>62</sup> Ismet Elezi, Vasilika Hysi, “Politika Kriminale” PEGI, Tiranë, 2006.

*të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjet vjet dhe me gjobë nga gjashtë milion në tetë milion lekë.*

*Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzetë vjet ose me burgim të përjetshëm si dhe me gjobë nga tetë milion deri në dhjetë milion lekë.*

*Kur vepra penale kryhet nepërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.”*

Mund të konkludohet se dobësia e ligjit ka ndikuar në mungesën e efikasitetit në goditjen e rasteve të trafikimit, po të kemi parasysh se në këtë periudhë kemi dhe një rritje më të madhe të fenomenit kriminal. Kjo dobësi u ndje edhe në praktikën gjyqësore. Për pasojë, u pa e nevojshme ndërmarrja e nismave të tjera për përmirësimin e legjislacionit në këtë fushë.

Siç dihet, pjesë e legjislacionit tonë të brëndshëm janë edhe konventat ndërkombëtare, por edhe akte të tjera që lidhen me to, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, të cilat përveç sa mund të zbatohen drejtpërdrejt, paraqesin edhe detyrimin për të hartuar ligje kombëtare penale që ndëshkojnë trafikimin e qenieve njerëzore.

Vepra penale e trafikimit e përpunuar si nga jurisprudenca, ashtu dhe doktrina, konsiderohet me rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe në përputhje me këtë rrezikshmëri janë përcaktuar edhe masat e rënda të dënimit.

Shtojca e Kodit Penal e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2004, bëri të mundur që vepra penale e trafikimit e kryer nga subjekte që shfrytëzojnë funksionin shtetëror ose shërbimin publik, të konsiderohet në rrethana rënduese dhe të ketë efektet e saj parandaluese apo ndëshkuese ndaj personave zyrtarë. Deri në vitin 2004, kjo rrethanë e cilësuar rënduese nuk ishte parashikuar për trafikimin, por ishte parashikuar vetëm për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit me një shtojcë që i ishte bërë Kodit në vitin 1999.

Kështu nën frymën e Konventës dhe dy protokolleve të saj dhe me reflektim të efektit të kësaj norme ndërkombëtare, sipas përcaktimit të nenit 122/2 të Kushtetutës, u bënë dhe ndryshimet përkatëse të legjislacionit penal me anë të Ligjit nr.8733, date 24.1.2001.<sup>63</sup> Siç dhe u përmend më sipër, ndryshime dhe përmirësime mjaft të rëndësishme të legjislacionit të brendshëm, janë bërë veçanërisht gjatë vitit 2004, për shkak të përpjekjeve për përqasjen e tij me konventat ndërkombëtare dhe veçanërisht

---

<sup>63</sup> Shih nenin 122/2 të Kushtetutës së RSH, i cili parashikonte se... “një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”.

me ratifikimin nga Shqipëria të Konventës së O.K.B “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe 2 protokolleve shtesë të saj<sup>64</sup>.

Neni 2 i tij parashikon qëllimin që të parandalojë dhe të luftojë trafikun ndërkombëtar të personave duke i kushtuar vëmendje të veçantë grave dhe fëmijëve. Mbi këtë bazë, legjislacioni penal shqiptar u amendua, duke i kushtuar një vëmendje të posaçme mbrojtjes së grave dhe fëmijëve nga trafiku.

Siç u theksua më sipër, nisur nga fakti që femrat nuk janë shfrytëzuar vetëm për qëllime prostitucioni, kjo bëri që ligjvënësi t’i jepte kësaj dispozite karakter më të përgjithshëm duke e titulluar “Trafikimi i femrave”, duke parashikuar në të, të gjitha format e shfrytëzimit. Kjo mundëson edhe një lehtësim dhe përmirësim në praktikën gjyqësore, duke pasur parasysh faktin se pjesa më e madhe e personave të trafikuar janë gra. E njëjta gjë vlen edhe për dy dispozitat e tjera në lidhje me trafikimin.

Më tej, për një zbatim sa më të mirë dhe të saktë në praktikë të këtyre dispozitave, lind e nevojshme qartësimi i konceptit të trafikimit. Kështu, në Ligjin nr.8920, dt.11.7.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” edhe dy protokolleve shtesë të saj, jepet përkufizimi i trafikimit dhe sqarimi i disa nocioneve të tjera.

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi krimin e organizuar ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj mbi kontrabandimin e emigrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore kanë bërë dallimin mes këtyre dy dukurive. Edhe kontrabandimi edhe trafikimi përfaqësojnë forma të emigracionit të parregullt, por ato kurrësesi nuk janë e njëjta gjë.

Nga ana tjetër është e rëndësishme të theksojmë se shumë shpesh të lidhura me trafikimin janë edhe vepra të tjera penale të parashikuara nga Kodi Penal, të tilla si:

a. Kalimi i paligjshëm i kufirit (Neni 297).<sup>65</sup>

b. Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit (Neni 298).<sup>66</sup>

---

<sup>64</sup> Shih Ligjin nr.8920 dt. 11.7.2002.

<sup>65</sup> Neni 297 i KP parashikon: “*Kalimi i paligjshëm i kufijve shtetërorë përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet*”.

<sup>66</sup> Neni 298 i KP me përmbajtje: “*Strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimi apo i mjeteve të tjera të transportit, me qëllim për të ndihmuar për kalimin e paligjshëm të kufirit, dënohen me burgim nga 1 deri në 4 vjet dhe me gjobë nga 3 milion deri në 6 milion lekë.*

*Kur ndihma jepet për qëllime fitimi, dënohet me burgim nga 3 deri në 7 vjet dhe me gjobë nga 4 milion deri në 8 milion lekë.*

c. Shfrytëzimi i prostitucionit (Neni 114).<sup>67</sup>

d. Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (Neni 114/a).<sup>68</sup>

Ndërkohë, ndryshimet prekin edhe pjesën e përgjithshme të Kodit Penal. Në lidhje me pjesën e përgjithshme, vlen të përmenden ndryshime, të tilla si:

- Ndryshimet në nenin 7 të Kodit Penal “Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas të huaj”, me ndryshimet e bëra në shkronjën “d” dhe shtimin e shkronjës “h”.

- Neni 28 i Kodit Penal “Forma të veçanta bashkëpunimi”, ndryshuar me Ligjin nr.9275, datë 16.09.2004. Në këto ndryshime parashikohet nocioni i grupit të strukturuar kriminal si një formë e veçantë bashkëpunimi si dhe bëhen ndryshime në lidhje me pikën 2 të këtij neni që lidhet me organizatën terroriste.

- Neni 36 i Kodit Penal “Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale”, ndryshuar me Ligjin nr.9086, datë 19.06.2003.

- Neni 50 i Kodit Penal “Rrethanat rënduese”, duke ndryshuar rrethanat rënduese apo duke shtuar të reja, një pjesë prej të cilave ndeshen në veprat penale në lidhje me trafikimin<sup>69</sup>.

- Neni 34 i Kodit Penal “Dënimi me gjobë”. Me ndryshimet e bëra, u rrit vlera e gjobës për krimet dhe kundërvajtjet si dhe u shtua një paragraf. Gjithashtu u shtua një paragraf tjetër që parashikon dhënien e gjobës me vlerë nga 100.000 lekë deri në 5 milion lekë nga gjykata, në rastin kur, për personat që kryejnë krime për motive të fitimit të pasurive ose të sigurimit të çdo lloji përfitimi tjetër material, dispozita përkatëse parashikon dënim me burgim.

---

*Kur kjo veper kryhet në bashkëpunim ose me shumë se një herë, apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga 5 deri në 10 vjet dhe me gjobë 6 milion deri në 8 milion.*

*Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo me pak se 15 vjet ose burgim të përjetshëm si dhe me gjobë nga 8 milion deri 10 milion lekë.*

*Kur vepra kryhet nepërmjet shfrytëzimit të funksionit shoqërore ose sherbimit publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohet me ¼ e dënimit të dhënë”.*

<sup>67</sup>Neni 114 i kodit Penal parashikon: “Shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

*Po kjo vepër, kur kryhet me të mitur, ndaj disa personave, me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie, apo duke përfituar nga raportet zyrtare, ose kryhet në bashkëpunim apo më shumë se një herë, ose nga persona të ngarkuara me funksione shtetërore dhe publike, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.*

<sup>68</sup> Neni 114/a i K.Penal, shfuqizuar me ligjin nr.144/2013.

<sup>69</sup> I.Elezi, S.Kaçupi, M.Haxhia, “Komentari i Kodit Penal të R.Shqipërisë”, GEER, Tiranë, 2006.

Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor në lidhje me trafikimin dhe veprat e tjera penale që lidhen më të, ka qenë objektiv thelbësor i punës së institucioneve përgjegjëse në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Në këtë drejtim me qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar me standartet evropiane dhe ndërkombëtare, në vijim të ndryshimeve të bëra në Kodin Penal në vitin 2004, me konkretisht ndryshimi i nenit 110/a “Trafikimi i personave” në përputhje të plotë edhe me Protokollin e Palermos, janë miratuar disa ndryshime të rëndësishme siç është ai për parandalimin dhe goditjen e kontrabandimit të personave, si dhe nenet për mbrojtjen e fëmijëve.

Në kuadër të ndryshimeve të bëra në legjislacion me qëllim forcimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor në drejtim të ndjekjes penale, janë miratuar ndryshimet në nenin 298 të Kodit Penal “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, me Ligjin nr.9686, datë 26.02.2007, të cilat përfshijnë elemente të veprës penale të kontrabandimit të qenieve njerëzore, sipas konceptit të Protokollit Shtesë të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional, kundër Kontrabandimit të Migrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri, duke mundësuar hetimin e rasteve të kontrabandimit edhe në ato shtete që nuk kanë kufij tokësorë me Shqipërinë. Me miratimin e këtij neni në Kodin Penal, ndër të tjera, tashmë është bërë i mundur edhe dallimi ndërmjet veprës penale të trafikimit të personave nga kontrabandimi.<sup>70</sup>

Për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve, në kuadër të masave mbrojtëse dhe parandaluese ndaj shfrytëzimit të tyre, në muajin Mars të vitit 2007 u propozuan disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal, të cilat u miratuan nga Kuvendi me Ligjin nr.9859, datë 21.01.2008. Më konkretisht, nenet e shtuara janë:

- Neni 124/b “Këqtrajtimi i të miturve” që ndër të tjera, dënon fenomenin e shfrytëzimit të fëmijëve për punë të detyruar, lypje dhe shërbime të tjera të detyruara;

- Shtesa e një paragrafi në nenin 117 “Pornografia” në lidhje me pornografinë më të mitur;

Si dhe shtesa në nenin 128/b “Trafikimi i të miturve” ku tashmë penalizohet me ligj jo vetëm rekrutimi, fshehja, pritja etj, por edhe shitja e të miturve.

- Paketa e këtyre ndryshimeve do të shoqërohet me një paketë të re social-edukative për ndihmën ndaj këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre në formën e punësimit, arsimit dhe llojeve të tjera të ndihmës.

---

<sup>70</sup> Shih K.Penal i R.Shqipërisë, i azhurnuar, Qendra e Publikimeve Zyrtare, Tiranë, web site: [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al).

Në 2 Maj, 2013 Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi një ligj të ri, atë nr. 144/2013 “Mbi disa ndryshime të Ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Në nenin 110/a bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

**“Trafikimi i personave të rritur”**

b) Në paragrafin e parë fjalët “dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga dy milionë deri në pesë milionë lekë” zëvendësohen me fjalët “si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet”.

c) Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

*“Kur kjo vepër kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.*

ç) Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

*“Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.”.*

Pas nenit 110/a shtohen nenet 110/b dhe 110/c me këtë përmbajtje:

**“Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar”(Neni 110/b)**

*“Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni që personi është i trafikuar, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.*

*Kur kjo vepër kryhet ndaj një fëmije dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.”*

**“Veprimet që lehtësojnë trafikimin.” (Neni 110/c)**

*“Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave të rritur, por pa pasur dijeni për këtë fakt, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.*

*Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, apo është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, ose ka mundësuar trafikimin e fëmijëve, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.*

*Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.”*

Neni 114 ndryshohet si më poshtë:

**“Shfrytëzimi i prostitucionit.”**

*“Shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.*



*Po kjo vepër, kur kryhet me të mitur, ndaj disa personave, me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie, apo duke përfutuar nga raportet zyrtare, ose kryhet në bashkëpunim apo më shumë se një herë, ose nga persona të ngarkuara me funksione shtetërore dhe publike, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”*

Neni 117 ndryshohet si më poshtë:

### **“Pornografia”**

*“Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike nëmjediset ku ka fëmijë, me çdo mjet ose formë, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me burgim deri në dy vjet.*

*Prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.*

*Rekrutimi, përdorimi, shtrëngimi, ose bindja e një fëmije, për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, ose marrja pjesë në shfaqje pornografike që përfshijnë fëmijët, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”*

Në nenin 124/b, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

*“Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.”.*

Në nenin 128/b paragrafi i parë, fjalët “dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga katër milionë deri në gjashtë milionë lekë” zëvendësohen me fjalët “dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet”.

- Ndryshimet kryesore në këtë Kod janë:

Neni 114/a i KP mbi shfrytëzimin e prostitucionin në rrethana rënduese dhe neni 114/b “Trafikimi i femrave” janë shfuqizuar me ligjin e lart përmendur dhe nuk konkurrojnë më me nenet e tjera të trafikimit;

Neni 110/a i KP “Trafikimi i personave” titull i ndryshuar me “Trafikim i personave të rritur”. **Neni i ri i trafikimit të personave të rritur është ndryshuar duke dalluar trafikimin e brendshëm nga trafikimi ndërkufitar duke i dhënë fund konfliktit ligjor në implementimin e këtij neni mbi rastet e trafikimit të brendshëm.**

Një nen i ri garanton mos-ndëshkueshmërinë dhe dënimin e viktimave të trafikimit për përfshirjen e tyre në aktivitete të penalizuara të cilat ato janë detyruar ti ndërmarrin si konsekuencë direkte e të qenurit subjekt i TP.<sup>71</sup>

Edhe në kete rast, ndryshimet prekin edhe pjesën e përgjithshme të Kodit Penal. Në lidhje me pjesën e përgjithshme, vlen të përmenden ndryshime, të tilla si:

- Në nenin 1/c paragrafi i parë, pas fjalëve “*të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit*” shtohen fjalët “*të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve*”.

- Në nenin 34, paragrafi i pestë ndryshohet si më poshtë:

*“Për personat që kryejnë krime për motive fitimi të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, gjykata vendos sipas nenit 36 të këtij Kodi, konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale ose, në mungesë të tyre, dënim me gjobë në masën nga 100 mijë deri në 5 milion lekë.”*

- Në nenin 48 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

*“Rrethana lehtësuese, e parashikuar në shkronjën “e” të paragrafit të parë të këtij neni, nuk lehtëson dënimin e një personi që ka kryer një vepër penale ndaj fëmijëve apo një vepër penale të dhunës në familje.”*

- Pas nenit 52 shtohet neni 52/a me këtë përmbajtje:

*“Përrjashtimi ose ulja e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe viktimat.*

*Personi i dëmtuar nga veprat penale, që lidhen me trafikimin e personit, mund të përfitojë përjashtimin nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë i detyruar t'i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme.*

*Personi që ka kryer njërën nga veprat penale që kanë lidhje me trafikun e narkotikëve, armëve apo municioneve, trafikimin e personave ose për vepra penale të kryera nga organizata kriminale, që bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale në luftën kundër tyre ose, sipas rastit, në zbulimin e personave të tjerë, që kryejnë krime të tilla, nuk mund të dënohet më tepër se gjysma e dënimit të parashikuar për veprën e kryer prej tij. Në raste të veçanta, kur konkurrojnë edhe rrethana lehtësuese në favor të tij, ky person mund të përjashtohet nga dënimi.”*

Për të përmbledhur atë çka është parashtruar më lart, nga analiza e dispozitave të Kodit Penal rezulton se:

---

<sup>71</sup> Një vajzë e shfrytëzuar për vjedhje dyqanesh: “Një vajzë e re mongoleze (D) u arrestua në Holandë për vjedhje dyqanesh. Gjatë marrjes në pyetje, D deklaroi se ajo ishte detyruar që të vidhte. Megjithatë, dha kaq pak informacione të sakta rreth personit që pretendonte se e detyronte, sa që policia nuk ishte në gjendje të bënte asgjë me atë informacion, kështu që D duhet të paguante një gjobë për vjedhjet. Për shkak se D jetonte në Holandë në mënyrë të paligjshme, u bënë përgatitjet për riatdhesimin e saj. Gjatë intervistës me D, Shërbimi i Kthimit dhe Largimit gjeti të dhëna për trafikim qeniesh njerëzore. Kur Shërbimi vazhdoi me pyetjen e saj, doli se ajo kishte qenë e detyruar nga një bandë që të punonte si prostitutë dhe të kryente vjedhje në Holandë. D përfundimisht raportoi se kishte qenë e trafikuar. Ajo u pranua në skemën B9 [rregullim i përkohshëm qëndrimi për viktimat e trafikimit]. Megjithatë, sipas punonjësës së saj sociale, për shkak të dënimit të saj për vjedhje, ekziston mundësia që D-së të mos i lejohet të vazhdojë të jetojë në Holandë. Çështja ndaj trafikantëve ishte ende në proces në kohën që u shkrua kjo pjesë.”

(Burimi: Dutch National Rapporteur on Trafficking in Human Beings, Trafficking in human beings, Seventh Report of the Dutch National Rapporteur (2010), pp. 233-234.)

- **Së pari**, legjislacioni ynë ka rritur dhe përmirësuar numrin e dispozitave ligjore që godasin trafikimin, duke parashikuar vepra të reja penale.<sup>72</sup>

- **Së dyti**, në legjislacionin shqiptar janë bërë ndryshime cilësore, duke përmirësuar strukturën e dispozitave ligjore, me qëllim që të goditet më mirë vepra penale përkatëse. Megjithatë, nga ana e formulimit, disa prej dispozitave mbi trafikimin janë të gjata, në formë komentari dhe jo konçize.<sup>73</sup>

- **Së treti**, të miturve dhe grave, deri në ndryshimet e fundit me ligjin nr. 144/2013, iu është kushtuar rëndësi e veçantë, pasi veprat penale të kryera prej tyre janë trajtuar si figura me vete dhe konsiderohen me rrezikshmëri më të lartë, prandaj dhe dënimet janë më të ashpra.

Në të gjitha rastet, dënimi është më i madh kur viktima është i mitur, kur shfrytëzimi është bërë nga një grup njerzish, për qëllime fitimi, apo kur është përdorur forca, ose kur vepra është kryer në mënyrë të vazhdueshme apo në bashkëpunim me të tjerët, përmes abuzimit të detyrave shtetërore, apo nga organizata kriminale.

- **Së katërti**, gjithashtu, është qartësuar më mirë pozita e subjekteve kriminale (trafikantëve), duke rënduar sanksionet e veprave penale, duke zgjeruar forcën goditëse në drejtim të pasurive të krijuara nga trafikimi.

Gjithashtu me ndryshimet e fundit është zgjeruar rrethi i ndëshkimit për personat që përfitojnë apo përdorin shërbimet e ofruara nga personat e trafikuar si dhe ndaj personave që me veprimet e tyre lehtësojnë trafikimin.

- **Së pesti**, një karakteristikë në lidhje me këto ndryshime, lidhet me faktin se krahas dënimit me burgim si dënim kryesor, në të njëjtën kohë mund të jepet edhe dënim me gjobë. Vlera e gjobës ishte e lartë në mënyrë që goditja të jetë sa më e madhe.

Në nenin 48 të ligjit nr.144/2013 pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim është shfuqizuar.

- **Së gjashti**, bazuar në Strategjinë Kombëtare të Luftës Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore, si dhe instrumentave ndërkombëtare të nënshkruara dhe ratifikuara nga Shqipëria, u bë një rishikim i legjislacionit, me qëllim rritjen e dënimit për forma të caktuara të trafikut të qenieve njerëzore, si dhe bazuar në përvojën ndërkombëtare të

---

<sup>72</sup> Migena Leskoviku, “Njohja me legjislacionin shqiptar mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe disa probleme që dalin në praktikën gjyqësore”, Revista Juridike, Fakulteti i Drejtësisë, UT, Tiranë, Nr.2, 2005.

<sup>73</sup> Ismet Elezi, “E Drejta Penale-Pjesa e Posaçme”, Ribotim, Shtëpia Botuese, “P.S.H 2015”, Tiranë, 2007, fq.132.

dallimit të viktimës nga trafikanti, ku viktima e rritur apo fëmijë duke u trajtuar si e tillë, nuk ndiqet penalisht.

- **Së shtati**, Kodi Penal shqiptar parashikon sanksione për vepra penale që lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me trafikimin e njerëzve dhe fëmijëve. Këtu përfshihen përveç veprave penale të përmendura më lart edhe ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, shfrytëzimi i prostitucionit, financimi dhe dhënia me qera e lokaleve për prostitucion, rrëmbimi i personit si dhe i fëmijës, rrezikimi i jetës së personit duke e shoqëruar me vuajtje të rënda fizike ose psikologjike, rrahje, marrëdhënie seksuale me dhunë, vjedhja e dokumentave të identifikimit, falsifikimi i dokumentave të identifikimit, i pasaportave, i vizave etj.

- **Së teti**, me ndryshimet e bëra me ligjin nr.144/2013 me qëllim zbulimin dhe ndëshkimin e trafikantëve në nenin 52/a parashikohet përjashtimi ose ulja e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe viktimat. Në raste të veçanta, kur konkurrojnë edhe rrethana lehtësuese në favor të tij, ky person mund të përjashtohet nga dënimi.”.

- **Së nënti**, me ndryshimet e fundit Kodi Penal shqiptar trafikimin e ka të ndarë në dy figura veprash penale që gjenden të shpërndara në dy seksione të ndryshme. Kështu, “Trafikimi i personave të rritur” (Neni 110/a) ndodhet në seksionin e “Veprave penale kundër lirisë së personit”; dhe “Trafikimi i të miturve” (Neni 128/b) është përfshirë në seksionin e “Veprave penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”.

Këto vepra penale shoqërohen me dënime kryesore të ashpra kumulative me burgim dhe me dënime plotësuese të konfiskimit të pasurive.

### **3.3. Zhvillime të tjera në legjislacion.**

Një tjetër zhvillim pozitiv ka qenë edhe miratimi i Ligjit nr. 9509, date 3.4.2006 “Për shpalljen e Moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë”<sup>74</sup> i cili pezullon të gjitha lëvizjet e mjeteve motorike lundruese shqiptare në ujërat territoriale dhe të brendshme të Republikës së Shqipërisë, si dhe transportit të mjeteve lundruese në rrugë tokësore, për një periudhë prej 7 vjetësh për të parandaluar dhe goditur trafiket e paligjshme, përfshi këtu edhe atë të personave, drejt Italisë. Si rezultat i miratimit të këtij ligji, që nga periudha e hyrjes së tij në fuqi është ulur ndjeshëm numri i rasteve të trafikimit në rrugë detare.

---

<sup>74</sup> Ligji Nr.9509, datë 3.4.2006 “Për shpalljen e Moratoriumit për mjetet motorike lundruese te Republikës së Shqipërisë”.

Një hap tjetër i rëndësishëm në drejtim të plotësimit të kuadrit ligjor për trafikimin, është edhe miratimi i Konventës së Këshillit të Evropës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore” e cila u ratifikua nga Kuvendi me Ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006.<sup>75</sup> Procedura transparente janë krijuar me Prokurorinë e Përgjithshme dhe atë të Krimeve të Rënda, si dhe me partnerët ndërkombëtarë lidhur me ndjekjet penale të realizuara nga Policia e Shtetit. Në kuadër të forcimit gjyqësor, një hap i rëndësishëm është pajisja e Gjykatës së Krimeve të Rënda me elementët e duhur teknikë për mbrojtjen dhe sigurinë e nevojshme për viktimat e trafikimit që dëshmojnë gjatë një procesi gjyqësor, me “video konferencë”<sup>76</sup>.

Në këtë trajtim nuk mund të lëmë pa përmendur edhe zhvillime të tjera të legjislacionit shqiptar. Këto zhvillime përfshijnë miratimin e disa ligjeve, si Ligji “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”, “Për mbrojtjen e dëshmitarit”, “Për parandalim dhe goditjen e krimit të organizuar”, etj.

Me Ligjin nr.9276, datë 16.9.2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 7905, datë 21.3.1995 ”Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, u bënë disa ndryshime të tjera të rëndësishme proceduriale. Një ndër to është edhe shtimi i nenit 37/a “Bashkëpunimi me drejtësinë”, sipas së cilit:

*“Personi nën hetim ose i pandehuri, që akuzohet për një krim të rëndë, të kryer në bashkëpunim, kur bashkëpunon me prokurorinë dhe gjykatën, duhet të japë informacion të plotë dhe pa asnjë rezervë ose kusht për të gjitha faktet, ngjarjet dhe rrethanat, që shërbejnë prova vendimtare për zbulimin, hetimin, gjykimin dhe parandalimin e krimeve të rënda dhe riparimin e dëmeve të shkaktuara prej tyre. Për dënimin e tij zbatohen rregullat e përcaktuara në nenin 28 të Kodit Penal.*

*Kushtet e bashkëpunimit caktohen në marrëveshjen e mbrojtjes, të hartuar sipas dispozitave të posaçme ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunorëve të drejtësisë.*

*Kur marrëveshja e bashkëpunimit realizohet gjatë gjykimin, gjykata që shqyrton çështjen vendos uljen e masës së dënimit ose përjashtimin nga dënimi, sipas nenit 28 të Kodit Penal.*

*Kur bashkëpunimi kryhet gjatë ekzekutimit të vendimit të dënimit, bashkëpunëtori i drejtësisë mund të kërkojë nga gjykata që e ka dënuar ose nga ajo e vendit të ekzekutimit, ndryshimin e dënimit të dhënë. Gjykata vendos pasi merr edhe mendimin e prokurorit. Marrëveshja e bashkëpunimit mund të revokohet kur bashkëpunëtori i drejtësisë shkel kushtet e përcaktuara ose bën deklaratime të rreme.”*

Krahas ndryshimit të mësipërm, ky ligj ka shtuar edhe nenin 361/a “Pyetja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe e dëshmitarëve të mbrojtur”, i cili parashikon se:

*“Pyetja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe e dëshmitarëve të mbrojtur zhvillohet nën masa të veçanta për mbrojtjen e tyre”<sup>77</sup>, të cilat përcaktohen nga gjykata, kryesisht ose me kërkesën e palëve.*

<sup>75</sup> Ligj nr.9642 datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për trafikimin e qenieve njerëzore”.

<sup>76</sup> Shih Kodi i Procedurës Penale i R.SH. i azhurnuar, Qendra e Publikimeve Zyrtare, www.qpz.gov.al.

<sup>77</sup> Shih “Analizë e sistemit të Drejtësisë penale në Shqipëri-Raporti i programit për zhvillimin e një gjykimi të drejtë”, OSCE, Pegi, Tiranë, 2006.

*Kur disponon mjete teknike, gjykata mund të vendosë që marrja në pyetje e tyre të zhvillohet në distancë me anë të lidhjes audiovizive, sipas rregullave të parashikuara në pikën 7 të nenit 361 të Kodit të Procedurës Penale.*

*Kur ndaj një personi që do të pyetet është vendosur ndryshimi i identitetit, gjykata urdhëron marrjen e masave të përshtatshme për të bërë të mundur që fytyra dhe zëri i personit të mos jenë të dallueshme për palët. Në rast se është e domosdoshme njohja e identitetit ose kqyerja e personit, gjykata urdhëron thirrjen ose shoqërimin e detyrueshëm për përmbushjen e këtij veprimi. Në këtë rast gjykata urdhëron marrjen e masave të nevojshme për të mënjeluar pamjen e dallueshme të fytyrës së personit, të cilit i është ndryshuar identiteti.”*

Nga pikëpamja procedurale, vlen të përmendet krijimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda, e cila është gjykata kompetente për gjykimin e veprave penale të trafikimit. Ligjet përkatëse në këtë pikë që kanë ndryshuar Kodin Penal, janë Ligji nr. 9276, datë 16.9.2004, si dhe Ligji nr. 9911, datë 05.05.2008.<sup>78</sup>

Neni 75/a i Kodit Penal parashikon gjithë gamën e veprave penale të cilësuar si të rënda të cilat janë nën kompetencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda, ku përfshihen edhe figurat e veprave penale të trafikimit. Kështu, Gjykata e Krimeve të Rënda gjykon krimet e parashikuara nga nenet 7,74,75,79 shkronjat “c” dhe “ç”, 109, 109/b, 110/a, 111, 114/b, 128/b, 219, 220, 221, 230, 230/a, 230/b, 231, 232, 233, 234, 234/a, 34/b, 278/a, 282/a, 233/3a, 284/a, 287/a, 333,333/a, e 334 të Kodit Penal, duke përfshirë edhe rastet kur ato janë kryer nga subjekte, që janë në kompetencë të gjykatave ushtarake ose nga të miturit.”

Në gjysmën e parë të vitit 2014, kompetenca lëndore e Gjykatës u shtua me katër figura të reja kundër korrupsionit<sup>79</sup> të parashikuara nga nenet 245, 260, 319, 319/c i KP.

Gjithashtu edhe veprat penale kundër terrorizmit global, të shtuara në KP janë të përfshira në kompetencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda<sup>80</sup>,

*Neni 265/a “Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj”, Neni 265/b “Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj”, Neni 265/c “Thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj”.*

Këto ndryshime ligjore kanë hyrë në fuqi në shtator të vitit 2014<sup>81</sup>.

Duke mbetur në termat e ndryshimeve ligjore dhe për ta bërë sa më të plotë kuadrin ligjor në fuqi, është e rëndësishme të përmendet edhe miratimi i:

<sup>78</sup> Shih *Përmbledhje legjislativi për sistemin e drejtësisë*, Botimi i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Tiranë, 2004.

<sup>79</sup> Ligjin nr. 21/ 2014 datë 10.03.2014 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i RSH”.

<sup>80</sup> Ligji nr. 98/2014, datë 31.07.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i RSH”, i ndryshuar.

<sup>81</sup> Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 132, datë 19 gusht 2014 dhe hyrë në fuqi me datën 02.09.2014.

- Ligjit nr.8633, date 18.09.2000 “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20t”. Qëllimi i tij është të rregullojë mënyrën e regjistrimit, të klasifikimit, të përdorimit dhe të kontrollit të mjeteve lundruese me motor, me tonazh neto të regjistrit nën 20 ton (20NT) dhe ka për qëllim disiplinimin e përdorimit dhe sigurimin e kontrollit të këtyre mjeteve, për të parandaluar kryerjen e veprave penale.

- Ligjit nr.10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunorëve të drejtësisë”<sup>82</sup>. Ky ligj rregullon masat e posaçme, mënyrat dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunorëve të drejtësisë, si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara me propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes. Në zbatim të këtij ligji, ndër të tjera parashikohet edhe shtrirja e nocionit “krim i rëndë”, ku si vepra të tilla penale përmenden edhe ato të parashikuara në nenet 110 shkronja “a”, 114 shkronjat “a” e “b”, 128 shkronja “b”, të Kodit Penal, nene të cilat lidhen konkretisht me format e ndryshme të trafikimit, si dhe dispozitat e tjera penale, që shprehimisht përfshihen në zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Ndërkohë, paralelisht me përmirësimin e legjislacionit material dhe procedural, angazhimi dhe sensibilizimi i shtetit dhe organizmave ndërkombëtare, i organizatave joqeveritare kombëtare ose ndërkombëtare, kanë ardhur vazhdimisht në rritje për të luftuar fenomenin e trafikimit në Shqipëri. Qeveria shqiptare ka hartuar Strategjinë e Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, si dhe ka krijuar mekanizma që të mundësojnë realizimin e saj.

**Të gjitha keto masa kanë ndikuar në përmirësimin e situatës së trafikimit në Shqipëri, por nuk janë të mjaftueshme pa një koordinim të mirë të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tyre praktik, për të cilin ka ende shumë për të bërë, në mënyrë që këto struktura të mos ngelen formale dhe apatike, por t’i shërbejnë qëllimit për të cilin janë ngritur. Theks i veçantë vihet veçanërisht në zbatimin e ligjit nga ana e gjykatave. Këto të fundit kanë një rol kryesor në luftimin e këtij fenomeni, pasi, nëpërmjet vendimeve të tyre mund t’i jepet goditje krimi të organizuar.**

---

<sup>82</sup> Ligji nr.10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunorëve të drejtësisë” shfuqizoi Ligjin nr.9205, datë 15.03.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunorëve të drejtësisë”.

- Ligji nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”<sup>83</sup>. Ky ligj përcakton rrethin e personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, si dhe kompetencat dhe kriteret për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive që lidhen me këto krime. Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar nepërmjet zbulimit, identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, si dhe përcaktimi i mënyrës së përdorimit të këtyre pasurive.

Me konfiskim kuptohet marrja dhe kalimi në favor të shtetit i sendeve që kanë shërbyer ose ishin caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale, si dhe të sendeve, produkteve dhe të çdo përfitimi tjetër, të realizuar a të premtuar, që rrjedh nga vepra penale.<sup>84</sup>

Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova për kategori të caktuar veprash penale<sup>85</sup>, ku përfshihen edhe veprat penale që lidhen me trafikimin, si dhe ndaj një rrethi personash të caktuar<sup>86</sup> që përcaktohen shprehimisht në ligj. Në të parashikohej gjithashtu edhe mënyra e konfiskimit të pasurive dhe përdorimit të pasurive të konfiskuara. Gjithashtu, si organ të posaçëm ky ligj parashikon krijimin e Komitetit Këshillues për Masat Kundër krimit të Organizuar, si dhe krijimin e një fondi të Posaçëm për Parandalimin e Kriminalitetit dhe Edukimit Ligjor duke filluar nga buxheti vjetor 2005 e në vazhdim. Ishte parashikuar që

---

<sup>83</sup> Ky ligj është shfuqizuar me Ligjin nr.10192, date 03.12.2009 2 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nepërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, Fletorja zyrtare nr.181, datë 24 dhjetor 2009.

<sup>84</sup> Shefqet Muci, “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Dudaj, 2007, fq. 253

<sup>85</sup> Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova për:

- a) Pjesëmarrje në organizata kriminale ose në grupe të strukturuar kriminale, sipas parashikimeve të neneve 333 dhe 333/ te K.Penal dhe kryerjen e krimeve prej tyre.
- b) Pjesëmarrja në organizata terroriste ose në banda të armatosura, sipas parashikimeve të neneve 234/a dhe 234/b të K.Penal dhe kryerjen e krimeve prej tyre.
- c) Kryerjen e krimeve të tjera, për qëllime terroriste, të parashikuara në pjesën e posaçme, kreu VII i K.Penal.
- d) Kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283/a e 284/a te K.Penal.

<sup>86</sup> Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj:

- a) Bshkëshortit,
- b) Fëmijëve,
- c) Personave gjini ose krushqi e afërt me personin e dyshuar (të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehri, vjehrra, dhëndri, nusja, kunata, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka).
- d) Personave fizik ose juridik, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, nga personat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.



ky fond të shërbente për mbështetjen financiare të projekteve që synonin administrimin për qëllime institucionale, sociale ose për interes publik të pasurive të paluajtshme të konfiskuara, si dhe për projektet konkrete në këtë drejtim.

Pavarësisht miratimit të tij, ligji nuk pati zbatim praktikë. Për pasojë, ai u shfuqizua me Ligjin nr.10192, date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nepërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Ky ligj zgjeron fushën e veprimit edhe për vepra të tjera penale dhe forcon mjaft pushtetin e drejtësisë për të sekuestruar pasuritë kriminale, përfshirë edhe ato të vëna nga trafikimi i qenieve njerëzore. Më tej, Ligji nr. 10 192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit përmes masave parandaluese kundër pronës”, i quajtur ndryshe si Ligji Anti-mafia, i cili hyri në fuqi në Janar të vitit 2010, krijoi hapësirën e nevojshme për hetimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave kriminale bazuar tashmë mbi indiciet e nevojshme dhe jo mbi prova, si dhe duke e kaluar barrën e provës nga prokurori te i dyshuari. Edhe rrethi i personave të cilët i nënshtroheshin masave parandaluese sipas këtij ligji u shtri më tej edhe mbi të afërmit.

Ky ligj kishte për qëllim jo dënimin, por parandalimin.<sup>87</sup> Për një efikasitet më të lartë kundër terrorizmit dhe trafikimit, ligji Anti-mafia pësoi ndryshime të rëndësishme edhe në vitin 2014, duke krijuar kornizën e duhur për parandalimin e krimit. Sigurisht që në efikasitetin e luftës kundër trafikimit dhe terrorizmit luan më së shumti edhe aplikimi i duhur e cilësor i ligjit, gjë që është për t’u vlerësuar ende.

#### **3.4. Problematikat e praktikës gjyqësor lidhur me ndryshimet legjislative.**

Përveç vështirësive të hetimit, vetë kuadri ligjor paraqet disa probleme që mund të shtrohen për diskutim. Ndryshimet e bëra në Kodin Penal, sidomos ato të viteve 2001 e 2004 që lidhen me dispozitën e “trafikimit të femrave”, krijuan probleme në disa drejtime. Së pari, u krijua një dualizëm mes kësaj dispozite dhe nenit 114/a, “Shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese”. Ende sot nuk është bërë e mundur të hiqet një vijë ndarëse e qartë mes këtyre dy dispozitave, pasi besojmë se për këdo specialist të fushës është e qartë se neni 114/b i përmban të gjithë elementët e anës objektive të nenit 114/a. Kjo sipas mendimit tonë ka krijuar konfuzion dhe ka çuar në

---

<sup>87</sup> Gjykata e Apelit, *Vendim nr. 799*, datë 20.09.2013.

interpretime të sforcuara nga prokuroritë dhe gjykatat. Fillimisht është ndjekur interpretimi sipas të cilit neni 114/a do të aplikohet në rastet kur mendimi kriminal ka lindur dhe veprimet e kundërligjshme janë konsumuar tërësisht jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë apo kur nuk ka pasur zhvendosje të të dëmtuarës, pra krimi është kryer tërësisht brenda territorit të vendit. Për mendimin tim, ky është një interpretim i bërë në kushtet e ekzistencës së dy figurave të veprës penale, ana objektive e të cilave përputhet në pjesën më të madhe, ndërkohë që vetë neni 114/b është mjaft i zgjeruar në kuptim të formave që parashikon, si p.sh rekrutimi, transporti, shfrytëzimi etj. Për rrjedhojë logjike, çdo interpretim që bëhet për dallimin mes dy dispozitave është i sforcuar dhe vështirë se mund të ketë koherencë në qëndrimet e mbajtura nga organet ligj zbatuese.

Kohët e fundit, të paktën në Prokurorinë për Krimet e Rënda, është ndjekur edhe një tjetër interpretim që besojmë është më i drejtë se i pari dhe që lidhet me konsensusin e femrës që ushtron prostitucion. Në rastet kur konstatohet se ka një marrëveshje mes femrës dhe personit që e shfrytëzon, pra femra nuk ka qenë e shtrënguar të hyjë në një marrëdhënie të tillë si në rastet që parashikon neni 114/b i kodit, është bërë cilësimi juridik sipas nenit 114/a të kodit. Për këto arsye mendojmë se ka nevojë për ndryshime tek këto dispozita. Ne vlerësojmë se ka vend që të dyja dispozitat të vazhdojnë të qëndrojnë të veçuara, por dallimi mes tyre duhet bërë më i qartë. Si kriter themelor ndarës duhet që të shërbejë pikërisht vullneti i femrës për të ushtruar ose jo prostitucion, ndërkohë që mund të bëhen rregullime të caktuara tek neni 114/a.

Një tjetër problem i hasur ka qenë edhe aplikimi i nenit 114/b kur veprimet e kundërligjshme që kanë nisur para hyrjes në fuqi të ndryshimeve në kod (viti 2001) dhe kanë vazhduar më tej, ose në rastet kur ka vazhduar edhe pas ndryshimeve të vitit 2004. Këto situata kanë krijuar mjaft konfuzion dhe kanë çuar në interpretime të ndryshme. Një nga qëndrimet ka qenë ai i cili ka konsideruar se janë konsumuar dy vepra të ndryshme penale, si 114/a, pra shfrytëzimi prostitucionit në rrethana rënduese ashtu edhe 114/b, trafikimi i femrave për periudhën pas ndryshimeve në ligj. Ka pasur edhe qëndrime të cilat i kanë kualifikuar veprimet kriminale sipas nenit 114/a të kodit. Mendojmë se shfuqizimi i këtyre dy neneve e ka zgjidhur përfundimisht këtë paqartësi dhe keqinterpretim nga organet ligjzbatuese dhe interpretuese të dispozitave të mësipërme të këtyre neneve të Kodit Penal.

### **3.5. Procesi i të provuarit të krimit të trafikimit.**

Më mirë paraqitet situata me hetimin e veprave penale të kryera vitet e fundit ku ka më tepër mundësi të grumbullohen prova me dëshmitarë apo prova dokumentare si dhe të përdoren më me efikasitet teknikat speciale të hetimit. Tashmë ka edhe raste të hetimit proaktiv të këtyre veprave penale, të cilat janë dërguar edhe për gjykim. Madje nuk mungojnë rastet kur janë arritur të kryhen edhe hetime të koordinuara në kohë reale me autoritetet e huaja.

Mjaft vëmendje i është kushtuar kontaktit me të dëmtuarit, të cilat përveç se konsiderohen si dëshmitarët kyç të hetimit dhe gjykimit, njihen edhe me mundësitë që u ofron ligji për mbrojtje apo për të ngritur padi civile në procesin penal. Në një rast e dëmtuara nga vepra penale është futur në programin për mbrojtjen e dëshmitarit (çështje e vitit 2010).

Gjatë vitit 2011 ka patur ulje të numrit të regjistrimeve për çështje që lidhen me trafikimin, ndërkohë që konstatojmë sërish referime të paplota nga policia gjyqësore. Ndeshe mi shpesh me kallëzime të prindërve të cilët dyshojnë për mundësi të trafikimit të fëmijëve të tyre, por që janë të pambështetura nga të dhëna të tjera që lejojnë regjistrimin e procedimit penal. Megjithatë është synuar në çdo rast orientimi i policisë gjyqësore që të vazhdojë me verifikime të tjera të cilat të krijojnë hapësirat për regjistrimin e procedimit penal. Megjithëse ka një përmirësim të ndjeshëm, ende ka raste të ndalimeve apo arrestimeve të nxituara nga ana e prokurorive në rrethe apo policisë për rastet e trafikimit. Përveç se ato shpesh nuk janë në përputhje të plotë me ligjin procedural, kufizojnë shumë mundësinë e përdorimit të teknikave speciale të hetimit, ndërkohë që në planin afatgjatë, kur çështja lidhet me ekzekutimin e letërporosive për jashtë shtetit, afatet e paraburgimit zgjaten deri në kufijtë e afateve ligjore, duke sjellë dhe dëme të mëdha në planin financiar për shtetin kur çështja duhet të pushohet për mungesë provash. Pikërisht për këto arsye duhet vepruar me shumë kujdes në lidhje me kufizimin e lirisë së personit nën hetim në këto çështje, ndërsa ngelet ende një sfidë shtimi i rasteve të sigurimit të provës në gjykatë, pasi është mjaft e vështirë për organet e ndjekjes penale të gjenden provat e kërkuara nga ligji procedural për të justifikuar një kërkesë të tillë para gjykatës, ndërkohë që rastet e ndryshimit të thënieve të mëparshme nuk janë të pakta.

#### 4. Elementët e veprës penale të trafikimit.

Nga një analizë e dispozitave të Kodit Penal, del se trafikimi i qenieve njerëzore përban tri elemente:

1. **Veprimi.** Ku përfshihen rekrutimi, transportimi, strehimi ose pranimi i personave.
2. **Mjetet.** Përfshihen kërcënimi ose përdorim të forcës apo me forma tjera të detyrimit, rrëmbimit, fallsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër.
3. **Qëllimi.** Ka të bëjë me shfrytëzimin. Shfrytëzimi është përkufizuar si “shfrytëzim i prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllaverinë, robërisë ose heqjes së organeve”.

Dy elementët e para kërkojnë veçanërisht ekzistencën e *actus reus*, ndërsa elementi i tretë kërkon ekzistencën e *mens rea*. Këto elemente janë shqyrtuar më gjerësisht në paragrafët e mëposhtëm.

##### 1. Elementi i “veprimit”.

Elementi i parë *actus reus* ose elementi “i veprimit” mund të plotësohet përmes njëres nga pesë veprimet me radhë, respektivisht: (i) rekrutimi; (ii) transportimi; (iii) transferimi; (iiii) pranimi; ose (iiiii) strehimi i personit.

“*Rekrutimi*” nënkupton punësimin e personit. Nuk kërkohet që rekrutuesi të ketë për qëllim ta paguajë atë person. Rekrutimi mund të ndodhë jashtë vendit e po ashtu edhe në fshatin ose vendlindjen e viktimës<sup>88</sup>.

“*Transportimi*” nënkupton levizjet fizike të personit nga një vend në tjetrin. Kjo nuk kërkon domosdo kalimin e kufijve. Një person mund të trafikohet edhe brenda shtetit<sup>89</sup>.

“*Transferimi*” nënkupton dhënien e kontrollit mbi një person, një personi tjetër, i cili pastaj “e pranon” viktimën e trafikimit. Paguesa me të holla mund të jetë dëshmi që ka ndodhur trafikimi, por nuk është element i nevojshëm në veprën penale të trafikimit.

---

<sup>88</sup>Sipas raportit të Raportuesit special të Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e njeriut, *aspekte të viktimitave të trafikimit me qenie njerëzore, veçanërisht grave dhe fëmijëve, Integrimi i të drejtave të njeriut për gratë dhe perspektiva gjinore*, E/CN.4/2006/62, e 20 shkurtit 2006 (“*Raporti i Raportuesit Special e vitit 2006*”), “trafikimi është trafikim edhe po të ndodhë në fshatin ose qytetin vendlindje të viktimës” (para. 44).

<sup>89</sup>Ibid.

“Pranimi” është marrja e kontrollit mbi viktimën (zakonisht nga ndonjë person që më parë e ka rekrutuar ose transferuar viktimën)<sup>90</sup>.

“Strehimi” nënkupton sigurimin e dhomës ose një hapësire tjetër për personin, por pa e pranuar atë në cilësinë e viktimës (në të kundërt do të ekzistonte “pranimi”).

## 2. Elementi i “mjetit”.

Elementi i dytë *actus reus* i veprës penale të trafikimit është i ashtuquajtur i elementit “mjetit”. Ky kusht aplikohet vetëm nëse viktimë e trafikimit është e moshës madhore. Posaçërisht në Kodin Penal, kërkohet që autori të ketë kryer “veprimet”<sup>91</sup> (rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose pranimin e personave) në raport me viktimën “me mjete të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, fallsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër). Prandaj, vetëm transferimi, pranimi, strehimi, rekrutimi ose transportimi i personit nuk përbën në vetvete veprën penale të trafikimit.

## 3. Elementi “mental”.

Komponenti i fundit i veprës penale të trafikimit është kushti subjektiv, domethënë shfrytëzimi i qëllimshëm i viktimës. Ashtu siç e përmendëm, shfrytëzimi përfshin por nuk kufizohet në prostitucionin, shërbimet e tjera seksuale, punën e detyruar, skllavërimin, robërimin ose heqjen e organeve.

Qëllimi i shfrytëzimit është elementi mental “*dolus specialis*”<sup>92</sup>, dhe kjo do të thotë me fjalë të tjera që “veprimi” dhe “mjeti” të autori duhet të kenë për qëllim shfrytëzimin e viktimës. Prandaj, nuk është e domosdoshme që autori i veprës në të vërtetë ta shfrytëzojë viktimën. Si rrjedhim, nëse “veprimet” dhe “mjetet” e kryera nga autori, (si p.sh. transferimi me përdorim të forcës, pranimi me anë të mashtrimit etj) janë bërë me

---

<sup>90</sup>Kjo nënkupton se vetëm vepra e transferimit mund të detyrojë përgjegjësinë e të dy palëve, shitësit dhe pranuesit. Ngjashëm, personi që transporton si dhe personi që pranon, janë që të dy përgjegjës për trafikim.

<sup>91</sup> Ismet Elezi, “E Drejta Penale-Pjesa e Posaçme”, Ribotim, Shtëpia Botuese, P.S.H 2015, Tirane, 2007.

<sup>92</sup>*Dolus specialis* mund të definohet si qëllim i drejtuar nga kryesi i veprës gjatë kryerjes së veprimit material të veprës penale. Është qëllimi që ka rëndësi, e jo rezultati praktik i realizuar nga kryesi i veprës. Si rrjedhim, arritja e qëllimit nuk është kusht që të përmbushet elementit *dolus specialis*.

qëllim tjetër nga ai i shfrytëzimit të viktimës (p.sh. me qëllim të fitimit të parave nga viktima), vepra penale e trafikimit nuk është kryer.

Sidoqoftë, edhe nëse elementi subjektiv i veprës penale të trafikimit nuk është plotësuar, i dyshuari mund të ndiqet penalisht për krime të tjera (p.sh. lehtësimin e prostitucionit, kontrabandimin me emigrant etj).<sup>93</sup>

Ndërkohë që në lidhje me trafikimin e fëmijëve, nën dritën e Protokollit të Palermos, Kodi Penal e bën të qartë se “rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i fëmijës me qëllim të shfrytëzimit, duhet të konsiderohet si “trafikim i qenieve njerëzore” edhe nëse kjo nuk përfshin asnjë nga mjetet.

Kështu, kur të miturit rekrutohen, transportohen, transferohen, strehohen ose pranohen, nuk është e nevojshme të tregohet që fëmija është mashtruar, kërcënuar etj. Prandaj nuk nevojitet kushti “i mjetit” në rastet kur viktima e trafikimit është fëmijë. Ndaj, vetëm thjesht rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i fëmijës me qëllim të shfrytëzimit, çdo herë i përmbush të gjitha elementët e veprës penale të trafikimit.

#### **4.1. Çështja e dhënies së pëlqimit nga viktima.**

Në rastet e trafikimit me të rriturit mund të paraqitet si problem, nëse ai ka dhënë pëlqimin që t'i nënshtrohet shfrytëzimit p.sh. prostitucionit ose punës së detyruar. Mirëpo kur “pëlqimi” i viktimës është dhënë përmes mënyrave të numëruara në elementin e dytë p.sh., kërcënimit ose përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, fallsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose përfitimit nga gjendja sociale, fizike ose psikike e viktimës, ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër, atëherë pëlqimi i viktimës nuk është i rëndësishëm e as i vlefshëm. Ligji i Kosovës p.sh. e kodifikon këtë interpretim.<sup>94</sup>

Kodi Penal nuk e përcakton fare çështjen e dhënies së pëlqimit lidhur me rastet e trafikimit të fëmijëve. Megjithatë, kjo mund të interpretohet si e parëndësishme ngaqë për trafikimin e fëmijëve nevojitet përmbushja e vetëm dy elementeve, “veprimit” dhe “*mens rea*”. Mjafton të vërtetohet “rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi, ose

<sup>93</sup> Ismet Elezi, “*E drejta Penale-Pjesa e posaçme*”, Ribotim, Shtëpia Botuese, “P.S.H 2015”, Tirane, 2007.

<sup>94</sup> Shih Grup autorësh “*Kërkim Studimor mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore*”, Kosovë, 2007.

pranimi i fëmijes “me qëllim të shfrytëzimit” që vepra të quhet e konsumuar. Nëse ka dhënë “pëlqimin” apo jo fëmija për shfrytëzim, kjo nuk është e rëndësishme për analizën ligjore për të vërtetuar se a është kryer vepra penale apo jo.

#### **4.2. Trafikimi dhe kategori të veçanta të personave të trafikuar.**

Praktikisht ç’do vend European po përballet me problemin e trafikimit të qenieve njerëzore, ose brendapërbrenda kufijve ose si vend pikënisje, pikëmbërritje, tranziti, ose një ndërthurje e tyre. Kjo dukuri nuk është e re, megjithë ndryshimet politike, shoqërore dhe ekonomike që përfshinë kontinentin në dekadën e fundit i kanë vënë një vulë të veçantë dinamikës së trafikimit. Këto ndryshime çuan gjithashtu në një rritje të korrupsionit, mungesës së shtetit të së drejtës, etj, duke mundësuar kështu përhapjen e industrisë së trafikimit. Përgjigjja e qeverive dhe organizatave ndërkombëtare e joqeveritare ishte e shpejtë dhe e përqëndruar. Ajo forcoi në mënyrë të veçantë ligjin dhe aftësitë zbatuese të ligjit për luftën kundër trafikimit, gjithashtu ngriti programe ndihme për viktimat e trafikimit. Sado që dha disa rezultate, kjo lloj qasjeje shpesh u kritikua nga që mungonte fokusimi në të drejtat e njeriut.

Veçanërisht kur flasim për trafikimin në këtë kontekst që lidhet me të drejtat e njeriut, vëmendje e posaçme i kushtohet kategorive të caktuara si: fëmijët dhe femrat.

Trafikimi i fëmijëve shqiptarë, si në vendet fqinje ashtu edhe brenda vendit, ka mbetur një nga fenomenet më shqetësuese, duke i shkaktuar një dëm të madh fizik dhe psikologjik jetës dhe të ardhmes së fëmijëve viktimat, si dhe brezave të ardhshëm të shqiptarëve në përgjithësi.

Në disa raste, braktisja e shkollës në zonat rurale dhe lëvizjet e mëdha demografike të familjeve, veçanërisht nga pjesa verilindore e Shqipërisë, kanë detyruar shumë fëmijë të punojnë në rrugët e qyteteve të mëdha, ku bien viktimë e rekrutimit për veprimtari të paligjshme dhe trafikimit. Në raste të tjera, veçanërisht në komunitetet e marginalizuara, familjet, të panjohura me fenomenin e trafikimit të fëmijëve dhe pasojat e tij, kanë inkurajuar në mënyre aktive dërgimin e fëmijëve të tyre jashtë shtetit me besimin se kjo do t’u siguronte atyre një të ardhme më të mirë, dhe shpesh kanë rënë dakort me të ashtuquajturit “protektorë”.

Lidhur me rrethanat që parashikon paragrafi i dytë i nenit 114/b mendoj se është i drejtë ky interpretim.

- *Së pari*, me trafikim të realizuar në bashkëpunim, do të nënkuptojmë atë lloj trafikimi të femrave për prostitucion, të realizuar nga dy ose më shumë persona mbi bazën e një marrëveshje të thjeshtë, me gojë apo me shkrim. Marrëveshja mund të dalë edhe nga zhvillimi i anës objektive.

- *Së dyti*, me trafik të kryer më shumë se një herë, do të kemi parasysh realizimin e tij në dy apo më shumë raste me kushtin që subjektet kriminale për asnjë nga rastet të mos jenë ndëshkuar më parë.

- *Së treti*, përsa i përket konceptit pasoja të rënda për shëndetin rrjedhojë e trafikut, do të kemi parasysh çdo dëmtim të rëndë fizik apo psikik i shfaqur në formën e gjymtimit të personit, shëmtimit të përhershëm apo dëmtimit të përhershëm që sjellin humbjen e plotë të aftësisë për punë, deri vdekjen e viktimës.

- *Së fundi*, është ekspertimi mjeko-ligjor ai që do të përcaktojë rast pas rasti llojin e pasojës që shoqëron apo pason trafikun e personave.

### **4.3. Trafikantët dhe mënyrat e rekrutimit.**

Autorësia e trafikimit të qenieve njerëzore i'u përket trafikantëve modern të cilët i trajtojnë gratë, burrat dhe fëmijët, si artikuj që mund të blihen dhe të shiten, kalohen nëpër kufij dhe abuzohen, njëlloj si droga apo armët e vjedhura.<sup>95</sup>

Trafikantët modern kanë shumë fytyra. Ata janë diplomatë që importojnë shërbëtorë të cilët i mbajnë më pas të izoluar për të bërë punë të detyruar në shtëpitë e tyre.

Mënyrat e rekrutimit që përdoren janë nga më të ndryshmet:

- **Mashttrim për punë.**<sup>96</sup> Të nxitur nga niveli i lartë i papunësisë dhe niveli shumë i ulët ekonomik, viktimat ndjekin trafikantët të bindur se do të kenë mundësi të punësohen dhe sigurojnë jetesën dhe familjet e tyre. Punët që premtohen janë “shumë të

---

<sup>95</sup> Në gjykimin e çështjes ndaj të pandehurve G.H., akuzuar për kryerjen e veprës penale të trafikimit të femrave për prostitucion, në bashkëpunim me të pandehurin K.Xh., me pasojë vdekjen e viktimës S.K., të pandehurit K.Xh. akuzuar për trafik prostitucioni, më shumë se një here, në bashkëpunim me të pandehurat M.L. e T.L. ndaj dy shtetaseve rumune U.M.R., B.L.M. si dhe të akuzuar për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese, si dhe të pandehurat T.L. dhe M.L. të akuzuara për veprën penale të trafikimit të femrave për prostitucion në bashkëpunim në dëm të shtetaseve rumune, Gjykata e Krimeve të Rënda ka vendosur si masë dënimi për sejcilin nga të akuzuarit përkatësisht burgim të përjetshëm, 25 vite burgim, 8 vite burgim dhe 5 vite burgim. Vlen për t'u theksuar se në këtë vendim janë aplikuar të gjitha mënyrat e rekrutimit nga ana e trafikantëve. Për hollësi të mëtejshme shih vendimin nr. 57, dt. 01.11.2005.

<sup>96</sup> Për më tej shih, *Manualin e përgatitur nga IOM*, Tiranë 2002, fq.17.



leverdisshme” dhe mundësia për të përfituar prej tyre “rrallë të vjen në jetë”. Shpesh punët janë të përshtashme edhe për fëmijët të cilët me kalimin e kohës, me parat e fituara “mund të ndjekin një shkollë dhe të ecin përpara në jetë”.

- Mashtrim për martesë. Trafikantët kanë përdorur shpesh këtë mënyrë rekrutimi. Ata fillimisht krijojnë lidhje dashurie me viktimat e tyre duke e bërë viktimën të besojë se ka gjetur “dashurinë e vërtetë” apo ”shpirtin binjak” prej të cilit nuk mund të ndahet më kurrë. Duke i joshur me përshtime fantastike të mënyrës së ndërtimit të jetës së tyre jashtë shtetit e cila nuk mund të jetë kurrë e tillë këtu ku të mbysin paragjykimet, ata premtojnë parajsën e vërtetë. Viktimat shpesh minorenë, i binden në çdo hap partnerit të tyre, pa ditur se po ecin në rrugën drejt “ferrit”.

- Mashtrim për shkollim. Duke shfrytëzuar pikën e dobët të shumë të rinjëve dhe familjarëve të tyre për arsimim dhe përfitim dijesh në shkollë sa më të lartë, trafikantët bëhen garant për sigurimin e mundësive të tilla. Ata krijojnë marrëdhënie besimi shumë të ngushta me viktimat dhe familjet e tyre, shpesh duke shfrytëzuar njohjen nëpërmjet personave të tretë. Shpesh paraqiten nën maskën e një “prindi” që do të kujdeset “si për fëmijën e tij” dhe “rregullojnë” gjithçka që duhet për realizimin e ëndrrës së këtyre viktimave. Viktimat kur arrijnë në perëndim, detyrohen të punojnë si prostituta, në kundërshtim me vullnetin dhe premtimin për studime.<sup>97</sup>

- Mashtrim për jetë më të mirë. Pre e kësaj mënyre janë zakonisht ato viktimat që deri tani kanë jetuar një jetë tmerrësisht të vështirë janë ndrydhur, dhunuar apo abuzuar në forma të ndryshme.<sup>98</sup> Trafikantët në këtë rast, shfaqen si “dashamirës” të këtyre njerëzve.

- Fejesë/martesa false. Pasi identifikojnë viktimat, kandidatët studiojnë mënyrën më të përshtatshme për të krijuar besim tek to. Shpesh prezantohen nga të tretët të cilët hyjnë garant tek familjet e viktimave për “njeriun e mrekullueshëm” që po kërkon vajzën e tyre. Fejesa dhe martesa kryhen brenda një kohe shumë të shkurtër. Të lumturuar për

---

<sup>97</sup> Xh.Shala. “*Strategjia Kombëtare dhe Sfidat e Integritit*”, Tiranë, 2003, fq.41.

<sup>98</sup> Në gjykimin e çështjes ndaj të pandehurit B.G., akuzuar për kryerjen e veprës penale të trafikimit të femrave për prostitucion, Gjykata e Krimeve të Rënda, pasi ka vlerësuar mënyrën e rekrutimit nga i pandehuri për të jetuar në Itali për një jetë më të mirë dhe rrethanat e tjera të çështjes, ka vendosur si masë dënimi për të akuzuarin 16 vjet burg. *Vendimi nr.26*, dt.29.09.2005.

“fatin që i trokiti në derë” prindërit në shumë raste, i detyrojnë fëmijët të pranojnë martesë të tilla, pa marrë parasyshë moshën dhe dëshirën e tyre.<sup>99</sup>

- Rrëmbim personi. Paraprakisht merren të dhëna rreth jetës së viktimës dhe studiohen lëvizjet e saj. Në momentin e përshtatshëm kryhet rrëmbimi. Ka raste kur viktima ftohet nga shokët, shoqet apo persona të tjerë të afërt të lidhur me trafikantët për të shkuar në festa, disko, etj. Pranimi i ftesës e bën akoma më të lehtë procesin e rrëmbimit të saj.
- Dokumenta udhëtimi false. Shpesh trafikantët i detyrojnë viktimat e tyre të udhëtojnë me dokumenta false. Qëllimi i përfitimit në këtë rast është jopasuror.<sup>100</sup>
- Lajme të rreme në gazeta/agjenci turistike. Viktimat mund të joshen nga çmimet fantastike dhe organizimi “i përkryer” i udhëtimeve turistike etj.

## 5. Trafikimi i njerëzve.

### 5.1. Elementet e veprës.

Ashtu si për të gjitha veprat penale, edhe për trafikimin, e drejta penale parashikon analizimin e tërësisë së elementeve objektive dhe subjektive për këto figura krimi.

**Objekt i krimit** të trafikimit të njerëzve konsiderohen marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë personale të sanksionuara në Kushtetutë, shëndetin dhe jetën e njeriut të mbrojtura nga Kodi Penal si dhe rregullat e vendosura për kalimin e kufirit të shtetit shqiptar nga veprimet kriminale<sup>101</sup>. Trafikimi në ditët e sotme ka marrë shtrirje të madhe. Liritë dhe të drejtat e personit si edhe dinjteti i tij moral e shoqëror garantohen vetëm në një shtet juridik.

**Ana objektive** kryhet me veprime aktive të kundërligjshme që konsistojnë në trafikimin e njerëzve me çdo mjet, anije, avion, automjete, barka, skafe, gomone etj. duke i transportuar nga territori shqiptar në territor të huaj, nëpërmjet tokës, detit e ajrit.<sup>102</sup> Ky lloj trafikimi kërkon disa aktivitete ndërkufitare si transportimi i organizuar i njerëzve ose bërja e një kontrate ndërmjet kërkesës dhe ofertës në rajone të ndryshme nga njëri-tjetri me kufij ndërkombëtarë. Trafiku i klandestinëve ka marrë përmasa të tilla sa që

---

<sup>99</sup> Në gjykimin e çështjes ndaj të pandehurve B.S., B.S., E.K. dhe P.L., akuzuar për kryerjen e veprës penale të trafikimit të femrave për prostitucion, Gjykata e Krimeve të Rënda, duke vlerësuar faktin se i pandehuri B.S i kishte premtuar viktimës se do t'i gjente një djalë të mire për fejesë, si dhe kryerjen e veprës penale në bashkëpunim, ka vendosur si masë dënimi për secilin nga të akuzuarit 16, 15, 16 dhe 15 vjet burg. *Vendimi nr. 6, dt. 03.02.2005.*

<sup>100</sup> I. Elezi, vep. cit. faq. 136.

<sup>101</sup> I. Elezi, vep. cit. fq. 133.

<sup>102</sup> I. Elezi . vep. cit. fq. 133.

mund të quhet “biznes shumëfitimprurës” ose “biznes në hije”. Do të ishte gabim po të mendohej se ky trafik kryhet rast pas rasti nga persona të veçantë që nuk kanë lidhje njeri me tjetrin. Përkundrazi, jo vetëm që organizatat kriminale në këtë lloj trafiku kanë penetruar nga jashtë në Shqipëri, por janë krijuar dhe grupe kriminale vendase. Shumica e trafikut të shtetasve të huaj drejtohet nga një rrjet ndërkombëtar trafikantësh që fillojnë në Kinë ose Turqi dhe nëpërmjet Shqipërisë kanë destinacion Italinë. Brenda këtyre rrjeteve, kontributi i anëtarëve të organizatave kriminale jepet në: pritjen e klandestinëve, transportimin e tyre brenda kufirit shqiptar, strehimin, vënien në dispozicion të mjeteve të lundrimit si skafe e anije kundrejt çmimeve tepër të larta. Nga studimi i rasteve dhe veçanërisht nga hetimet e kryera ka rezultuar se shpeshherë në këto organizata kriminale, në transportimin e klandestinëve bashkëpunojnë dhe punonjës policie të veçantë të qyteteve bregdetare.

**Subjekt i krimit**, mund të jetë trafikanti, personi që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm. Subjekt të vepres penale konsiderohen edhe shtytësit, ndihmësit dhe organizatorët e shoqatës kriminale.<sup>103</sup> Si rregull këta janë profesionistë, recidivistë.

**Ana subjektive**, krimi kryhet me dashje direkte përsa i përket veprimit, ndërsa ndaj pasojave kriminale të dëmshme për shëndetin ose për jetën e personave, krimi mund të kryhet me dashje indirekte apo nga pakujdesia, sipas rrethanave konkrete të çeshtjes.<sup>104</sup> Motivi është shumë i rëndësishëm si komponent psikologjik i jetës shpirtërore e cila shtyn personin të ndërmarrë veprimin e caktuar dhe zbulon faktorin intim i cili ka ndihmuar që personi të vendosë dhe të kryejë veprën penale.<sup>105</sup> Në të shumtën e rasteve, motivi është i lidhur ngushtë me qëllimin i cili është përfytyrim mbi pasojën e veprës penale, apo mbi ndonjë rrethanë tjetër që është e rëndësishme për të drejtën penale.<sup>106</sup>

Rregullimi i organizimit të shoqatës kriminale me norma të posaçme, veçmas është i kushtëzuar nga natyra juridike e përgjegjësisë penale të organizatorit të shoqatës kriminale dhe veprat penale që kryhen nga shoqata. Tek organizimi i shoqatës kriminale lidhja subjektive dhe objektive midis organizatorit të shoqatës kriminale në një anë, dhe anëtarëve të shoqatës kriminale në anën tjetër, është shumë më e ç’lirë. Këto qëndrojnë

---

<sup>103</sup> I. Salihu, vep. cit. fq. 189

<sup>104</sup> I. Elezi . vep. cit. fq. 136

<sup>105</sup> I. Salihu, vep. cit. fq. 303

<sup>106</sup> I. Salihu, vep. cit. fq. 302

në një distancë më të largët dhe lidhja e tyre është më e dobët se te format e tjera të bashkëpunimit.<sup>107</sup>

## **5.2. Trafikimi i njerëzve – preferencë e krimit të organizuar.**

Diskutimi i trafikut të njerëzve bën pjesë brenda një teme akoma më të gjërë që është ajo e krimit të organizuar ndërkombëtar. Nga të gjitha rrugët e ndjekura nga emigracioni klandestin për kalimin nga Ballkani në Europën Perëndimore, rruga nëpërmjet Shqipërisë cilësohet si përrallore. Pozicioni gjeografik i Shqipërisë, si porta e vendeve të lindjes drejt perëndimit u shfrytëzua edhe nga shtetas të huaj si, shtetas turq me kombësi kurde, kineze, etj. Aktualisht nga shumë raporte të organizmave ndërkombëtare, Shqipëria konsiderohet si një vend me trafik të lartë të njerëzve për qëllime përfitimi. Ajo paraqitet si një vend ku trafikantët dhe rrjetet mafioze rekrutojnë njerëz me qëllim furnizimin e tregjeve ilegale të perëndimit, por edhe si vend tranziti për vendet e tjera të lindjes<sup>108</sup>.

Duhet theksuar edhe një herë se trafiku i njerëzve është një fenomen ndërkombëtar. Padyshim, që disa grupe kriminale janë specializuar në trafikim, sidomos ato grupe që veprojnë në ato vende që karakterizohen nga një shkallë e lartë emigracioni si për shkak të presioneve të brendshme dhe faktorëve të tjerë shtytës. Megjithatë, nuk janë vetëm perspektiva e krimit të organizuar dhe i kontrollit të tij që duhet përmendur për sa i përket krimit. Është e qartë që lidhur ngushtë me këtë problem është emigracioni i paligjshëm. Rasti më i pastër i trafikut të njerëzve do të ishte p.sh. kur një person nis për në vendet e perëndimit, por nuk ka para për të paguar udhëtimin. Kur personi arrin në destinacion, qëndron për shumë kohë nën urdhrat e trafikantit për të shlyer detyrimin, kjo bën që trafikanti të jetë pronar mbi këtë njeri. Ky është rasti me klasik i trafikimit të njerëzve e cila është një formë moderne e skllavërisë së njerëzve.<sup>109</sup> Një formë e tillë për realitetin shqiptar është thuajse e pamundur. Ajo gjen zbatim për kinezët të cilët shfrytëzohen sipas një forme të tillë. Prapa bosëve Shqiptarë dhe Italian të trafikut të

---

<sup>107</sup> I.Salihi, *E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme*, Prishtinë 1995, fq.243

<sup>108</sup> Avni Jaçellari, Drejtor për anti-trafikimin në ministrinë e rendit në Tiranë, thotë se sipas një studimi të bërë vitin e kaluar, 5100 vajza të reja shqiptare gjendeshin në perëndim të trafikuar për të punuar në rrugë. Policia shqiptare ka shkatërruar 75 grupe kriminale, që merreshin me trafikimin e vajzave, ka arrestuar 500 tutorë dhe 120 persona dënuar deri tani nga 5 deri në 20 vjet burg. Radio "Zëri i Amerikës", 9 tetor 2003, Linda Karadaku.

Këtë vit ka pasur 68 raste denoncimesh për trafikantë dhe grupe trafikantësh.

<sup>109</sup> Raporti "Trafiku i Personave 2001" Departamenti i Shtetit Sh. B. A.

njerëzve shpesh shfaqen ndonjëherë dhe “kumbarët” e frikshëm të mafias kineze, të futur në Itali.

Tiparet dhe karakteristikat e krimit të organizuar, në kuadër të të cilit kryhet edhe trafikimi, janë:

1. Krimi i organizuar karakterizohet nga qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e veprimtarisë kriminale. Subjektet e këtij krimi nga të dhënat e hetimeve të disa proceseve që disponojmë, vazhdimisht janë përpjekur për të rritur në maksimum aktivitetin e tyre. Vazhdimësia e këtij aktiviteti kriminal, nga i cili autorët synojnë garantimin e fitimeve në rritje, përbën dhe një nga karakteristikat më të qëndrueshme të këtij krimi.

2. Krimi i organizuar kërkon të përdorë operacione të zakonshme biznesi, me qëllim që të qarkullojë dhe investojë fitimet e jashtëzakonshme që kanë ardhur nga aktiviteti i tyre kriminal. Veprimtaria e tyre nuk mund të ketë jetëgjatësi pa një financim të vazhdueshëm të strukturave të tyre. Njohja sa më e mirë e këtij tipi të krimit të organizuar, na bën të mundur për të krijuar një vizion më të drejtë, jo vetëm në zbulimin dhe identifikimin e rrejtësive të tyre, por edhe të teknikave të hetimit që duhet të përdoren për të qenë të suksesshëm. Drejtuesit e krimit të organizuar duke transformuar paratë e tyre, që vijnë drejtëpërdrejt nga kriminë veprimtari biznesi në dukje, paraqiten para opinionit publik dhe strukturave të shtetit si biznesmenë të suksesshëm, e në disa raste dhe si financues humanitarë. Ky tipar specifik i këtyre krimeve të krimit të organizuar jo rrallë i çon ata të mpleksen dhe me funksione në strukturat e shtetit ose dhe në politikë.

3. Tipar tjetër dallues është dhe struktura e krimit të organizuar. Struktura varion në varësi të veprimtarisë së kundërligjshme që ata kryejnë. Sa më i madh të jetë aktiviteti kriminal aq më i theksuar paraqitet shkallëzimi hierarkik i saj. Hierarkia e saj presupozon në të njëjtën kohë dhe centralizmin e aktivitetit. Krimi i organizuar ka normat dhe rregullat e funksionimit të tij të pashkruara. Shkelja e urdhërave dhe rregullave brenda anëtarëve të organizates kriminale ka çuar jo rrallë herë në vrasje brenda kësaj organizate.

4. Tipar tjetër i rëndësishëm i krimit të organizuar është se ai kooperon me disa aktivitete tradicionale kriminale. Kështu fitimet që krijohen nga krimi i organizuar ekonomik, vihen në dispozicion për financimin e krimeve më të rënda siç është trafiku i narkotikëve. Më e rrezikshme bëhet kjo pasi jo rrallë herë konstatohen raste të

bashkëpunimit të krimit të organizuar me organizata terroriste. Këto të fundit shpenzojnë shuma të jashtëzakonshme për të mbajtur gjallë strukturat e tyre.

### **5.3. Trafikimi si pjesë e krimit të organizuar ndërkombëtar.**

Krimi i organizuar ndërkombëtar ka një dimension ndërkombëtar. Ai vepron përmes kufijve dhe nën juridiksionin e të paktën dy shteteve. Globalizimi është shoqëruar nga një rritje dramatike e krimit të organizuar. Kriminelët veprojnë në mënyrë ndërkombëtare me drogën, femrat e trafikuar, armët, makinat dhe veprat e artit. Pasojë e krimit të organizuar është nënvleftësimi i bazës demokratike dhe ekonomike, përmes korrupsionit, dobësimit të institucioneve dhe humbjes së udhëheqjes së ligjit.

Padiskutim që pasojat negative janë jo vetëm për personin viktimë, por ato vihen re edhe për vetë shtetin. Kështu, pasojat negative që sjell ky fenomen kriminal për Shqipërinë mund të identifikohen si më poshtë:

1. Pengohet integrimi i Shqipërisë në Evropë. Një ndër kushtet vendimtare sa i takon integrimin të shumëdëshiruar të Shqipërisë në gjirin Evropian, ka të bëjë direkt me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
2. Pengohet seriozisht zhvillimi i vërtetë dhe i ndershëm i vendit. Një biznes i dyshimtë nuk sjell kurrë të ardhme të ndritur. Paraja që vjen nga krimi i organizuar është provuar që është kundër zhvillimit, sepse ajo dëmton në mënyrë serioze ekonominë dhe nuk mund të sjellë kapërcimin e problemeve të një shoqërie në tranzicion.
3. Krijohet një ekonomi informale. Shuma të mëdha parash kanalizohen përmes burimeve informale. Paraja nuk qarkullon përmes bankave ose mjeteve të njohura të ligjshme, por përmes burimeve të paligjshme dhe informale. Kjo krijon një ekonomi të brishtë dhe të paqëndrueshme, pavarësisht se mund të ketë ndikim në rritjen ekonomike të vendit.
4. Reputacioni i vendit jashtë kufijve të tij, është njollosur në mënyrë serioze. Kjo shkaktohet nga ata elementë kriminal shqiptarë të krimit të organizuar që veprojnë në shkallë të gjërë në Europën Perëndimore.

Trafikimi i personave klasifikohet nën titullin e Krimit të Organizuar Ndërkombëtar. Format në të cilat shfaqet krimi i organizuar i këtij dimension përfshijnë:

1. Trafikimi i narkotikëve dhe armëve;
2. Kontrabandimi dhe trafikimi i qenieve njerëzore;

3. Abuzimi me teknologjitë e reja për të vjedhur, mashtruar, ose për t'ju shmangur ligjit;
4. Pastrimi i të ardhurave nga krimi.

Këto forma përbëjnë një biznes global të organizuar nga rrjete kriminale. Trafikimi i personave është organizuar nga grupe kriminale që trafikojnë klandestinë, që gjithashtu përfshihen në lloje të tjera të kriminalitetit të organizuar, të tilla si narkotikët, makinat, armët. Strukturat e këtyre grupeve variojnë nga grupe të vogla amatore deri tek organizata me struktura ndërkombëtare.

Elementët kryesorë të krimit të organizuar ndërkombëtar, ku përfshihet edhe trafikimi, janë:

1. I kryer nga një Grup i Organizuar Kriminal.

Trafikimi i personave është një formë e krimit të organizuar ndërkombëtar të kryer nga një grup “kriminal i organizuar”. Ky është një grup i strukturuar<sup>110</sup> që synon të kryejë krim të rëndë ndërkombëtar përmes kërcënimit, dhunës, korrupsionit ose mjeteve të tjera, në mënyrë që të përfitoj direkt ose indirekt një përfitim financiar, ose përfitim tjetër material. Pra, trafikimi mbështet mbi shfrytëzimin e pastër, mashtrimin dhe gënjeshtren.

2. Maksimizimi i fitimit/përfitimit ekonomik.

Trafikimi i personave si një krim i organizuar mund të diferencohet nga “krimi ordiner” nga shkalla që ai ndjek me parimet ekonomike. Qëllimi kryesor i krimit të organizuar është të maksimizojë fitimet dhe përfitimet ekonomike. “Krimi ordiner” është ai lloj krimi ku të ardhurat mbahen nga keqbërësi i veprës penale. Suksesi i krimit të organizuar varet nga tregjet e paligjshme, ekzistenca e të cilave ka të bëjë direkt me veprimet e qeverive.

## **6. Trafikimi i femrave.**

### **6.1. Analiza ligjore dhe të dhëna sasiore.**

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë kishte parashikuar këto sanksione për veprën penale të trafikimit të femrave, të parashikuara në nenin 114/b.

---

<sup>110</sup> Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale. Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një vepre penale nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash organizim dhe strukturim të zhvilluar. Neni 28 pika “4” të K.Penal, Tiranë, 2004, fq.23.

Në paragrafin e parë të këtij neni (*Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e femrave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike a psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve, për të marrë pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose trasplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit...*), si sanksion penal parashikohet dënim me burgim nga 7 deri në 15 vjet burgim dhe gjobë nga tre milion deri në gjashtë milion lekë.<sup>111</sup>

Sipas paragrafit të dytë, (*Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të femrave*) ky krim dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga pesë milion deri në shtatë milion lekë.

Sipas paragrafit të tretë:

*“Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të së dëmtuarës për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin e saj”*

Ky krim dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet, dhe me gjobë nga gjashtë milion deri në tetë milion lekë.

Sipas paragrafit të katërt (*Kur ka sjell si pasojë vdekjen e të dëmtuarës*), krimi i trafikimit dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga shtatë milion deri në dhjetë milion lekë.

Dhe sipas paragrafit të pestë (*Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik*), trafikimi i femrave i kryer nga subjekte të posaçme, dënimin me burgim dhe gjoba shtohen me 1/4 e dënimit të dhënë.<sup>112</sup>

Në Ligjin Nr. 144/2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, trafikimi i femrave është rrethana cilësuese në paragrafin e dytë të nenit 110/a me këtë paraqitje:

*“Kur kjo vepër kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet”.*

Nga sa u tha me sipër, trafikimi për prostitucion është më i përhapuri ndër trafikimet. Për këtë arsye, do të fokusohemi kryesisht tek kjo formë shfaqje e kësaj vepre penale.

Termi prostitucion vjen nga latinishtja dhe fjalorët që e zbërthejnë këtë fjalë i kanë dhënë kuptimin e ofertës, me interes, për të kënaqur dikë, për të shitur diçka që është

<sup>111</sup> Për më tej shih nenin 114/b të K. Penal, Tetor 2004, fq.66.

<sup>112</sup> Shtesat dhe ndryshimet e bëra në K. Penal me ligjin Nr. 9188 datë 12. 02. 2004, janë publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 13/2004.



destinuar për të mos u shitur.<sup>113</sup> Prostitucioni mund të përcaktohet si dhënia e favoreve seksuale për para ose kundrejt parave. Studiuesit kanë cilësuar dallimin midis dashnores me pagë dhe prostitutës. Kjo e fundit ofertën seksuale ua bën shumë blerësve. Fjala prostitutë fitoi përdorim të zakonshëm në fundin e shekullit XIX. Në botën antike shumica e ofrueseve të seksit kanë qenë kurtizane, konkubina (dashnore që mbaheshin rregullisht) ose skllave.<sup>114</sup>

Paul Golbstein (1979) i ka klasifikuar llojet e prostitucionit nga pikëpamja e angazhimit në punë dhe e rrethanave të punës. Angazhimi në punë lidhet me shpeshtësinë e përfshirjes së një gruaje në prostitucion.

Rrethanat e punës nënkuptojnë llojin e mjedisit të punës. Një prostitutë rrugë e kërkon biznesin në rrugë. Një vajzë me telefon i kërkon klientët, apo kërkohet prej tyre, përmes telefonit. Një prostitutë shtëpie punon në një shtëpi apo klub privat. Në lidhje me këtë të fundit, në kushtet e legalizimit, prostitucioni ushtrohet në qendra legale, në shtëpi publike.

Përmasat e prostitucionit është vështirë të llogariten me shifra qoftë edhe për arsye se prostitucioni ushtrohet kryesisht si një treg ilegjitim, pra si një trafik i seksit dhe i vetë grave të destinuara për këtë treg. Vlera e “mallit seks” llogaritet të jetë e rendit dhjetra bilion dollarë në vit. Sipas ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës), të ardhurat që vijnë nga tregtia e seksit konsiderohen si komponent i rëndësishëm i të ardhurave kombëtare të shumë vendeve të varfëra, të cilat kanë një sektor (zë), të veçantë që quhet “sektori i seksit”.

Në Europë, më shumë se ç’do kontinent tjetër, prostitucioni ka marrë trajtën e një trafiku ndërkombëtar, të destinuar për tregjet e prostitucionit të vendeve kryesore perëndimore. Kjo përfaqëson një veprimtari kriminale gjithnjë e në rritje. Sipas një vlerësimi të kryer nga IOM (Organizata Nderkombëtare për Migrimet), rreth ½ milioni femra prej vendeve të Europës Qendrore e Lindore, janë përfshirë në tregjet e seksit të Europës Perëndimore.<sup>115</sup> Nga burime të tjera jepen shifra më shqetësuese. Thuhet, për shembull, se përmes trekëndëshit Mal i Zi – Kosovë – Serbi, kanë kaluar rreth 700 mijë

---

<sup>113</sup> Zingarelli, Nicola, *Vocabolario della lingua italiana*. Bologna, 1970, p.1360: Zanichedi SPA.

<sup>114</sup> Giddens, Anthoni.1998. *Sociologjia*. Tiranë, p.201.

<sup>115</sup> Arlecchi, Pino. *Skllavet e Perëndimit. Pas gjurmëve të tregtarëve të Mishit Bardhë*. Tiranë 2000, fq.10.

femra të destinuar për në tregun Europian të prostitucionit.<sup>116</sup> Shqipëria është vend origjine dhe tranzitimi kryesisht për gratë dhe vajzat e trafikuar për qëllime të shfrytëzimit seksual në drejtim të Italisë, Greqisë, Belgjikës, Francës dhe Hollandës.<sup>117</sup> Viktimat vijnë kryesisht nga Rumania e Moldavia dhe në numër më të vogël nga Bullgaria e Ukraina.

Më shumë se 5.000 femra shqiptare kanë qenë viktime të trafikimit në dekadën e fundit të shekullit XX. Vlen për t'u kujtuar se nga mesi i viteve 1990, OJQ të ndryshme shqiptare raportonin se mijëra gra dhe fëmijë ishin mashtruar me anë të martesave të rreme, të ofertave për punë ose thjesht ishin rrëmbyer apo shitur për t'ia nenshtruar prostituimit në Europën Perëndimore.<sup>118</sup>

Trafikimi i femrave për prostitucion është një nga format më të ashpra të krimit të organizuar të qenieve njerëzore. Ky aktivitet kriminal ushtrohet nga struktura të organizatave kriminale, me detyra të ndara për futjen e femrave në rrugën e prostitucionit, siç janë gjetja dhe studimi i femrave për prostitucion, strehimi në vende të përshtatshme dhe trafikimi i tyre nga një vend në tjetrin, mbikqyrja e prostitutave, kontrolli i klientëve dhe grumbullimi i fitimeve. Biznesi i këtyre organizatave është i përmasave të jashtëzakonshme. Tutorët e femrave që ushtrojnë prostitucion janë skllavërues, ç'njerëzorë dhe të zhveshur nga çdo normë morale dhe njerëzore. Nëpërmjet mashtrimit, presionit, dhunës psikike dhe fizike shpesh ç'njerëzorë deri në rrëmbime,<sup>119</sup> Anëtarët e këtyre organizatave marrin femra dhe i transportojnë ato nëpër rrjetet e prostitucionit. Në kuadrin e mashtrimit, subjektet e këtyre veprave penale bëjnë edhe ndërmjetësime fiktive për martesë për të tërhequr vajzat në prostitucion nga Shqipëria për në vendet e Evropës Perëndimore. Anëtarët e këtyre organizatave kriminale në Shqipëri, fillimisht kanë qenë individë që e kanë realizuar këtë trafik në mënyrë të thjeshtë, por aktualisht ata në disa rajone dhe disa vende fqinjë po dominojnë tregun e prostitucionit dhe zonat e influences. Bandat shqiptare kanë bërë marrëveshje me mafien italiane në Puglia që u lejon lëvizje të lirë në atë zonë në shkëmbim të mosndërhyrjes së tyre në kontrabandën italiane të cigareve përmes Adriatikut.<sup>120</sup>

<sup>116</sup> Kallaba, I.Zyrtarë të lartë malazezë trafikantë prostitutash. Gazeta Panorama: 16 dhjetor 2002.

<sup>117</sup> Pjesë nga «Raporti për Trafikimin e Personave», të Vitit 2002, Departamenti i shtetit Sh.B.A.

<sup>118</sup> «Në Dobi të Gruas Shqiptare», Raport “Prostitucioni: Shoqëria në Dilemë”, Tiranë 1997.

<sup>119</sup> Për më tej shif Xh.Shala, vep.cit., fq.45.

<sup>120</sup> Raport i AP (Romë) mbi komentet e bëra nga senatore Tana de Zulueta, Komiteti Antimafia i Parlamentit Italian, Janar 2001.

Trafikantët e femrave janë bërë pjesë e një zinxhiri të gjerë kriminal në Evropën Lindore duke mashtruar, blerë e rrëmbyer vajza në moshë të re nga rajonet e Rumanisë, Ukrainës, Moldavisë dhe Bullgarisë dhe nëpërmjet Malit të Zi i trafikojnë për në Itali. Shqipëria nga një vend që fillimisht siguronte vetëm prostituta, aktualisht luan rol të dyfishtë duke u përfshirë në kalimin ndërkombëtar të një trafiku të tillë. Të trafikosh do të thotë të blesh ose të shesësh duke realizuar të ardhura jo të ligjshme, në formë të fshehtë dhe me mjete të paligjshme.

## **6.2. Rrethanat cilësuese në veprën penale të trafikimit të femrave.**

Një tjetër problem që vlen të diskutohet ka të bëjë me rrethanat cilësuese të nenit 114/b, si p.sh. kryerja më tepër se një herë e veprës apo bashkëpunimi. Praktika e deritanishme me të drejtë ka konsideruar se do të konsiderohet si e kryer më tepër se një herë kjo veprë kur nuk ka një dënim të mëparshëm për episodet e mëparshme. Problemi qëndron tek masa e dënimit që aplikohet pasi në rast se personi është recidivist merr një dënim në minimum 7 vjet burg, ndërkohë që nëse e ka kryer dy ose më tepër herë këtë krim, pa u dënuar për ndonjërin nga rastet, dënohet me të paktën 15 vite burg. Këtu mendoj se ka nevojë për ndërhyrje pasi duket krejt e paarsyeshme të bëhet një diferencim kaq i madh dhe të dyja situatat duhet të vlerësohen në mënyrë të përafërt. Vetë Kodi Penal dënimin e mëparshëm për një veprë penale e cilëson si një rrethanë rënduese e që mbahet parasysh në caktimin e masës së dënimit, ndërkohë që sipas rregullimit aktual ligjor të nenit 114/b, kjo kthehet në favorizuese për subjektin e veprës penale, ndërsa do të duhej të ndodhte e kundërta.

Edhe në rastin e bashkëpunimit, ne e shohim si mjaft të lartë minimumin që parashikon ligji pasi nuk ka asnjë justifikim që personi të marrë dyfishin e dënimit për një rrethanë që kodi e vlerëson si rënduese në shumicën e dispozitave dhe madje edhe në rastin e dispozitave ku bashkëpunimi parashikohet si rrethanë cilësuese, diferenca në masat e dënimit është dukshëm më e ulët, si p.sh rasti i trafikimit të lëndëve narkotike.

Ky parashikim ligjor duket edhe më absurd nëse do të merrnim parasysh rastet kur vepra kryhet në kuadër të grupit të strukturuar, ku subjekti mund të dënohet më pak se në rastin e një bashkëpunimi të thjeshtë.

Kemi mjaft raste kur individë që në bashkëpunim arrijnë të rekrutojnë një femër për ta shfrytëzuar për prostitucion por pa arritur të avancojnë më tej në shfrytëzimin e të

dëmtuarës, dënohen më shumë se një person që ka arritur ta shfrytëzojë të dëmtuarën, dhe kjo për shkak të diferencës së madhe në marzhet e dënimit mes paragrafëve përkatës. Sërish mendojmë se është e pajustificueshme që organizuesi apo financuesi i trafikimit të femrave të dënohet nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet burg, ndërsa në rastin e bashkëpunimit të thjeshtë dënimi është sërish më i lartë.

Këto probleme si dhe çështje të tjera do të demonstrojnë nevojën për një riformulim tërësor të neni 114/b të Kodit Penal, i cili duhet të thjeshtohet në përmbajtjen e tij, duke marrë parasysh natyrisht dhe kontradiktat që ai krijon me nene të tjerë të Kodit Penal.

## **7. Trafikimi i fëmijëve.**

### **7.1. Analiza juridike.**

Gjatë trajtimit të problemit të të miturve, rëndësi paraqet dhe studimi i figurës së të miturit si i dëmtuar nga vepra penale. Kjo, pasi kriminaliteti studiohet edhe nga këndvështrimi i viktimës së tij.<sup>121</sup> Mirërritja dhe interesat e fëmijëve dhe të adoleshentëve duhet të jenë objektivat parësorë për çdo shoqëri. Për shkak të moshës së mitur që përbën një rrethanë specifike e cila e dallon nga individët madhorë, fëmija duhet të përfitojë një mbrojtje të veçantë dhe lehtësira të mjaftueshme në mënyrë që të rritet i shëndetshëm dhe normal nga ana fizike, intelektuale, morale e shpirtërore.

Organizatat Ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara (OKB) kanë pranuar se fëmijët kanë të drejtë për masa të veçanta mbrojtje dhe ndihmë duke e shpallur këtë në Deklaratën e të Drejtave të Fëmijës (1959) dhe në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Është papjekuria fizike dhe intelektuale e fëmijës që kërkojnë mbrojtje të përshtatshme juridike para dhe pas lindjes. I mituri është një person që ende nuk i ka fituar të gjitha zotësitë për të qenë plotësisht i pavarur dhe të përballojë problemet jetësore, ndër to dhe aftësinë për t'u mbrojtur nga një vepër penale kundër tij. Legjislacioni penal shqiptar, në kohë të ndryshme, ka parashikuar disa vepra penale, të krimeve ose kundërvajtjeve penale ku si subjekt pasiv paraqitet i mituri.

Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në paragrafin e parë shprehet se:

*“Fëmijët, të rinjët, gratë shtatëzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti”, ndërsa në paragrafin e tretë shprehet që: “Ç’do fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojnë shëndetin, moralin ose të rrëzikojnë jetën a zhvillimin e tij normal”.*

<sup>121</sup> Hysi V. ”Hyrje në kriminologji dhe penologji”, botim i Ilar, Tiranë 2000, faqe 45.

Edhe Kodi Penal në fuqi, ka parashikuar një sërë veprash penale duke i kushtuar vëmendje të posaçme të miturit, i cili për shkak të moshës së vogël nuk mund të mbrohet nga veprimet kriminale e të kundërligjshme dhe në këtë artikull do të trajtohet vepra penale e *trafikimit të fëmijëve*, e cila nuk është problem i një shteti të vetëm, por një fenomen ndërkombëtar që përfshin vende të ndryshme dhe sjell pasoja të rënda. Trafikimi i fëmijëve me qëllim shfrytëzimin e tyre në punë, prostitucion, prodhimin e materialeve pornografike është një fenomen që ka marrë dimensione të gjëra në plan ndërkombëtar. Këto aktivitete kriminale janë mjaft të dëmshme për zhvillimin psiko-social të fëmijës dhe adoleshentëve. Studimi i kësaj figure të krimit paraqet interes pasi vendi ynë këto vitet e fundit ka shërbyer në të shumtën e rasteve si pikënisje për trafikimin e fëmijëve shqiptarë drejt vendeve të Europës.

Me Ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001, kjo figurë vepre penale u përfshi në Kodin Penal aktual, në nenin 128/b.<sup>122</sup> Përfshirja e kësaj dispozite u pasua dhe nga ratifikimi që i bëri shteti ynë Konventës së OKB për Luftën ndaj Krimit të Organizuar dhe të Protokollit shtesë për trafikimin e qenieve njerëzore në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti. Konventa u ratifikua me anë të Ligjit nr. 8920, datë 11. 07. 2002. Ky nen përbëhet nga dy paragrafe, ku në paragrafin e parë thuhet: “*Trafikimi i fëmijëve me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër dënohet me burg nga dhjetë gjer në njëzet vjet.*”

**Objekt** i këtij krimi<sup>123</sup>, sipas asaj që është pranuar në teori janë mardhëniet juridike të vendosura për të siguruar paprekshmërinë e lirisë së fëmijëve dhe personave të tjerë, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet kriminale që drejtohen kundër tyre.

Nga **ana objektive**, krimi kryhet me anë të transferimit të fëmijëve brenda dhe jashtë shtetit, duke mosrespektuar rregullat ligjore dhe tek këto forma të transferimit duhet të mbahen parasysh dhe përcaktimet që bën protokollin shtesë për trafikimin e fëmijëve.

Si **subjekte**, do të paraqiten të gjithë ata persona të cilët kanë mbushur moshën e kërkuar nga ligji për t’u marrë në përgjegjësi penale dhe janë të përgjegjshëm, që realizojnë trafikimin e fëmijëve.

---

<sup>122</sup>Kjo dispozitë gjendet në seksionin IX, “*Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes*”, kreu II të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal në fuqi.

<sup>123</sup> Elezi.I. *E drejta Penale, Pjesa e Posaçme*, Ribotim, Tiranë 2007.

Nga **ana subjektive**, krimi kryhet me dashje të drejtëpërdrejtë dhe dispozita kërkon dhe ekzistencën e qëllimit për të pasur fitim material ose çdo përfitim tjetër.

Paragrafi i dytë përcaktonte:

*“Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarit për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasojë të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe, kur ka sjelle si pasojë vdekjen, me burgim të përjetshëm.”*

Për sa i përket elementëve të figurës së krimit, vlejné përcaktimet e bëra më lart.

Paragrafi i dytë i kushton më tepër vëmendje rrethanave të cilësuar të anës objektive pra:

- marrëveshjes mes tyre;
- kryerjes më shumë se një herë, që do të thotë se personi e ka kryer këtë vepër dy ose më tepër herë, në intervale kohore të ndryshme, pa u dënuar me parë dhe ndjekja penale nuk duhet të jetë parashkruar për asnjërën prej tyre;
- keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarit për të kryer veprime të ndryshme ku përfshihen dëmtimet trupore e psikike që mund t'i shkaktohen fëmijëve viktimë e sidomos që ata të kryejné punë të ndryshme si p. sh, punë prodhuese, të lypin, të prostitudojnë, etj.

Pasojat e rënda për shëndetin, që për nga karakteri dhe rëndësia e tyre njësohen me ato që parashikon dispozita për plagosjen e rëndë me dashje.<sup>124</sup> Deri në këtë pikë, dënimi që jepet për këtë krim ishte jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet, ndërsa kur krimi sillte si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënimi ishte me burgim të përjetshëm.

Me Ligjin nr. 9188, datë 12. 02. 2004, kjo dispozitë pësoi ndryshime të tjera. Dispozita konkrete e ka zgjeruar rrethin e veprimeve ose mosveprimeve me anë të të cilëve konsumohet ky krim duke ju afruar gjithnjë e më tepër përcaktimeve që bën Protokollin shtesë i Konventës Kundër Krimit Ndërkombëtar të Organizuar. Neni 128/b, tanimë përbëhet nga pesë paragrafe. Në paragrafin e parë thuhet:

*“Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimin ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga katër milion deri në gjashtë milion lekë.”*

Ndryshimet qëndrojnë në **anën objektive**, ku janë rënditur format e realizimit të krimit që janë:

---

<sup>124</sup>Neni 88 i K. Penal të R. Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895 datë 27. 01. 1995.

- rekrutimi,
- transportimi,
- transferimi,
- fshehja,
- pritja e të miturve.

Ndryshimet i përkasin dhe **anës subjektive** e pikërisht qëllimit për të cilin kryhet kjo veprë e që kanë të bëjnë me:

- shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual,
- shfrytëzimit të punës ose shërbimeve të detyruara,
- vënia në kushte skllavërimi ose forma të ngjashme me të,
- vënia në përdorim ose transplantimi i organeve,
- forma të tjera të shfrytëzimit, të cilat do të tregohen nga praktika.

Vepra cilësohet në paragrafin e dytë për të gjithë ata persona që organizojnë, drejtojnë dhe financojnë trafikimin e të miturve. Dënimi është jo më pak se pesëmbëdhjete vjet burgim dhe me gjobë nga gjashtë deri në tetë milion lekë. Paragrafi i katërt cilësohet nga pasoja e rëndë, që është vdekja e të dëmtuarit e cila duhet të ketë ardhë si pasojë e veprës, pra kërkohet dhe ekzistenca e lidhjes shkakore. Dënimi është jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm si dhe me gjobë nga tetë deri në dhjetë milion lekë. Paragrafi i pestë<sup>125</sup> synon në goditjen e personave të cilët shfrytëzojnë funksionin shtetëror ose shërbimin publik për të realizuar krimin e trafikimit të fëmijëve. Në këtë rast dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me ¼ e dënimit të dhënë. Ky paragraf dallon nga të tjerët për shkak se **subjekti** është i posaçëm, pra mbajtës i disa cilësive të veçanta të cilat i përdor për realizimin e veprës.

Nga sa u tha më sipër rezulton se;

- dispozita bën përshkrimin e kuptimit të trafikimit të fëmijëve duke përfshirë përkufizimet e dhëna nga Protokollin shtesë.
- nuk cakton më vete dënime fikse.
- cilësimi në paragraf të dytë bëhet për organizuesit, drejtuesit dhe financuesit.
- synon të godasë strukturat shtetërore të përfshira në këtë dukuri me anë të paragrafit të pestë dhe në këtë rast rritet masa e dënimit.

---

<sup>125</sup> Në paragrafin e pestë thuhet: “Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me ¼ e dënimit të dhënë”.

Në 2 Maj, 2013 Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi një ligj të ri nr. 144/2013 “Mbi disa ndryshime të Ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe në nenin 128/b paragrafi i parë, fjalët : *“dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga katër milionë deri në gjashtë milionë lekë”* zëvendësohen me fjalët *“dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet”*.

Ky ndryshim i bërë ka rritur sanksionin penal si në minimumin e tij ashtu dhe në maksimumin e dënimit duke i dhënë një goditje më të fuqishme trafikantëve. Në këtë mënyrë, ligjvënësi ka sjellë disa ndryshime të rëndësishme në këtë dispozitë.

## **7.2. Nocioni “trafikimi i fëmijëve”.**

Trafikimi i fëmijëve nuk është një dukuri e re. Ky fenomen ekziston prej kohësh dhe po merr zhvillim në të gjitha kontinentet dhe kulturat. Gati të gjitha vendet janë të përfshira në një farë mënyre në të, qoftë si vende të origjinës, të destinacionit ose tranzitë. Protokollin shtesë i Konventës së OKB për Krimin e Organizuar, për Parandalimin dhe dënimin e Trafikimit të Njerëzve e në Veçanti atë të Grave e Fëmijëve, përcakton tre elemente që përfshijnë trafikimin e personave 18 vjeç e më të moshuar; rekrutimin me anë të një ndërmjetësi (apo transportimi apo transferimi apo mbyllje apo marrje në dorëzim), mjete abuzive të kontrollit-kërcënimi ose përdorimi i forcës ose forma të tjera shtrëngimi-gjatë rekrutimit, transportimit, transferimit, mbylljes ose marrjes në dorëzim; shfrytëzimi vijues, ose symimi për të shfrytëzuar, në një apo disa mënyra, konkretisht shfrytëzimi i prostituimit të të tjerëve, forma të tjera të shfrytëzimit seksual, puna apo shërbime të detyruara, skllavëria ose praktika të ngjashme me skllavërinë, vënia në shërbim ose heqja e organeve.

Protokollin shtesë i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, mbi shitjen e fëmijëve (2000), e përkufizon atë si *“ç’do veprimtari ose marrëveshje në bazë të së cilës një fëmijë i kalohet nga ç’do person ose një grup personash një tjetri, në këmbim të një shpërblimi ose për çfarëdo arsye tjetër”*.

Sa më sipër, me **trafikim të fëmijëve do të kuptojmë zhvendosjen e fëmijëve nga një vend në një tjetër, brenda kufijve të një shteti ose dhe jashtë tyre, me anë të përdorimit të forcës, shtrëngimit ose mashtrimit, duke pasur si qëllim shfrytëzimin**



**e tyre në veprimtari fitimprurese dhe të paligjshme të karakterit ekonomik ose seksual.**

Edhe Rezoluta AG 49/166 e Asamblese së Përgjithshme të OKB që përpiket të japë një përkufizim të trafikimit të fëmijëve, shton që shfrytëzuesit janë trafikantë dhe organizata kriminale që përdorin trafikun e qenieve njerëzore në të njëjtën mënyrë si veprimtaritë e tjera të paligjshme, si punën e detyruar, martesat e rreme, punën e paligjshme dhe birësimet e rreme. Kështu, trafikimi i fëmijëve është tërësia e veprimeve me anë të të cilave një fëmijë zhvendoset brenda ose jashtë një shteti si të ishte një send për të rriturit.

Në gjykimin e çeshtjes ndaj të pandehurve H.K., N.K. dhe Z.L., akuzuar për kryerjen e veprës penale të trafikimit të fëmijëve, parashikuar nga neni 128/b/2 i K.Penal, Gjykata e Krimeve të Rënda, konkludon se :

*« Veprën penale të pandehurit e kanë kryer me veprime konkrete, duke filluar nga gjetja, rekrutimi i dëshmitares M.L. që pritej të lindte, bërja e “pazarit” për fëmijën duke e konsideruar atë si një send e jo si një qenie njerëzore, transportimi i dëshshmitares me fëmijën që ajo mbante, në Greqi për të lindur, konkretizimi përfundimtar i këtij veprimi kriminal, me lënien e fëmijës në klinikë dhe marrjen për këtë të shumës 500.000 lekë. Vlen për t’u thksuar se gjykata në arsyetimin e vendimit ka përcaktuar rrezikshmërinë e theksuar shoqërore të të pandehurit N.K., i cili këtë lloj veprimtarie kriminale e kishte kthyer në profesion<sup>126</sup>. «*

Fenomeni i trafikimit të fëmijëve për shfrytëzimin e tyre në punë ka rrënjë të thella dhe të ndërlikuara me motive shumplanëshe dhe të ndryshme sipas shteteve dhe ekonomive të përfshira. Trafikimi i fëmijëve është një krim që konsiderohet si i tillë nga e drejta ndërkombëtare. Ai përbën një dhunim të drejtëpërdrejtë dhe të rëndë të të drejtave të fëmijës.

Kjo dukuri shfaqet në ç’do shtet, pavarësisht nga niveli i zhvillimit të tij ekonomik. Në shtetet e varfëra, efektet e globalizimit të ekonomisë botërore ndërthuren me konflikte të ndryshme duke e bërë më të cënueshme familjen dhe duke rritur rrezikun e shfrytëzimit të pjesës më të dobët të popullsisë. Organizatat kriminale shfrytëzojnë pamundësinë për t’u mbrojtur të fëmijëve, sidomos kur ato vijnë nga vende të varfëra, duke përdorur rrugë të tilla si trafikimi e paligjshme që kanë qëllim fitimi nëpërmjet lypjes, birësimet ndërkombëtare, shfrytëzimit seksual, trafikimit të drogës dhe organeve, punës së detyruar, etj.

---

<sup>126</sup> Për më tej shih *Vendimin nr.19 të Gjykatës për Krime të Rënda*, dt.05.04.2006.

Në gjykimin e çështjes ndaj të pandehurit A.K., akuzuar për kryerjen e veprës penale të trafikimit të të miturve, parashikuar nga neni 128/b/3 i K.Penal, Gjykata e Krimeve të Rënda, konkludon se :

*« I pandehuri A.K. me veprimet e tij të kryera me dashje dhe me qëllim përfitimin material, nepërmjet dhunës fizike ndaj të të dëmtuarës për ta detyruar të prostituonte dhe të punonte për të ka konsumuar veprën penale të “Trafikimit të të miturve” në një nga format e parashikuara në nenin 3 te Protokollit të Dytë Shtesë “Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkrimin e trafikut të personave, veçanrisht të grave dhe fëmijëve”, në plotësimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtare”<sup>127</sup>.*

Transferimi i fëmijëve jashtë vendit të tyre bëhet me miratimin e prindërve ose të vetë fëmijëve. Ky miratim arrihet me anë të mashtrimit ose të dhunës, duke përdorur dhe një seri ndërmjetësish dhe në disa raste dhe bashkëpunimin e shprehur ose të heshtur të funksionarëve shtetëror.

Në gjykimin e çështjes ndaj të pandehurit K.D., akuzuar për kryerjen e veprës penale të trafikimit të fëmijëve, parashikuar nga neni 128/b/2 i K.Penal, Gjykata e Krimeve të Rënda, konkludon se:

*« Veprimet e kryera nga i pandehuri K.D. përmbajnë elementët e anës objektive të veprës penale të trafikimit, pasi ai, në marrveshje me shtetasin S.S., të atin e fëmijës së mitur, ka rekrutuar dhe transferuar këtë të fundit në greqi me qëllim për ta nxjerrë për të lypur, pra për ta shfrytëzuar për qëllime përfitimi material, që është element i anës subjektive që kërkohet shprehimisht nga dispozita penale për të patur figurën e veprës penale të trafikimit të fëmijëve »<sup>128</sup>.*

Trafikimi i fëmijëve karakterizohet nga qëllimi i fitimit, nga prania e një sërë ndërmjetësish, nga sjelljet abuzive për të marrë pëlqimin e fëmijëve dhe të prindërve të tyre, nga largimi i fëmijës prej ambientit ose komunitetit ku jeton, me fjalë të tjera nga zhvendosja gjeografike e detyruar, të gjitha këto karakteristika përputhen me së miri me kuptimin e thjeshtë të skllavërisë: qenia njerëzore konsiderohet dhe trajtohet sikur të ishte send. Trafikimi i fëmijëve është një plagë që ka prekur dukshëm dhe shtetin tonë i cili shpesh shërben si vend origjinë për zhvendosjen e fëmijëve shqiptarë drejt vendeve të tilla si Greqia, Italia, ose vende të tjera. Llogaritet që të paktën 3.000 fëmijë shqiptarë janë dërguar në Greqi dhe Itali për të kërkuar lëmsh.<sup>129</sup>

<sup>127</sup> Për më tej shih *Vendimin nr.42 te Gjykatës për Krime të Rënda*, dt.26.06.2008.

<sup>128</sup> Për më tej shih *Vendimin nr.66 te Gjykatës për Krime të Rënda*, dt.14.11.2008.

<sup>129</sup> Të dhëna të marra nga “Raport i Unicef mbi shfrytëzimin seksual të fëmijëve” i vitit 2001.

Sipas të dhënave të Terre des Hommes, gjatë viteve 1999-2001 në qytetet greke të Selanikut dhe Athinës gjendeshin 3000-4000 fëmijë<sup>130</sup> shqiptarë. Ata mbledheshin në cepat e rrugëve për të larë xhamat e makinave, afër pikave turistike për të kërkuar lëmosh ose duke shitur lule. Gjithë të ardhurat nga puna i dorëzohen pronarit, që i mbikqyr nga afër. Fëmijët tregonin se nëse nuk fitonin shumën e caktuar i rrihnin. Shumica e tyre gjendeshin aty me pëlqimin e heshtur të prindërve, të cilët “pronari” i ka mashtruar me premtimin se do të ndante me ta fitimet nga puna e fëmijës. Në 1998, 983 fëmijë shqiptarë janë përcjellë nga policia e të miturve të Selanikut në kufirin shqiptar. Në 1999, 385. Në 2001, 56.<sup>131</sup>

### **7.3. Cilët janë viktimat e trafikimit të fëmijëve dhe faktorët që ndikojnë në trafikim.**

Trafikimi<sup>132</sup> përbën një shkëlqje të patolerueshme të së drejtës së fëmijëve për mbrojtje ndaj shfrytëzimit, të së drejtës për të luajtur, për t’u arsimuar dhe të kujdesit për të pasur shëndet të mirë dhe të jetës së tyre familjare. Shfrytëzimi, të cilit i nënshtrohen viktimat e trafikimit i bën ata të humbin aftësinë për t’u bërë të rritur të zotë.

Është e vështirë të jepen shifra të sakta lidhur me numrin e të trafikuarve. Sipas një raporti botëror të ONP të 2002, *A future without child labour*,<sup>133</sup> numri i fëmijëve viktimat të trafikimit ishte rreth 1,2 milion. Në pjesën më të madhe të rasteve fëmijët vijnë nga familje tepër të varfëra ose nga grupe etnike të lëna mënjanë brenda shoqërive përkatëse. Në raste të tjera, bëhet fjalë për fëmijë që vijnë nga familja që përjetojnë probleme ekonomike të cilëve ju propozohen “vende pune” jashtë komunitetit të origjinës ose shtetit të tyre. Trafikimi i fëmijëve prek njësoj si djemtë ashtu edhe vajzat. Këta fëmijë shfrytëzohen dhe ushqehen e vishen keq, nuk shkojnë në shkollë, janë të lënë pa kujdes dhe shpesh rrihen ose keqtrajtohen. Disa herë, sidomos vajzat, bëhen viktimat të dhunës seksuale. Ata vihen në situatë të rrezikshme prandaj dhe vazhdimisht bëhen viktimat të aksidenteve, plagosen. Vajzat mund të mbeten lehtë shtatzëna dhe

---

<sup>130</sup> *Trafiku i fëmijëve shqiptarë në Greqi*, Janar 2003, botim i Terre des Hommes. Gjithsesi, të dhënat jepen nga kjo OJF dhe nuk mund të konsiderohen të dhëna zyrtare.

<sup>131</sup> Statistika të dhëna nga departamenti i policisë së të miturve të Selanikut i 15 Majit 2002 (*Trafiku i fëmijëve shqiptarë në greqi*, botim i Terre des Hommes, janar 2003, faqe 10).

<sup>132</sup> Neni 35 i konventës mbi të drejtat e fëmijës i ngarkon shtetet me detyrimin për të marrë masat e duhura në mënyrë që të parandalojnë rrëmbimin, shitjen ose trafikimin e fëmijëve pavarësisht nga qëllimi ose forma në të cilën kryhet.

<sup>133</sup> Përmbledhja e këtij raporti mund të gjendet në faqen e internetit [www.ilo.org](http://www.ilo.org).

kështu dënohen ose përjashtohen nga rrjeti. Asnjëherë nuk marrin para, që kontrollohen tërësisht nga "tutorët" e tyre. Janë pa dokumenta identifikimi dhe shpesh nuk dinë zonën nga vijnë.

Që nga vendi i nisjes, zonat tranzite dhe vendi i destinacionit përfundimtar, përgjithsisht marrin pjesë shumë aktorë të ndryshëm. Prandaj ndërhyrjet kundër trafikut nuk mund të shtrihen vetëm mbi fëmijët. Vëmendje i duhet kushtuar familjeve, komuniteteve të origjinës, rekrutuesve, ndërmjetësve, personave që sigurojnë dokumentet, transportuesve, funksionarëve të korrumpuar, punëdhënësve dhe klientëve. Motivet<sup>134</sup> e këtijë fenomeni të rëndë kanë të bëjnë me një sërë faktorësh që ndërthuren dhe ndërveprojnë duke krijuar një gjendje që sot është alarmuese dhe në përkeqësim të vazhdueshëm. Më poshtë po japim disa nga faktorët që ndikojnë në trafikimin e fëmijëve:

- *Faktori kulturor.*

Në vendet në zhvillim, ekziston tradita e lëvizjes së fëmijëve drejt të afërmeve me qëllim për t'u lehtësuar jetën atyre dhe familjes. Të mësuar me këtë dukuri, këtyre personave u mungon reagimi shoqëror ndaj vetë trafikimit.

- *Faktori ekonomik.*

Në përgjithësi ky krim vjen si rrjedhojë e një kërkese të pakënaqur për krah të lirë pune dhe të një kërkese në rritje të shpejtë për djem e vajza që të përfshihen në tregëtinë e seksit dhe në sektorët ekonomik. Edhe pse fëmijët shpesh punojnë më pak se të rriturit, mashtrohen lehtë, shfaqin me pak rezistencë dhe nuk arrijnë të mbrojnë të drejtat e tyre. Kështu, ata i detyrojnë të punojnë me orë të gjata pune, me pak ushqim, në kushte të këqija strehimi, pa pasur asnjë kujdes. Për ta nxitur trafikimin e fëmijëve ndikojnë dhe shumë faktor të lidhur me ofertën. Faktorët më të rëndësishëm janë varfëria dhe dëshira për të fituar të ardhura për të jetuar ose për të ndihmuar familjen, mungesa e arsimimit ose pamundësia për shkollim, konfliktet dhe fatkeqësitë natyrore që shkatërrojnë ekonominë lokale, qëndrimi shoqëror ndaj fëmijëve, sidomos ndaj vajzave, legjislati

---

<sup>134</sup> Në pjesën hyrëse të Protokollit shtesë të Konventës mbi të drejtat e fëmijës lidhur me shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë feminare, rënditen këto shkaqe që ndikojnë në këtë problem: prapambetja, varfëria, dallimet ekonomike, strukturat e pabarabarta social-ekonomike, familjet me probleme, mungesa e arsimimit, migrimi urbano-rural, diskriminimi mes sekseve, qëndrimet seksuale të papërgjegjshme të të rriturve, praktikat tradicionale të dëmshme, konfliktet e armatosura.

dhe rregullat lokale. Trafikimi i fëmijëve përbën një shkelje të të drejtave të njeriut që lidhet me përfitimin ekonomik në rritje të shpejtë. Trafikimi në vetvete organizohet nga persona të tretë që i zhvendosin njerëzit në vende të tjera, me qëllimin e vetëm që të përfitojnë prej tyre nga ana ekonomike. Shkaqe të sjelljes kriminale konsiderohen të gjitha ato rrethana dhe ndikime që e shtyjnë individin apo grupet në veprime kriminale. Si rrethana të këtilla në literaturën kriminologjike bashkëkohore, përmenden kushtet ekonomike, kundërthëniet dhe konfliktet politike dhe ideore, familja, arsimimi etj<sup>135</sup>. Në këtë kuptim, trafikimi i fëmijëve përfaqëson një përgjigje ndaj kërkesës për punë, brenda dhe jashtë kufijëve të një shteti.

- *Faktorët që lidhen me lëvizjet migruese të të rriturve.*

Këtu ndikojnë zakoni i zhvendosjes, mungesa e kontrollit dhe lehtësia në kalimin e kufirit që lehtësojnë përzierjen e fëmijëve të trafikuar me ata që emigrojnë bashkë me familjen.

- *Faktorët që lidhen me boshllëqet institucionale dhe ligjore.*

Në mjaft vende mungojnë sanksionet juridike dhe kualifikimi i duhur juridiko-penal i krimit të trafikimit. Mungojnë rregullat mbi qarkullimin e të miturve dhe kontrolli i përshtatshëm në kufi.

#### **7.4. Veprimtaritë kryesore ku shfrytëzohen të miturit e trafikuar.**

Sipas të dhënave, zonat më të goditura janë Azia e Jugut, Azia Juglindore, Afrika dhe Europa Lindore. Pjesa më e madhe e fëmijëve trafikohet me qëllimin për t'i shfrytëzuar seksualisht. Ata përdoren dhe për të kryer punë të ndryshme si shërbime shtëpiake, përfshirja në konflikte të armatosura, shërbime restoranti, bari, në fabrika, bujqësi, ndërtim dhe lypje.

Brenda shtetit, fëmijët trafikohen nga zonat rurale drejt qyteteve me qëllimin për tu shfrytëzuar në kryerjen e punëve ose seksualisht. Duke qenë se midis vendeve fqinje dallimet ekonomike po theksohen së tepërmi, trafiku ndërkombëtar po synon të përhapet në të gjitha rajonet. Ai po ecën në të njëjtin hap me lëvizjen në rritje të njerzëve.

---

<sup>135</sup> Ragip Halili, *Kriminologjia*, Prishtinë 2002, fq.229.

Veprimtaritë në të cilat përfshihen fëmijët viktima të trafikimit janë të shumta dhe të lidhura më tepër me zonat e ekonomisë joformale, urbane dhe rurale.

**Llojet e veprimtarive ku përfshihen fëmijët janë si më poshtë:**

- a) punët shtëpiake (në shtëpitë e të tjerëve);
- b) puna e detyruar (që përfshinë forma skllavërimi);
- c) shfrytëzimi seksual;
- d) puna në degë të industrisë ose bujqësisë (që përbën rrezik për shëndetin);
- e) lypja (kërkimi i lëmoshës);
- f) puna pranë të afërmeve;
- g) trafiku i birësimeve;
- h) trafiku i organeve trupore.

Do të ndalemi tek disa prej këtyre veprimtarive:

**a) Puna e fëmijëve, puna e detyruar dhe format bashkëkohore të skllavërimit<sup>136</sup>**

Do të konsiderohet shfrytëzim i fëmijës në punë atëherë kur konsumohet shkelja e tre prej të drejtave të tij themelore: e drejta për shëndet, e drejta për arsim dhe e drejta për liri.

Punët më të zakonshme që bëjnë fëmijët janë: si argat, në miniera, në fabrika e furra, shërbetorë në familje të pasura, mbledhës mbeturinash, hamej, në punishte të ndryshme, etj.

Si një formë veçanërisht e rëndë e shfrytëzimit të fëmijëve në këtë aspekt nga ana e trafikantëve, është shtrëngimi i tyre për të lypur në një vend të huaj. Kështu, në gjykimin e çështjes penale me të gjykuarit F.K. dhe A.K., Gjykata e Lartë ndër të tjera arsyeton:

*...Nepër semaforët e Athinës, i dëmtuari S.M. punonte paradite që prej orës 08-00 të mëngjezit deri në ora 14.00 dhe pasdite nga ora 16.00 deri në ora 22.00 dhe lekët e fituara gjatë ditës rreth 40-60 euro, ia dorëzonte të gjitha të gjykuarit F.K.. Këtë punë i dëmtuari e ka kryer për rreth 3 muaj, derisa është ndaluar nga policia greke dhe është deportuar në Shqipëri. Pas një qëndrimi të shkurtër në Shqipëri, i dëmtuari është nisur përsëri drejt Greqisë, me qëllim marrjen e parave që ia mbante i gjykuari F.K. Në shtëpinë e të gjykuarit, i dëmtuari ka pëlqyer një magnetofon të cilin i gjykuari e ka vlersuar në çmimin 1.000 euro dhe një video, të dyja së bashku sipas bisedës së bërë në mes të gjykuarit dhe të dëmtuarit*

<sup>136</sup> Neni 3 i Konventës për të Drejtat e fëmijës i ngarkon shtetet me detyrimin për të mbrojtur fëmijët nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga çdo lloj pune e rrezikshme ose që e pengon në shkollimin e tij apo është e dëmshme për shëndetin, zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror. Për të garantuar zbatimin e këtij neni, shtetet duhet të marrin masa të natyrave legislative, administrative, sociale dhe edukuese.

*S.M. plotësonin shumën e lekëve që i gjykuari i kishte borxh atij. Pas kësaj marrëveshje, i dëmtuari ka qëndruar në Greqi edhe rreth një muaj tjetër duke kryer të njëjtën punë, por në këtë kohë është kapur përsëri nga policia greke dhe është kthyer në Shqipëri<sup>137</sup>.*

Sipas raportit botëror të ONP “*A future without child labor*” (Shtator 2002), rreth 180 milion të mitur të moshave 5-17 vjeç i nënshtrohen formave më të rënda të shfrytëzimit, pra në punë të rrezikshme. Ndërkohë 67 milion të mitur të moshave 5 dhe 14 vjeç i nënshtrohen punëve jo të rrezikshme, por që nuk përshtaten me moshën e tyre.

Në bazë të dispozitave të konventave nr.138 dhe nr.182 të ONP, raporti nxjerr në pah tre kategori punësh që duhen hequr ose zhdukur.

- Punët e bëra nga fëmijë që kanë moshë më të vogël nga ajo që përcaktohet për këtë lloj pune në legjislacionin kombëtar.
- Punët që shkaktojnë dëme në shëndetin fizik ose mendor, ose në moralin e fëmijës (punët e rrezikshme);
- Punët e klasifikuara si format më të rënda të punës së fëmijëve pasi përbëjnë veprimtari të dënueshme dhe që lidhen nga e drejta ndërkombëtare me skllavërinë, trafikun e njerëzve dhe me punën e detyruar si prostitucioni, pornografia dhe veprimtari të tjera të paligjshme.

Nga studimi i vendimeve të Gjykatës për Krime të Rënda rezulton se në vitet 2006 - 2007 nuk janë gjykuar persona për trafikim fëmijësh në format e mësipërme, ndërsa në vitet 2008 dhe 2010 janë gjykuar 4 çështje, ku autorët e krimeve kanë shfrytëzuar të miturit për punë të detyruar dhe lypje në vende të huaja.

#### **b) Shfrytëzimi seksual.**

Shfrytëzimi seksual<sup>138</sup> i fëmijëve me qëllim fitimi rritet në mënyrë proporcionale me zhvillimin e turizmit dhe është një tregues i qartë i dallimeve në ekonominë botërore.

Si në çdo lloj tjetër “trafikun” edhe në këtë fushë “oferta” lidhet me “kërkesën” nga ana e shtetasve të huaj që vijnë nga vendet e pasura. Tregtia seksuale është një industri që sjell miliarda dollarë dhe rritet mbi kurrizin e personave më të dobët. Zgjidhen fëmijët meqë këmbëhen lehtë dhe paraqesin vlerë të lartë monetare. Shfrytëzimi seksual me qëllim

<sup>137</sup> Për më tej shih vendimin nr.502, datë 14.10.2009, të Gjykatës Lartë të R.Shqipërisë.

<sup>138</sup> Neni 34 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës i detyron shtetet për ti mbrojtur fëmijët nga çdo formë e shfrytëzimit seksual dhe të dhunës seksuale. Ata duhet të marrin masa për të parandaluar përfshirjen e tyre në aktivitete të tilla si, prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme, spektakle ose materiale pornografike.

fitimi i fëmijëve shfaqet në shumë forma. Një prej tyre është prostitucioni fëmënor<sup>139</sup>, ku fëmijët shndërrohen në skllëvër të një numri të konsiderueshëm njerëzish, ku secili prej tyre nxjerr të ardhura nga kjo veprimtari. Arsyet janë të shumta dhe përfshijnë varfërinë, mungesën e arsimimit dhe qëndrimet diskriminuese ndaj disa grupeve etnike, grave dhe vajzave të vogla. Në 1997, 1600 të mitur shqiptar janë shfrytëzuar seksualisht në Greqi. Për fëmijët e moshës 15-18, 90% ishin të seksit femër. Ky numër përfshin 400 fëmijë të shfrytëzuar seksualisht në tregun “pedofil” në Greqi, 75% ishin shqiptar, 60% të seksit mashkull<sup>140</sup>.

Nga studimi i vendimeve të gjykatës që kanë marrë formë të prerë rezulton se në vitin 2006 janë gjykuar 3 çështje për veprën penale të trafikimit të të miturve, parashikuar nga neni 128/b/2 të Kodit Penal, në vitin 2008 janë gjykuar 4 çështje ku 3 prej tyre me akuzën e parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal, ndërsa 1 çështje në bazë të nenit 128/b/1 të Kodit Penal. Në vitin 2009 është gjykuar 1 çështje në bazë të nenit 128/b/1 të Kodit Penal, në vitin 2010 është gjykuar 1 çështje dhe në vitin 2011 janë gjykuar dy çështje penale. Bazuar në arsyetimet e vendimeve të gjykatës del se, të pandehurit e kanë kryer veprën penale me veprime aktive, konkrete, duke filluar me rekrutimin e të dëmtuarës me anë të mashtrimit për martesë e krijim familje, vazhduar me transportimin e saj jashtë shtetit etj., ku në thelb konsiston shfrytëzimi i tyre si prostituta duke i detyruar nepërmjet dhunës fizike e psikike.

Në gjykimin e çështjes në ngarkim të të gjykuarve L.L. e P.C, Gjykata e Lartë, pasi ka lënë në fuqi vendimet e gjykatave të të dy shkallëve, në arsyetimin e vendimit ndër të tjera shprehet:

*“...Duke qenë se është provuar se trafikimi i të dëmtuarës është bërë nga të pandehurit në bashkëpunim me qëllimin për ta shfrytëzuar atë, pasi përmendëm më lart se është provuar se e dëmtuara është detyruar me dhunë të ushtrorë prostitucion, por nga deklaratimet e të dëmtuarës provohet se të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i prostitucionit prej saj i ka përfituar në një rast i gjykuari L.L, ndërsa kur kishte punuar në shtëpi publike, të ardhurat i merrte i gjykuari P. Ç.. Kolegji Penal çmon se nuk qëndron pretendimi i mbrojtësit të të gjykuarit L.L., se gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin penal. Kjo për arsyen se të gjykuarit janë gjykuar e dënuar në bazë të nenit 128/b/2 të K.Penal, akuzë, e cila është paraqitur në kërkesën për gjykim nga ana e organit të akuzës, pasi është provuar se të gjykuarit e kanë trafikuar të dëmtuarën, për qëllime fitimi, e cila ka qenë nën moshën 18 vjeç e që është “fëmijë” sipas nenit 3/d të Protokollit mbi*

<sup>139</sup> Me prostitucion fëmënor do të kuptohet përfshirja e fëmijës në veprimtari seksuale në këmbim të fitimit ose për çdo qëllim tjetër (neni 2/8 i Protokollit shtesë të konventës për të drejtat e fëmijës).

<sup>140</sup> Të dhëna të marra nga “Trafiku i fëmijëve shqiptar në greqi”, botim i Terre des Hommes, janar 2003, fq. 23.



*parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, dalë në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara, kundër krimit të organizuar ndërkombëtar<sup>141</sup>.*

Një dukuri tjetër është rritja e pornografisë feminare<sup>142</sup> në internet. Kjo shpjegohet me mundësinë për të këmbyer material në mënyrë të shpejtë, të fshehtë dhe anonime, gjë që ka bërë që shumë organizata kriminale të preferojnë këtë rrjet për të zhvilluar tregti të paligjshme. Vlerësohet që në internet të ketë më shumë se 30.000 site me përmbajtje pedofilie. Termi “pedofili” i referohet përgjithësisht meshkujve të rritur që tërhiqen nga individ më të vegjël se ata. Përkufizimi më i përdorur është “tërheqje seksuale për individ të moshës para pubertitetit”, ndërkohë që vetë termi pedofili do të thotë dashuri për fëmijët (pedia-fëmijë; filia-dashuri), por prej kohësh është përcaktuar si një sjellje perverse, një shmangie nga marëdhëniet seksuale normale.

Nje tjetër dukuri është dhe turizmi me sfond seksual që prek fëmijët. Shfrytëzimi i fëmijëve nëpër udhëtimet turistike ndodh nga persona që përfitojnë nga fakti se gjenden në vend të huaj dhe mund të shkelin ato ndalime që respektojnë zakonisht.

### *c) Birësimi Ndërkombëtar.*

Në rastin e birësimeve ndërkombëtare, kërkesa për fëmijë nga çifte në vendet e pasura tërheq vemendjen e shumë vendeve në vështirësi ekonomike. Këtu shfrytëzohen pretekstet për të shpëtuar fëmijët, fakti se birësimi është një veprim privat, etj. Dëshira për të pasur një fëmijë është ndonjëherë kaq irracionale, sa bën që shumë çifte të shndërrohen në viktima të mashtrimeve mbi origjinën e fëmijëve. Shpesh këta kanë identitet të rreme, të dhëna të ndryshuara. Konventa e Hagës për mbrojtjen e të miturve dhe bashkëpunimin për birësimin ndërkombëtar<sup>143</sup> përbën një hap përpara në fushën juridike për shtetet nënshkrues. Ajo garanton që birësimi të bëhet në interesin më të lartë të fëmijës dhe lejon vendosjen e një sistemi bashkëpunimi mes shteteve nënshkrues. Megjithatë, konventa do të sjellë pasoja të efektshme vetëm nëse shtetet do të ushtrojnë një kontroll të rreptë mbi strukturat ndërmjetësuese, në favor të prindërve birësues.

<sup>141</sup> Për më tej shih *Vendimin nr.92*, datë 04.03.2009, të Gjykatës Lartë të R.Shqipërisë.

<sup>142</sup> Pornografi feminare do të kuptohet shfaqja , me anë të çdo mjeti, të një fëmije të përfshirë në veprimtari seksuale të qarta të vërteta ose të simuluar apo çdo lloj shfaqje e organeve seksuale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale (neni 2/c i *Protokollit shtesë të konventës mbi të drejtat e fëmijës*).

<sup>143</sup> Kjo konventë është ratifikuar me ligjin nr. 8624, date 15.6.2000, botuar në fletoren zyrtare nr.18, faqe 876.

*d) Trafiku i organeve.*

Zakonisht, organet e trupit merren dhe dërgohen menjëherë me avion drejt vendeve të pasura. Në vendet e varfëra janë vënë re klinika private të cilat presin paciente nga vendet e zhvilluara që nuk e kanë të vështirë të paguajnë shpenzimet e udhëtimit dhe të ndërhyrjes kirurgjikale. Nuk ka të dhëna zyrtare që në Shqipëri të ekzistojë ndonjë klinikë e tillë.

Nga studimi i vendimeve të Gjykatës për Krime të Rënda, rezulton se nuk është gjykuar asnjë çështje penale për raste të tilla.

Si përfundim, vlen të përmendet se në disa raste edhe krimet e trafikimit ndaj të miturve janë shfaqur në forma të rënda dhe me pasoja deri në braktisje të familjes dhe fëmijëve të mitur. Ky është grupi i dytë i veprave penale më të përhapura pas trafikimit të femrave.

Raportet aktuale tregojnë se siguria sociale, sistemet sociale dhe përfitimet që ato sjellin janë duke u shënjestruar nga trafikantët për të mbështetur dhe për të justifikuar kërkesat e lidhura për përfitime familjare dhe shtëpiake. Kjo është në shtesë të krimeve të rrugës dhe të përfshirjes në trafikimin e fëmijëve në prodhimin, kontrabandimin dhe furnizimin e drogave. Këto janë të gjithë shembuj të punës së detyruar të cilat janë të orkestruara nga grupet e krimit të organizuar. Këto veprimtari gjenerojnë të ardhura kolosale dhe shumë shpesh prindërit e viktimave apo anëtarë të tjerë të familjeve janë bashkëpunues në trafikimin e fëmijëve, diktuar kjo nga gjëndja e tyre ekonomike.

Për grupet e krimit të organizuar, lëvizja e fëmijëve përgjatë kufijve të kontrolluar është një veprimtari pa probleme. Në shumë raste viktimat udhëtojnë me pasaporta të rregullta të cilët nuk bashkëshoqërohen nga të rriturit. Shumë fëmijë nuk mund të identifikohen për shkak të ngjashmërive që kanë në pasaporta, madje brenda kufijve shengen në sajë të kontrolleve të hequra është gati e pamundur të identifikohen këta fëmijë.

Pavarësisht nga numri i vogël i gjykimeve në lidhje me të dënuarit për veprën penale të trafikimit të fëmijëve, karakteristikë e tyre është se shumica e të trafikuarve për të lypur dhe punë të detyruar i përkasin minoritetit të grupeve “evgjite” dhe “rome”. 90% e fëmijëve të trafikuar në Greqi janë evgjitë, ndërsa 10% janë ose rom ose shqiptarë të bardhë. Shumica vijnë nga Elbasani, Korça, Berati dhe Tirana ku ka një numër të madh evgjitësh dhe romësh. ”Ndihmë për Fëmijët” vlerëson se 80% e fëmijëve janë të

rekrutuar prej trafikantëve, ndërsa 20% janë të dërguar nga familjet e tyre. Trafikantët janë ose shqiptarë ose evgjit shqipëtar, megjithse bosët e përgjithshëm janë zakonisht shqiptarë të “bardhë” që jetojnë në Elbasan ose në Greqi.<sup>144</sup>

---

<sup>144</sup> Daniel Renton , “*Trafikimi i Fëmijëve në Shqipëri*”, nga ”Save the Children”, Tiranë, Korrik 2001.

## **Kapitulli II: Shikim i përgjithshëm i kuadrit ligjor ndërkombëtar përkatës lidhur me trafikimin.**

### **1. Traktatet ndërkombëtare për krimin e organizuar ndërkombëtar, trafikimin e qenieve njerëzore dhe kalimin kontrabandë të migruesve.**

Traktati është një marrëveshje, thuajse gjithmonë midis dy apo më shumë shteteve, i cili parashikon të drejta dhe detyrime të zbatueshme në të drejtën ndërkombëtare. Shtetet janë të detyruar ta zbatojnë sepse ato bien dakord për një gjë të tillë. Shtetet që kanë rënë dakord të detyrohen ta zbatojnë një traktat njihen si “shtete palë” të traktatit në fjalë. Duke u bërë palë e një traktati, shtetet marrin përsipër detyrime të zbatueshme në të drejtën ndërkombëtare. Në shumicën e traktateve që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore apo me kalimin kontrabandë të migruesve, kjo do të thotë se shtetet palë marrin përsipër të sigurojnë që legjislacioni, politikat apo praktikat e brendshme të tyre të përmbushin kërkesat ligjore të traktatit dhe të përputhen me standardet e tij.

Në varësi të burimit të tyre, këto detyrime mund të jenë objekt gjykimi i gjykatave ndërkombëtare me juridiksionin e duhur, siç është Gjykata Ndërkombëtare, Gjykata Ndërkombëtare Penale apo Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Nëse këto detyrime janë apo jo objekt gjykimi në gjykatat e brendshme, kjo është një çështje më vete, e cila duhet vendosur nga ligji i brendshëm.

Në disa vende, është i nevojshëm nxjerrja e një legjislacioni për t'i trupëzuar traktatet në ligjin e brendshëm, ndërsa në vende të tjera kushtetuta parashikon që traktatet të kenë automatikisht statusin e ligjit të brendshëm.

Tre traktatet që lidhen drejtpërdrejt me trafikimin e qenieve njerëzore dhe kalimin kontrabandë të migruesve në kuadrin e gjerë të krimit të organizuar ndërkombëtar janë: “Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” (UNTOC), “Protokolli i OKB-së për Trafikimin” dhe “Protokolli i OKB-së për Kontrabandën”, të gjithë të miratuar në dhjetor 2000. Më poshtë jepet informacion i hollësishëm për dispozitat madhore të tyre. Në kërçet në vijim jepet informacion shtesë për aspektet e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar të këtyre instrumenteve.

### **1.1. Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC).**

Kjo Konventë është instrumenti qendror i një pakete traktatesh të hartuar për të trajtuar krimin e organizuar ndërkombëtar. Protokollet e veçanta që i janë bashkëlidhur UNTOC-së trajtojnë konkretisht trafikimin e qenieve njerëzore, kalimin kontrabandë të migruesve dhe trafikimin e armëve të vogla. Dispozitat e Konventës zbatohen për të tria format e krimit. Qëllimi i UNTOC-së është nxitja e bashkëpunimit midis shteteve për ta luftuar më me efektivitet krimin e organizuar ndërkombëtar. UNTOC kërkon t'i eliminojë 'bazat' ku mund të zhvillohen veprimtaritë kriminale të organizuara apo të fshehjes së provave apo fitimeve, përmes nxitjes së miratimit të masave bazë minimale.

Ka dy parakushte parësore për zbatimin e UNTOC-së. Së pari, vepra përkatëse duhet të jetë "e rëndë" dhe të ketë njëfarë aspekti ndërkombëtar. Së dyti, duhet të përfshijë një grup kriminal të organizuar. Të dy këto elemente janë të përkufizuar në mënyrë shumë të gjerë. "Krimi i rëndë" përkufizohet në mënyrë të atillë që të përfshijë të gjitha veprat e rëndësishme kriminale. Për pasojë, shtetet mund ta përdorin Konventën për të trajtuar një gamë të gjerë veprimtarish kriminale bashkëkohore, ku përfshihen edhe trafikimi i qenieve njerëzore dhe kalimi kontrabandë i migruesve. Kjo është sidomos e rëndësishme duke pasur parasysh faktin se shtetet mund të bëhen palë e Konventës pa iu dashur të ratifikojnë ndonjërin apo të gjithë protokollet dhe se ratifikimi i Konventës duhet t'i paraprijë ratifikimit të protokolleve.

Detyrimi parësor i Konventës ka të bëjë me përcaktimin si vepër penale të sjelljes konkrete.

Shteteve palë u kërkohet të përcaktojnë si vepër penale dhe të paeashikojnë sanksionet e duhura:

- Pjesëmarrjen në një grup kriminal të organizuar;
- Pastrimin e të ardhurave nga krimi
- Korrupsionin e sektorit publik; dhe
- Pengimin e drejtësisë.

Njëra prej pengesave kryesore ndaj veprimit të efektshëm kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, përfshirë edhe trafikimin e qenieve njerëzore, ka qenë mungesa e komunikimit dhe bashkëpunimit midis agjencive kombëtare të drejtësisë penale. UNTOC parashton një varg masash për t'u miratuar nga shtetet palë, për të

rritur bashkëpunimin midis forcave të ligjit. Zbatimi praktik i këtyre dispozitave ka të ngjarë të rritet nga përfshirja e një kuadri ligjor të hollësishëm për ndihmën e ndërsjelltë juridike në hetimin, ndjekjen penale dhe proceset gjyqësore në lidhje me veprat e zbatueshme.

Shtetet palë mund ta përdorin Konventën për të kërkuar ndihmë të ndërsjelltë juridike për një varg qëllimesh përfshirë:

- Marrjen e provave;
- Realizimin e shërbimit të dokumenteve gjyqësore;
- Ekzekutimin e kontrolleve;
- Identifikimin e produkteve të krimit;
- Nxjerrjen e informacionit dhe të dokumentacionit.

Shtetet palë nxiten gjithashtu edhe që:

- Të krijojnë organe hetimore të përbashkëta;
- Të arrijnë marrëveshje zyrtare për përdorimin e teknikave hetimore të posaçme;
- Të shqyrtojnë transferimin e çështjes penale;
- Të shqyrtojnë transferimin e personave të dënuar;
- Të mundësojnë procedurat e ekstradimit për veprat e zbatueshme;
- Të rrisin dhe, kur të jetë nevoja, të vendosin kanale komunikimi për mundësimin e shkëmbimit të sigurt dhe të shpejtë të informacionit.

## **1.2. Protokollin i OKB-së kundër trafikimit.**

“Protokollin i OKB-së për Parandalimin, Ndalimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, sidomos të Grave dhe Fëmijëve, i cili plotëson Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” është më i rëndësishmi nga të gjithë traktatet ndërkombëtare për trafikimin. Ky Protokoll ka hyrë në fuqi në vitin 2003, ndërsa deri më 1 janar 2009 në të merrnin pjesë mbi 124 shtete palë. Ai u kërkon shteteve të përcaktojnë si vepër penale trafikimin e qenieve njerëzore sipas përkufizimit në këtë instrument, si edhe veprat e lidhura me të.

Qëllimet e këtij Protokolli janë:

- Parandalimi dhe luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore, duke treguar vëmendje të veçantë për gratë dhe fëmijët;
- Ndihma e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, duke i respektuar plotësisht të drejtat e tyre të njeriut; dhe
- Nxitja e bashkëpunimit midis shteteve palë, në mënyrë që të arrihen këto objektiva.

Detyrimet kryesore të shteteve palë të Protokollit janë si vijon:

- Të cilësojnë si vepër penale “trafikimin e qenieve njerëzore” sipas përkufizimit në Protokoll dhe të vendosin ndëshkime të cilat të marrin në konsideratë natyrën e rëndë të kësaj vepre.
- Të mbrojnë, me aq sa jep mundësi ligji i brendshëm, fshehtësinë e të dhënave dhe identitetin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të shqyrtojnë idenë e ofrimit të një vargu shërbime sociale për të mundësuar rikuperimin e tyre nga trauma që kanë pësuar.
- Të sigurojnë që sistemi ligjor të përmbajë masa që u ofrojnë viktimave mundësinë për të marrë kompensim.
- Të fuqizojnë ato kontrole kufitare që janë të nevojshme për parandalimin e trafikimit, pa cenuar detyrimet e tjera ndërkombëtare që mundësojnë lëvizjen e lirë të njerëzve.
- Të sigurojnë integritetin e dokumenteve kombëtare të udhëtarëve apo të letërnjoftimeve dhe të veprojnë menjëherë në përgjigje të kërkesave për verifikimin e dokumenteve të tilla.
- Të fuqizojnë, si duhet, bashkëpunimin me shtetet e tjera për shkëmbimin e informacionit lidhur me identitetet, përdorimin keqberës të dokumenteve dhe mjetet dhe metodat e përdorura nga trafikantët. Kërkohet edhe ofrimi dhe/ose fuqizimi i trajnimit të zyrtarëve për njohjen dhe parandalimin e trafikimit, përfshirë edhe trajnimin ndërgjegjësues për të drejtat e njeriut.
- Të shqyrtojnë mundësinë e lejimit të viktimave të qëndrojnë në territorin e tyre, përgjithmonë apo përkohësisht, duke marrë në konsideratë faktorët humanitarë apo njerëzorë.
- Të pranojnë kthimin e çdo viktime të trafikimit që është shtetas i atij vendi, apo që ka leje qëndrimi të përhershme në atë vend, në kohën e hyrjes në shtetin pritës. Gjatë

kthimit të një viktime, i duhet kushtuar vëmendja e duhur sigurisë së viktimës, ku preferohet që kthimi të jetë i vullnetshëm.

### **1.3. Protokollit i OKB-së kundër kontrabandës.**

Qëllimet e “Protokollit të OKB-së kundër Kalimit Kontrabandë të Migruesve me Tokë, Det dhe Ajër, i cili plotëson Konventën e OKB-së kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar” janë parandalimi dhe lufta kundër kalimit kontrabandë të migruesve, si edhe nxitja e bashkëpunimit mes shteteve palë për këtë qëllim.

Detyrimet kryesore të shteteve palë të Protokollit janë si vijon:

- Të përcaktojnë si veprë penale “kalimin kontrabandë të migruesve”, përdorimin e dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit ose identitetit (për qëllimet e kontrabandës) dhe ndihmën që u jepet migruesve të kaluar kontrabandë për të qëndruar në mënyrë të paligjshme në një vend, duke pranuar, në të njëjtën kohë, që migrimi në vetvete nuk përbën krim.
- Të rrisin bashkëpunimin ndërkombëtar për parandalimin e kontrabandës së migruesve dhe të kërkojnë e të gjejnë dhe të ndjekin penalisht kontrabandistët.
- Të miratojnë masa të tilla legjislative dhe të tjera, të cilat janë të nevojshme për të mundësuar një ndëshkim më të rëndë kur veprimtaritë e kontrabandistëve vendosin, ose kanë mundësi të vendosin, në rrezik jetën dhe sigurinë e migruesve, ose përfshijnë trajtim çnjerëzor ose poshtëruës, përfshirë edhe shfrytëzimin e migruesve.
- Të shkëmbejnë mes tyre, në përputhje me sistemet juridike dhe administrative të brendshme respektive, informacione përkatëse për çështjet që lidhen me rrugët, mënyrën e veprimit dhe identitetin e bandave kriminale të organizuara që janë të përfshira në kalimin kontrabandë të migruesve si edhe përvojat dhe praktikën legjislative dhe përvojat shkencore dhe teknike të dobishme për forcat e ligjit, në mënyrë që të rritet aftësia për t’i parandaluar, diktuar dhe hetuar veprimtari të tilla dhe për t’i ndjekur penalisht autorët e tyre;
- Të fuqizohen ato kontrolle kufitare që mund të jenë të nevojshme për të parandaluar dhe diktuar kalimin kontrabandë të migruesve, pa cenuar angazhimet ndërkombëtare lidhur me lëvizjen e lirë të njerëzve.



#### **1.4. Marrëdhëniet midis UNTOC-së dhe Protokolleve të OKB-së për Trafikimin dhe Kontrabandën.**

Më poshtë jepen parimet kryesore që rregullojnë marrëdhëniet midis UNTOC-së dhe Protokolleve të OKB-së për Trafikimin dhe Kontrabandën.

- Duke qenë se Protokollet nuk janë menduar si traktate të pavarura, Shtetet duhet të ratifikojnë UNTOC-në përpara se të ratifikojnë ndonjërin prej protokolleve të tij.
- Protokollet e OKB-së për Trafikimin dhe Kontrabandën duhet të interpretohen së bashku me UNTOC-në. Gjatë interpretimit të Protokolleve, duhet mbajtur parasysh qëllimi i deklaruar i tyre, i cili mund të shkaktojë një ndryshim të kuptimit që vlen për UNTOC-në.
- Dispozitat e UNTOC-së zbatohen edhe për Protokollet, duke bërë ndryshimet e nevojshme. Kjo do të thotë se kur Konventa zbatohet për Protokollet, ndryshimet e interpretimit apo zbatimit duhet të bëhen vetëm kur janë të nevojshme dhe aq sa janë të nevojshme.

Shkeljet e përcaktuara në Protokollet duhet të konsiderohen si shkelje të përcaktuara në UNTOC. Kjo do të thotë se, pasi të ratifikojë njërin prej Protokolleve të lartpërmendur, detyrimet e një Shteti në kuadër të instrumentit në fjalë, sa i takon trafikimit të qenieve njerëzore apo kalimit kontrabandë të migruesve, plotësohen nga detyrimet e përgjithshme të parashtruara në Konventë. Për shembull, ratifikimi i Protokollit do të thotë që Shtetit do t'i kërkohet të zbatojë, në lidhje me krimet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe kalimin kontrabandë të migruesve, dispozitat e Konventës për ndihmën e ndërsjelltë juridike, ekstradimin, mbrojtjen e dëshmitarëve dhe pastrimin e parave

#### **1.5. Traktatet specifike rajonale për trafikimin e qenieve njerëzore dhe kalimin kontrabandë të migruesve.**

Kuadri ligjor ndërkombëtar për trafikimin e qenieve njerëzore përfshin edhe traktate të specializuara të cilat janë realizuar midis grupeve rajonale të shteteve. Një shembull shumë i rëndësishëm është Konventa e vitit 2005 e Këshillit të Evropës “Për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore” (Konventa Evropiane kundër Trafikimit), e cila hyri në fuqi në muajin Shkurt 2008. Kjo konventë ka potencialin për të lidhur më se dyzet vende të Evropës Perëndimore, Qendrore dhe Lindore me një nivel shumë më të

lartë detyrimi, sidomos sa i takon mbrojtjes së viktimave, në krahasim me detyrimin e kërkuar nga Protokollin i OKB-së për Trafikimin. Të gjitha vendet pjesëmarrëse e kanë zbatuar këtë Konventë (Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia dhe Mali i Zi në vitin 2008, dhe Serbia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë në vitin 2009).

Nuk ka ndonjë traktat specifik rajonal lidhur me kalimin kontrabandë të migruesve. Mirëpo, Konventa për Bashkëpunimin Policor për Evropën Juglindore (KBP) i mbulon të gjitha aspektet e bashkëpunimit ndërkombëtar midis agjencive të forcave të ligjit në lidhje me të gjitha format e krimit, përfshirë, këtu, edhe trafikimin e qenieve njerëzore dhe kalimin kontrabandë të migruesve. KBP-ja është ratifikuar nga të gjitha vendet pjesëmarrëse, me përjashtim të Kroacisë, së bashku me Bullgarinë, Moldavinë dhe Rumaninë, dhe është në faza të ndryshme të vënies në zbatim nga Palët Kontraktuese. Konventa i angazhon Palët Kontraktuese ta forcojnë bashkëpunimin mes tyre në lidhje me luftën kundër rreziqeve që i kanosen sigurisë publike dhe/ose rendit publik, si edhe në lidhje me parandalimin, zbulimin dhe hetimet policore të veprave penale.

Edhe pse traktatet rajonale vendosin detyrime vetëm mbi ato shtete të cilat janë palë të tyre, ato mund t'u ofrojnë të gjitha vendeve një informacion të dobishëm lidhur me zhvillimin e standardeve. Ato mund të ndihmojnë edhe në zhvillimin e së drejtës zakonore ndërkombëtare në një fushë apo për një çështje të caktuar.

### **1.6. Traktatet për të Drejtat e Njeriut.**

Traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kuadrit ligjor të zbatueshëm për trafikimin e qenieve njerëzore. Dy prej traktateve ndërkombëtare më të rëndësishme për të drejtat e njeriut e përmendin shprehimisht trafikimin e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimin e lidhur me të.

- *Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Femrave (CEDAË):*  
Neni 6 i saj e ndalon shprehimisht trafikimin dhe shfrytëzimin për prostitucion të femrave.
- *Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (CRC).* Kjo konventë e ndalon trafikimin e fëmijëve dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve si detyrimin e tyre për të bërë punë të detyruar apo për t'i shfrytëzuar. Kjo konventë përmban edhe dispozita të rëndësishme për mbrojtjen e fëmijëve që janë trafikuar.

Edhe traktate të tjera për të drejtat e njeriut<sup>145</sup> i ndalojnë disa sjellje apo praktika të caktuara të cilat kanë lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, ku përfshihet: diskriminimi kombëtar, racial dhe seksual; skllavëria; puna e detyruar dhe puna shërbëtori; shfrytëzimi seksual i fëmijëve; martesat me forcë; torturat dhe trajtimi e ndëshkimi ç'njerëzor dhe ngujimi pa arsye.

Traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut identifikojnë dhe mbrojnë edhe disa të drejta të cilat janë veçanërisht të rëndësishme në kuadër të trafikimit të qenieve njerëzore, siç janë: e drejta për të pasur dhe trashëguar pronë; e drejta për arsim; e drejta për të pasur mundësi për të fituar jetesën përmes punës së zgjedhur apo pranuar lirisht; dhe e drejta për një rrugëzgjdhje ligjore. E drejta për proces të drejtë dhe të rregullt gjyqësor është një e drejtë qendrore e njeriut e cila ka rëndësi të veçantë në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, përfshirë edhe ndihmën e ndërsjelltë reciproke dhe ekstradimin.

Konventa e vitit 1951 e OKB-së “Për statusin e refugjatëve”, në nenin 31 thotë:.,

*“Shtetet Kontraktuese nuk i ndëshkojnë, lidhur me hyrjen apo praninë e paligjshme, refugjatët të cilët, duke ardhur drejtpërdrejt nga një territor ku është vendosur në rrezik jeta apo liria e tyre sipas kuptimit të nenit 1, hyjnë ose ndodhen pa leje në territorin e tyre, me kusht që ata të paraqiten vetë, pa vonesë, përpara autoriteteve dhe të tregojnë një shkak të fortë për hyrjen apo praninë e paligjshme të tyre”.*

### **1.7. Traktatet e së drejtës penale / traktatet e mbajtjes në kontroll të krimit.**

Gjatë dekadës së fundit, janë miratuar një sërë traktatesh ndërkombëtare që kanë të bëjnë me çështjet penale (si në përgjithësi, ashtu edhe në lidhje me përgjegjësinë penale individuale të veçantë). Ata që lidhen më shumë me trafikimin e qenieve njerëzore dhe kalimin kontrabandë të migruesve janë Protokollet e lartpërmendur të UNTOC-së.

Në krerët në vijim flitet për rrjetin kompleks të instrumenteve të së drejtës penale / mbajtjes në kontroll të krimit, i zhvilluar në nivele dypalëshe dhe rajonale për t'u dhënë zgjidhje çështjeve konkrete siç është ndihma e ndërsjelltë reciproke dhe ekstradimi.

---

<sup>145</sup>Disa shembuj të traktateve për të drejtat e njeriut janë:

- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR).
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (ICESCPR).
- Konventa për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD).
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (Konventa Kundër Torturës).
- Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punonjësve Migrues dhe të Anëtarëve të Familjeve të Tyre (Konventa për Punëtorët Migrues).

### **1.8. Instrumente që nuk janë në formën e traktatit.**

Jo të gjitha instrumentet ndërkombëtare që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore apo kalimin kontrabandë të migruarëve (apo, madje, me vetë çështjet e bashkëpunimit ndërkombëtar) janë traktate të zbatueshme me detyrim. Deklaratat, kodet dhe marrëveshjet dypalëshe apo shumëpalëshe si edhe rezolutat e OKB-së janë të gjitha burime të rëndësishme orientuese për hartimin e masave strategjike të bashkërenduara kundër autorëve të këtyre krimeve. Si e drejtë që nuk ka formën e mirëfilltë të legjislacionit, këto instrumente mund të ndihmojnë edhe në përgatitjen e normave dhe standardeve të reja ligjore.

Në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore, instrumenti joligjor më i rëndësishëm është dokumenti i vitit 2002, me titull “Parimet dhe udhëzuesit e rekomanduar nga OKB-ja për të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore” (Parimet dhe Udhëzuesit për Trafikimin). Shumë aspekte të Parimeve dhe Udhëzuesve për Trafikimin mbështeten në të drejtën e traktateve ndërkombëtare.

Mirëpo, disa pjesë të këtij dokumenti shkojnë më tej, ato përdorin standardet ligjore ndërkombëtare të pranuar për të përgatitur udhëzime më specifike dhe të hollësishme për shtetet, në fusha të tilla si legjislacioni, kundërpërgjigja e drejtësisë penale, bashkëpunimi ndërkombëtar, ndalimi i viktimave dhe mbrojtja e mbështetja e viktimave. Kohët e fundit Fondi për Fëmijët i Organizatës së Kombeve të Bashkuara nxori një paketë me “Udhëzime për mbrojtjen e fëmijëve viktimë të trafikimit” (Udhëzimet e UNICEF-it), të cilat ofrojnë orientime të mëtejshme për çështjen konkrete të fëmijëve viktimë.

Edhe në nivel rajonal janë hartuar instrumente pjesërisht-ligjore ose joligjore. Ashtu sikurse edhe instrumentet ndërkombëtare homologe me to, edhe këto instrumente shpesh i ritheksojnë e i zgjerojnë parimet ekzistuese juridike dhe, ndonjëherë, shkojnë edhe përtej gjërave për të cilat kanë rënë dakord zyrtarisht shtetet. Mirëpo, në këtë rast të fundit, ato mund të ndihmojnë vetëm në sqarimin se në cilin drejtim lëviz e drejta ndërkombëtare në lidhje me çështje të caktuara.

## **1.9. Konventa dhe akte të tjera ndërkombëtare që mbështesin konventat mbi trafikimin.**

Historia tregon se trafikimi i grave dhe fëmijëve të seksit femër për qëllime të shfrytëzimit seksual ka qenë në qendër të vëmendjes së politikës. Proçesi i krijimit dhe i zbatimit të marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare fillon që në fillim të viteve 1900 të cilat renditen më poshtë:

- Marrëveshja Ndërkombëtare për Shtypjen e Tregut të Skllevërve të Bardhë e nënshkruar në Paris me 18 Maj 1904. Efekti minimal përqëndrohej në mbrojtjen e viktimave, i kufizuar në dënimin e autorëve.
- Konventa për Shtypjen e Trafikut të Skllevërve të Bardhë e 4 Majit 1910, mbajtur në Paris, e cila parashikonte detyrimin e shteteve nënshkruese të dënonin autorët.
- Konventa për Shtypjen e Trafikut të Grave dhe Fëmijëve e 30 Shtatorit 1921, mbajtur në Gjenevë nën kujdesin e Lidhjes së Kombeve.
- Konventa për Shtypjen e Trafikut të Grave në Moshë Madhore e 11 Tetorit 1933, mbajtur në Gjenevë.
- Konventa e Lidhjes së Kombeve për shtypjen e Trafikimit të Personave dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të tjerëve e 2 Dhjetorit 1949.

Kjo është Konventa e parë e rëndësishme në lidhje me trafikimin human e cila konsolidon dhe zgjeron kuptimin dhe synimet e konventave të deriatëhershme. Në mënyrë të qartë Konventa dënon çdo person që trafikon një tjetër për qëllime prostitucioni, si dhe dënon çdo person që shfrytëzon prostitucionin e një tjetri. Aktet e mësipërme bëhen të dënueshme pavarësisht nga pëlqimi i të dëmtuarit. Bëhet e dënueshme mbajtja, menaxhimi, financimi i shtëpive publike apo lënia, marrje me qira e tyre. Në Konventë në mënyrë eksplicite bëhet e dënueshme tentativa dhe përgatitja e veprave të mesipërme sikurse dhe pjesëmarrja në to.

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut në kuadër të OKB-së (10 Dhjetor 1948). Është dokument bazë ku janë mbështetur legjislacionet e shteteve dhe që kanë lidhje me liritë dhe të drejtat e njeriut, nuk ka norma detyruese e dënime, vendos norma e parime që shtetet zotohen t'i ndjekin, sanksionon liritë themelore, barazinë, ndalimin e skllavërisë e trajtimit skllavërues, torturën-trajtimitin degradues etj.<sup>146</sup>

---

<sup>146</sup> Neni 2 i *Konventës dhe Protokollit 6*, neni 3 i Konventës, neni 4 i Konventës.

- Konventa Nderkombëtare mbi të Drejtat Civile e Politike (16 Qershor 1966). Sanksionon heqien e skllavërisë dhe tregëtisë së skllavërve, gjendjes së nënshtrimit dhe punës së detyruar. Parashikon rastet e palejuara të punës së detyruar.
- Konventa Nderkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, po e vitit 1966 bën plotësimin e konventës së mësipërme në lidhje me liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale e kulturore.
- Konventa mbi Zhdukjen e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (3 Shtator 1981). Parashikon detyrimin e palëve të marrin masa (përfshirë dhe ato legislative) për shtypjen e të gjitha formave të trafikimit të grave dhe shfrytëzimin për prostitucion të tyre.
- Konventa kundër Torturës dhe trajtimeve apo Dënimeve të tjera mizore, ç'njerëzore apo Degraduese<sup>147</sup> (10 Dhjetor 1984). Jep kuptimin e torturës apo trajtimit ç'njerëzor e degradues, Detyron palët të bëjnë të dënueshme me legjislacion të brendshëm akte të tilla.
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (20 Nëntor 1989). Jep kuptimin e fëmijës si qenie humane nën 18 vjeç, detyrimin e palëve për mbrojtjen prioritare të të drejtave të fëmijëve, detyron palët të marrin të gjitha masat për mbrojtjen e tyre nga përfshirja, shfrytëzimi seksual apo pornografik, nga trafikimi në ç'do formë apo për ç'do qëllim.
- Konventa mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve, Migrantëve dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre (18 Dhjetor 1990). Synon mbrojtjen e emigrantëve dhe familjeve të tyre nga skllavëria, puna e detyruar, dhe përcakton rastet që nuk janë punë të detyruara.
- Konventa mbi Skllavërinë (25 Shtator 1926). Jep përcaktimin e skllavërisë, punës së detyruar dhe tregëtisë së skllavërve, detyrimin e palëve të marrin masat për zhdukjen e skllavërisë në ç'do formë të saj, si dhe jep ndalimin e tregëtisë apo trafikut.
- Konventa Shtesë mbi Zhdukjen e Skllavërisë, Tregtimit të Skllavërve, të Instituteve e Praktikave të Ngjashme me Skllavërinë (7 Shtator 1956). Përpunon me tej konceptin e skllavërisë dhe formave moderne të shfaqjes, konceptin e trafikimit duke theksuar atë të fëmijëve, si dhe kriminalizon aktet e skllavërisë.

---

<sup>147</sup> Ratifikuar me Ligjin nr. 8135, datë 31.07.1996 të Kuvendit Popullor, shpallur me Dekretin nr.1572, datë 2.8.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Prof.Dr.Sali Berisha, për aderimin në “Konventën Europiane për parandalimin e torturës dhe të trajtimit ose ndëshkimit ç'njerëzor ose degradues”.

• Konventa nr. 29 dhe 105 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me Punën e Detyruar dhe Zhdukjen e Punës së Detyruar (1930 dhe 1957). Në këto konventa bëhet përkufizimi i konceptit “punë e sforcuar apo me detyrim”, jep rastet se kur nuk jemi para punës së sforcuar apo me detyrim.

• Konventa Europiane mbi të Drejtat e Njeriut<sup>148</sup> dhe Karta e BE mbi të Drejtat Themelore (4 Nëntor 1950). Në këtë konventë u arrit në përfundimin se ishte pikërisht mosrespektimi i të drejtave të individit, që shpuri në shpërthimin e Luftës së II Botërore.<sup>149</sup> Kjo konventë ndalon skllavërinë dhe kushtet skllavëruese, punën e sforcuar apo atë me detyrim.

1. *Askush nuk mund të mbahet në skllavëri apo në kushte skllavëruese.*<sup>150</sup>

2. *Asnjë person nuk do t'i kërkohet të kryejë punë të sforcuar apo me detyrim.*<sup>151</sup>

Konventa parashikon në nenin 4 atë se çfarë nuk është punë e detyruar:

*“Puna që kërkohet të kryhet gjatë kohës se qeni nën një masë sigurimi me heqje lirie apo lirimi me kusht, shërbimi me karakter ushtarak, shërbimi i urdhëruar me rastin e një emergjence apo fatkeqësie natyrore, punë apo shërim si pjesë e detyrimeve normale civile.”*

Konventa nuk jep kuptimin e punës së sforcuar apo me detyrim. Kuptimi i punës së sforcuar apo me detyrim sipas nenit 2 të Konventes nr. 29 të ONP (ILO) është:

*“Ç’do lloj pune që kërkohet nga një person me urdhër, nën kërcënimin e një dënimi, dhe për të cilën personi në fjalë nuk është ofruar vullnetarisht”.*

Parimi universal i Konventës për interpretim progresiv të së drejtës pozitive, duke mos dhënë përkufizimet e nocioneve “skllavëri”, ”kushtet skllavëruese”, ”punë e sforcuar apo me detyrim” mban parasysh format moderne të shfaqjes.

Karta e të Drejtave Themelore sjell si të re në nenin 3 të saj parashikimin: “*Trafikimi i qenieve njerëzore është i ndaluar*”, në këtë mënyrë ky dokument e identifikon trafikimin si një formë moderne skllavërie”.<sup>152</sup>

<sup>148</sup> Republika e Shqipërisë këtë Konventë e miratoi në Parlament me Ligjin nr. 8137 datë 31.07.1996, shpallur me dekretin nr.1573, date 2.8.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Prof. Dr. Sali Berisha dhe e ratifikoi me 02.10.1996.

<sup>149</sup> Marek Antoni Novicki, *Gurët udhërrëfyes*, Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, përkthyer nga polonishtja. Tiranë 1999, fq.7.

<sup>150</sup> Neni 4 EHCR, *Ndalimi Skllavërisë dhe robërisë*, Fragmente Kryesore të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe vendimeve e Raporteve të Komisionit Europian të të Drejtave të Njeriut, shtator 1998, fq. 27.

<sup>151</sup> Neni 4 parag. 2, vep. cit. fq. 28.

- Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, parashikon si krim kundër njerëzimit në nenin 7 atë të skllavërimit si “*ushtrim të një apo të gjitha tagrave që lidhen me të drejtën e pronësisë mbi një person*”, duke përfshirë “*ushtrimin e këtyre tagrave gjatë trafikimit të njerëzve*” kur kryhet si pjesë e një sulmi të gjërë e sistematik kundër popullsisë civile dhe me dijeninë e shkaktarëve. Ky statut parashikon si krime lufte të njëjtat krime në rrethana konfliktesh të brendshme apo ndërkombëtare.

Si përfundim theksojmë se si deklarata e BE-së, edhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, përdorin konceptin e skllavërisë në kontekstin e sotëm duke përmendur në mënyrë të qartë trafikimin në të njëjtën dispozitë ku përdoret skllavëria dhe puna e detyruar.<sup>153</sup>

---

<sup>152</sup> Konventa e ndalon në terma absolute torturën dhe trajtimin ç’njerëzor ose poshtëruës, ose ndëshkimin, pavarësisht nga sjellja e viktimës. Ndryshe nga pjesa më e madhe e dispozitave materiale të Konventës dhe të Protokolleve Nr.1 dhe 4, Neni 3 nuk parashikon përjashtime dhe, në bazë të nenit 15 paragrafi 2, prej tij nuk mund të ketë derogim, madje as në rastin e një situatë të jashtëzakonshme publike që kërcënon jetën e kombit.

<sup>153</sup> Sipas marreveshjes së nënshkruar, Gjykata Penale ndërkombëtare do të ketë 18 gjykatës dhe do të jetë kompetente t’i gjykojë personat e akuzuar për krimet e gjenocidit, krimet e luftës, për agresionin dhe në përgjithësi për krime kundër njerëzimit. I. Salihu. *E Drejta Penale*, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë 2003.



## **Kapitulli III: Vështrim komparativ i trafikimit të qenieve njerëzore**

### **1. Trafikimi dhe prostitucioni. Prostitucioni “i lirë” dhe i “forcuar”.**

Konventa e vitit 1949 e Kombeve të Bashkuara mbi shtypjen e personave të trafikuar i konsideronte të gjitha format e prostitucionit si shfrytëzim. Që nga ajo kohë mënyra se si trajtohen prostitucioni “i lirë” dhe ai “i forcuar” ka pësuar një ndryshim të dukshëm dhe të rëndësishëm. Deklarata e vitit 1993 për eliminimin e dhunës kundër Grave dhe Platforma e Pekinit për Veprim, kanë njohur vetëm prostitucionin e forcuar si një dhunim të të drejtave të njeriut. Prirjet aktuale e trajtojnë punën e seksit si një formë pune të përligjur dhe në të njëjtën kohë edhe Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO)<sup>154</sup> e klasifikon trafikimin si një formë të punës së forcuar. Krahas kësaj ka pikëpamje që argumentojnëse të njëjtat kushte degraduese të trafikimit ekzistojnë edhe në rastin e prostitucionit. Kundër të drejtës individuale për vetvendosje, ato argumentojnë se nuk ekziston diçka e tillë që mund të quhet prostitucion i lirë, asnjë grua nuk mund të punojë në të vullnetarisht, por nëpërmjet përdorimit të mjeteve mashtruese dhe abuzimit me gjendjen e vulnerabilitetit. Kontrolli dhe shfrytëzimi ushtrohet nga protektorët. Për më tej pohohet që parandalimi i prostitucionit duhet të konsiderohet si një masë për parandalimin e trafikimit, duke njohur kështu faktin që kërkesa për prostitucionin çon në rritjen e shpejtë të fenomenit të trafikimit.

Është shtruar për diskutim edhe çështja nëse legalizimi i prostitucionit mund të luajë rol edhe në forcimin e masave kundër trafikimit të grave dhe vajzave. Prostitucioni është legalizuar në pjesën më të madhe të vendeve të Europës. Nga një studim është argumentuar se “legalizimi i prostitucionit nuk është shoqëruar me ndonjë ndikim domethënës në shkallën e përhapjes së trafikimit”. Për më tepër, numri më i madh i vajzave dhe grave të trafikuar është identifikuar në vendet e Europës Perëndimore në të cilat prostitucioni është legalizuar.

Trafikimi i heq viktimave të tij të drejtën për një jetë produktive, shpërblyese dhe me dinjitet. Viktimat (gratë, vajzat dhe fëmijët e trafikuar) nënshtrohen, robërohen, abuzohen nga trafikantët, kriminelët duke u dhunuar në të gjitha format e dhunës.

Siç edhe është theksuar, trafikimi i femrave për shfrytëzim prostitucioni është një nga format më të ashpra të trafikimit. Për të përdoren të njëjtat rrugë kalimi si edhe për

---

<sup>154</sup> IOM, „*Guidë për Instrumentet e Zgjedhura Ligjore të BE-së mbi Emigracionin*“, Vienë, Gusht 2005.

trafikun e personave që emigrojnë për punësim. Në pjesën më të madhe të rasteve, vajzat dhe gratë janë trafikuar për të punuar në shtëpi publike, masazheri, klube nate ose për të prodhuar materiale pornografike.

Kohët e fundit ka pasur një njohje të faktit se trafikimi përfshin jo vetëm trafikimin e detyruar por dhe shfrytëzimin seksual, por gjithashtu është i njohur trafikimi i grave, burrave dhe fëmijëve për punë të detyruar. Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës kemi këtë përkufizim për punë e forcuar: “Kryerja e punëve apo shërbimeve si rrjedhojë e një kërcënimi apo ndëshkimi”.

### **1.1. Ndryshime ndërmjet prostitucionit dhe trafikimit.**

Ka një problem identifikimi ose problemi sqarimi të pamjaftueshëm të grave dhe vajzave nga fenomeni i përgjithshëm i prostitucionit. Nga kjo lind nevoja për një përcaktim më të qartë dhe një njohje të elementeve që bëjnë ndryshimin e trafikimit të qenieve njerëzore, pikërisht trafikimin e grave dhe vajzave nga fenomeni i prostitucionit.

Dhënia me dëshirë e trupit dhe e shërbimeve seksuale për kompensim të caktuar material është një karakteristikë domethënëse në përcaktimin e ndryshimit ndërmjet këtyre dy fenomeneve. Kjo dëshirë për të prostituuar dallohet nga zotërimi i mundësive për të marrë vendim individual për ndalimin e këtij aktiviteti nga vetë prostitutat, d.m.th kur të dëshirojnë dhe të vendosin ato, pavarësisht nga problemet ekonomike.

Në trafikimin e qenieve njerëzore një mundësi e tillë thjesht nuk ekziston për gratë dhe vajzat e tregtuara d.m.th për viktimat. Ato kanë një sistem varësie të vendosur për to. Ky është një sistem i tërë i përbërë prej kërcënimit, përdorimit të dhunës psikologjike dhe fizike, të mashtrimit, të shkatërrimit mendor dhe fizik, lidhjet e borxhit dhe ndonjëherë edhe raste vrasjesh si shembull për të tjerët. Ky lloj sistemi e bën viktimën të paafte të çlirojë vetveten nga ky rreth i pamëshirshëm varësie, shfrytëzimi seksual dhe skllavërie. Elementet e skllavërisë, të zgjedhjes, të shfrytëzimit, të kontrollit, të realizuara nëpërmjet mjeteve çnjerëzore, të tilla si forca, detyrimi, mashtrimi, dhuna, kërcënimi për jetën, deri tek gjymtimi dhe vrasja, tregojnë fare mirë se në çfarë gjendje janë këto viktima. Viktimat e trafikimit nuk mund dhe nuk duhet të paragjyken si prostitutat me dëshirë. Konceptet e vlerësimit të ulët për viktimën e trafikimit, të menduarit se ato shkojnë me dëshirë në shtëpi publike apo trotuare, se ato marrin para

etj, janë koncepte të gabuara dhe paragjykuese. Faktet që do të përmendim si dhe shumë fakte të tjerë do të ishin argumentet më të mirë për të çrrenjosur njëherë e mirë koncepte të tilla të gabuara.

## **1.2. Ndryshimi midis kontrabandimit të njerëzve dhe trafikimit të tyre.**

Termi kontrabandë do të thotë përdorim direkt i shërbimeve të ndërmjetësit, që ka të bëjë me organizimin dhe kalimin e kufijve ndërkombëtarë, duke evituar kontrollin e policisë kufitare dhe të doganave. Neni 3 i Protokollit kundër Kontrabandimit të Emigrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri, Konventa e O.K.B-së kundër krimit të organizuar e përkufizon kontrabandimin si:

*“Ndërmjetësimi për të futur në mënyrë të paligjshme një person në një shtet në të cilin personi nuk është shtetas ose me qëndrim të përhershëm, me qëllim të një përfitimi financiar ose përfitimi tjetër material”.*

Kontrabandimi dallohet nga trafikimi në atë që kontrabandimi i të huajve përfshin sigurimin e një shërbimi, megjithëse të paligjshëm, për njerëz që me ndërgjegje blejnë shërbimin në mënyrë që të hyjnë në një shtet të huaj. Trafikimi i qenieve njerëzore mund të ndodhë edhe pa kaluar ndonjë kufi ndërkombëtar. Përveç kësaj, një emigrant i kontrabanduar mund të heqë dorë në çdo moment nga dëshira dhe qëllimi që ta çojnë përtej kufirit. Viktimës së trafikimit, nuk i lihet në dorë të bëjë zgjedhje. Por, kontrabandimi i njerëzve gati gjithmonë përfaqëson një pjesë të veprimeve të lidhura me krimin e trafikut të qenieve njerëzore (dhe lehtësisht mund të konvertohet në trafikim), ku si element bazë për të vlerësuar, është ekzistenca e paramendimit (*dolus directus* - qëllimshmëri direkte), ose edhe produkti i paramendimit (ajo që rezulton në fund), (*dolus eventualis* - qëllimshmëri sipas rastit) për qëllimin final që është shfrytëzimi, dhe në rastin tonë shfrytëzimi seksual ose forma të tjera të shfrytëzimit.

Ç’do lloj aktiviteti kontrabandimi të qenieve njerëzore, veçanërisht i grave, vajzave dhe fëmijeve duke marrë parasysh mundësinë e abuzimit me to për shfrytëzim dhe prostitucion të detyruar, konsiderohet si trafikim.

Vepra penale e trafikimit dallon nga vepra më pak serioze e “mundësimit të prostitucionit” dhe “kontrabandimi me imigrant”. Sa i përket “mundësimit të prostitucionit”, ajo do të konsiderohet vepër penale kur autori me dije rekruton, organizon ose ndihmon një person tjetër apo ia lëshon lokalet një personi tjetër për qëllime të prostitucionit. Kjo do të thotë që ligji dënon secilin që me përdorimin e

dhunës, me kërcënim se do të perdorë dhunën ose duke mbajtur personin tjetër në situatë te varësise personale a ekonomike e detyron këtë person të merret me prostitucion. Krimi i trafikimit mund të dallojë nga mundësimi i prostitucionit dhe kontrabandimi i imigranteve nga fakti që këto dy të fundit nuk kërkojnë qëllimin për të shfrytëzuar viktimën.

## **2. Trafikimi i qenieve njerëzore sipas disa Kodeve Penale bashkëkohore të disa shteteve.**

Emigrimi është një problem i vjetër dhe kompleks nga të dyja këndvështrimet, social dhe kriminologjik. Në nivelin European, janë bërë përpjekje për të përcaktuar fenomenin e migrimit njerëzor duke identifikuar raste të veçanta, kryesore në mes të cilave janë:

- Emigrimi legjitim dhe legal dhe kërkimi i azilit;
- Emigrimi ilegal, i parregullt ose pa dokumenta identifikimi apo udhëtimi;
- Emigrimi i organizuar ilegal;
- Trafikimi në persona.

Emigrimi dhe trafikimi ilegal në persona janë kategoritë më të rëndësishme brenda kontekstit të analizës socio-kriminologjike dhe të dyja janë duke u rritur në Europë. Në bazë të të dhënave të Europolit,<sup>155</sup> emigrimi ilegal është zhvilluar në disa shtete anëtare të Bashkimit European, veçanërisht dukshëm në Spanjë e Itali. Megjithatë, shtetet më të preferuara si destinacion janë akoma Austria, Belgjika, Holanda, Suedia dhe Britania e Madhe. Në kontrast me këtë, një vendosmëri e (përcaktuar) saktë e prirjeve të kohëve më të fundit në trafikimin e personave nuk është e mundur. Kjo ndodh se viktimat zakonisht lëvizin nga një shtet anëtar tek një tjetër, kështu që është e vështirë të identifikohen shtetet më të preferuara si destinacion. Megjithatë, Gjermania, Holanda, Belgjika e Franca duket së janë më të cënueshme se të tjerat. Këto arsyetime hedhin në dritë se trafikimi në persona dhe kontrabanda e emigrantëve po zhvillohet në shkallë shqetësuese jo vetëm brenda shteteve individuale, por edhe në nivelin e Bashkimit European.

Pavarësisht nga një përmirësim i kohëve të fundit, statistikat mbi emigrimin ilegal dhe trafikimin janë akoma të pamjaftueshme, si në BE dhe vende të tjera. Pak dihet për

---

<sup>155</sup> Europol, 2000 *EU Raport mbi situatën e krimit të organizuar 2001*, e mundëshme në <http://www.europol.eu.int/index.asp?page=EUOrganisedSitRep2000>.

numrin e atyre që migrojnë ilegalisht me ndihmën e trafikuesve, ose rreth numrit të personave në shërbim të grupeve kriminale të angazhuara në kontrabandim. Situata, është akoma më serioze kur dikush kërkon të marrë informacion mbi numrin dhe karakteristikat e viktimave të kontrabandimit dhe trafikimit. Informacioni më i detajuar mbi numrin dhe karakteristikat e viktimave është ai i siguruar nga IOM e cila kryen analiza periodike mbi fenomenin.<sup>156</sup>

Për sa u përket më sipër, ka të bëjë me fenomenin e përhapjes së krimit të trafikimit të qenieve njerëzore në vendet kryesore të Bashkimit Europian.

Më poshtë po paraqesim legjislacionin e këtyre vendeve që luftojnë veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore, bazuar në këndvështrimin krahasues.

## **2.1. Legjislacioni Penal Italian.**

Shteti Italian<sup>157</sup> bazuar në standartet ndërkombëtare dhe Europiane dhe në parimet ligjore, miratoi Ligjin nr. 228 “Masat kundër trafikimit të njerëzve”, datë 11 Gusht 2003 duke ndryshuar legjislacionin penal në fuqi nga pikvështrimi material dhe proçedural, ashtu dhe sa i takon riorganizimit të kompetencave të institucioneve përkatëse.

- Direktivat e reja në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Evidente, gjatë leximit të “*travaux pre`paratoires*” (puna përgatitore) për versionin final të ligjit të ri të anti-trafikimit (Ligji nr. 228, 11 Gusht 2003), është përpjekja politike dhe teknike e ndërmarrë ndërmjet dy legjislatrave për të ndrequr difektet e legjislacionit të trafikimit të njerëzve. Teksti i ligjit, i cili ishte i nevojshëm për t’u përshtatur me ndërmarrjet ndërkombëtare si pasojë e nënshkrimit të Konventës së Palermos nga Italia, ishte objekt i leximit sipas proçedurave pralamentare dhe i proçesit të modifikimit që zgjati për më tepër se dy vite përpara miratimit final të tekstit.<sup>158</sup>

---

<sup>156</sup>IOM. *Udhëtimet e rrezikshme*. Një përmbledhje e kërkimeve mbi trafikimin e grave e fëmijëve në Europë, IOM Seri kërkimesh mbi Emigracionin. Nr.11 Gjenevë, shtator 2002. IOM. Viktimat e trafikimit në Ballkan. një studim mbi trafikimin e grave e fëmijëve për shfrytëzim seksual, të, përmes dhe nga Rajoni Ballkanik. IOM Trafikimi i emigrantëve në Europë.

<sup>157</sup> Iniciativën legjislative e kanë ç’do deputet dhe senator, qeveria, Këshilli Kombëtar i Ekonomisë dhe i Punës, këshillat regjionale si dhe populli, i cili mund ta ushtrojë këtë të drejtë kur një projektligj e nënshkruajnë të paktën 50.000 zgjedhës. L.Omari, Sistemi Parlamentar, Tiranë 2000, fq.64.

<sup>158</sup>Teksti i prezantuar në Dhomën e Deputetëve nga On. Finocchiaro në 9 Korrik 2001, ishte shënuar në komisionin e dytë (drejtësi) dhe aprovuar me 21 Nëntor 2001. Pastaj u ekzaminua nga senati dhe u aprovua me modifikime dhe riprezantuar në Dhomën e Deputetëve me 26 Shkurt 2003. Dhoma aprovoi modifikimin me Tekst të konsoliduar dok. nr. 1584, (kërkesë e hedhur nga qeveria) dhe dërguar përsëri

Dokumentet parlamentare dhe qeveritare janë bazuar në të njëjtat konsiderata për sa i përket trafikimit të njerëzve:

*“Fenomeni ka rritur proporcione serioze dhe nuk ka asnjë legjislacion kriminal të përshtatshëm, në gjendje për të plotësuar boshllëqet ligjore të lëna nga parashikimet e vjetra të Kodit”.*<sup>159</sup>

Këto synime çuan në disa parashikime ligjore me qëllimpër të modifikuar atotë vjetrat e Kodit Penal mbi skllavërinë, si dhe për të dhënë përcaktimin e duhur të vepër penale të “trafikimit të njerëzve”, duke bërë kështu edhe ndryshimin dhe përditësimin e ligjit substancial material mbi këtë fenomen i cili po përhapej gjerësisht. Gjatë rishikimit të tekstit, këto parashikime substanciale u ripërcaktuan nëpërmjet masave të tjera procedurale, me qëllim për të krijuar mënyrat konkrete me të cilat do luftohej trafikimi.<sup>160</sup>

Përveç aspekteve ndaluese, u futën edhe komponente të tjerë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore: parandalimi dhe masat për të mbrojtur viktimat. Këto parashikime ishin akoma prezente *“in nuce”* në tekstin e prezantuar Dhomës së Deputetëve në 2001<sup>161</sup>, por tashmë i dukshëm ishte synimi për të adoptuar një përqsasje integruese të trafikimit, duke ndjekur drejtimit sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara dhe Protokolleve të saj.

- *Sanksionet e reja.*

Një aspekt i reformës që ka ndikuar më tepër në ndryshimin ligjor, janë sanksionet për krimet që lidhen me trafikimin e njerëzve. Parashikimet e Kodit të cilat, me vështirësi dhe me interpretime të ndryshme të çështjeve ligjore janë përdorur për këtë qëllim, u rinovuan thellësisht me qëllim përmirësimin e përgjigjes ligjore ndaj dinamikës kriminale të kohës.

---

për ekzaminim nga senati (dak. nr. 885-B) të cilin e aprovoj atë me modifikime të tjera me 4 Korrik 2003. Pas caktimit në komisionin e dytë (drejtësi) dhe aprovimit të saj 30 korrik 2003, teksti u bë ligj me 11 Gusht 2003 dhe hyri në fuqi me 7 Shtator 2003.

<sup>159</sup>Gjykata e Lartë zbuloi problemin me një citim të rastit ligjor që identifikonte ngjarjet e vetme të rralla të krimeve dhe ku disa nga viktimat ishin nën moshë.

<sup>160</sup> Shiko tekstin e modifikuar nga Senati me 28 Shkurt 2003 dhe Raportin e Komisionit (dok. nr. 1255 C) i cili prezantoi synimet vijuese: sanksioni kundër personave ligjor të përfshirë në trafik, modifikime të kodeve procedurale kriminale në lidhje me kompetencat dhe përdorimi i teknikave speciale investiguese.

<sup>161</sup> Artikujt 4-6 në tekst paraqitur në Dhomë në Nëntor 2001 flasin për përdorimin e mallrave të konfiskuara nga trafikant duke asistuar mbrojtje viktimave, ashtu si për synimin e ndalimit dhe versionin e mësipërm të tekstit (dok. nr. 1255-B, nr. 1255-C, nr. 1255-D), këto synime për parandalim dhe ndihmë u bënë konkretisht me një fond për qëllime anti-trafikim dhe me një program të veçantë.

Në veçanti, shkelja kriminale e degradimit në robëri (Neni 600 i Kodit Penal), trafikimi dhe tregëtimi i sklleverve (Neni 601 i Kodit Penal), tjetërsimi dhe shitja e sklleverve (Neni 602 i Kodit Penal) janë riformuluar. Gjithashtu, është parashikuar mundësia e dënimit të grupeve kriminale të përfshira në trafikim dhe kriminalitet. Vëmendje specifike i është kushtuar këtij aspekti kriminal, pra përfshirjes së grupeve kriminale në trafikim.<sup>162</sup> Neni 5 i Ligjit 228/2003 aplikon sanksionet administrative ndaj personave juridikë, kompanive dhe shoqërive për krimet e parashikuara nga nenet e reja 600, 601, 602 të Kodit Penal Italian.

- Riformulimi i krimit “Degradimi apo mbajtja në skllavëri ose robëri” (Neni 600). Aplikimi i nenit 600 të Kodit Penal ngriti probleme të shumta për studiuesit dhe për gjykatat si në lidhje me implementim ashtu edhe me interpretimin, të cilat kishin të bënin me fjalët e dispozitës. Ky ishte një “rregullim konçiz”<sup>163</sup> që sillte probleme me parimin e përcaktimit të veprës penale. Neni i ri 600 i Kodit Penal (titulluar “Degradimi apo mbajtja në skllavëri ose robëri”) jep përfundime të qarta të shkeljes si dhe siguron një përkrahje më të detajuar të karakteristikave të saj:

*“Kushdo që ushtron mbi një person tjetër pushtete të barabarta me të drejtat e pronësisë ose kushdo që mban një person tjetër në një pozicion nënshtrimi të pandërprerë, duke e detyruar atë të punojë ose të ofrojë shërbime seksuale ose të lypë, ose çfarëdoj aktiviteti tjetër që përfshin shfrytëzimin e atij/saj, do të dënohet me burgim për një periudhë nga tetë deri nënjëzetë vjet.  
Degradimi ose mbajtja në nënshtrim është kur personi mbahet me dhunë, kërcënim, mashtrim, abuzim me autoritetin, ose duke përfutur nga një situatë inferioriteti fizik ose psikologjik, ose nga një situatë nevojë, me premtimin ose pagimin e parasë ose avantazhe të tjera ndaj kujt do që ka fuqi mbi personin.  
Dënimi do të rritet nga 1/3 në 1/2 në qoftë se sjellja e referuar në paragrafin e parë bën fjalë për minorenë ose ka si synim shfrytëzimin e prostitucionit ose heqjen dhe marrjen e organeve të trupit.”*

Nisur nga parashikimi i mësipërm, vihet re se janë specifikuar disa forma të shfrytëzimit si shfrytëzimi seksual dhe lypja në rrugë, megjithatë lista e shkeljeve nën këtë nen është lënë qëllimisht e hapur. Kjo teknikë legjislativë është e saktë nga këndvështrimi i parandalimit, duke qënë se është e vështirë të parashikohet çfarë formash mund të marrë shfrytëzimi në të ardhmen.

---

<sup>162</sup> Shiko paragrafin e ri 6 të nenit 416 të Kodit Penal, i cili tregon që “në qoftëse qëllimi i bashkëpunimit është kryerja e një krimi referuar në nenin 601 dhe 602, dënimi me burgim do jetë nga 5-15 vjet si tregohet nga paragrafi 1 [bashkëpunimi i tre apo më tepër personave për qëllimin e të bërit më tepër se një krim] dhe nga 4 në 9 muaj për rastet e referuara në paragrafin 2 . Kjo është një rrethanë të cilësuarat të. Për këtë shiko G. Amato, “Dubio aggravante per le associazioni a delinquere”, in Guida al diritto, nr. 35, 2003, p. 48

<sup>163</sup> G. Fiandaca, E. Musco, *Diritto penale. Parte Generale* [Criminal Law, General Part], Edition Zanichelli, Bologna, 2001, p. 72.

Nga pikëpamja e sanksionit, neni i ri 600 i Kodit Penal Italian parashikon dënime më të ashpra për krimin e degradimit ose mbajtjes në skllavëri ose robëri, duke rritur kohën e burgimit nga “5 deri 15 vjet” në “8 deri 20 vjet”. Për më tepër, tre rrethana të ndryshme specifike janë konsideruar të rënda, në qoftë se shkelja është bërë:

- Kundër një personi nën moshë (nën 18 vjeç).
- Për qëllim shfrytëzim prostitucioni.<sup>164</sup>
- Për heqjen e organeve të trupit.

Përveç këtyre rrethanave, të tjera rrethana (me efekte të veçanta) janë parashikuar: në qoftë se shkelja është bërë kundër një personi nën moshën 14 vjeç, ose kur janë kushte të lidhjeve specifike familjare, varësie, kujdestarie të të miturve, ose birësimi, si edhe abuzimi me pushtetin nga një zyrtar publik.

Kjo dispozitë përmbledh ato shkelje të bëra nga grupet e krimit të organizuar të tipit Mafie (Neni 7, Dekreti legjislativ nr. 152, 13 Maj 1991 shndërruar në Ligjin nr. 203, 12 Korrik 1991).

**- Reformulimi i shkeljes “Trafikim të personave” (Neni 601 të Kodit Penal) dhe “Blerja dhe mbajtja e skllavërve” (Neni 602 i Kodit Penal).**

Neni 601 ndëshkon të paktën tre lloje veprimesh si më poshtë:

1. Trafikimin (me të cilin nënkuptohet çdo formë e transferimit nga territori kombëtar ose brenda tij) të personave në situatën e përshkruar nga neni 600;
2. Nxitjen me anë të mashtrimit për të hyrë, qëndruar ose për të dalë nga kufijtë kombëtarë, ose për të lëvizur brenda tyre, me qëllim degradimin apo mbajtjen e një personi në skllavëri apo robëri;
3. Detyrimin e një personi me anë të dhunës, kërcënimit apo abuzimit me autoritetin, apo duke përfituar nga situata e nevojshmërisë, apo duke i premtuar para apo përfitime të tjera personit që ka pushtet mbi viktimën, për të hyrë, qëndruar ose dalë nga territoret kombëtare ose për të lëvizur brenda tij, me qëllim degradimin apo mbajtjen e një personi në skllavëri apo robëri.

---

<sup>164</sup> A duhet të aplikohet rrethana e shfrytëzimit të prostitucionit, Kjo është debatuar, Aplikohet Neni 3 i ligjit nr. 75 i 1958-ës. Shiko G. Amato (*Sistemi i ri i lejimit dhe investigimit për luftimin efektiv të skllavërisë*) në Guido al Diritto nr. 35. 2003, p. 44.



Ndryshimi midis formës së parë dhe dy formave të tjera, është situata e viktimës. Rasti i parë ndodh kur viktima është tashmë në kushtet e nënshtrimit referuar nenit 600 të Kodit Penal; rasti i dytë dhe i tretë ndodhin kur personi është i lirë dhe nxitet apo detyrohet t'i nënshtrohet trafikimit. Dallimi nga veprimi i pershkruar nga neni i ri 602 i Kodit Penal konsiston në mungesën e referencës sa i takon transferimit të viktimës brenda apo jashtë territorit kombëtar.

## **- Dispozitat e reja penale.**

### *1. Emigracioni ilegal.*

Përcaktimi i ligjit penal të shfrytëzimit të emigrantëve është modifikuar kohët e fundit nga ligji Bossi-Fini.<sup>165</sup> Ligji i tanishëm thotë:

*“Edhe pse sjellja është pjesë e një krimi më serioz, ato që shkelin kushtin që ndodhet në “Tekstin Unik” duke u marrë me ndonjë aktivitet me qëllim sjelljen e qytetarëve të huaj në territorin kombëtar ose ndonjë aktivitet me qëllim marrjen e hyrjes ilegale në një shtet tjetër për një person që nuk është qytetar aty ose i cili nuk ka leje qëndrimi ligjor të përkohshëm në atë vend, duke shkelur kështu kushtin e vendosur në “Tekstin Unik” ky akt mund të dënohet me më shumë se 3 vjet burg ose mund të gjohet me një shumë maksimumi 15.000 Euro për person.”*

Përveç hyrjes së paligjshme, një shkelje tjetër penale e lidhur me të ashtëquajturën “Ç’atdhësim ilegal” është shtuar, duke zgjeruar kështu dënimet për krimet e bëra në dëm të shteteve të tjera.

Paragrafi i tretë i nenit 12, është rishikuar me qëllim parashikimin e sanksioneve më të rënda në rast se ekzistojnë rrethana specifike, të tilla si:

- *Mens rea* me qëllim specifik për të përfiturar të ardhura edhe në mënyrë të tërthortë nga krimi;
- Pjesëmarrja e 3 ose më shumë personave në krim;
- Përdorimi i shërbimeve ndërkombëtare të transportit dhe përdorimi i dokumenteve false ose të marra në mënyrë joligjore.

Rrethana rënduese të këtij krimi janë parashikuar dhe nga neni 3 i Kodit Penal, si:

- Lehtësimi i hyrjes ose i qëndrimit në një territor kombëtar për pesë ose më shumë persona;
- Duke vepruar në mënyrë që të jetë vendosur në rrezik jeta apo shëndeti fizik i personave të trafikuar;
- Trajtimi i personit në mënyrë jonjerëzore ose degraduese;

---

<sup>165</sup> Ligji nr. 189, 30 Korrik 2002.

- Shtyrja drejt prostitucionit apo shfrytëzimit seksual të peronave të trafikuar apo kontrabandimi i të miturve me qëllim shfrytëzimin e tyre në veprimtari të paligjshme.

Neni 12 gjithashtu prezanton një “shpërblim” për ata emigrantë të cilët bashkëpunojnë me policinë apo organet gjyqësore me qëllim parandalimin e aktivitetit kriminal që të sjellë pasoja të mëtejshme, duke ndihmuar në mbledhjen e provave, identifikimin apo arrestimin e kriminelëve, ose eliminimin e burimeve të rëndësishme të kryerjes së krimeve.

Këto ishin risitë e draftit ligjor të bërë nga Ligji Bossi-Fini, i cili ruan elementet kryesore të nenit 12 të mëparshëm, dhe nga ana tjetër rëndon sanksionet dhe prezanton shkelje të reja ligjore.

Duhet theksuar se thjesht hyrja e paligjshme apo e parregullt në shtetin Italian nuk është e dënueshme si krim në vetvete, por konsiderohet të jetë shkelje administrative e cila dënohet me dëbim. Qëllimet e ligjvënësve për të mos dënuar një akt të tillë si hyrja e paligjshme, përveçse me sanksione administrative, prezanton një ekzistencë të vlerave pluraliste të mbrojtura. Ndërsa nga njëra anë qëllimi është për të mbrojtur kufijtë dhe efektivitetin e kontrollit të këtyre kufijve, nga ana tjetër ky qëllim është për të mbrojtur sigurinë dhe dinjitetin e atyre, hyrja e të cilëve është lehtësuar apo rregulluar.

## *2. Degradimi në robëri (Neni 600 i Kodit Penal).*

Deduktimi në robërim dënohet sipas ligjit Italian nga neni 600 i Kodit Penal si krim kundër personit. Dispozita shprehet se:

*“Kushdo që con një person tjetër në robërim ose në kushte të ngjashme, do të dënohet me burg nga pesë deri nëpesëmbëdhjetë vjet”.*

Akti i dënueshëm konsiston nga njëra anë në vendosjen e një të drejte pronësie qoftë edhe e pjesëshme mbi një person tjetër, dhe nga ana tjetër në privimin apo ndalimin e zotësisë ligjore dhe lirisë së subjektit pasiv.

Ky është një krim që mund të kryhet në ç’do lloj forme, kjo do të thotë që mënyrat e ekzekutimit janë lënë të paspecifikuara. Kryerja e krimit fillon në momentin kur viktimë kthehet në skllav dhe mbaron kur viktimë rifiton lirinë.

## *3. Trafikimi dhe tregëtimi i skllavëve (Neni 601, paragrafi 1 i Kodit Penal).*

Neni 601, paragrafi 1 i Kodit Penal parashikon:

*“Kushdo që përfshihet në trafikim ose ç’do formë të tregtimit të skllavërve ose personave në kushte të ngjashme me skllavërinë, do të ndëshkohen me burgim nga pesë deri në njëzetë vjet”.*

Këtu termi “trafikim” do të thotë “veprime të atyre që përfshihen në një shkallë të gjerë të aktivitetit të rekrutimit, detyrimit, transportimit dhe shitjes, ndërsa koncepti i tregtimit është më i kufizuar. Faktikisht koncepti i “tregtisë” është pjesë e nocionit të “trafikimit”, dhe qëllimi i tij është përfshirja e shkeljeve të vogla brenda qëllimit të shkeljes kriminale.

Dispozita në fjalë ka një aplikim të kufizuar, dhe kjo sepse trafikimi mund të ndodhë pavarësisht faktit nëse viktimat janë reduktuar apo jo në skllavërim apo në kushte të njëjta.

### *3. Tjetërsimi dhe blerja e skllavërve (Neni 602 i Kodit Penal)*

Neni 602 i Kodit Penal parashikon:

*“Kushdo që, me përjashtim të rasteve të përshkruara në nenin e mëparshëm, tjetërson apo shndërron një person në gjendje skllavërie apo në kushte të ngjashme, ose e merr atë, ose e blen, ose e mban atë në skllavëri apo në kushte të ngjashme, do të dënohet me burgim nga tre deri dymbëdhjetë vjet”.*

Shkeljet shtesë të parashikuara nga ky nen mbulojnë të gjithë rastet e tjera që nuk bien nën klauzolat e mëparshme, kështu që mbrojtja ligjore penale e *status libertatis* të plotësohet. Veçanërisht klauzola dënon tjetërsimin apo blerjen e personave që janë tashmë në skllavëri pa qenë e nevojshme të ndodhë ndonjë aktivitet tregtar.

### *5. Trafikimi i personave nën-moshë (Neni 601, paragrafi i 2 i Kodit Penal).*

Sipas nenit 601, paragrafi 2 shprehet:

*“Kushdo që trafikon apo tregëton persona nën 18 vjeç me qëllim shtyrjen në prostitucion do të dënohet me burgim nga gjashtë në njëzetë vjet”.*

Neni 601, paragrafi 2 i Kodit Penal si risi e ligjit nr. 269, datë 03.08.1998, aplikohet për krimin e trafikimit apo tregtimit të personave të mitur, dhe është identike me parashikimin e paragrafit 1 me vetëm dy përjashtime: moshën minorene të subjektit pasiv si dhe elementin tjetër të krimit që është *mens rea* e që nënkupton qëllimin e shtyrjes së të miturve në prostitucion.

Duhet theksuar që eliminimi i lidhjes së konceptit të skllavërisë si kërkesë paraprake që personi të cilësohet si i trafikuar, ka lehtësuar ndëshkueshmërinë e trafikimit të qenieve njerëzore.

Krimi në fjalë sipas nenit 601, paragrafi 2, kërkon një *mens rea* specifike për shtyrjen e viktimave në prostitucion, por qëllimi nuk është i domosdoshëm që krimi të quhet i kryer.

## **2.2. Trafikimi i qenieve njerëzore në Kosovë.**

Trafikimi i qenieve njerëzore në Kosovë është krim që është përkeqësuar prej vitit 1999 dhe për një kohë të gjatë është menduar si problem që godet vetëm vajzat dhe gratë e huaja (me origjinë jo kosovare). Ndonëse në vitet e para pas 1999, ky fenomen negativ është lidhur kryesisht me vajzat adoleshente dhe gratë e huaja, të cilat janë trafikuar në Kosovë, sot krimi i trafikimit të vajzave dhe grave kosovare, si në Kosovë, dhe jashtë vendit është i pamohueshëm.

Aktualisht, Kosova nuk është vetëm vend tranziti apo destinacioni, por është edhe vend ku trafikimi i brendshëm për shfrytëzim seksual është në rritje<sup>166</sup>. Megjithëse trafikimi i qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual mbetet dominues, ekzistojnë të dhëna edhe për forma të tjera të shfrytëzimit. Sidoqoftë, rastet e identifikuara të fëmijëve të trafikuar për kërkim lëmoshe, të cilëve iu është dhënë ndihmë, janë të pakta.

Duke humbur shpresën për një jetë më të mirë, duke pasur vështirësi ekonomike, probleme familjare, apo mungesë të informacionit të drejtë, shumë vajza largohen nga shtëpitë e tyre duke besuar në premtimet për punë, martesë apo kushte më të mira të jetës.

Për të luftuar këtë dukuri, Këshilli i Ministrave i Institucioneve të Përkohshme Vetë-Qeverisëse të Kosovës, me datë 17 Maj 2005, ka miratuar “Planin e veprimit për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë”. Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM-i) dhe organizata të tjera ndërkombëtare e kanë ndihmuar dhe mbështetur Zyrën Këshilldhënëse për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, gjatë gjithë procesit të hartimit të këtij plani.

Plani i veprimit për luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë shtron detyra për institucionet e Kosovës që të konkretizojnë masat për ta luftuar këtë dukuri.

---

<sup>166</sup>Raporti i DASH për vitin 2012.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është përgjegjëse që të “sigurojë jetësimin dhe rrjedhën e vazhdueshme të ndërgjegjësimit të nxënësve për problemin e trafikimit të qenieve njerëzore, nëpërmjet planit dhe programit shkollor në nivelin e shkollave para-universitare”.

Kodi Penal i Kosovës ka këtë panoramë dhe përkufizim në lidhje me trafikimin e njerëzve.<sup>167</sup>

*“Kushdo që merr pjesë në trafikimin e njerëzve dënohet me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.  
Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën 18-vjeçare, kryrësi dënohet me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet.  
Kushdo që organizon një grup personash për të kryer veprën nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë deri në 500.000 Euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.  
Kushdo që nga pakujdesia lehtëson kryerjen e trafikimit me njerëz dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.  
Kushdo që përdor ose siguron shërbime seksuale të një personi për të cilin e di se personi i tillë është viktimë e trafikimit, dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.  
Nëse vepra penale nga paragrafi 5 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën 18-vjeçare, kryrësi dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.  
Nëse vepra penale nga ky nen kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës së tij kryrësi dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose 2, me burgim prej së paku dhjetë vjetësh për veprën penale nga paragrafi 3, me burgim prej dy deri në shtatë vjet për veprën penale nga paragrafët 4 ose 5 ose me burgim prej pesë vjetësh deri në dymbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafi 6.”*

Në paragrafin 8 të nenit 139 të Kodit Penal të Kosovës definohe shprehjet “Trafikim me njerëz” dhe “shfrytëzim” në pikat 1 dhe 2, ndërsa pika 3 e këtij paragrafi përcakton: pëlqimi i viktimës së trafikimit me njerëz për qëllime shfrytëzimi nuk merret parasysh kur cilado prej mjeteve të parashtruara më lart në pikën (1) të këtij paragrafi është përdorur kundër viktimës.

Pika 4 e paragrafit 8 të nenit të mësipërm thotë:

*“Rekrutimi, transportimi, transferi, strehimi ose pranimi i fëmijës me qëllim të shfrytëzimit konsiderohet “trafikim me njerëz”, madje edhe nëse kjo nuk përfshin asnjërin nga mjetet e parashtruara në pikën (1) të këtij paragrafi.”*

Bazuar në paragrafët e këtij neni si dhe në sanksionet penale që parashikojnë dispozitat përkatëse rezulton se formulimi i nenit 139 të Kodit Penal të Kosovës është në përputhje të plotë me ligjet që parashikon e Drejta Penale Ndërkombëtare.

Kodi Penal i Kosovës<sup>168</sup> përkufizon trafikimin duke përdorur të njëjtën gjuhë si Protokollin e Palermos.<sup>169</sup> Kodi Penal dënon veprën penale të trafikimit të të rriturve me

---

<sup>167</sup>Shif nenin 139 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. UNMIK/Rreg/2003/25, 6 Korrik 2003, fq 62.

dënim prej 2-12 vjet burg.<sup>170</sup> Trafikimi i një fëmije, i përcaktuar si një person nën moshën 18 vjeç,<sup>171</sup> mbart një dënim prej 3-15 vjet burg.<sup>172</sup>

Duke përdorur të njëjtat fjalë që gjenden në nenin 3 të Protokollit të Palermos, neni 139 (8) (1) i Kodit Penal Kosovës përkufizon trafikimin si:

*“Rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit.”*

Përkufizimi i trafikimit është i ndërlikuar, por bëhet i qartë nëse zërthehet në tri elementet e veta: *vepra, mjetet e paligjshme dhe për qëllim të shfrytëzimit.*

1. *Vepra*: Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi apo pranimi i personave.
2. *Mjetet e paligjshme*: Kërcënimi ose përdorimi i dhunës apo formave të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit të keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës apo të një pozitë të ndjeshme apo me anë të dhënies apo marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që të ketë kontroll mbi personin tjetër.
3. *Për qëllim të shfrytëzimit*: Fjala shfrytëzim përkufizohet ajo që “përfshin ndër të tjera shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve.”<sup>173</sup>

Siç u tha më sipër të gjithë elementet, janë të nevojshme për të dënuar dikë për trafikim të një viktime të rritur, por elementet ligjore të domosdoshme për dënim ndryshojnë paksa kur viktima është fëmijë. Kur një fëmijë është viktimë e trafikimit atëherë vetëm elementi i veprës dhe ai i shfrytëzimit nevojiten për dënim.<sup>174</sup> Pasi që nga fëmija nuk mund të pritët që të pajtohet me çfarëdo vepre që bëhet me qëllim të shfrytëzimit, elementi “mjetet e paligjshme” nuk konsiderohet si element i domosdoshëm i veprës

---

<sup>168</sup> *Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës*, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/25, 6 korrik 2003, me ndryshimet pasuese. Me 6 nëntor 2008, Kosova ka shpallur Ligjin Nr. 03/ 002 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës Nr 2003/25, që la ligjin përmbajtësish të njëjtë me ligjin e vitit 2003, me vetëm një pjesë të shtuar për azhurnimet lidhur me deklaratimet për fajësi dhe ndryshimin e emrit të ligjit në Kodi Penal i Kosovës.

<sup>169</sup> Trafikimi po ashtu është i ndaluar me kushtetutën e Kosovës.

<sup>170</sup> Neni 139(1) të KPK-së.

<sup>171</sup> Neni 107(21) të KPK-së.

<sup>172</sup> Neni 139(2) të KPK-së.

<sup>173</sup> Neni 139(8)(2) të KPK-së.

<sup>174</sup> Neni 139(8)(4) të KPK-së.

penale.<sup>175</sup> Duke kryer cilëndo vepër (rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin apo pranimin e personave) për qëllim të shfrytëzimit është trafikimi kur viktimë është një fëmijë.

Në qoftë se për disa përkufizimi mbetet i rëndë, edhe pas zbërthimit të definicionit në tri elementet e veta, një praktikues i ligjit mund të përzgjedh një pjesë të secilit element si mënyrë për t'ju qasur analizës së një rasti të dyshuar të trafikimit.

Kodi Penal i Kosovës parasheh edhe veprën penale të kontrabandimit me migrantë<sup>176</sup> në të cilën sanksionet penale parashikohen si me poshtë:

*“Kushdo që merret me trafikimin të migrantëve dënohet me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet. Kushdo që prodhon, prokuron, siguron ose posedon dokument të rrejshëm të udhëtimit ose të identifikimit me qëllim të mundësimit të marrjes me trafikimin me migrantë dhe për të fituar drejtëpërdrejt ose tërthorazi dobi pasurore a financiare dënohet me burgim deri në pesë vjet. Kushdo që personit i cili nuk është banor i Kosovës i mundëson të qëndrojë në Kosovë ose personit i cili nuk është banor vendor a i përhershëm për të qëndruar në shtetin në fjalë pa i respektuar kushtet e domosdoshme ligjore për të mbetur sipas mjeteve nga paragrafi 2 i këtij neni ose me ç’fardo mjeteve të tjera joligjore dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Tentativa për të kryer vepër nga paragrafi 3 i këtij neni është e dënueshme. Kushdo që organizon ose urdhëron personat e tjerë për të kryer vepër penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 denohet me gjobe deri në 500. 000 EUR dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet. Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet nga kryrësi si anëtar i grupit ose në një mënyrë e cila rrezikon ose ka gjase të rrezikojë jetërat a sigurinë a e migrantëve përkatës ose që përfshin trajtimin ç’njerëzor a degradues, duke përfshire eksploatimin e migrantëve të tillë, ai dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.”*

Paragrafi i 7 i nenit 138 të K. Penal të Kosovës në pikat 1 dhe 2 definon kuptimet e shprehjeve “kontrabandim me migrantë” dhe “hyrje e paligjshme”, ndërsa pika 3 jep definimin e shprehjes “dokument i rrejshëm i udhëtimit ose identifikimit” në tre versionet e mundëshme.

Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse ai është migrant që është objekt i veprës penale nga ky nen.

Përveç dy neneve të mësipërme, Kodi Penal i Kosovës parasheh vendosjen e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë dhe e punës së detyruar<sup>177</sup> si më poshtë:

*“Kushdo që duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare, mban, ruan, vendos, blen apo shet një person tjetër në skllavëri apo në kushte të ngjashme me skllavërinë ose në punë të detyruar, që përfshin mbajtjen e personit në pronësi, mohimin e fryteve të punës së tij ose mohimin e lirisë së një personi për të*

<sup>175</sup> Neni 139(8)(3) të KPK-së.

<sup>176</sup> Neni 138 i Kodit Penal të Përkohshëm të Kosovës. UNMIK/RREG?2003/25, 6 korrik 2003, fq 61.

<sup>177</sup> Neni 137 i K. Penal të Përkohshëm të Kosovës. Miratuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/25, 6 Korrik 2003, fq. 60.

*ndryshuar statusin e tij apo kushteve të punës, dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet dhe me gjobë.*

*Kushdo që duke shkelur rregullat e të drejtës ndërkombëtare, me qëllim të kryerjes së veprës nga paragrafi 1 i këtij neni nxit një person tjetër të heq dorë nga liria e tij ose ndërmjetëson në shitjen apo blerjen e një personi tjetër dënohet me dënimin e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.*

*Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet kundër personit me të cilin kryrësi është në mardhënie familjare, kryrësi dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.*

*Nëse kryen veprë penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kundër fëmijës, kryrësi dënohet me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet.*

*Kur vepra nga ky nen kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës së tij, kryrësi dënohet me burgim prej pesë deri në dymbëdhjetë vjet për veprën nga paragrafi (1), (2) ose (3) ose me burgim prej pesë deri në njëzet vjet për veprën nga paragrafi (4).”*

### **2.3. Kodi Penal Polak.**

Trafikimi i qenieve njerëzore përkufizohet në nenin 253 (1) të Kodit Penal Polak. Sipas këtij kodi ç’do njeri që trafikon qeniet njerëzore, qoftë edhe me vullnetin e tyre, mban përgjegjësi penale. Ligjvënsi polak ka zgjedhur një përkufizim të gjerë dhe të hapur i cili është i qartë e që përmbledh gjithashtu edhe ato veprime që kanë pëlqimin e personit të trafikuar. Për më tepër, rangi i sjelljeve që mbulohet nga ky përkufizim, është i qartë që nuk kufizohet vetëm në trafikimin e grave dhe fëmijëve për qëllim të shfrytëzimit seksual, por mbulon gjithashtu edhe trafikimin e personave me motivin e vendosjes së një personi në punësim ilegal ose vetëm në mbështetje të emigracionit ilegal. Neni 204 i kodit kërcënon me dënim penal ata që lehtësojnë ose fillojnë aktivitet prostitucioni me qëllim fitimi personal dhe fitimi nga aktivitetet e prostitucioni. Për më tepër neni 204 i kodit rrit dënimin kur viktimat janë të rinj ose ku këta të fundit shtyhen në prostitucion jashtë vendit.

### **2.4. Kodi Penal Zviceran.**

Kodi Penal Zviceran për veprën penale të trafikimit është i afërt me atë të parashikuar në Kodin Penal Polak. Neni 196 i Kodit Penal Zviceran, për veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore parashikon një dënim minimal prej gjashtë muajsh burgim.

Megjithatë, qëllimi i trafikimit kufizohet në lehtësimin e veprimeve seksuale të të tjerëve. Vepra penale e trafikimit konsumohet edhe thjeshtë për ata perona që i shërbejnë kryerjes së veprës në formën e ndërmjetësit (komisionerit). Për këtë të fundit duhet të provohet që ka vepruar me qëllim fitimin e të ardhurave materiale.

Krahas veprës penale të trafikimit, ligji penal zviceran parashikon gjithashtu norma kundër qenies tutor (Neni 195 i Kodit Penal), i cili penalizon afrimin e një personi tjetër



në prostitucion duke shfrytëzuar situatën e tij të dobët ose me qëllim të fitimeve financiare. Krahas kësaj, mbikqyrja e një prostitute ose vendosja e kushtit për të punuar si punëtor seksi përbëjnë gjithashtu, vepra penale.

### **2.5. Kodi Penal Austriak.**

Neni 217 i Kodit Penal Austriak parashikon një dënim me burg prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet, nëqoftëse një person shtyn një tjetër në prostitucion në një vend të huaj. Trafikimi konsumohet pavarësisht nga fakti nëse ai person që trafikohet ka qenë më parë prostitutë apo jo. Dënimi rritet deri në 10 vjet burgim nëqoftëse autori i veprës penale trafikon një person tjetër për të ushtruar prostitucion nëpërmjet dhunës, kërcënimit ose mashtrimit. Në këtë rast, dënimi me burgim parashikohet nga 1 vit deri në 10 vjet.

Parashikimi ligjor kundër personave që veprojnë si tutorë (Neni 216 i K. Penal) në Austri, korrespondon me parashikimet ligjore të Zvicrës.

### **2.6. Kodi Penal Gjerman.**

Kodi Penal Gjerman përkufizon trafikimin e qenieve njerëzore (Neni 180 i Kodit Penal), si ushtrim i influencës mbi një person tjetër për qëllime të fitimit personal, dhe duke qenë në dijeni të situatës së pashpresë, të synojë bindjen e personit viktimë të fillojë aktivitetet e prostitucionit ose t'i vazhdojë ato.

Trafikimi konsumohet gjithashtu edhe në qoftë se për fitime personale ushtrohet influencë mbi një person tjetër për të bindur këtë person të përfshihet në akte seksuale, kur autori është në dijeni të gjendjes së pashpresë p.sh. për shkak të qëndrimit të personit në një shtet të huaj.

Trafikimi përfundimisht konsumohet në qoftë se një person ushtron influencë mbi një person tjetër i cili është pa ndihmë për shkak të qëndrimit në një vend tjetër ose është nën moshën 21-vjeç, me qëllim afrimin e personit të fillojë ose të vazhdojë prostitucionin. Kështu ligji Gjerman i trafikimit mbulon jo vetëm ato vepra që lidhen me prostitucionin e detyruar, por edhe ato vepra të zgjedhura që lidhen me komisionimin e martesave.

## 2.7. Trafikimi i qenieve njerëzore në Amerikë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë një burim tranziti dhe destinacioni për burrat, gratë dhe fëmijët – si qytetarë amerikanë ashtu dhe të huaj – në trafikimin e qenieve njerëzore. Individët të cilët hyjnë në territorin amerikan në mënyrë të jashtëligjshme janë konsideruar si viktimat e trafikimit. Është vlerësuar se rreth 17.500 persona kryesisht gra dhe fëmijë trafikohen çdo vit në SHBA<sup>178</sup>. Në nivel kombëtar, qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është anagazhuar gjithmonë në ndjekje të trafikantëve dhe ndihmën e personave të trafikuar. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Akti për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit (TVPA) është një statut kompleks, shumë-dimensional që fokusohet në parandalimin, mbrojtjen e viktimave dhe ndëshkimit të trafikantëve. Statuti është gjithashtu një mjet studimi ndërkombëtar nga ana e Sh.B.A, i zbatimit të standarteve të luftës kundër trafikimit nga të gjitha vendet e botës. Statuti trajton dy kategori krimi: trafikim për shfrytëzim komercial seksual dhe trafikim për shfrytëzim të punës së detyruar<sup>179</sup>. Një rëndësi në parandalimin e trafikimit ka edhe deklarata e Miamit mbi Parimet e Trafikimit Njerëzor e cila synon luftimin e trafikimit dhe rritjen e dinjitetit njerëzor: ajo është rezultat i diskutimit në konferencën e trafikimit njerëzor organizuar në St.Thomas University Miami, Florida, konferencë e cila zanafillën e saj e kishte nga programi i Masterit Ndërkulturor në të Drejtat e Njeriut në këtë universitet<sup>180</sup>.

Qeveria amerikane ka bërë përpjekje në përpjekjet për parandalimin e trafikimit, përpjekjet e vazhdueshme synojnë të shqyrtojnë me kujdes kategoritë e vizave për dobësitë, dhe kryerjen e aktiviteteve të vetëndërgjegjësimit publik. Detyra e kabinetit të nivelit ndër-institucional të presidentit është të vazhdojë koordinimin e përpjekjeve federale për të luftuar trafikimin e personave, të mbështetur nga Grupi Operativ i Lartë të Politikave<sup>181</sup>. Gjithashtu qeveria amerikane ka ndërmarrë përpjekje të shumta për të reduktuar kërkesën për seks komercial dhe punë të detyruar. Kjo qeveri ka ndikuar pozitivisht në financimin e OJQ-ve për hartimin e programeve për parandalimin e

---

<sup>178</sup>U.S Department of State Trafficking in persons, “Attorney General’s Annual Report to Congress on US Government Activities to Combat Trafficking in persons” Maj 2007, viwed on 4 February 2013, At: <http://www.justice.gov/archive/ag/annualreports/tr2006/agreporthumantrafficking2006/pdf>.

<sup>179</sup>Terri Coonan, “The Trafficking Victims Protection Act: A work in Progress”, Intercultural Human Rights Law Review, 2006, vol.1, fq.100.

<sup>180</sup>Roza Pati, “The Miami Declaration of Principles on Human Trafficking: Its Genesis and Purpose”, Intercultural Human Rights Law Review, 2006, vol.1, f.8.

<sup>181</sup>Departamenti i Shtetit Amerikan, “Trafficking in persons report: United States of America”(2012). viwed on 4 February 2013, available at:<http://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/2012/1923368.htm>.

trafikimit si dhe identifikimin e mbrojtjen e viktimës, ndryshe nga Shqipëria e cila në këtë aspekt ka dështuar<sup>182</sup>. Qeveria Amerikane ka vazhduar në përpjekjet e saj për të mbrojtur viktimat, për t'i riintegruar në mjedisin shoqëror si dhe ka marrë masa në informimin dhe edukimin e publikut kryesisht viktimave në rrezikshmerinë dhe pasojat e trafikimit.

### **2.8. Kodi Penal Belg.**

Në Belgjikë ligji i të huajve krahas rregullimit të përkrahjes për emigrantët ilegalë, mbulon gjithashtu edhe trafikimin e qenieve njerëzore. Përkufizimi është aq i gjërë sa edhe përkufizimi i ligjit polak, sepse ai mbulon jo vetëm trafikimin e femrave për qëllimin e futjes së tyre në prostitucion, por edhe për ç'do motiv tjetër në qoftë se përdoret dhunë, kërcënim, mashtrim etj, për të trafikuar një shtetas të huaj përtej kufijve ose për të mbajtur atë brenda kufijve të Belgjikës. Ushtrimi i veprimeve aktive si dhuna ose kërcënim i dhunës mbi viktimën, mund të zëvendësohet me shfrytëzimin e situatës së dobët të viktimës.

### **2.9. Kodi Penal Hollandez.**

Në Hollandë trafikimi kufizohet në shfrytëzimin për qëllime seksuale nëpërmjet sjelljes së një personi për të ushtruar prostitucion, sepse sipas nenit 250 të Kodit Penal të Hollandës, ai penalizon përdorimin e forcës ose frikësimit ose abuzimit me autoritetin apo pushtetin ose mashtrimin për të futur një person tjetër në prostitucion. Megjithëse trafikimi i femrave shpeshherë ngatërrohet me kalimin e paligjshëm të të huajve, ai konsiderohet si një krim tjetër.

### **2.10. Trafikimi i qenieve njerëzore në Finlandë.**

Ç'do vit Finlanda bëhet vend tranzit ose vendstrehim për afro dhjetëra madje qindra viktima të trafikimit të qenieve njerëzore. Këto viktima mund të jenë gra, fëmija dhe burra. Në Finlandë trafikimi i qenieve njerëzore shfaqet në formën e prostitucionit dhe veprimtarisë së tutorëve. Shfrytëzimi i punëtorëve të huaj dhe imigrantëve, për shembull, në shtëpi, restorante, ndërtimtari, pastrim, në fushën e metaleve, transportit, kopshtarisë dhe në grumbullimin e frutave të pyllit, mund të plotësojë shenjat dalluese

---

<sup>182</sup>Po aty.

të krimit të trafikimit të qenieve njerëzore. Në Finlandë deri tani nuk është hasur trafikimi i organeve. Edhe shtetasit e Finlandës mund të bien viktima të trafikimit të qenieve njerëzore.

Në Finlandë trafikimi i qenieve njerëzore është krim që dënohet ashpër. Sipas legjislacionit të Finlandës trafikimi i qenieve njerëzore është:

- shfrytëzimi seksual i një personi tjetër, si në rastin e krimit të tutorimit.
- punë me detyrim ose krjimi i rrethanave që çënojnë dinjitetin e njeriut ose
- trafikim organesh me qëllim përfitimin financiar.

Raportimi mbi trafikimin e qenieve njerëzore. Si raportues i trafikimit të qenieve njerëzore në Finlandë, ombudsmani monitoron fenomene që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore dhe jep sugjerime, deklarata dhe këshilla lidhur me zhvillimin e veprimtarisë dhe për përparimin e pozitive dhe të të drejtave të viktimave nga trafikimi i qenieve njerëzore. Ndihmën e raportuesit mbi trafikimin e qenieve njerëzore mund ta kërkojnë si autoritetet zyrtare, vepruesit në sektorin e tretë ashtu edhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

## **2.11. Trafikimi i qenieve njerëzore në Afrikë.**

Vendet afrikane janë konsideruar problematike për sa i përket trafikimit njerëzor dhe kjo vjen si rezultat i mungesës së mundësive profesionale dhe ekonomike të të rinjëve në zona rurale, arsimit, injoranca e familjeve për ti përfshirë fëmijët në trafikim duke abuzuar dhunshëm me ta, duke i torturuar apo dhe përdhunuar, dëshira e të rinjve për t'u çliruar nepërmjet emigracionit, varfëria e madhe që mbulon këto vende si dhe mungesa e informacionit drejt së keqes. Trafikimi këtu zakonisht ndodh brenda vendit, nga zonat e varfëra rurale trafikohen fëmijë në qendrat urbane të tilla si Johannesburg, CapeToën, Durban dhe Bloemfontein<sup>183</sup>. Vajzat janë të nënshtruara për trafikimin e seksit dhe robëri në familje; djemtë janë të detyruar të punojnë në rrugë duke kërkuar lëmoshë, duke kryer aktivitete kriminale dhe duke bërë punë të vështira në bujqësi. Është vlerësuar se rreth 800.000 burra, gra dhe fëmijë trafikohen çdo vit nga vendet e Afrikës

---

<sup>183</sup>USA Departament of State, *Human trafficking Report 2012*, viewed on 5 February 2013, available at:<http://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/2012/1923368.htm>.

drejt perëndimit<sup>184</sup>. Afrika e Jugut është destinacioni kryesor i trafikimit të grave. Shumica e vendeve nga Afrika e Jugut ku trafikimi i qenieve njerëzore është më shumë i përhapur janë vendet si Angola, Zimbabve, Mozambik, Republika Demokratike e Kongos<sup>185</sup>.

Qeveria e Afrikës së Jugut nuk përmbush plotësisht standartet minimale për eliminimin e trafikimit, megjithatë, ajo po bën përpjekje domethënëse për ta bërë këtë. Përpjekjet për të adresuar morinë e formave të trafikimit të qenieve njerëzore në Afrikën e Jugut mbeten të kufizuara nga sfidat sistematike, duke përfshirë: ligjet që nuk përputhen me Protokollin e Palermos(2000), burimet e pamjaftueshme për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore e sidomos problemet që shfaqen në lidhje me punën e detyruar. Pavarësisht përpjekjes së qeverisë për t'i bërë ligjet e tyre të plota, shpesh kjo përpjekje ka dështuar si rezultat i rryshfeteve që organet doganore marrin nga trafikantët.

Një hap të rëndësishëm në luftën e trafikimit të njerëzve në vendet e Afrikës ka shënuar krijimi i të ashtëquajturës “South Africa Bill of Rights” e cila ka për qëllim mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut në Afrikën Jugore. Në dispozitat e kësaj karte duken qartë mbrojtja e të drejtave të njeriut por natyrisht dhe parandalimi i skllavërimit dhe punës së detyruar. Të drejtat me themelore që parashikon karta janë e drejta e jetës, e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, e drejta e privatësisë, e drejta e fesë, të drejtat e grave, të drejtat e fëmijëve, e drejta e shëndetit. Kushtetuta e Republikës së Afrikës Jugore e vitit 1996 përbën ligjin themeltar të shtetit, ku në të cilën janë të parashikuara të drejtat themelore të njeriut dhe ku çënim i tyre përbën shkelje të rëndë të këtij ligji suprem për vendin.

Një përparësi në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e trafikimit njerëzor në Afrikë përbën dhe legjislacioni penal i vendit (Criminal Law (Sexual Offences and Related Matters) Amendment Act 32, 2007) si dhe „Children’s Act“ i 2005 i cili garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, madje i jep një kuptim më të gjërë trafikimit të fëmijëve. Deri më tani sistemi gjyqësor në Afrikë në trajtimin e rasteve të trafikimit njerëzor është mbështetur në ligje të tjera të tilla si “Sexual Offences Act” 1957, Akti i Imigracionit 2002, “Akti i Dhunës në Familje” 1998 si dhe “Akti i

---

<sup>184</sup>Consultancy Africa Intelligence “*Human Trafficking in Africa-A modern day evil*”, September 2009, viewed on 7 February 2013.

<sup>185</sup>UNESCO, “*Human Trafficking in Mozambique: Root causes and recommendations*”, 2006, viewed on 7 February 2013, Available at:<http://unesdoc.unesco.org/images/0014/001478/147846E.pdf>.

Parandalimit të Krimit të Organizuar” 1998. Të gjitha këto legjislacione të lartpërmendura, përfshirë dhe protokollin e Palermos të cilin Afrika e ka nënshkruar dhe ratifikuar, po të gjenin zbatimin e duhur do kishte një ulje të krimit në këtë vend.

## PJESA E DYTË

### VËSHTRIM KRIMINOLOGJIK I TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE GJATË PERIUdhËS 2001-2014 DHE MASAT ME QËLLIM TË LUFTIMIT TË TYRE.

#### Kapitulli IV: Disa karakteristika fenomenologjike të trafikimit të qenieve njerëzore gjatë periudhës 2001-2014.

##### 1. Vëllimi dhe dinamika e trafikimit të qenieve njerëzore.

Rezulton se trafikimi i qenieve njerëzore nuk është në grupin e figurave të veprave penale më të proceduara dhe me prirje numerike në rritje. Sipas Vjetarit Statistikor të Ministrisë së Drejtësisë në vitin 2004<sup>186</sup>, në vendin tonë janë proceduar 35 krime të trafikimit të qenieve njerëzore (nenet 110/a, 114/b, 128/b) dhe ky është numri më i madh i çështjeve të gjykuara në periudhën e studimit. Në tabelën më poshtë kemi këtë paraqitje të kriminalitetit për këtë grup veprash penale:

Viti	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Nr. i çështjeve gjyqësore	35	15	21	10	17	7	5	13	2	2	6

**Tab. Nr. 1**

Po të krahasohen me vëllimin total të çështjeve të proceduara nga gjykata për krime të rënda ndër vite shohim se krimet e trafikimit të qenieve njerëzore janë pakësuar ndjeshëm, dhe për më tepër, ato përbëjnë të vetmin grup krimesh që ka pësuar rënie. Më tej, evidentohet fakti që vepra penale me frekuencë më të lartë midis grupit të veprave penale objekt hulumtimi është trafikimi i femrave për prostitucion, parashikuar nga neni 114/b të Kodit Penal (nga 121 krime të trafikimit të qenieve njerëzore të proceduara në

<sup>186</sup>Në raport analizën e këtij viti të Gjykatës për Krime të Rënda ndër të tjera thuhet: *Për vepra të tilla si "Vrasje në rrethana të cilësuar", "Vjedhje me pasojë vdekjen", "Trafikim i femrave për prostitucion", janë dhënë masa dënimi nga 15 vjet deri në burgim të përjetshëm. Në dhënien e sanksioneve është pasur parasysh dhe aplikimi i njëkohshëm i dy dënimeve kryesore, atij me burgim dhe me gjobë, ndaj të pandehurve të gjetur fajtorë për kryerjen e veprës penale të trafikimit.*

periudhën e hulumtimit, 84 prej tyre janë krime të trafikimit të femrave). Ndërsa krimet më të pakta në numër për periudhën e hulumtimit janë ato të trafikimit të personave, parashikuar nga neni 110/a të Kodit Penal, me respektivisht 11 çështje penale të proceduara.

Lidhur me trafikimin e femrave, problematik shfaqet edhe fakti që trafikimi i femrave konstatohet se kryhet në rrethana rënduese, me numër të madh viktimash dhe në forma të rënda bashkëpunimi. Raste të tilla të gjykuara janë të shumta. Kështu Gjykata për Krime të Rënda në një vendim penal ndër të tjera arsyeton:

*“...Nga të gjitha provat del qartë që i pandehuri R.E. ka bashkëpunuar në formën e marrëveshjes subjektive dhe bashkëveprimit objektiv me të pandehurin F.S. Veprimet e tyre janë në koherencë të plotë e të përputhshëm me njëri-tjetrin deri në momentin kur i pandehuri R.E. ka rënë në burg. Në këto kushte në kuptim të normës ndërkombëtare dhe frymës së Kodit Penal ky i pandehur ka zhveshur nga vullneti i të vepruarit në mënyrë të lirë të dëmtuarën duke konsumuar veprën penale të ‘‘Trafikimit të femrave’’ në bashkëpunim.”<sup>187</sup>*

Në një vendim tjetër, në gjykimin e çështjes penale në bazë të nenit 128/b të Kodit Penal, në arsyetimin e vendimit, gjykata nënvizon:

*“... I pandehuri J. ka përfituar nga marrëdhëniet familjare me të dëmtuarën S.K. për të realizuar ‘‘rekrutimin’’ e saj me qëllim trafikimin për prostitucion. E dëmtura S.K. ka braktisur familjen, fëmijën e saj të mitur, pasi i pandehuri i ka premtuar se do të martohej me të.”<sup>188</sup>*

Më poshtë po paraqesim në mënyre analitike çështjet e dërguara për gjykim në Gjykatën e Krimeve të Rënda për disa vite, bazuar në të dhënat e statistikave të gjykatës.

Për vitet 2004-2006, janë gjykuar gjithsej 22 çështje. Nga vëzhgimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, gjatë kësaj periudhe objekt studimi rezulton se gjatë vitit 2004 numri i çështjeve penale të trafikimit të qenieve njerëzore të gjykuara nga kjo gjykatë zë 40.9% të çështjeve, gjatë vitit 2005 numri i çështjeve të gjykuara zë 27.2% të çështjeve dhe gjatë vitit 2006, numri i çështjeve zë 31.8 % të çështjeve.

Në lidhje me numrin e të gjykuarve, nga vëzhgimi i vendimeve gjyqësore, rezulton si më poshtë vijon: Gjatë vitit 2004, numri i të gjykuarve përbën 36.5% të numrit të përgjithshëm të tyre, gjatë të tria viteve objekt studimi. Gjatë vitit 2005, numri i të gjykuarve përbën 41.4 % të të gjykuarve. Gjatë vitit 2006, numri i të gjykuarve përbën 21.9% të tyre.

---

<sup>187</sup> Vendimi nr.15, date 12.03.2012, Gjykatës për Krime të Rënda.

<sup>188</sup> Vendimi nr.39, date 12.07.2011, Gjykatës për Krime të Rënda.



Sikurse mund të shihet lehtë, gjatë vitit 2006 numri i të gjykuarve ka pësuar rënie në krahasim me numrin e të gjykuarve gjatë vitit 2004 dhe 2005. Gjatë vitit 2005 ka një rritje të numrit të tyre në krahasim me vitin 2004.

Për veprat penale sipas neneve 110/a, 114/b, 128/b të Kodit Penal, në vitin 2008 janë dërguar për gjykim 14 çështje me 25 të pandehur, ndërsa në vitin 2009, shifrat kanë pësuar ulje, ku janë dërguar për gjykim 7 çështje me 10 të pandehur.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në këto dy vite ka rënie të numrit të procedimeve të ardhura për gjykim për veprat penale të trafikimit. Nëse në vitet e para të krijimit të kësaj gjykate, në periudhën 2004-2006, numri i çështjeve penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, zinte afërsisht rreth 50% të numrit total të çështjeve, tashmë këto lloj çështjesh, përfshijnë më pak se 10% të punës së Gjykatës për Krime të Rënda. Megjithatë duhet theksuar se për çështjet e gjykuara është rritur cilësia dhe efektiviteti i punës në drejtim të dënimit të trafikantëve si dhe realizimit të proceseve gjyqësore të drejta bazuar në ligj dhe të drejtat e njeriut përfshirë edhe atë për një proces të rregullt gjyqësor. Gjatë zhvillimit të procesit është treguar një kujdes i veçantë për viktimat e trafikimit sidomos për ato që kanë bashkëpunuar me organet e drejtësisë.

Ndërkohë nga statistikat konstatohet se në periudhën shtator 2008 – prill 2009, krahas çështjeve të sipërcituara, kanë qenë në gjykim dhe janë dhënë vendime përfundimtare për 8 çështje penale me 27 autorë nga të cilat 5 për trafikim femrash (neni 114b) me gjithsej 9 autorë dhe 2 çështje për ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit (neni 298 i K.P) me 16 autorë<sup>189</sup>.

Nga statistikat për vitin 2010, konstatohet se për veprat penale të *trafikimit të femrave për prostitucion* janë rregjistruar 10 çështje penale, ndërsa sipër tyre në shifra qëndron vepra penale e *trafikimit të lëndëve narkotike*, me 31 çështje të ardhura për gjykim.

Po ashtu, edhe për vitin 2011 numrin më të madh të çështjeve e përbëjnë ato të trafikimit të narkotikëve me 47%, ndërsa trafikimi i qenieve njerëzore përbën 12,4%.<sup>190</sup> Gjatë vitit 2011 Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka trajtuar gjithsej 12 çështje me objekt trafikimin e personave. Për të gjitha çështjet janë marrë vendimet përkatëse, të cilat kanë konkluduar në:

---

<sup>189</sup>Raporti për Realizimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzor 2008-2010 (Shtator 2008 – Maj 2009).

<sup>190</sup>Raporti mbi analizën e veprimtarisë së Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda, viti 2011.

- 7 çështje është vendosur lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
- 1 çështje është vendosur prishja e vendimit dhe pushimi i çështjes;
- 2 çështje ka ndryshuar masa e dënimit për personat e dënuar (nga 1 person për secilën çështje përkatësisht nga 13 në 11 vjet burg dhe nga 15 vjet e 6 milion lekë në 7 vjet burgim dhe 4 milion lekë);
- 1 çështje është dërguar për gjykim në Gjykatën Kushtetuese;
- 1 çështje është prishur vendimi dhe është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Krimeve të Rënda<sup>191</sup>.

Për vitin 2012 numrin më të madh të çështjeve e përbëjnë ato të trafikimit të narkotikëve, me 61.5% të numrit total të çështjeve, ndërsa trafikimi i qenieve njerëzore zbrit ndjeshëm në 3% të numrit total të çështjeve.<sup>192</sup> Mbështetur në treguesit e mësipërm del se për këtë vit krimi i trafikimit zë përqindje të vogël në krahasim me grupin e veprave penale në kompetencë lëndore të Gjykatës për Krime të Rënda.<sup>193</sup>

Në vitin 2013 vepra penale të trafikimit të qenieve njerëzore zë përqindje të papërfillshme, ndërkohë që numrin më të madh të çështjeve, i cili është në rritje, e përbëjnë ato të trafikimit të narkotikëve me 69% të numrit total të çështjeve. Gjatë periudhës 1 Tetor – 31 Dhjetor 2013 janë regjistruar 9 çështje për trafiket e qenieve njerëzore dhe për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor 2013 janë regjistruar 23 çështje.

Ndërsa për vitin 2014 numrin më të madh të çështjeve e përbëjnë ato të “*Trafikimit të narkotikëve*” me 59.7 %, të numrit total të çështjeve, “*Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë*” dhe “*Rrëmbimi i personit*” që zënë 12.2% të numrit total të çështjeve të gjykuara në këtë vit, “*Vrasjet e kryera ndaj personave me cilësi të veçanta*” që zënë 2.3% të numrit të çështjeve, “*Trafikimi i armëve dhe municioneve*” që zë 0.45% të këtij numri, vepra të tjera penale ndër të cilat dhe ajo e “*Vrasjes për gjakmarrje*” (neni 79/c i KP), “*Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare*” (neni 79/b

<sup>191</sup>Raporti mbi analizën e veprimtarisë së Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, viti 2011.

<sup>192</sup>Raporti mbi analizën e veprimtarisë së Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda, viti 2012.

<sup>193</sup>Me ligjin nr. 99/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, dt. 21.03.1995 Kodi i Procedurës Penale të Republikës të Shqipërisë, i ndryshuar”, u përcaktua se Gjykata e Krimeve të Rënda do të gjykojë krimet e parashikuara nga nenet 73, 74, 75, 79, shkronjat c dh ç, 109, 109/b, 110/a, 111, 114/b, 128/b, 219, 220, 221, 230, 230/a, 230/b, 231, 232, 233, 234, 234/a, 234/b, 245, 260, 265/a, 265/b, 265/c278/a, 282/a, 283/a, 284/a, 287/a, 319, 319/ ç , 333, 333/a e 334 të Kodit Penal, duke përfshirë edhe rastet kur ato janë kryer nga subjekte që janë në kompetencë të gjykatave ushtarake dhe nga të miturit.

i KP) që zënë 14.9%, Vepra të tjera, ku këtu përfshihen edhe veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe që përbëjnë 10.5% <sup>194</sup>.

Në vitin 2014 vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore ka një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2013. Gjatë këtij viti janë gjykuar 6 çështje penale me 9 të pandehur. Nga këta 6 të pandehur janë gjykuar për veprën penale të “trafikimi i personave të rritur” parashikuar nga neni 110/a/4 i K.Penal, 1 i pandehur për veprën penale të “trafikimi i personave të rritur” të parashikuar nga neni 110/a/2 të K.Penal, 1 i pandehur për veprën penale të “trafikimi i personave të rritur” të parashikuar nga neni 110/a/3 të K.Penal dhe 1 i pandehur për veprën penale të “trafikimi i femrave për prostitucion” të parashikuar nga neni 114/b/1 i K.Penal

Më poshtë po paraqesim në mënyre analitike çështjet e regjistruara në Prokurorinë e Krimeve të Rënda për disa vite, bazuar në të dhënat e raporteve të Prokurorisë.

Gjatë vitit 2010, në Prokurorinë për Krime të Rënda janë hetuar 39 procedime penale (sipas regjistrimit të njoftimit të veprave penale) që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, *nenet 114/b, 128/b, 110/a* nga të cilat 28 të reja të regjistruara gjatë vitit 2010, si dhe 11 të mbartura nga vitet e mëparshme. Një risi e veçantë është për këtë vit regjistrimi i një procedimi për veprën penale “Trafikimi i të miturve” – neni 128/b i KP, me objekt trafikimin e brendshëm. Për sa i përket procedimeve të tjera në lidhje me të miturit, nga të dhënat rezulton se ata trafikohen jashtë vendit për qëllime prostitucioni ose për lypje. Rastet e tjera të procedimeve penale të regjistruara në Prokurorinë për Krime të Rënda për veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore paraqiten si rastet më tipike të trafikimit me qëllim shfrytëzimi për prostitucion jashtë vendit (Greqi, Itali, Kosovë). Për sa i përket rasteve të regjistruara gjatë vitit 2010, sipas veprave penale, kane qenë këto tregues:

- 20 raste për veprën penale “Trafikim i femrave” - neni 114/b i KP;
- 2 raste për veprën penale “Trafikim i personave” - neni 110/a i KP;
- 6 raste për veprën penale “Trafikim i të miturve” - 128/b i KP.

Për të gjitha procedimet penale që lidhen me veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore (të regjistruara në vitin 2010 si dhe të mbartura nga viti 2008-2009), në

---

<sup>194</sup> Raporti mbi analizën e veprimtarisë së Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda, viti 2014.

regjistrin e njoftimit të veprave penale janë regjistruar emrat e 29 shtetasve si persona që i'u atribuohet kryerja e veprës penale.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2011 në Prokurorinë e Krimeve të Rënda janë regjistruar dhe kanë vazhduar hetimet gjithsej për 28 çështje që kanë të bëjnë me trafikim personash, nenet 114/b, 128/b dhe 110/a të KP. Nga këto 21 janë të mbartura nga 2009-2010 dhe 7 çështje janë të reja të regjistruara gjatë 2011. Të ndara sipas neneve kemi këto dhëna:

- 20 proçedime penale për “Trafikim femrash” - neni 114/b i KP;
- 7 proçedime për “Trafikim të miturish” – neni 128/b i K.P;
- 1 proçedim për “Trafikim personash” – neni 110/a i K.P;
- Për të gjitha proçedimet penale (të mbartura dhe të reja) janë të regjistruar 27 autorë prej të cilëve 5 janë marrë në cilësinë e të pandehurve.

Treguesit e proçedimeve penale të Prokurorisë për Krime të Rënda (dërguar për gjykim, hetim, pushim etj.) për periudhën Janar – Dhjetor 2011):

- 2 proçedime penale për “Trafikim të miturish” - neni 128/b KP, janë dërguar për gjykim;
- 6 proçedime penale (4 për “Trafikim femrash” - neni 114/b dhe 2 për “Trafikim të miturish” – neni 128/b i K.P.), është vendosur pushimi i çështjes;
- 1 proçedim penal për “Trafikim femrash” - neni 114/b, është vendosur pezullimi;
- 6 proçedime penale për “Trafikim femrash” - neni 114/b, është vendosur mos kompetenca lëndore;
- 13 proçedime penale (1 për “Trafikim personash” – neni 110/a i K.Penal, 9 për “Trafikim femrash” - neni 114/b i K.Penal dhe 3 për “Trafikim të miturish” - neni 128/b i K. Penal), kanë vazhduar hetimet.

Të dhënat e Prokurorisë për Krime të Rënda tregojnë se gjatë vitit 2013 janë hetuar 42 çështje për trafiket e qenieve njerëzore, nga të cilat 10 çështje janë të mbartura nga vitet e kaluara dhe 32 çështje janë regjistruar gjatë vitit 2013. Për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2013 vetëm 1 çështje është dërguar në gjykatë për trafik qeniesh njerëzore<sup>195</sup>.

---

<sup>195</sup>Raport Analiza Vjetore e vitit 2013, Prokuroria e Krimeve të Rënda.

Më poshtë, paraqiten në mënyrë tabelare numri i përgjithshëm i çështjeve të dërguara për gjykim në Gjykatën e Krimeve të Rënda, si dhe në veçanti numri i çështjeve të grup veprave objekt hulumtimi dhe autorëve të këtyre veprave penale.

Në vite	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Çështje themeli	140	141	123	124	145	136	111	118	130	171	221

**Tabela nr.2**

Figura e veprës penale	Çështje	Autorë
Neni 110/a. Trafikimi i personave	11	13
Neni 114/b. Trafikimi i femrave	84	150
Neni 128/b. Trafikimi i të miturve	26	38
Totali	121	201

**Tabela nr.3**

Në trajtimin e vëllimit dhe dinamikës së veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore do t'u referohemi edhe statistikave të Policisë së Shtetit (PSH). Më poshtë, paraqiten në mënyrë tabelare numri i përgjithshëm i çështjeve dhe autorëve si dhe në veçanti numri i personave të arrestuar, ndaluar dhe në kërkim, sipas të dhënave të evidentuara nga Policia e Shtetit, gjatë periudhës objekt hulumtimi, për trafikimin e qenieve njerëzore.

### Statistika nga PSH lidhur me TQNJ për vitin 2012

Vepra Penale	Evidentuar	Autorë	Arrestuar	Gjendje e		
				Lirë	Ndaluar	Kërkim
Trafikim i femrave	25	30	8	19	-	3
Trafikim i te miturve	3	3	-	2	1	-
Trafikim i personave	2	2	-	2	-	-
<b>SHUMA</b>	<b>30</b>	<b>35</b>	<b>8</b>	<b>23</b>	<b>1</b>	<b>3</b>

*Tabela nr.4*

### Statistika nga PSH lidhur me TQNJ për vitin 2011

Vepra Penale	Evidentuar	Autorët	Arrestuar	Gjendj		
				e Lirë	Ndaluar	Kërkim
Trafikim i femrave	17	24	8	11	3	2
Trafikim i te miturve	6	10	2	7	-	1
<b>SHUMA</b>	<b>23</b>	<b>34</b>	<b>10</b>	<b>18</b>	<b>3</b>	<b>3</b>

*Tabela nr.5*

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2011, nga Policia e Shtetit janë realizuar me sukses gjithsej 10 operacione me 33 persona të evidentuar si të implikuar në trafikë të paligjshme. Sipas veprave penale rezulton 3 operacione kanë patur për objekt “Trafikimin e femrave”, neni 114/b i KP me gjithsej 10 autorë (9 të arrestuar në flagrancë dhe 1 person i proceduar në gjendje të lirë), ndërsa 7 operacionet e tjera kanë patur për objekt veprat penale: “Shfrytëzim për prostitucion në rrethana rënduese”, “Shfrytëzim për prostitucion”, “Mbajtje e lokaleve për prostitucion”, me gjithsej 23 autorë (17 të arrestuar në flagrancë, 3 të shpallur në kërkim dhe 3 të proceduar në gjendje të lirë).

Gjatë vitit 2011 janë goditur gjithsej 6 grupe kriminale ku njëri prej tyre kishte të bënte me “Trafikimin e femrave” neni 114/b i KP me 6 autorë të arrestuar në flagrancë, ndërsa 5 grupet e tjera kanë të bëjnë me veprën penale “Shfrytëzim i prostitucionit në rrethana rënduese”. Në bashkëpunim me Greqinë janë zhvilluar 2 operacione, të cilat kanë patur për objekt trafikimin e femrave, parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal. Në këto

operacione janë identifikuar si të implikuar 9shtetas, ku 8shtetas janë arrestuar e ndaluar dhe 1është proceduar në gjendje të lirë<sup>196</sup>.

#### Statistika nga PSH lidhur me TQNJ për vitin 2010:

Vepra Penale	Evidentuar	Autorët	Arrestuar	Gj Lirë	Ndaluar	Kërkim
Trafikim i femrave	33	45	5	34	3	3
Trafikim i personave	3	3	-	3	-	-
Trafikim i te miturve	1	3	3	-	-	-
<b>SHUMA</b>	<b>37</b>	<b>51</b>	<b>8</b>	<b>37</b>	<b>3</b>	<b>3</b>

*Tabela nr.6*

Gjatë vitit 2010, nga Policia e Shtetit (SKTP) janë zhvilluar gjithsej 3 operacione me objekt trafikimin e qenieve njerëzore (2 operacione për “Trafikim i femrave” dhe 1 operacion për veprën penale “Trafikim i të miturve”). Nga këto operacione janë goditur 3 grupe kriminale, 2 për “Trafikim femrave”, me 7 autorë, 3 të arrestuar në flagrancë, 3 të proceduar penalisht në gjendje të lirë dhe 1 i shpallur në kërkim, si dhe 1 grup kriminal për “Trafikim i të miturve” me 3 autorë të arrestuar në flagrancë. Gjatë vitit 2010, janë kapur gjithsej 21 persona në kërkim, të akuzuar për trafikim të qenieve njerëzore (18 të akuzuar për “Trafikim i femrave” dhe 3 për veprën penale “Trafikim i të miturve”<sup>197</sup>.

#### Statistika nga PSH lidhur me TQNJ për vitin 2009

Vepra Penale	Evidentuar	Autorët	Arrestuar	Gj. Lirë	Ndaluar	Kërkim
Trafikim i femrave	8	9	1	4	3	1
Trafikim i personave	2	4	-	4	-	-
Trafikim i te miturve	4	4	-	4	-	-
<b>SHUMA</b>	<b>14</b>	<b>17</b>	<b>1</b>	<b>12</b>	<b>3</b>	<b>1</b>

*Tabela nr.7*

<sup>196</sup>Raporti për Zbatimin e Planit Kombëtar tëVeprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave, Janar-Dhjetor 2011, Tiranë, Shkurt 2012.

<sup>197</sup>Për më tej shih, Raportin për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, janar-dhjetor 2010, Tiranë, Shkurt 2011.

### Statistika nga PSH lidhur me TQNJ për vitin 2008

Vepra Penale	Evidentuar	Autorët	Arrestuar	Gj. Lirë	Ndaluar	Kërkim
Trafikim i femrave	19	16	1	10	2	3
<b>SHUMA</b>	<b>19</b>	<b>16</b>	<b>1</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>3</b>

*Tabela nr.8*

### Statistika nga PSH lidhur me TQNJ për vitin 2007

Vepra Penale	Evidentuar	Autorët	Arrestuar	Gj. Lirë	Ndaluar	Kërkim
Trafikim i femrave	11	11	2	5	2	2
Trafikim i personave	1	1	-	-	-	1
Trafikim i te miturve	6	7	2	2	2	1
<b>SHUMA</b>	<b>18</b>	<b>19</b>	<b>4</b>	<b>7</b>	<b>4</b>	<b>4</b>

*Tabela nr.9*

Ndërsa për vitin 2007, duke u bazuar dhe në të dhënat statistikore, vërehet një ulje e numrit të punonjësve të policisë së roleve të ndryshme të përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore. Gjatë këtij viti nga Drejtoria e SHKB-së në organin e Prokurorisë janë referuar 157 kallëzime penale për 219 subjekte policore ku 5 janë roli i lartë, 74 i mesëm dhe 140 bazë, prej tyre 44 të arrestuar, 12 punonjës të rolit të mesëm dhe 31 të rolit bazë.

Vetëm gjatë vitit 2007 nga Drejtoria e SHKB-së janë dërguar pranë organit të Prokurorisë 4 kallëzime penale për dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufijve për 12 subjekte policore ku 4 të rolit të mesëm dhe 8 të rolit bazë, si dhe 10 prej tyre të arrestuar në flagrancë.

Në bashkëpunim me Prokurorinë e Krimeve të Rënda, gjatë 2007 u bë e mundur vërtetimi, dokumentimi i veprimtarisë antiligjore të 2 grupeve kriminale të strukturuar dhe organizuar, në përbërje të të cilëve bënin pjesë punonjës të policisë. Kështu në muajin qershor të vitit 2007 u bë arrestimi i një grupi kriminal të strukturuar prej 9 personash nga të cilët 4 oficerë policie, të cilët në bashkëpunim me trafikantët merreshin dhe favorizonin trafikimin e paligjshëm të qenieve njerëzore në drejtim të Greqisë. Nga hetimet e deritanishme implikohen 35 persona, nga të cilët 15 janë punonjës policie.



Ndërsa në korrik të 2007 u arrestuan anëtarët e një tjetër grupi kriminal prej 11 personash, nga të cilët 6 punonjës policie, të cilët realizonin trafikimin e qenieve njerëzore drejt shtetit fqinj, Greqisë, nga PKK Qafë – Botë dhe zona kufitare Konispol<sup>198</sup>.

**Statistika nga PSH lidhur me TQNJ për vitin 2006 :**

<b>Vepra Penale</b>	<b>Evidentuar</b>	<b>Autoret</b>	<b>Arrestuar</b>	<b>Gj Lire</b>	<b>Ndaluar</b>	<b>Kerkim</b>
Trafikim i femrave	25	28	2	7	10	9
Trafikim i te miturve	2	4	2	1	1	-
<b>SHUMA</b>	<b>18</b>	<b>32</b>	<b>4</b>	<b>8</b>	<b>11</b>	<b>9</b>

**Tabela nr.10**

Në organin e Prokurorisë gjatë vitit 2006 janë referuar 175 kallëzime penale për 244 subjekte policore ku, 15 roli i lartë, 87 i mesëm dhe 142 bazë, prej tyre 71 të arrestuar. Nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm (SHKB) gjatë vitit 2006 janë evidentuar 5 raste të dhënies së ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve nga punonjës policie ku, 4 prej tyre janë arrestuar në flagrancë dhe këta punonjës janë përjashtuar nga radhët e Policisë së Shtetit, ndërsa për 11 prej tyre janë dërguar pranë organit të Prokurorisë me materialet kallëzuese për hetime të mëtejshme<sup>199</sup>.

**2. Disa karakteristika të autorëve të trafikimit të qenieve njerëzore për periudhën 2001-2014.**

Karakteristikat kryesore të autorëve të trafikimit të njerëzve janë gjinia, mosha, vendi nga vijnë, statusi familjar, statusi gjyqësor, marrëdhëniet me viktimën dhe arsimimi. Numri i të pandehurve mbi të cilët është disponuar me vendim nga Gjykata për Krime të Rënda është i konsiderueshëm. Për periudhën 2004-2014, ai arrin në mbi rreth 1560, dhe mosha rezulton të jetë 20–35 vjec.

<sup>198</sup> *Raport Vlerësimi për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2005-2007. Tiranë Mars, 2008.*

<sup>199</sup> *Raport Vlerësimi për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2005-2007. Tiranë Mars, 2008.*

Harta gjeografike e veprimtarisë kriminale tashmë është zgjeruar, përveç vendeve të rajonit e atyre evropiane përfshin dhe vende të Amerikës Latine, atyre të ulëta e skandinave. Karakteristikë është rritja e numrit të femrave autore të veprave penale si ato të trafikimit të narkotikëve si dhe rritja e nivelit arsimor të të pandehurve.

Në librin “Trafikimi. Rasti i Shqipërisë”, autorët L.Sokoli dhe I.Gëdeshi kanë evidentuar:

*“Nga të dhënat e marra nga anketuesit del se trafikimi i grave dhe adoleshentëve është, gjithsesi një problem mbarëkombëtar. Por në Shqipëri, ai perceptohet si ‘më shqetësues’ në prefekturat e Elbasanit, Vlorës dhe Shkodrës. Ndërkohë që më pak probleme trafikimi duket se kanë Kukësi, dhe sidomos Gjirokastra.”<sup>200</sup>*

Nga analiza e vendimeve rezulton se vetëm në disa raste autorët e veprës penale kanë pasur marrëdhënie familjare me viktimën. Ka patur edhe ndonjë rast, që është karakteristikë e veçantë, kur vetë familjarët e të trafikuarve kanë mbështetur trafikimin e të afërmeve të tyre për nevoja ekonomike.

Nga të dhënat e parashtruara mbi vëllimin e trafikimit të qenieve njerëzore, mund të konstatohet se ky lloj kriminaliteti është kryer nga persona madhorë dhe pjesëmarrja e personave të mitur dhe femra është e papërfillshme. Asnjë person i mitur nuk është gjykuar për grupin e veprave penale të periudhës objekt hulumtimi. Gjithashtu për periudhën 2001-2005 numri i personave të dënuar femra është 0.

Veçantia e grup-veprave objekt studimi në Shqipëri, është lidhja e ngushtë e prostitucionit me krimin e trafikimit të femrave. Pjesa më e madhe e femrave shqiptare detyrohen me dhunë e presione të karakterit të ndryshëm, prandaj rezultojnë jo vetëm subjekte të ushtrimit të prostitucionit, por edhe viktima të krimit të trafikimit.<sup>201</sup>

Grupmosha kryesore e autorëve të trafikimit është 25-35 vjeç, e ndjekur nga grupmosha 18-25 vjeç.

Lidhur me arsimimin e trafikantëve, mund të thuhet se pjesa dërmuese e tyre janë maksimumi me arsim të mesëm.

---

<sup>200</sup> Ilir Gedeshi, Lek Sokoli, *Trafikimi, rasti i Shqipërisë*, fq.43, botim IS & Rinia.

<sup>201</sup> Në gjykimin e çështjes ndaj të pandehurve H. A dhe A. C, akuzuar për kryerjen e veprës penale të trafikimit të femrave për prostitucion, Gjykata e Krimeve të Rënda, duke vlerësuar që kjo veprë është kryer në bashkëpunim, ka vendosur si masë dënimi për secilin nga të akuzuarit shtatëmbëdhjetë vjet burg, Tiranë, 2004.

Karakteri i dhunshëm në kryerjen e veprës penale<sup>202</sup> përbën një tjetër karakteristikë të veçantë të trafikantëve.

Nga vëzhgimi i vendimeve gjyqësore rezulton se vetëm në disa raste autorët e veprës penale kanë pasur marrëdhënie familjare me viktimën. Në rastet e tjera, nuk ka pasur lidhje familjare mes të pandehurve dhe viktimave të tyre, përfshirë këtu edhe raste të shtetaseve të huaje, që janë kryesisht rumune dhe moldave.

Nga ky studim, rezulton se format e përdorura nga trafikantët për t'i detyruar femrat për të ushtruar prostitucion kanë qenë:

- Mashtrimet për t'u martuar dhe për të jetuar jashtë shtetit;
- Mashtrimet për sigurim pune e kushte jetese jashtë shtetit;
- Mashtrimet duke përdorur femra ndërmjetëse;
- Kërcënimet për jetën e familjen e saj;
- Shitblerja e femrave;
- Kompromentimet me anën e dhuratave, parave e duke krijuar detyrime të tjera materiale.

Shkaqet e përhapjes së trafikimit të grave dhe të vajzave në 15-vitet e fundit, janë të shumta dhe lidhen me dobësinë e shtetit të ri demokratik për të goditur fenomene si trafikimi. Shoqëria shqiptare, në vitet 1990-2000, u mbërthye nga një varg problematikash si, varfëria ekonomike, papunësia, emigrimi, lëvizja e lirë e njerëzve, etj. Të motivuar nga fitimi në këtë veprimtari të kundërligjshme, trafikantët kanë përdorur forma të tilla si mashtrimi me premtim për punë, martesat e rreme etj. Ka patur edhe ndonjë rast, që është karakteristikë e veçantë, kur vetë familjarët e të trafikuarve kanë mbështetur trafikimin e të afërmëve të tyre për nevoja ekonomike, etj.

Më poshtë do të shihen më hollësisht të gjitha karakteristikat e përmendura më sipër.

## **2.1. Moshë dhe kriminaliteti.**

Moshë është karakteristikë e rëndësishme e fenomenit kriminal. Të dhënat e shumta statistikore nga praktika gjyqësore si dhe nga shënimet e kërkimeve empirike kriminologjike, flasin se me veprime dhe sjellje kriminale merren persona të moshave të

---

<sup>202</sup> Në gjykimin e çeshtjes ndaj të pandehurve Q. D. dhe I. Sh. akuzuar për kryerjen e veprave penale të mardhënieve seksuale me dhunë dhe trafikimit të femrave, Gjykata e Tiranës, ka vendosur si masë dënimi për të akuzuarit me 16 vjet burg. *Vendimi nr. 588, Tiranë, Qershor 2003.*

ndryshme<sup>203</sup>. Siç dihet mosha e autorëve të veprës penale mund të ndahet sipas përcaktimeve ligjore pozitive. Mosha e autorëve të veprës penale ndahet në mosha të personave të mitur dhe personave të rritur. Brenda këtyre ndarjeve kryesore kemi edhe ndarje të tjera. Mosha e mitur ndahet në të mitur të rinj, e cila përfshinë moshën prej 14-16 vjeç dhe në të mitur të rritur që përfshinë moshën prej 16-18 vjeç. Personat në moshën deri në 14 vjeç, në literaturë kriminologjike dhe juridiko-penale trajtohet si moshë e fëmijëve të cilët nuk i nënshtrohen procedurës penale. Këta persona nuk janë të përgjegjshëm në aspektin juridiko-penal. Në disa shtete bëhen edhe përjashtime, ku mosha e personave prej 10-14 vjeç i nënshtrohet përgjegjësisë së caktuar penale, kjo ndodh në disa shtete të lindjes<sup>204</sup>.

Si moshë e rritur konsiderohet mosha prej 18 vjeç e deri në vdekje të personit. Në literaturën kriminologjike dhe në kërkimet praktike, ndarja dhe kategorizimi i moshave të personave të rritur zakonisht bëhet në dekada. Në periudhën e hulumtimit për veprën penale të trafikimit do të përshkruajmë moshën e personave të rritur prej 18-25 vjeç si moshë e veçantë, pastaj moshën prej 25-35, moshën 35-45 vjet, moshën 45-55 dhe, në fund, moshën më të vjetër se 55.

Bazuar në të dhënat e vendimeve të gjykatës, rezulton se numrin më të madh të personave të dënuar janë të moshës nga 18 – 45 vjeç, ndërsa personat e dënuar të mitur kapin shifër shumë të vogël në numrin e përgjithshëm të tyre. Pjesmarrja kaq e lartë e grupmoshës 18 – 45 vjeç në numrin e tërësishëm të të dënuarve duhet shpjeguar me ndikimin e disa faktorëve dhe rrethanave të caktuara, pasi kjo grupmoshë është grupi i popullatës më aktive në jetën shoqërore të ç’do shoqërie, pra edhe të shoqërisë shqiptare e cila është ballafaquar me probleme të shumta në jetën e përditshme.

Analiza e faktorëve kriminogjenë të personave të dënuar do të trajtohet më poshtë në pikat përkatëse që kanë të bëjnë me faktorët objektivë dhe subjektivë të tyre. Mosha e personave të dënuar është një ndër kriteret kryesore për klasifikimin dhe grupimin e të dënuarve në institucionet për ekzekutimin e dënimit me burgim. Zbatimi i mirëfilltë në

---

<sup>203</sup> R. Gassin, *Criminologie*, Paris, 1996, fq.289-290.


<sup>204</sup>Ligja penale otomane në nenin 40 bënte këtë ndarje të moshës së mitur:

- Fajtorët që nuk kishin mbushur moshën 13 vjeç nuk ndëshkoheshin, por vendoseshin nën kujdesin e prindërve, kujdestarëve, ose mbylleshin në strehë qortimore derisa ta arrinin moshën 18 vjeç.
- Nga 13-15 vjeç të pambushur fajtori dënohej nga 5 – 10 burg urtësimi, në rastet kur krimi ndëshkohej me vdekje, pranga ose burgim të përjetshëm. Ndëshkimet e tjera pakësoheshin.
- Nga 15-18 , dënimi më i rëndë nuk i kalonte 15 vjet dhe më i ulëti zbatohesh deri në gjysmën e dënimit për veprën penale konkrete.

praktikë i këtij kriteri krijon mundësi të gjera të aplikimit të mjeteve dhe metodave më të përshtatshme ndaj personave të dënuar gjatë vuajtjes së dënimit me burgim.<sup>205</sup>

Për sa i përket moshës së viktimave nga të dhënat që japin aktgjykimet, rezulton se moshja dominuese e tyre është 25 – 35 vjeç, ndërsa në vend të dytë janë grupmoshat 18 – 25 vjeç.

Në periudhën kohore të hulumtimit 2001 – 2014, moshja e personave të dënuar ka pasur ecurinë si vijon dhe paraqitet grafikisht më poshtë:



## 2.2. Gjinia ose përkatësia seksuale.

Gjinia ose përkatësia seksuale, në pjesmarrjen e kriminalitetit, gjithashtu vështrohet në literaturë kriminologjike dhe interpretohet nga këndvështrime të ndryshme. Ekziston një përshtypje e përgjithshme, në bazë të të dhënave statistikore kriminale dhe praktikës gjyqësore, se kriminaliteti është dukuri tipike e gjinisë mashkullore. Sipas kërkimeve kriminologjike të bëra në shumë vende të botës në ShBA, Gjermani, Francë, Angli, Japoni, dhe vende të tjera, deri në kohë më të re, gjinia mashkullore, përkatësisht autorët e veprave kriminale të gjinisë mashkullore, kanë ndryshuar dukshëm ngase edhe femrat, gjithnjë e më tepër, po marrin pjesë në kryerjen e sjelljeve të llojllojshme kriminale.<sup>206</sup> Sipas disa të dhënave statistikore, nga literatura kriminologjike, në vendet e ndryshme, përqindja e pjesëmarrjes në kriminalitet të personave të gjinisë femrore, sillet nga 8-

<sup>205</sup>R.Gashi, "Ekzekutimi i Dënimit me Burgim në Shqipëri", Prishtinë 2001, fq.164.

<sup>206</sup>R.Halili, *Kriminologjia*, Prishtinë 2002, fq.128.

10% të të gjithë pjesëmarrësve. Mirëpo duhet theksuar se te disa sjellje kriminale dhe vepra penale pjesëmarrja e femrës është më e madhe. Karakteristika e kriminalitetit të femrave është edhe fakti se ato më tepër marrin pjesë në kryerjen e krimeve si ndihmëse, shtytëse e më pak si autore e drejtëpërdrejtë apo organizatore e krimeve të caktuara. Pjesëmarrjen e vogël të femrave në kriminalitet, disa autorë janë të prirur ta shpjegojnë dhe ta arsyetojnë me faktin se femra është një qenie biopsikike dhe biofizike më e ndjeshme, më e dobët në pikëpamje anatomiko-fizike etj.

Hulumtimi dhe studimi i kësaj teme tregon se në mesin e autorëve të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore më shumë marrin pjesë meshkujt. Nisur nga vendimet e gjykatave në lidhje me viktimat e trafikuar për veprën penale të trafikimit të femrave 100% e tyre janë të gjinisë femërore, ndërsa për veprën penale të trafikimit të njerëzve pjesën dërmuese të tyre e zënë meshkujt, kurse për veprën penale të trafikimit të të miturve numrin më të madhe të tyre e zënë personat e gjinisë mashkullore. Dihet mirëfilli se meshkujt janë më tepër të përfshirë në jetën shoqëro-ekonomike.<sup>207</sup>

Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike numri i përgjithshëm i gjinisë së autorëve.



Ne territorin e Republikës së Shqipërisë Gjyqësor Tiranë, personat e dënuar meshkuj dukshëm kanë marrë pjesë më shumë në kryerjen e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore se sa të dënuarat femra.

<sup>207</sup> R. Gashi, *Politika Ndëshkimore Ndaj Delikteve të Gjaku në Kosovë Gjatë periudhës 1980 – 1989, Prishtinë 2003*, fq.46.

### 2.3. Arsimi dhe kriminaliteti.

Arsimimi është një faktor me rëndësi në formimin dhe aftësimin e personalitetit të njeriut për jetë më të sigurtë dhe më të suksesshme. Një kohë të gjatë është menduar se arsimimi është një mjet i fuqishme për pengimin e sjelljeve devijante dhe kriminale.<sup>208</sup> Njeriu i arsimuar është më qartë për të dalluar të keqen nga e mira. Personat e arsimuar me vështërsi mund të bien në ndikime negative. Ata janë të pajisur me dije dhe informata të shumta dhe e kanë më lehtë të marrin qendrimet dhe sjellje pozitive. Për këtë arsye, është theksuar se, personat e arsimuar, gati gjithherë sillen në pajtim me normat ligjore dhe morale të një shoqërie. Autori i njohur Enriko Feri në hulumtimet dhe studimet e veta ka theksuar se kriminaliteti zvogëlohet në shoqëri krahas rritjes së shkallës së arsimimit të popullsisë. Në veçanti thekson se emancipimi dhe civilizimi i popullsisë ndikon në rënien e kriminalitetit.

Nga ana tjetër, personat e pa-arsimuar më vështirë integrohen në procese jetësore, atyre u mungon aftësia për t'i kuptuar dhe gjykuar drejt pasojat e veprimet e ndryshme, për çka ata nuk janë të aftë t'u bëjnë rezistencë nxitjeve dhe sprovave të ndryshme të ambjentit shoqëror.


Ne botën bashkëkohore, në kryerjen e disa sjelljeve kriminale po rritet pjesëmarrja e personave me arsim të lartë. Autorët e veprave penale të kriminalitetit ekonomik, kriminalitetit politik, kriminalitetit të organizuar, kriminalitetit të jakës bardhë dhe kriminalitetit profesional, në të shumtën e rasteve janë persona të arsimuar, persona të cilët kanë njohuri dhe përgatitje profesionale të gjithanshme ekonomike, financiare dhe politike. Këta persona kanë njohuri lidhur me sistemet e komplikuara teknike teknologjike. Nga kjo del se nuk mund të flitet në mënyrë të përgjithësuar që arsimimi pengon kriminalitetin apo e nxit atë. Për këtë arsye, ndikimin e arsimimit në sjelljet e ndryshme kriminale duhet shikuar nga aspekti relativ e jo të përgjithësohet ky faktor.

Gjatë hulumtimit të këtij punimi, të realizuar në institucionet e gjykatës dhe prokurorisë, është konstatuar se pjesa më e madhe e të dënuarëve janë me arsim 8-vjeçar. Nuk mund të bëhet një statistikë e saktë për arsimimin për shkak se në disa raste gjykata nuk ka marrë informacion për këtë karakteristikë të trafikantëve.

---

<sup>208</sup>R.Halili, vepra e cituar, fq.249.

Paraqitja në mënyrë grafike e përpunimit të të dhënave jep tablonë në mënyrë të qartë të arsimimit të autorëve dhe nëpërmjet kësaj paraqitje del në përqindje dhe në numër arsimimi i tyre.



Nisur nga grafiku për vitet 2001-2014, pjesa dërmuese e të dënuarve janë me arsim 8-vjeçar dhe të mesëm dhe një pjesë e vogël e tyre është pa arsim dhe me arsim fillor. Nga kjo që u tha më lartë rezulton se veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore kërkojnë autorë me nivel arsimor, ndryshe nga veprat e tjera penale. Shkaqet e këtij konstatimi janë trajtuar me hollësi në pjesët e këtij punimi.

#### 2.4. Gjendja martesore, statusi familjar dhe regjional.

Njohja me statusin martesor dhe familjar të personave të dënuar është me rëndësi të madhe në procesin e risocializimit të tyre. Kjo ndihmon në gjetjen e mjeteve dhe të metodave adekuate në zbatimin e tretmanit ndaj të dënuarve.<sup>209</sup> Kjo rrethanë është marrë parasysh edhe në rastin e ndarjes së të dënuarve brenda instituconeve.


Përhapja e veprave penale të trafikimit të qenive njerëzore në regjionet fshatare dallohet nga shpërndarja e tyre në regjionet e qyteteve dhe të qendrave urbane, si nga forma e paraqitjes, vëllimi, dinamika, dhe shkaqet e përhapjes së këtij lloj kriminaliteti. Në

<sup>209</sup> R.Gashi, vep.cit., fq.171.




hulumtimin e bërë për veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore gjatë periudhës së përmendur kohore del se numri i personave të dënuar është më i madh në regjionet qytetare, ndërsa në fshat pjesëmarrja është më e ulët.

Paraqitja grafike e mëposhtme jep të dhënat e plota në lidhje me statusin familjar dhe regional të autorëve të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore.



Ajo që vihet në dukje është se në territorin e Republikës së Shqipërisë autorët e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore janë persona të martuar dhe në numrin e përgjithshëm të tyre kapin shifrën 52, ndërsa 37 janë persona beqarë, 12 të divorcuar dhe për 44 persona gjykata nuk ka informacion. Një paraqitje e tillë si shkak kryesor ka varfërinë dhe papunësinë e këtyre persona që kryejne veprat penale të trafikimit.




Duke parë grafikun që është i bazuar në të dhënat e vendimeve të gjykatës, rezulton se personat me prejardhje regjionale nga qyteti kanë pjesëmarrje më të lartë në dukurinë e kriminalitetit të trafikimit të qenieve njerëzore, ndërsa ato me prejardhje regjionale nga fshati zënë vendin e dytë me 69 persona. Edhe këtu për një pjesë personash, gjykata nuk ka informacion. Ky konstatim ka të bëjë me faktin se kjo shtresë e popullsisë është më e angazhuar me vendet e destinacionit.

## 2.5. Statusi gjyqësor i autorëve.

Recidivizmi apo përsëritja e sjelljeve kriminale paraqet një formë të veçantë dhe të rrezikshme të manifestimit të kriminalitetit. Shikuar nga aspekti i recidivizmit, veprat penale të trafikimit të qenive njerëzore i përkasin kriminalitetit dytësor. Kjo ka të bëjë me faktin se ky lloj kriminaliteti është parashikuar në Kodin Penal për herë të parë në vitin 2001 dhe para viteve 1991 që ishte në fuqi sistemi socialist ky lloj kriminaliteti nuk njihet fare në vendin tonë.

Sipas të dhënave që jepen në vendimet e gjykatës del se, tek veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore numri i personave recidivist është në përqindje të vogël me numrin e personave që dënohen për herë të parë.

Paraqitja grafike e tyre do të sqarojë statusin gjyqësor të personave të dënuar të trafikimit të qenieve njerëzore në lidhje me periudhën e hulumtuar 2001 – 2014.



Nisur nga të dhënat e grafikut të mësipërm rezulton se autorët e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore janë me status gjyqësor të pa dënuar. Personat me status

gjqësor “të dënuar më parë” zënë përqindje më të vogël dhe konkretisht parë në të dhënat e grafikut janë gjithsej 21 persona, ndërsa pa të dhëna janë po aq, 21 persona.

## **2.6. Gjendja sociale, statusi social.**

Për një kohë të gjatë ka dominuar mendimi se kriminaliteti është karakteristikë për shtresat e ulëta, sidomos për kategorinë e punëtorëve dhe njerëzve të papunë dhe të varfër. Konstatimet janë bazuar në shënime mbi numrin e personave ndaj të cilëve janë bërë kallëzime penale, janë ngritur akuza ose janë dhënë dënime nga gjykata. Pjesëmarrja e punëtorëve dhe e personave me profesione të tjera të shtresave të ulëta dhe të mesme të popullsisë në kryerjen e krimeve, është më e madhe në shumë vende të botës. Mirëpo në dekadat e fundit rritje të vazhdueshme tregon edhe krimi të cilën e kryejnë personat që u përkasin shtresave dhe klasave më të larta, qarqeve afariste dhe atyre në pushtet. I ashtuquajturimi kriminaliteti i “jakës së bardhë” është vazhdimisht në rritje.

Në vendimet objekt hulumtimi rezulton se gjykata ka marrë informacion vetëm për një numër të vogël të autorëve për statusin social të tyre dhe në këto kushte nuk mund të arrihet në një përfundim të saktë.

## **3. Disa karakteristika të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.**

### **3.1. Moshë.**

Për sa i përket moshës së viktimave nga të dhënat që japin vendimet rezulton se moshë dominuese e tyre është 18 – 25 vjeç, ndërsa në vend të dytë janë grupmoshat 14 – 18 vjeç.

Nga këto, numri më i madh (41%) i përket moshës 20-25 vjeç. Ndërkohë, rreth 19% e tyre i përket intervalit të moshës 15 – 20 vjeçare, po kaq i përket intervalit të moshës 30 – 35 vjeçare, të moshës 25 – 30 vjeçare dhe mbi 35 vjeçare. Shumica e viktimave të trafikimit janë gra dhe vajza, me moshë mesatare rreth 21 vjeç.<sup>210</sup> Por, përveç këtyre të

---

<sup>210</sup> Shih: Valentina Leskaj & Edmond Dragoti & Theodhori Karaj & Fiona Thodhri, “*Shoqëria Shqipëtare përballë sfidave të trafikimit të grave dhe vajzave*”, Tiranë, 2004, fq. 18-19.

dhënave, nga studimet e bëra dhe intervistat e marra,<sup>211</sup> rezulton se në prostitucionin shqiptar janë përfshirë kryesisht vajza minorene të moshës 13-14 vjeç<sup>212</sup>.

Në raport analizën e vitit 2013 të Prokurorisë për Krime të Rënda evidentohet se numri i viktimave gjatë 3 mujorit të katërt është 9, nga të cilët 6 persona janë gra dhe 3 persona janë minorenë, dhe për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2013 numri i viktimave është 45, nga të cilët 31 janë gra dhe 14 janë minorenë. Kjo pjesëmarrje ka të bëjë me faktorët shtytës si papunësia, varfëria, mungesa e arsimit, diskriminimi gjinor dhe dhuna, por përveç këtyre faktorëve pozicionohen një sërë faktorësh tërheqës, që veçse rritin vulnerabilitetin dhe ndjeshmërinë e vajzave ndaj trafikantëve.

Në një studim të CAAHT të vitit 2008, rezulton se nga 4 Strehëzat e Koalicionit,<sup>213</sup> 17% e tyre janë nën 18 vjeç dhe pjesa më e madhe e tyre (68%), i përket grupmoshës 18 – 30 vjeç. Një gjetje e ngjashme rezulton edhe nga të dhënat e strehëzave “Vatra” dhe “Të Ndryshëm & të Barabartë”. 18% e viktimave të përfshira në studim, janë nën 18 vjeç (Vatra, 2006) dhe po në të njëjtën moshë rezulton rreth 20% e viktimave në studimin e “Të Ndryshëm & të Barabartë” (2006).<sup>214</sup>

---

<sup>211</sup> Studimi “Shoqëria Shqipëtare përball sfidave të trafikut të grave dhe vajzave”, i kryer nga Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin si dhe nga KEGME (shoqatë greke).

<sup>212</sup> 70% e të miturave nga zonat rurale mashtrohen pas fejesave dhe martesave jashtë shtetit, duke përfutur trafikantët në këtë mënyrë nga gjendja e vështirë ekonomike e tyre apo prejardhja dhe niveli kulturor i tyre.

<sup>213</sup> “Jetë dhe Shpresë” Gjirokastër, Qendra Psikosociale “Vatra”, Vlorë, “Të Ndryshëm & të Barabartë”, Tiranë dhe “Tjetër Vizion”, Elbasan.

<sup>214</sup> “Të Ndryshëm & të Barabartë” është organizatë shqiptare jofitimprurëse e krijuar në Maj të vitit 2004 që ofron shërbime ri-integruese për viktimatshqiptare të trafikimit. Qysh prej 2004, “Të Ndryshëm & të Barabartë” kontribuon në këto linja me:- Shërbime për riintegrimin e viktimave shqiptare të trafikimit dhe fëmijëve të tyre përfshirë shërbime rezidenciale dhe komunitare;- Aktivitete për lehtësimin dhe rritjen e aksesit të viktimave të trafikimit në shërbimet publike;- Ndërgjegjësim i komunitetit për pasojat e trafikimit dhe të drejtat e viktimave të trafikimit;- Aktivitete për vlerësimin e tregut formal të punës dhe rritjen e aksesit të viktimave në të; - Mbështetje financiare dhe teknike për gjenerim të ardhurash dhe vetëpunësim;- Trainime për OJF dhe institucione shtetërore;- Studime dhe vlerësime të procesit të reintegrimit të viktimave të trafikimit;- Pjesëmarrje në procesin e identifikimit të viktimave të trafikimit;- Informim dhe konsulencë teknike për hartimin e akteve ligjore e nënligjore për mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

### **3.2. Niveli arsimor.**

Viktimat e trafikimit për periudhën kohore të hulumtimit 2001-2014, rezultojnë të jenë me arsim të ulët<sup>215</sup>. Ndërsa numri i personave me arsim të mesëm e veçmas me atë të lartë është tejte i ulët.

Niveli arsimor mesatar i viktimave të trafikimit është ai tetë/nëntëvjeçar, ku afro 67% e tyre rezultojnë ta kenë përfunduar atë. Ndërkohë, 11% e viktimave rezultojnë mos ta kenë përfunduar shkollën tetë/nëntëvjeçare, duke e ndërprerë shkollimin në klasën e gjashtë apo të shtatë. Një numër i vogël viktimash (7.4%), shprehen se niveli më i lartë arsimor i tyre është ai fillor.

Në Raportin Vjetor 2007 të Qendrës Psikosociale “Vatra” thuhet se vetëm 40% e viktimave kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm tetë-vjeçar. Ndërsa, pjesa tjetër, ka një arsim nga 0 në 13 vjet. E njëjta gjetje shihet edhe në Raportin Vjetor (2007) të organizatës “Të Ndryshëm & të Barabartë”, ku 63 % e viktimave të asistuar gjatë këtij viti prej kësaj organizate kanë kryer arsimin tetëvjeçar.

Ndërkohë sipas studimit të CAAHT, 51 % e të gjitha viktimave, e kanë kryer arsimin e detyrueshëm, duke e lënë shkollën në moshën 14 vjeç.

### **3.3. Gjinia e viktimave.**

Si subjekte të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në të shumtën e rasteve paraqiten femra. Pas këtij grupi vendin e dytë e zënë personat e mitur që janë fëmijë meshkuj. Numri kaq i madh i pjesëmarrjes së femrave duhet shpjeguar nga disa faktorë. Seksi i referohet ndryshimeve biologjike midis burrit dhe gruas. Gjinia është roli i ndërtuar ose i krijuar në bazë të dallimit shoqëror midis burrit dhe gruas. Seksi biologjik përcakton detyrat, funksionet dhe rolet që gratë dhe burrat realizojnë në shoqëri dhe në jetën private. E parë në këtë këndvështrim, vepra penale e trafikimit të femrave për prostitucion ka përhapjen më të madhe dhe subjekte të viktimave të këtij trafiku janë personat e gjinisë femërore.

---

<sup>215</sup> Nga ana e gjykatës vetëm në disa raste jepen të dhëna për viktimat e trafikimit si moshë, regjioni, arsimit etj.

### **3.4. Statusi familjar dhe regjional i viktimave.**

Në periudhën kohore të hulumtimit 2001-2014, statusi familjar i viktimave të trafikimit është që, ata janë të pamartuara, ndërsa një pjesë e vogël e tyre janë të divorcuara. Numri kaq i madh i pjesëmarrjes së tyre ka faktorët e vet dhe këta kanë të bëjnë me mënyrat se si rekrutohen nga trafikantët dhe të tilla janë: ofertat për punë, studime, martesë, udhëtime jashtë shtetit, joshja për një jetë luksoze në perëndim, shpërblimet financiare etj.

Në statusin regjional të viktimave vendin e parë e zënë personat me banim në qytet, ndërsa personat me banim në fshat zënë përqindje më të vogël. Nga vëzhgimi i vendimeve të gjykatës del se viktimat rekrutohen nga qytetet e vegjël, qytetet që ndodhen në zonat më të varfëra dhe nga fshatrat e vegjël fushor. Viktimat janë më së shumti të papuna, të varfëra, rrjedhin nga familje me probleme dhe nuk njohin gjuhë të huaja.

## **Kapitulli V: Disa faktorë kriminogjenë të trafikimit të qenieve njerëzore gjatë periudhës 2001-2014.**

### **1. Etiologjia kriminale.**

Etiologjia kriminale si një nëndarje e kriminologjisë është një përpjekje me bazë analizash shkencore për studimin e shkaqeve dhe arsyeve të krimit.<sup>216</sup>

Etiologjia kriminale ose faktorët mbi kriminalitetin kanë të bëjnë me njohjen e burimeve, rrënjëve dhe rrethanave përcaktuese të kriminalitetit të trafikimit të qenieve njerëzore. Këto çështje i studion dhe i analizon etiologjia kriminale, e cila deri vonë është konsideruar si pjesë kryesore e kriminologjisë. Etiologjia kriminale ose faktorët kriminogjen, konsiderohet sektor me rëndësi në studimet dhe kërkimet mbi kriminalitetin e trafikimit të qenieve njerëzore. Etiologjia kriminale analizon dhe studion lidhjet shkakësore ndërmjet rrethanave dhe faktorëve të ndryshëm nga njëra anë dhe kriminalitetit të trafikimit të qenieve njerëzore nga ana tjetër.

Në këtë studim, përmes etiologjisë kriminale, janë studiuar dhe hulumtuar shkaqet dhe rrethanat që kanë të bëjnë me të gjitha sjelljet kriminale dhe dukuritë e tjera në shoqëri. Pra, fjala është për faktorët objektivë dhe subjektivë të cilët angazhohen për njohjen, përcaktimin dhe analizën e faktorëve, shkaqeve, burimeve dhe rrënjëve të dukurisë së kriminalitetit në një vend.

Trafikimi për shfrytëzim seksual mbetet kategoria më e gjërë që e përbën këtë krim, për arsyen e thjeshtë që ky shërbim gjithmonë do të gjenerojë të ardhurat më të mëdha për trafikantët. Ndërkohë që janë prezente forma të tjera të trafikimit me qëllim shfrytëzimin e punës, futjen në një agjenci kriminale dhe transplantimin e paligjshëm të organeve. Por, fakt mbetet që shfrytëzimi i një femre të re dhe i fëmijëve në industrinë e seksit të vendeve më të pasura, gjeneron shumë më tepër të holla se sa shfrytëzimi i qenieve njerëzore si skllëvër pune, apo se një pagese e njëhershme për heqjen e një organi.

---

<sup>216</sup> *Crime Theories, An introduction to Criminology*, [http://ekunwe.net/intro\\_criminology.htm](http://ekunwe.net/intro_criminology.htm)

## 1.1. Faktorët kriminogjenë.

### 1.1.1. Faktorët shtytës dhe tërheqës të trafikimit të qenieve njerëzore.<sup>217</sup>

Tri elementet që qëndrojnë prapa këtyre faktorëve mund të shprehen si më poshtë:

- Brenda vendeve të origjinës ka gjithmonë viktimë që përbëjnë bazën për procesin e shfrytëzimit.
- Brenda vendeve të destinacionit, tregjet e seksit që janë gjithmonë në rritje mbajnë lart kërkesën për shërbimet e viktimave.
- Rrjetet e organizuara kriminale kanë marrë nën kontroll këtë situatë ekonomike të “kërkesës dhe ofertës” dhe trafikojnë e shfrytëzojnë viktimat me qëllim nxjerrjen e përfitimeve të jashtëzakonshme personale.

### 1.1.2. Faktorët shtytës.

Ndër faktorët shtytës të trafikimit të qenieve njerëzore, përmendim:

- Varfëria;
- Mungesë e mundësive për të përmirësuar kushtet e jetës;
- Papunësia e lartë;
- Tregu i punës jo i hapur ndaj grave dhe diskriminimi gjinor;
- Diskriminimi etnik ose seksual;
- Abuzimi me anë të dhunës fizike dhe/ose psikologjike;
- Arratisja nga ndjekja penale;
- Arratisja nga dhunimi i të drejtave të tjera të njeriut;
- Kolaps i infrastrukturës sociale.

### 1.1.3. Faktorët tërheqës.

Lidhur me faktorët tërheqës të trafikimit të qenieve njerëzore, përmendim gjithashtu:

- Përmirësimi i standardit të jetës dhe i cilësisë së jetës;
- Akses më i mirë ndaj shkollimit të lartë;
- Diskriminim apo abuzim më i ulët;
- Aplikimi i standardeve minimale dhe i të drejtave individuale;
- Mundësi më të mira të punësimit;

---

<sup>217</sup>C. B. Bodin, *Krimi & Skllavërimi: Një ekspozë e trafikut të grave për prostitucion nga Shtetet e Reja të Pavarura, Global Survival Netëork, 1997, UNHCR 2000; Faktorët social-ekonomik faktorë të përfshirjes së grave moldave në prostitucion, trafikim dhe skllavërinë e seksit, UNHCR, 2001.*



- Kërkesa për punë me paga të kënaqshme dhe kushte punë më të mira;
- Kërkesa për shërbime të tregut seksual;
- Kërkesa për punonjës brenda tregut të industrisë së seksit dhe përfitime të larta në shkëmbim;
- Komunitetet e mirëvendosura të migracionit.

Faktorët shtytës dhe tërheqës të cituar më sipër, janë prezentë në të gjitha vendimet e formës së prerë të Gjykatës për Krime të Rënda në vitet 2001-2014. Disa prej këtyre vendimeve do të përmenden më poshtë në trajtimin e faktorëve objektivë dhe subjektivë të trafikimit të qenieve njerëzore.

## **2. Faktorët objektivë e subjektivë të trafikimit të qenieve njerëzore gjatë periudhës 2001-2014.**

### **2.1.Faktorët objektivë të trafikimit.**

Ndikim më të madh në paraqitjen e kriminalitetit të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore e kanë faktorët e jashtëm kriminogjenë.<sup>218</sup>

Mbështetur në vendimet gjyqësore të formës prerë për veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore për periudhën 2001 – 2014, rezulton se rolin kryesor e luajnë faktorët ekonomiko-shoqëror, më pas vijnë faktorët ideo-politik, faktorët mikro-grupor, ku rolin kryesor e luan familja si faktor kriminogjen. Nuk ngelen pa ndikim këtu edhe faktorët socio-patologjik të këtij lloj kriminaliteti.

Nga vëzhgimi dhe studimi i vendimeve të formës prerë, të dhëna nga gjykata del se, për veprat penale të trafikimit të personave faktori kryesor kriminogjen i pranishëm është **varfëria si rezultat i papunësisë**. Kjo duket qartë po t'i referohemi vendimit penal në ngarkim të të dënuarit E.A.<sup>219</sup> Ky i dënuar duke qenë emigrant në Shqipëri, bën të mundur njoftimin e dy shtetasve tunizianë të cilët duke u futur pa dokumenta nëpërmjet territorit të Kosovës në Shqipëri, dhe kundrejt shpërblimeve që do t'i jepnin të dënuarit, kishin si pikësynim mbërritjen e tyre në Itali. Personat e trafikuar nga i dënuari për shkak të varfërisë si dhe të faktit që ishin të papunë, i kishin vënë qëllim vetes që të shkonin për një jetë më të mirë në shtetin Italian. Nga ky vendim gjyqësor si dhe bazuar në vendime të tjera del se, vendet e ndryshme të botës karakterizohen nga kontradikta të

<sup>218</sup> R. Halili, *Kriminologjia*, Prishtinë, 2002, fq. 231.

<sup>219</sup> Për më tej shih: *Vendim nr. 587 të Gjykatës Rrethit Tiranë*, Qershor 2003.

mëdha. Në një anë ka transformime dhe arritje, vende të pasura dhe me standard të lartë, ndërsa në anën tjetër ka vende, shtete dhe rajone shumë të varfra, ku popullsia nuk ka mundësi të sigurojë as nevojat më elementare për ekzistencë, për ushqim, për veshmbathje apo kulm mbi krye.<sup>220</sup>

Një tjetër faktor që ndikon në përhapjen e këtij kriminaliteti, që siç u përmend është edhe familja dhe nënshtrimi i vazhdueshëm i grave, e cila trajtohet si faktor kriminogjen. Familjet fshatare, që në përgjithësi kanë shumë fëmijë, përballen me vështirësi të rënda ekonomike. Një ofertë për martesë dhe një jetë më e mirë jashtë vendit është potencialisht një mundësi për familjen që të përmirësojë gjendjen e saj ekonomike. Ideja që personat nën 18 vjeç, janë fëmijë që kanë të drejta, nuk zë vend në zonat fshatare. Është normale për fëmijët (veçanërisht në familje shumë të varfëra) që të punojnë që nga mosha 14 vjeç. Rezulton të ketë burra shqiptarë tek të tridhjetat, që kthehen nga jashtë për t'u martuar, dhe që duan vajza të reja gjashtëmbëdhjet vjeçare e jo gra më të moshuara me të cilat të martohen. Nëse vajza është mbi 19 vjeç, ajo nuk ka shanse për t'u martuar.<sup>221</sup> Një grua e intervistuar nga një fshat i Beratit rrëfëhet "Nuk ka asgjë për të bërë, as punë. Unë e kaloj pjesën më të madhe të ditës në shtëpi. Edhe qeni ka një jetë më të mirë se ne gratë".<sup>222</sup>

Gjykata e Shkallës Parë për Krime të Rënda, Tiranë, në pjesën arsyetuese të Vendimit nr.18, datë 23.03.2005, shprehet se i pandehuri H.K. njihet me të dëmtuarën e mitur M.H. gjatë kohës që kjo po kryente një kurs rrobaqepësie në Peshkopi. Në bisedën e bërë, ai i propozon për t'u fejuar, duke i thënë që ishte i ndarë nga gruaja me të cilën kishte patur edhe një fëmijë. E dëmtuara bie dakort dhe i thotë që ta kërkonte sipas zakonit në shtëpi në një fshat të Dibrës. Prindërit e të dëmtuarës në bisedë e sipër me të pandehurin bien dakort që vajza e tyre të fejohej me të. I pandehuri H.K., qëndron një muaj tek banesa e të dëmtuarës dhe pas kësaj kohe me dëshirën e prindërve të të "fejuarës" largohet në Tiranë tek banesa e tij që e kishte blerë. Pas qëndrimit disa ditë në Tiranë, i pandehuri H.K. i kërkon M.H. që të shkonte e të punonte në Itali si prostitutë. M.H. nuk i bindet dhe i pandehuri H.K. e kërcënon se do t'i vriste pjestarët e familjes. Pas këtyre veprimeve i pandehuri takon në Durrës një shok të tij dhe bien dakort për t'ja shitur këtij të fundit shtetasen M.H. në shumën 1.200.000 lireta. I

---

<sup>220</sup> R. Halili, vep. e cit., fq. 237.

<sup>221</sup> D. Renton, *Trafikimi i Fëmijëve në Shqipëri*, Mars 2001, fq. 22.

<sup>222</sup> D. Renton, vep. cit. po aty.

pandehuri B.S. e merr të dëmtuarën, ikën në Vlorë dhe pas qëndrimit një javor nisen me skaf për Itali, ku aty akomodohen në qytetin e Pizza-s. I pandehuri B.S. paguan të gjitha detyrimet tek skafistët. Në Pizza të Italisë e dëmtuara M.H. ushtron prostitucion për rreth gjashtë muaj në bashkëpunim me të pandehurin B.S. dhe me paratë e fituara shlyen borxhet që ja kishte të pandehurit dhe ndihmon familjen e saj. Pas kthimit nga Italia, e dëmtuara M.H., e detyruar nga opinioni që ishte krijuar për të, largohet nga Dibra bashkë me familjen e saj dhe vendoset në një shtëpi me qera në fshatin Sukth të Durrësit, me ndihmën e të pandehurit B.S.

Vlen për t'u theksuar se në përfundim të gjykimit të pandehurit H.K. dhe B.S. janë dënuar për veprën penale të "Trafikimit të femrave për prostitucion" parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal me nga 17 vjet burgim.<sup>223</sup>

**Mos interesimi** dhe në disa raste **bashkëpunimi në krim** i disa qeverive, është një tjetër problem shumë i madh. Shumë struktura të ligjit dhe qeverive, injorojnë rastet e viktimave të trafikimit dhe fshehin qëllimin e vërtetë të problemit të trafikimit. Në disa raste, policët dhe autoritetet e tjera shtetërore, pranojnë rryshfete dhe i ndihmojnë trafikantët duke iu shitur dokumenta false. Përveç kësaj, policët e thjeshtë shpesh frikësohen nga hakmarrja e kriminelëve, prandaj preferojnë të mohojnë apo fshehin të dhënat mbi trafikimin.

**Pozita gjeografike** e një vendi mund të jetë shumë favorizuese. Për shkak të pozitës së saj gjeografike, Shqipëria është vend origjine, tranziti dhe destinacioni. Shumë vajza shqiptare janë trafikuar në Greqi, Itali dhe vende të tjera. Në të njëjtën kohë, Shqipëria shërben edhe si vend tranzit për kalimin e grave dhe vajzave moldave apo bullgare, në Itali ose shtete të tjera të Europës Lindore, ndërkohë që një pjesë e tyre mbahen për të ushtruar profesionin edhe këtu.

**Dhuna në familje** është një tjetër faktor që stimulon trafikimin. Jetesa në familje të dhunshme, brenda të cilave mohohet ç'do e drejtë, ka nxitur shumë vajza dhe gra të largohen, sapo u është paraqitur rasti i parë për ta bërë një gjë të tillë. Por, nga ana tjetër edhe shumë baballarë ose bashkëshortë të dhunshëm, nuk kanë nguruar të detyrojnë vajzat dhe gratë e tyre të prostitutojnë, për të siguruar jetesën. Po kështu, pjesa më e madhe e fëmijëve të trafikuar, vijnë nga familje me probleme të mëdha sociale dhe janë

---

<sup>223</sup> Për më tej shih *Vendimin nr. 18 dhe nr. 39 akti, datë 23. 03. 2005*, Gjykata e Krimeve të Rënda.

kryesisht fëmijë të abuzuar, të neglizhuar apo jetim, pra një kontigjent lehtësisht i rekrutueshëm dhe i përdorshëm nga trafikantët.

**Mungesa e informacionit** krijon mundësi për rekrutimin me lehtësi të një sërë viktimash. Mungesa e informacionit mbi të drejtat që gëzojnë në vendet ku shkojnë apo mbi institucionet që mund t'iu ofrojnë ndihmë, nëse kanë nevojë, vështirëson shkëputjen e tyre nga rrjeti i trafikimit.

**Trafikimi si zgjidhje e vetme.** Ka gra dhe vajza të cilat, të detyruara nga kushte të caktuara, “zgjedhin” trafikimin me qëllim ushtrimin e prostitucionit, si mundësinë e vetme për të siguruar të ardhura për mbijetesë. Mes tyre, duhet dalluar edhe ajo kategori që preferon të ushtrojë këtë lloj profesioni, pasi u garanton të ardhura shumë të mira dhe u krijon kushtet e dëshiruara për jetesë.<sup>224</sup>

## 2.2. Faktorët subjektivë të trafikimit.

Dukuria e kriminalitetit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe shkaqet e saj, nuk mund të shpjegohen drejt dhe deri në fund pa analizën dhe ndriçimin e faktorëve të brendshëm, subjektivë, të cilët kanë të bëjnë me personalitetin e autorit të veprave penale.<sup>225</sup> Kur flitet për faktorët subjektivë, zakonisht mendohet për individin, për personalitetin e njeriut, në rastin konkret, të trafikuesit të qenieve njerëzore. Në këtë drejtim, posaçërisht theksohet roli dhe rëndësia e jetës së tij biopsikike dhe lidhjet e saj me sjelljet dhe veprimet kriminale. Pavarësisht nga zhvillimi dhe mënyra e funksionimit të faktorëve të brendshëm, rezulton se këto kanë ndikim në sjelljet kriminale të personave trafikues. Madje, studiues të fushës theksojnë se: “çfarëdo që të bëhet për të manaxhuar situatën, d.m.th. duke ndryshuar ligjet, duke prezantuar penalitete që nuk përfshijnë burgimin, duke ndryshuar metodat e lirimit me kusht, duke kriminalizuar apo dekriminalizuar veprime të caktuara, ose duke ndryshuar gjithë sistemin..., të gjitha këto vetëm mund të influencojnë në sjelljen..”<sup>226</sup>

---

<sup>224</sup> Në gjykimin e çështjes ndaj të pandehurve L.D., Z.D., E.V., akuzuar për kryerjen e veprës penale të trafikimit të femrave për prostitucion në bashkëpunim, Gjykata e Krimeve të Rënda, duke vlerësuar që kjo veprë është kryer në bashkëpunim, si dhe faktin që e dëmtuara M.R. ka parë trafikimin si zgjidhje të vetme për të përballuar situatën ekonomike, ka vendosur si masë dënimi për secilin nga të akuzuarit 18 vjet dhe për dy tjerët 15 vjet burgim. Vendimi nr.29, datë 6 Tetor 2004.

<sup>225</sup> R. Halili. vep. cit. fq. 321.

<sup>226</sup> H.J. Eyesenck, G. H. Gudjonsson, *The causes and cures of criminality*, Plenum Press, New York, 1991, fq.8.

Dy komponentët me rëndësi për zhvillimin dhe formimin e një personaliteti normal të njeriut janë baza psikike dhe biologjike. Pavarësisht nga zhvillimi, formimi dhe kultivimi i personalitetit gjatë jetës së personit trafikant, baza psikike ka ndikim dhe reflektohet në sjelljet dhe veprimet e tij.

### 2.2.1. Karakteri dhe sjellja kriminale e trafikantëve.

Karakterit si një ndër vetitë kryesore të personalitetit, konsiderohet si cilësi esenciale e tij.<sup>227</sup> Si elementë të karakterit, në literaturën psikologjike dhe kriminologjike konsiderohen: vullneti, qëndrueshmëria, vendosmëria, vazhdueshmëria, iniciativa, guximi, besnikëria, altruizmi, stabiliteti, siguria etj. Nga vëzhgimi dhe studimi i vendimeve të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe Gjykatës për Krime të Rënda të Republikës së Shqipërisë, rezulton se këto veti të karakterit nuk përmbushen nga personat që kanë kryer veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe konkretisht qëndrimi i tyre është negativ ndaj disa vlerave dhe rregullave morale të shoqërisë. Qëndrimi negativ i tyre shprehet ndaj shkeljes flagrante të të drejtave të njeriut të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë<sup>228</sup> dhe Konventat Ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.<sup>229</sup>

Trafikantët e dënuar kanë karakter të dobët dhe kjo duket qartë në arsyetimet e vendimeve të formës së prerë të gjykatës, ku këta të dënuar gënjejnë, nuk tregojnë të vërtetën dhe janë persona që u nënshtrohen motiveve e interesave të ulëta dhe lakmisë materiale. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në pjesën arsyetuese të Vendimit nr. 3, datë 18.01.2005 shprehet se:

*“E dëmtuara F.A., madhore, më datë 04.07.2003 ka bërë kallëzim penal ndaj të pandehurve H.A. dhe A.C. pasi në bashkëpunim me njeri tjetrin e kanë trafikuar atë me qëllim të shfrytëzimit për prostitucion në shtetin Italian. Kështu, i pandehuri A.A. ka patur marrëdhënie miqësie me familjen e shtetasës F.A., me të cilën rreth vitit 2001 ka biseduar për t’i prezantuar dikë për martesë. Në Shtator të vitit 2001, i pandehuri A.A. i propozon një lidhje martesore me një shok të tij të quajtur F. nga një fshat i Durrësit, i cili në të vërtetë ishte i pandehuri H.A., propozim të cilin e dëmtuara e pranon. Më pas i pandehuri bashkë me të dëmtuarën shkojnë me skaf në Itali duke u akomoduar në Breshia në shtëpinë e një të njohuri, dhe pasi bashkëjetojnë disa ditë, i pandehuri i kërkon që ajo të punonte si prostitutë. E dëmtuara pohon se ndaj saj është përdorur mashtrimi për të realizuar qëllimin dhe gjatë kohës së qëndrimit kishte fiksuar disa biseda telefonike ndërmjet të pandehurve, ku i pandehuri H.A. nuk ishte i kënaqur nga rekrutimi që i pandehuri A.C. kish bërë.*

<sup>227</sup> R. Halili. vep. cit. fq. 322.

<sup>228</sup> Kushtetuta e Republikës Shqipërisë, Pjesa e Dytë, “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut “, Nenet 15,16,17,18,19 e 20.

<sup>229</sup> Shembuj të disa vendimeve gjyqësore.

*E dëmtuara nuk pranoi të punonte si prostitutë për të pandehurin H.A. dhe ky i fundit, për faktin se ajo kishte disa vëllezër, me qëllim që të mos binte në hasmëri vendosi ta kthente në shtëpi në muajin Janar të vitit 2002.*

*Kallëzimin penal e dëmtuara e bën pasi familja e saj e dëbon nga shtëpia. Në përfundim të gjyqimit trupi gjykues i ka dënuar të pandehurit për veprën penale të trafikimit të femrave për prostitucion parashikuar nga Neni 114/b-2 të Kodit Penal me nga 17 vite burgim.”<sup>230</sup>*

Në lidhje me temperamentin e personave të dënuar, është vështirë të zbulohet se cilit tip i përkasin, pasi vendimet e gjykatave nuk japin asnjë të dhënë në pjesën arsyetuese lidhur me këtë veti. Mungesa e informacionit rreth kësaj vetie ka vënë në vështirësi institucionet e vuajtjes së dënimeve dhe konkretisht punonjësit sociologë, psikologë, edukatorë etj. në risocializimin dhe rehabilitimin e plotë të tyre.<sup>231</sup>

Për sa i përket inteligjencës së këtyre autorëve të veprave penale, nuk mund të dilet në ndonjë konkluzion të saktë pasi një pjesë e mirë e këtyre veprave është kryer në vitin 1997, në kushtet e inekzistencës së plotë të shtetit për t’u përballur me këta autorë, në kushtet e boshllëkut ligjor, si dhe mosdenoncimit të rasteve nga viktimat për shkak të frikës ndaj trafikantëve.

### *2.2.2. Motivet sociale.*

Si motive sociale karakterizohen të gjitha ato shtytje a nxitje dhe nevoja që nuk janë të lindura dhe që nuk janë të karakterit anatomiko-biologjik, por të cilat fitohen në procesin e zhvillimit, formimit, edukimit dhe përsosjes së individit në shoqëri.<sup>232</sup> Si motive më të rëndësishme sociale përmenden: motivi për shoqërim, motivi për afirmim, motivi i përfitimit, motivi i përqaimit të rregullave të ndryshme morale dhe shoqërore, motivi i sigurisë, motivi i frikës, motivi i agresivitetit etj. Ky lloj motivi është prezent në të gjitha vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës për Krime të Rënda të Republikës së Shqipërisë.

Në Vendimin nr. 3 të datës 28.04.2004, në pjesën arsyetuese gjykata shprehet:

*“I pandehuri D.I., është banor i qytetit të Elbasanit. Nëpërmjet premtimit për shpërblim, ai në muajt e fundit të vitit 1997, ka marrë pëlqimin e prindërve të të miturve Sh.Z. dhe A.Z, për shfrytëzim të tyre si lypsa në Greqi. I pandehuri, së bashku me dy të miturit merr edhe familjen e tij dhe shkon në Selanik të Greqisë, ilegalisht. Me të arritur atje, fillon të vërë në zbatim qëllimin e tij kriminal, për nxjerrjen e*

<sup>230</sup>Për më tej shih *Vendimin nr. 3 dhe nr. 4/22 Akti të Gjykatës Krimeve të Rënda*, dt. 18.01.2005.

<sup>231</sup> R.Gashi, *Ekzekutimi i Dënimit me Burgim në Shqipëri*, Prishtinë 2001, fq. 244.

Puna individuale e edukatorit me personat e dënuar konsiderohet një ndër metodat mjaft të rëndësishme në zbatimin e programit të tretmanit dhe të procesit të risocializimit ndaj personave të dënuar në institucionet për ekzekutimin e dënimit me burgim në shqipëri.

<sup>232</sup>R. Halili, *vepra e cit. fq. 336.*

*fitimeve nëpërmjet shfrytëzimit të të miturve Sh.Z. dhe A.Z. duke i nxjerrë në semaforë, stacionë autobusi, në afërsi të kishave etj. Ditët e diela fëmijët vendoseshin për të lypur në kishën e Selanikut që, sipas të dëmtuarve ishte më e madhja në atë qytet dhe quhej "Argjio Dhimitrio". Të dëmtuarit ishin të detyruar të lypnin lëmshë dhe të arrinin të mblidhnin një sasi të caktuar të hollash, në të kundërt i nënshtroheshin keqtrajtimit e dhunës së të pandehurit. Për të nxitur të dëmtuarit që të lypnin më shumë dhe për të justifikuar dhunën ndaj tyre, i pandehuri bënte sikur nxirrte në rrugë edhe djalin e tij, që thirrej "Keli". Të dëmtuarit punonin gjithë ditën nga mëngjesi deri në darkë dhe gjithë të ardhurat ja jepnin të pandehurit, ndërsa tek familjet e të dëmtuarve dërgonte rreth 20.000 lek në muaj. Të miturit bënë edhe punë të tjera si shitje kartopetash, larje tapetësh, shitje cigaresh etj".<sup>233</sup>*

Gjykata në arsyetimin e saj thotë se, i pandehuri me dashje direkte dhe me qëllim përfitimi material ka cënuar rëndë marrëdhënien juridiko-shoqërore për mirëritjen, edukimin dhe mos-shfrytëzimin e fëmijëve. Ai ka cënuar të drejtat e fëmijëve të mbrojtura posaçërisht nga ligji (Neni 128/b/2 i Kodit Penal), dhe nga neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.<sup>234</sup>

Në dhënien e vendimit përfundimtar gjykata përveç dënimit prej 18 vitesh burgim për veprën penale të trafikimit të fëmijëve, e ka dënuar të pandehurin edhe me 1.000.000 lek gjobë.<sup>235</sup>

---

<sup>233</sup> Për më tej shih *Vendimin nr.3 datë 28.04.2004* të Gjykatës së Krimeve të Rënda të R.Sh.

<sup>234</sup> - Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatëzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti.

- Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesë.

- Cdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij.

<sup>235</sup> *Kodi Penal i R.Sh.*, Neni 34, Dënimi me gjobë, Tetor 2004, Tiranë.

## **Kapitulli VI: Masat me qëllim luftimin dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore gjatë periudhës 2001 – 2014.**

### **1. Parandalimi i kriminalitetit.**

#### **1.1. Parandalimi i përgjithshëm dhe i veçantë.**

Lidhur me nocionin e parandalimit, ky i fundit trajtohet edhe si “filozofia e parandalimit” e cila drejton shkencën e kriminologjisë dhe politikës penale. Përkufizimi i parandalimit në tekstin e kriminologjisë së Prof. Dr. Vasilika Hysit, plotëson kërkesat themelore të këtij nocioni. Sipas përkufizimit të fjalorit të kriminologjisë “SAGE” me parandalim të kriminit kuptohet çdo veprim ose mjet që përdoret nga persona privatë ose organe shtetërore dhe agjensi që ka për qëllim të minimizojë dëmet që mund të shkaktojnë veprat penale.<sup>236</sup>

Krahas përkufizimit të nocionit të parandalimit të kriminalitetit, janë trajtuar edhe format apo llojet e parandalimit si parandalimi i përgjithshëm, që në përgjithësi lidhen me reformat që ndërmerr Këshilli i Ministrave dhe ministritë, si p.sh. me hapjen e vendeve të reja të punës nëpërmjet investimeve të shtetit apo të investitorëve të huaj, me anë të masave për të zbutur varfërinë dhe masave në kuadër të ndihmës sociale të familjeve e njerëzve në nevojë etj. Ndërmarrja e të gjitha këtyre masave është në kompetencë të organeve qendrore të administratës publike, e cila ka për detyrë hartimin dhe implementimin e reformave ekonomike–sociale. Gjithashtu, reformat në arsim, në kulturë, në sektorë të tjerë socialë siç është rritja e pagave, pensioneve, rritja e buxhetit për arsimin, shëndetësinë etj., të cilat në një masë ose tjetër ndikojnë drejtpërdrejtë apo tërthorazi në parandalimin e kriminalitetit, përsëri realizohen nga këto organe.

#### **1.2. Mjetet e parandalimit të kriminalitetit.**

##### **a) Zbatimi i ligjit.**

Problemi më shqetësues për shoqërinë, shtetasit dhe vetë shtetin është **moszbatimi i ligjeve** të tij. Kështu, rëndësi primare ka zbulimi dhe përcaktimi i shkaqeve e kushteve që favorizojnë moszbatimin e ligjeve. Në këtë kuadër kemi të bëjmë me faktorë objektivë dhe faktorë subjektivë, të cilët janë trajtuar tashme më sipër.

---

<sup>236</sup>V. Hysi, *Kriminologjia*, Tiranë 2010, fq.399.



Ndër shkaqet e kushtet për të siguruar zbatimin e ligjit janë p.sh. pajisja me mjetet e nevojshme, siguria e buxhetit të shtetit që kërkohet për zbatimin tij, ndërhyrjet politike të formave të ndryshme që pengojnë zbatimin e ligjit etj. Në Shqipëri ende nuk është organizuar si duhet informacioni për njohjen e ligjeve nga publiku apo zyrtarët që detyrohet ta zbatojnë. Vetëm fakti i botimit të ligjeve në Fletoren Zyrtare është krejtësisht i pamjaftueshëm. As informacioni që mund të jepet me internet ose mënyra të tjera nuk janë mjete efikase për njohjen e ligjeve nga publiku i gjerë. As shtypi dhe televizioni nuk plotësojnë minimumin e njohjes së ligjeve sepse kufizohen me dhënien e titujve, ose të ndonjë neni dhe jo kuptimin e vërtetë të tij.

Shoqatat e gjyqtarëve e prokurorëve mund t'i kushtojnë vëmendje të veçantë punës parandaluese të kriminalitetit. Natyrisht ato veprojnë nëpërmjet dënimit të autorëve të veprave penale dhe në këtë kuptim dënimi luan edhe rol parandalues për atë që dënohet që të mos kryejë veprë tjetër penale, e njëkohësisht parandalues edhe për të tjerë, që nga frika e dënimit penal të mos kryejnë vepra penale.

Politika ndëshkuese nënkupton zbatimin e sanksioneve penale ndaj personave fajtorë që në mënyrë efikase të goditen veprat penale që prekin interesat e vlerat e rëndësishme shoqërore e individuale dhe të arrihet risocializimi i personave të dënuar. Në varësi nga arritja e këtyre qëllimeve mund të gjykohet për strukturën e sanksioneve penale, për drejtësinë e zbatimit dhe ekzekutimin e domosdoshëm të politikës së drejtës ndëshkuese për çdo rast e person konkret.

Si përfundim del se pa organizuar mirë njohjen e ligjeve dhe marrjen e masave organizative e teknike – financiare për zbatimin e tyre, nuk mund të pritët që problemi i zbatimit të ligjeve të gjejë zgjidhje të kënaqshme.

Në kuadër të parandalimit, janë prezantuar edhe projekte të tjera dhe të një natyre tjetër. Kështu, “Raporto dhe Shpëto”, prezantohet si nisma e re kundër trafikut të qenieve njerëzore nga Ministria e Brendshme. Linja falas 116006 do të shërbejë si një dritare më shumë në luftën kundër kësaj dukurie. Në fjalën e tij Ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri tha se kjo linjë është një përpjekje në luftën tonë kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe theksoi se teknologjia është një mjet i mirë që duhet të shfrytëzohet për ta luftuar këtë lloj trafiku.

*“Ne po përdorim teknologjinë për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore. Raport- progresi ka vlerësuar pozitivisht hapat e ndërmarra nga qeveria në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Ne besojmë që me gjithë përpjekjet tona dhe hapat konkrete të hedhur në këto 8-9 muaj raporti do e nxjerrë Shqipërinë nga lista e vendeve në vëzhgim.”- u shpreh Ministri Tahiri.*

Më tej ai theksoi se:

*“Vetëm për vitin 2013 janë identifikuar 93 viktima të mundshme të trafikimit nga të cilat 43 fëmijë. Është marrë iniciativa që me ndryshimin e ligjit të përfshihet paketa shëndetësore falas për dy vjet për viktimat e trafikimit. Janë ngritur tre njësi lëvizëse me dy punonjës social për të identifikuar viktimat e mundshme të trafikimit, janë evidentuar 57 viktima të mundshme të trafikimit. Edhe linja falas edhe aplikacioni smartphone është një nismë e re. Trafikimi nuk mund të jetë vetëm një fenomen social, por është një fenomen kriminal”.*

Nga ana tjetër, dhe Ambasadori i SHBA-ve Alexander Arvizu, ka vlerësuar angazhimin e qeverisë për të luftuar këtë trafik:

*“Në këtë trafik nuk kemi vetëm statistika por njerëz të dëmtuar. Është e qartë që kjo qeveri po ndërmerr hapa të rëndësishëm. Kjo qeveri e ka marrë me seriozitet dhe po bën përpjekje. Besojmë se përmes angazhimit të plotë nga ana e Kryeministrit, Shqipëria do ia dalë mbanë. Veçanërisht ajo që ne presim të shohim është një bashkëpunim më i madh mes hetuesve, prokurorëve e qytetarëve në mënyrë që sa më shumë persona të mund të ndalohen e ndiqen penalisht për shkelje të ligjit”<sup>237</sup>*

#### b) Ndërgjegjësimi i qytetarëve.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në parandalimin e krimit është ndërgjegjësimi i qytetarëve nga sjelljet negative. Rritja e denoncimeve nga qytetarët do të shkaktojë parandalim të veprimeve kriminale. Këto janë praktika të ndjekura në Evropë e ShBA.

Një teori e njohur në kriminologjinë botërore që pasqyron rëndësinë e bashkëpunimit në shoqëri dhe dënimit të sjelljeve kriminale është dhe ajo e quajtur “teoria e xhamave të thyer”. Thelbi i kësaj teorie është se për të parandaluar veprime kriminale është e rëndësishme të goditet fenomeni që në origjinën e tij. Kjo teori u fut për herë të parë në kriminologji nga sociologët James Q. Eilson and George L. Kelling dhe sipas saj nëse kemi një ndërtesë me disa xhama të thyer dhe këto xhama nuk riparohen, pra nuk ndërrohen, tendenca për persona me prirje kriminale për të thyer më shumë është më e madhe.

Kjo teori e parandalimit të krimit është aplikuar me sukses në qytete të ndryshme si Neë York, mbas zgjedhjes së Kryetarit të Bashkisë Rudy Giuliani, i cili deklaroi zero tolerancë ndaj krimit në programin e tij; në Neë Meksiko; Hollandë etj.<sup>238</sup>

#### c) Parandalimi në kuadrin ligjor.

---

<sup>237</sup> <http://www.lajm-shqip.com/2014/06/raporto-dhe-shpeto-prezantohet-nisma-e-re-kunder-trafikut-te-genieve-njerezore-burimi-shekulli-com-www-shekulli-com-al/>, aksesuar mw 16.06.2014.

<sup>238</sup> Broken windows theory, [http://en.wikipedia.org/wiki/Broken\\_windows\\_theory](http://en.wikipedia.org/wiki/Broken_windows_theory).

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, rendin kushtetues, forcimin e konsolidimin e shtetit të së drejtës, nga veprat penale si dhe parandalimin e tyre, parashikohet nga Kushtetuta e R.SH.<sup>239</sup> Në këtë kuadër bëhet edhe parandalimi juridiko – penal, nëpërmjet parashikimit të veprave penale, duke krijuar vetëdijen te njerëzit se nuk ka krim pa u parashikuar në ligj (*nullum crime sine lege*). Kjo është garanci për lirinë e personit, por, njëkohësisht është edhe detyrim i shtetit për cilindo që kryen veprë penale të parashikuar nga ligji. Njëkohësisht rol parandalues luan edhe parimi tjetër i pasqyruar në Kodin Penal se “nuk ka dënim pa u parashikuar në ligj” (*nulla poena sine lege*), si dhe neni 24 që parashikon heqjen dorë nga kryerja e veprës penale.

Parandalimi i shërben edhe përjashtimit të të miturit nga dënimi si dhe ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji (Nenet 52 e 59 të KP). Rëndësi të veçantë në parandalimin juridiko – penal të veprave penale kanë pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim, masat ndaj të dënuarit të vënë në provë dhe masat e tjera alternative të dënimit me burgim (Nenet 59 – 65). Veç këtyre në këtë vështrim të parandalimit hyn edhe parashkrimi i ndjekjes penale dhe parashkrimi i ekzekutimit të dënimit (Nenet 66-68) si dhe falja e aministia (Nenet 70-71).

Dispozita të veçanta në pjesën e posaçme të Kodit Penal synojnë t'i parandalojnë pasojat e disa veprave penale dhe krime të tjera, siç janë psh. kanosja për vrasje (Neni 84), armëmbajtja pa leje (Neni 278) që synon të parandalojë krimin e vrasjes apo të plagosjes, drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt (Neni 291), që synon të parandalojë aksidentet rrugore, falsifikimi i dokumenteve (Neni 186) i cili synon përdorimin e këtyre dokumenteve për qëllime kriminale, përfitime të padrejtë etj.

Krahas Kodit Penal ka edhe ligje të tjera që ndihmojnë në parandalimin e kriminalitetit si Kodi i Proçedurës Penale, i cili rregullon veprimtarinë proçedurale të policisë gjyqësore, prokurorisë e të gjykatës, e cila synon në goditjen dhe parandalimin e veprave penale nëpërmjet zbulimit të tyre që në fazat e para të përgatitjes e në vazhdimësi.

d) Bashkëpunimi me qytetarët.

Aktualisht kjo detyrë është bërë prioritare dhe realizohet në forma e mënyra të ndryshme nga organet e policisë. Veçanërisht ky bashkëpunim e këto lidhje të policisë me qytetarët kanë dhënë rezultate në parandalimin e prodhimit, shpërndarjes, trafikimit,

---

<sup>239</sup>Kodi Penal i R.SH, Neni 1/b.

tregtimit të drogës brenda e jashtë vendit si dhe në parandalimin e veprave të tjera penale. Bashkëpunimi dhe lidhjet e organeve shtetërore me opinionin publik kërkojnë si kusht që të bëhen në forma të organizuara, sepse kështu japin rezultate më të mira. Por, kjo nuk duhet kufizuar në forma strikte, sepse edhe vetë iniciativa apo format spontane të qytetarëve për parandalimin e kryerjes së veprës penale është jo pak efikase.

e) Etapat proceduriale të hetimit.

Gjithashtu për parandalimin e kriminalitetit kanë rëndësi etapat duke filluar nga hetimi, kundërveprimi, bllokimi (ndërprerja) e veprimtarisë kriminale në fazën e tentativës ose të ardhjes së pasojës (psh. arrestimi në çast i personit që kryen veprën penale).

f) Ashpërsimi i dënimit penal dhe politika penale në përgjithësi.

Në këto rrethana kuptohet vetvetiu që, pa lënë në një anë parandalimin e krimit, është i domosdoshëm edhe ashpërsimi i dënimit penal kundër atyre krimeve që ndeshen më shpesh dhe prekin rëndë vlerat e rëndësishme shoqërore, si p.sh. vrasjet për hakmarrje e gjakmarrje apo trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike që kanë marrë përhapje të gjerë vitet e fundit.

Ashpërsimi i dënimeve penale jo gjithnjë sjell rezultatin e parandalimit.

Një studim i Institutit të Kriminologjisë të Universitetit të Kembrixhit arriti në përfundimin se: *“ashpërsimi i dënimeve rrallë herë bën të mundur rritjen e efekteve parandaluese të krimit”*. Në vazhdim, studimi pohonte se një njohje dhe kuptimi i drejtë i dënimit lidhej me uljen e shkallës së kriminalitetit.<sup>240</sup>

Daniel Nagin dhe Greg Pogarsky, studiues të parandalimit, arrijnë në përfundimin se *“siguria e dënimit çon në parandalimin e kriminaliteti më tepër se sa ashpërsia e dënimeve dhe pasojat ekstra ligjore të krimit janë një parandalues më i mirë se sa ato ligjore”*.<sup>241</sup>

Një seri tjetër studimesh kanë trajtuar edhe efektet e sigurisë publike në rastin e aplikimit të periudhave të gjata të burgimit.<sup>242</sup> Në teori, nga pikëpamja e parandalimit, sa më i ashpër të jetë dënimi, aq më pak ekziston mundësia që të dënuarit të kryejnë

---

<sup>240</sup> V. Wright, *Deterrence in Criminal Justice. Evaluating Certainty vs. Severity of Punishment*, Nëntor 2010, Research and Advocacy for reform.

<sup>241</sup> D. Nagin, G. Pogarsky, *“Integrating Celerity, Impulsivity, and Extralegal Sanction Threats into a Model of General Deterrence: Theory and Evidence,”* *Criminology*, 39(4), 2001.

<sup>242</sup> P. Gendreau, T. Little, C. Goggin, *“A Meta-Analysis of Adult Offender Recidivism: Èhat Èorks!”*, *Criminology*, 34 (3):575-607, 1996.

M. A. Levin *“Policy Evaluation and Recidivism,”* *Law and Society Review*, 6(1):17-46, 1971.

L. Song, R. Lieb, *“Recidivism: The Effect of Incarceration and Length of Time Served,”* Olympia, WA: Washington State Institute of Public Policy, 1993.

sërish krime. Një studim i vitit 1999 zhvilloi një analizë mbi 336,052 të dënuar për vepra të ndryshme penale. U konkludua se dënimet më të gjata me burgim lidheshin me një rritje prej 3% të recidivizmit. Të dënuarit që kalonin një mesatare prej 30 muajsh në burg kishin një shkallë recidivizmi prej 29%, krahasuar me shkallën 26% të të burgosurve që ishin dënuar me një mesatare prej 12.9%. Autorët vlerësuan gjithashtu ndikimin që kishte dënimi me burgim me dënimin alternativ. Dënimi me burgim sillte një rritje prej 7% të recidivizmit në krahasim me dënimin alternativ.<sup>243</sup>

## **2. Aktorët që ndikojnë në parandalimin e kriminalitetit.**

Ndërmarrja e masave për parandalimin e veçantë është në dorë të të gjitha organeve shtetërore, nga ato qendrore deri tek ato vendore.

a) Bashkitë e qyteteve, kryetarët e komunave.

Mund të japin kontributin e tyre kryetarët e komunave në territorin e juridiksionit të tyre, drejtpërdrejtë ose nëpërmjet pleqësive të fshatrave.

b) Parandalimi nga policia.

Në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit, rol të madh dhe përgjegjësi të drejtpërdrejtë kanë organet e rendit – policia e shtetit me gjithë komponentët përbërës të saj. Në kuadrin e reformave të sistemit të institucioneve shtetërore, edhe reforma në polici është realizuar si përsa i përket modelit ashtu edhe standarteve të policimit për sigurinë e qytetarëve.

Të dhënat tregojnë se pavarësisht nga disa rezultate pozitive, mbetet shumë për të bërë që të rritet efektiviteti i policisë në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit.

Strategjia e miratuar për bashkëpunimin dhe bashkëveprimin polici – komunitet kundër kriminit është platformë që siguron mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, sigurinë e rendin në Shqipëri.

c) Parandalimi nga prokuroria.

Roli dhe përgjegjësia e prokurorisë në parandalimin e kriminalitetit buron nga statusi juridik që ajo ka në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit organik të saj.

Gjatë ushtrimit të funksionit të saj, prokuroria nga njohja e rrethanave, shkaqeve, kushteve që kanë çuar në kryerjen e veprës penale, gjatë hetimit të kontrollit të çështjeve

---

<sup>243</sup> P.Gendreau, C. Goggin, F. T. Cullen, “*The Effects of Prison Sentences on Recidivism*” Ottawa, Ontario, Canada: *Public Works and Government Services Canada*, 1999.

konkrete penale, ka të gjitha mundësitë të nxjerrë konkluzione edhe për marrjen e masave parandaluese nga ajo vetë dhe organet e tjera që të mos ndodhë veprë penale tjetër, që të izolohet ose parandalohet personi, i cili është futur në rrugën e krimit për të mos kryer veprë penale. Ligji e detyron Prokurorinë për marrjen e masave parandaluese, por praktika e përditshme i jep prioritet ndjekjes penale dhe jo parandalimit, edhe pse qëllimi kryesor duhet të jetë parandalimi i krimit dhe jo dënimi penal, i cili duhet të konsiderohet si mjete i fundit.

d) Parandalimi nga gjykata.

Detyra për parandalimin e kriminalitetit shtrihet edhe për gjykatat, të cilat nuk janë vetëm për të gjykuar e dënuar autorët e veprave penale, por nga studimi dhe njohja me materialet e dosjes, nga dëgjimi në seancë gjyqësore i të pandehurit, dëshmitarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në proces, mund të dalin me konkluzione e rekomandime për organet shtetërore që të marrin masa parandaluese për grupe veprash penale ose për vepra penale të veçanta.

Në tabelën e mëposhtme jepen masa e dënimit të dhëna nga ana e gjykatës për trafikantët e të gjitha veprave penale objekt hulumtimi për periudhën kohore 2006-2014.

<b>Dënimet e dhëna nga gjykata në vjet burg</b>	4-10 vjet burgim	11-18 vjet burgim	Mbi 18 vjet burgim	Pafajësi, pushim
<b>Nr. i personave</b>	27	33	3	3

Siç shihet nga ana e Gjykatës për Krime të Rënda është ndjekur një politikë e ashpër dënimi për trafikantët dhe konkretisht masat e dënimit të dhëna në numrin e përgjithshëm të tyre janë nga 11 deri në 18 vjet burgim.

Në këto aksione rol parësor ka patur edhe bashkëpunimi i organeve tona me organet respektive të shteteve fqinje, sidomos ato të Italisë e Greqisë.

### 3. Masat preventive (parandaluese) të trafikimit.

Marrja e masave preventive është një ndër elementët kryesor në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo luftë do të ishte e efektshme në qoftëse do të shtrihej si në planin kombëtar ashtu dhe atë ndërkombëtar. Formimi dhe vlerësimi i një politike antitrafikim varet me së shumti nga një konsensus ndërkombëtar. Ky konsensus shprehet nëpërmjet një morie të tërë dokumentash ndërkombëtare, nga të cilat më të rëndësishme janë Konventat, Protokollet, Vendimet apo Rekomandimet që trajtojnë drejtëpërdrejt trafikimin e qenieve njerëzore etj., të cilat janë trajtuar në pjesën e parë.

Të gjitha këto instrumenta ndërkombëtare shprehin një proces zhvillimi drejt politikave anti-trafikim që përqëndrohen mbi të drejtat e njeriut. Ky është veçanërisht rasti i UN-TrafProt, i cili hedh baza të forta për një legjislacion dhe politika të duhura në lidhje me të drejtat e viktimave të trafikimit.

Megjithatë, sanksionet kundër trafikimit të presonave duhet të kenë një fuqi frenuese dhe të pasqyrojnë natyrën serioze të krimit, dhe të dhunimeve të të drejtave të njeriut. Kriminalistët mendojnë se dënimi ka – përveç një funksioni parandalues specifik dhe që konsiston në neutralizimin e fajtorit për periudhën që zgjat sanksioni penal – edhe, e mbi të gjitha, një funksion parandalues të përgjithshëm, d.m.th. që u drejtohet të gjithë pjesëtarëve të tjerë të komunitetit të cilët në këtë mënyrë shtrëngohen të heqin dorë nga kryerja e ndonjë krimi kur shohin se reagimi, nga ana e autoriteteve, është rezultativ, i sigurtë dhe mbi të gjitha i shpejtë.<sup>244</sup>

Udhëzimet e rekomanduara, të botuar nga UNHCR i këshillojnë shtetet që të konsiderojnë: “formulimin e dispozitave legjislative për dënime kriminale efektive dhe proporcionale (duke përfshirë dënimet në mbajtje nën arrest deri në ekstradim të individëve). Atje ku është e domosdoshme, legjislacioni duhet të parashikojë penalitete të tjera që duhet të zbatohen për personat e gjetur fajtorë për krimin e trafikimit në rrethana të rënduara, përfshirë veprat penale që kanë të bëjnë me trafikimin e fëmijëve apo veprat e kryera nga nëpunësit zyrtarë apo ato ku këto nëpunës kanë ofruar bashkëpunimin e tyre”.<sup>245</sup>

---

<sup>244</sup> Criminal Justice I, pergatitur nga N. Lettieri dhe A. Serafini. “Programi kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në Europën Jug – Lindore”, Tiranë, Mars 2002.

<sup>245</sup> UN Principles and Guidelines, Guideline 4. 3, fq. 8.

Është shumë e rëndësishme që në vijim viktimat të trajtohen me respekt dhe ndjeshmëri, dhe jo të dënohen për ndonjë shkelje të vogël të rregullave.<sup>246</sup> Vetëm kështu do të inkurajohen viktimat që të ofrojnë mbështetjen e tyre në procesin e ndjekjes penale të trafikantëve.

Si një shembull shumë i spikatur, vlen për t'u përmendur politika belge kunder trafikimit. Që në fillim të viteve 1990, Belgjika ngriti një strukturë, e cila mundësonte një përafrim ndaj problemit qoftë në nivel federativ, qoftë në nivel vendor. Kjo politikë fillonte me një plan veprimi qeveritar i cili angazhonte për bashkëpunim një numër departamentesh federale, kryesisht Departamentin e Drejtësisë (duke përfshirë magistraturën), atë të Punëve të Jashtme (duke përfshirë postet diplomatike dhe konsullore), të Punëve të Brendshme (duke përfshirë Zyrën e të Huajve dhe Policinë Federale), të Punës dhe të Punësimit, të Çështjeve Sociale dhe departamentet e Inspektimit Social dhe të Punës. Një Task Forcë mbi trafikimin e personave, e krijuar brenda zyrës së Kryeministrit, hartoi udhëzimet konkrete për bashkëpunimin midis departamenteve dhe shërbimeve të ndryshme të përmendura më lartë, si dhe me organizata e tjera belge që janë partnere të tyre në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Departamentit Federal të Drejtësisë i'u caktua detyra e sigurimit që të gjitha veprimet e ndërmarra brenda departamenteve të ndryshme të përputhen dhe të respektojnë planin qeveritar të masave.

### **3.1. Parandalimi parësor dhe dytësor.**

“Parandalimi parësor” synon të identifikojë situatat në një shkallë të gjerë, p.sh. duke adresuar grupet e riskut në një etapë më të hershme, ndërsa termi “parandalim dytësor” i referohet situatave të rreziqeve shumë të mundshme, por përpara se të kryhet një krim.

Në bazë të nenit 9, paragrafi 2 i Protokollit të Trafikimit, shtetet palë:

*“do të përpiqen të ndërmarrin masa të tilla si, të bëjnë kërkime, të mbledhin informacion dhe të bëjnë fushata nepërmjet medias masive dhe të ndërmarrin nisma sociale dhe ekonomike për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e njerëzve.”*

---

<sup>246</sup>Legjislacioni penal shqiptar nuk ka ndonje dispozitë që të përjashtojë viktimat e trafikimit nga ndjekja penale. Edhe nga vendimi nr.485, date 24.09.2001 i Kolegjit Penal të Gjykatës Lartë, të cituar më poshtë rezultojnë fakti i tillë; Gjykata e Rrethit Kukës, me Vendimin nr.53, datë 27.8.2001 ka vendosur: Të vleftësojë të ligjshëm arrestimin në flagrance të të pandehurve F.D, H.V e N.P dhe caktimin ndaj tyre masën e sigurimit “arrest në burg”. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs e pandehura N.P, e cila këkon shfuqizimin e vendimit dhe lirin e menjëhershëm nga paraburgimi. Kolegji Penal i Gjykatës Lartë e ka miratuar këtë masë sigurimi.



Ndër të tjera kjo kërkon të ndërtohen programe për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi risqet e trafikimit. Një përafrim i tillë mund të jetë i suksesshëm, nëse realizohet në një mënyrë informative dhe jo patronizuese. Fushatat informative duhet të synojnë që t'u ofrojnë personave që kërkojnë të emigrojnë, informacione të sakta në mënyrë që t'u jepet atyre mundësi që të marrin vendime mbi bazën e informacioneve të duhura. Informacioni, gjithashtu, duhet t'u jepet mbi adresat referencë në vendet e destinacionit që ofrojnë shërbime në ndihmë të emigrantëve.<sup>247</sup>

Masat parësore parandaluese duhet të luftojnë pozicionin delikat social dhe ekonomik të personave ndaj trafikimit. Neni 9 i UN-TrafProt u kërkon shteteve palë të:

*“marrin ose përforcojnë masat, duke përfshirë bashkëpunim dypalësh apo shumëpalësh, për të lehtësuar faktorët që i bëjnë njerëzit, veçanërisht gratë dhe fëmijët, të mbeten të zbuluar ndaj trafikimit, varfërisë, mos zhvillimit dhe mungesës së mundësive të barabarta”.*

Neni 9 i UN-TrafProt i nxit shtetet palë që të hartojnë ose të përforcojnë masat legjislative dhe masa të tjera, si p.sh. ato arsimore, sociale ose kulturore, që *“të dekurajojë kërkesën që është në themel të të gjitha formave të shfrytëzimit të njerëzve, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve, e që të çon në trafikim”*. Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara mbi të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin Njerëzor, të nxjerra nga Komisioneri i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut përmbajnë parimin sipas të cilit *“strategjitë që kanë për synim parandalimin e trafikimit duhet të kenë në qendër të tyre rrënjët e shkakut të trafikimit”*.

### **3.2. Parandalimi shoqëror i trafikimit.**

Zhvillimi i dimensionit social preventiv në kuadër të luftës kundër kriminalitetit është kushtëzuar nga rrethanat, sikurse që është thënë se lufta penalo-juridike nuk mund të jetë formë e kënaqshme në këtë proces. Mosefikasiteti në luftimin e kriminalitetit, në një pjesë të madhe e ka shkakun e vet në faktin se kjo e vërtete ende nuk po kuptohet sa duhet. Për këtë arsye mendimi politik kriminal, kohëve të fundit orientohet gjithnjë e më tepër në funksionin dhe risocializimin preventiv social për delikuentët duke konsideruar se në këtë pikë qëndron thelbi i zgjidhjes së kësaj dukurie shoqërore. Këtu është fjala për krijimin dhe zhvillimin e kushteve të atilla shoqërore, të cilat e eliminojnë gjithnjë e më tepër mundësinë e socializimit negativ të personalitetit e me këtë kufizohen edhe

---

<sup>247</sup>CCEM (2002) 80: *Perspectives on trafficking in human being*.

sjelljet e rrezikshme shoqërore brenda një vëllimi më të vogël dhe një rrethi më të ngushtë. Kështu, shoqëria sipas parashikimeve tona, do të mund t'i përballojë më lehtë, pa dhimbje dhe me sukses kushtet e atilla të zhvilluara. Kjo është fushata e të ashtuquajturit prevencion shoqëror, i cili imponohet parë në perspektivë si formë gjithnjë e më e rëndësishme dhe më e domosdoshme e luftës kundër sjelljeve të përmendura, dhe rrjedhimisht i kushtohet kujdes më i madh në politikën kriminale bashkëkohore.

Në pajtim me këtë orientim, disa autorë theksojnë me të drejtë se prevencioni është bërë një nga “bregat e mëdha” të teorisë dhe praktikës bashkëkohore kriminale. Ky prevencion shoqëror shfaqet në kuadër të dy drejtimeve:

1. I pari qëndron në pengimin e ndikimeve negative e kriminogjene që janë të ndërlidhura me mjedisin shoqëror ose me personalitetin e individit dhe do të mund të bëjnë ose rrisin formimin negativ të personalitetit dhe ta kushtëzojnë paraqitjen e ardhshme të kriminalitetit, po qe se ai nuk luftohet apo ngushtohet.
2. Drejtimi i dytë i këtij prevencioni ka të bëjë me delikuentët ekzistues, të cilët duhen risocializuar dhe aftësuar nëpërmjet zbatimit të trajtimeve të pershtatshme në çdo aspekt për jetën dhe rifutjen normale në shoqëri. Mirëpo, përmirësimi dhe riedukimi i këtyre personave trajtohet në kuadër të penalogjisë si disiplinë e posaçme praktike dhe teorike mbi trajtimin dhe risocializimin, kështu që këtu nuk është ndalur shumë.

### **3.3. Parandalimi juridiko-penal.**

Përveç parandalimit, i cili ka karakter shoqëror në kuptimin e gjerë të fjalës, është edhe prevencioni juridiko-penal, i cili ka për detyrë të parandalojë shkeljen e normave penale nga ana e individëve të caktuar. Format dhe llojet e aktiviteteve preventive janë një fushë e veprimit teorik, politik dhe praktik që synon drejt kufizimit dhe parandalimit të faktorëve social negativ prezentë në grupe dhe individë të ekspozuar ndaj një formimi negativ në një mjedis të caktuar socio-kulturor. Qëllimi është luftimi i kriminalitetit me ndihmën e luftimit të shkaqeve, kushteve dhe rrethanave të tjera të volitshme, të cilat shkojnë në dobi të sjelljeve negative shoqërore. Për këtë formë të prevencionit që është e ndërlidhur me luftimin e ndikimeve kriminogjeneë dhe me krijimin e kushteve të cilat fusin në veprim formimin negativ të personalitetit, disa autorë përdorin edhe termin “profilaksia”, e cila do të duhej të shndërrohej në shprehjen sinonime për këtë formë të

prevencionit. Të tjerët, ndërkaq, përdorin terma të tjerë si parandalimi, luftimi, prevencioni, profilaksia etj., që kryesisht kanë të bëjnë me të gjitha format e prevencionit në kuptimin e gjerë dhe të ngushtë. Por ka edhe nga ata autorë që bëjnë dallime ndërmjet termit “prevencion” dhe “profilaksi”. Prevencioni ka të bëjë, sipas tyre, me aplikimin e masave, me ndihmën e të cilave ndalohen persona të caktuar të kryejnë vepra penale. Këto janë terma sinonime dhe nuk ka arsye të bëhen dallime ndërmjet tyre, sepse veprimi ndaj personave të caktuar që të mos kryejnë vepra penale, në masë të madhe është i ngjashëm me veprimin e shkaqeve, “të cilat e kanë nxitur marrjen e vendimit për kryerjen e sjelljes kriminale”. Më konkretisht, për nga esenca e çështjeve, të gjitha këto janë shprehje sinonime, prandaj nuk do të duhej të bëheshin dallime të mëdha ndërmjet tyre apo shqyrtime të tjera teorike.

Në bazë të shqyrtimit të deritanishëm, do të mund të arrihej në konkluzionin se sistemi i prevencionit social, përkatësisht politika dhe praktika e tij, ndërtohen në bazë të njohurive dhe mënjanimit të determinantëve socialë të sjelljeve të inkriminuara. Ky drejtim i prevencionit ka përmbajtje dhe orientim tjetër shoqëror për përmbushjen e qëllimit. Ai është shumë më i gjerë se metodat juridiko-penale, pasi fut shumë forma të luftës sociale, ekonomike, ideore, politike e organizative, të cilat do të duhej të bëheshin prodominante dhe vendimtare në fushën e luftës dhe në parandalimin e sjelljeve të rrezikshme shoqërore.

Politika kriminale pra, përfshin dy fusha të parandalimit: fushën juridiko-penale dhe fushën e parandalimit të përgjithshëm social.

#### **4. Kuptimi i masave të luftimit të trafikimit të qenieve njerëzore; Llojet e masave me qëllim luftimin dhe parandalimit e trafikimit të qenieve njerëzore gjatë periudhës 2001 – 2014.**

Krimi i trafikimit është një shkelje e rëndë e të drejtave të viktimave të tij dhe detyra e zbatueseve të ligjit është që të luftojnë trafikimin me anë të vënies në zbatim të masave kundër këtij krimi. Një nga shkencat që heton tërë veprimtarinë represive dhe preventive me qëllim luftimin e kriminalitetit është kriminalistika. Kriminalistika preventive përsos metodat e mjeteve ekzistuese dhe gjen ato të reja të prevenimit

kriminalistik, ndërsa kriminalistika represive është e lidhur ngushtë me shkencën e procedurës penale.<sup>248</sup>

Është roli dhe detyra e punonjësve të policisë që të mbrojnë dhe mbështesin anëtarët më të prekshëm të shoqërisë dhe ata duhet të jenë në frontin e parë të veprimtarisë kundër trafikimit.

Para se të marrim në shqyrtim mënyrat më efektive me anë të të cilave policia mund të kontribuojë për këtë, është e rëndësishme që policët të kuptojnë dhe të veprojnë në përputhje me parimet e ruajtjes së demokracisë.<sup>249</sup>

Lufta kundër kriminalitetit të trafikimit të qenieve njerëzore do t'ia arrijë qëllimit të saj vetëm atëherë kur të njihen mirë karakteristikat e tyre etiologjike, fenomenologjike dhe karakteristika të tjera në mjedisin e caktuar ku këto vepra janë të përhapura. Që të mund të ndërmerret aksioni efikas shoqëror, është i domosdoshëm depërtimi njohës në karakterin e rrënjës, shkakut dhe kushteve të kriminalitetit me suazat e dhëna kohore dhe hapësinore.<sup>250</sup> Evolucionin historik të shoqërisë njerëzore ka nxjerrë në pah mënyra, mjete dhe forma të ndryshme të luftimit dhe parandalimit të kriminalitetit. Një ndër masat e rëndësishme për luftimin e kriminalitetit dhe të sjelljeve të tjera devijante janë sanksionet penale, të cilat dallohen për nga karakteri i tyre shtrëngues dhe represiv.<sup>251</sup> Politika e luftimit të kriminalitetit supozon dhe kërkon ndihmën e mendimit bashkëkohor shkencor të cilat do të shërbejnë si bazë për luftën kundër kriminalitetit të trafikimit të qenieve njerëzore. Lidhur me veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore nuk ka hulumtime të karakterit etiologjik dhe fenomenologjik të mëparshëm, me përjashtim të disa monitorimeve. Këto hulumtime, do të shërbenin që masat me qëllim luftimin dhe parandalimin e veprave penale të trajtoheshin mbi bazën e këtyre karakteristikave.

Megjithatë duhet theksuar se bazuar në standartet ndërkombëtare, dispozitat e Kodit Penal, praktikat gjyqësore dhe të dhënat e OJQ-ve, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një sërë masash në luftimin dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, duke përfshirë këtu dhe strategjitë përkatëse.

---

<sup>248</sup> V. Latifi, *Kriminalistika*, Prishtinë 2001, fq.5.

<sup>249</sup> Shndërrimi i policisë nga forcat policore në shërbim policor është një aspekt themelor për zhvillimin dhe forcimin e shoqërisë demokratike. Marrë nga revista Të drejtat e njeriut, nr. 3, Tiranë, 2002, fq.105

<sup>250</sup> V. Latifi, *PolitikaKriminale*, Prishtinë 2003, fq.219.

<sup>251</sup> R. Gashi, *Politika Ndëshkimore ndaj Delikteve të Gjaku në Kosovë Gjatë Periudhës 1980 – 1989*, Prishtinë 2003, fq.61.

#### **4.1. Korniza Ligjore Kombëtare.**

##### **a) Ligji Kombëtar.**

Legjislacioni Shqiptar Kundër Trafikimit është miratuar me qëllimin e përballjes me fenomenin. Konkretisht kjo është parashikuar në Ligjin nr.8733, datë 24 Janar 2001 ku specifikohen veprat penale “trafikimi i qënieve njerëzore, trafikimi i grave për prostitucion, trafikimi i fëmijëve”. Sipas ligjit dënimi për trafikimin është rritur dhe një përkufizimi i ri i trafikimit, bazuar në përkufizimin e Protokollit të Palermos, është realizuar.

Që nga Qershori 2001, sipas Legjislacionit Shqiptar, të gjithë personat e trafikuar, gra dhe fëmijë, konsiderohen si viktima të trafikimit dhe nuk dënohen, edhe në rastet kur kanë kryer një veprim kriminal lidhur me të qënurit i trafikuar si: prostitucioni, kalimi ilegal i kufijve, etj. Që nga kjo periudhë, një numër grash dhe fëmijësh të trafikuar janë ndihmuar të arratisen dhe asnjëri prej tyre nuk është gjykuar në mënyrë kriminale. Në kuadër të ndryshimeve që i janë bërë legjislacionit, me qëllim parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, Këshilli i Ministrave ka aprovuar amendamente Nenit 298 të Kodit Penal, që të përballet në mënyrë më efektive me trafikimin e qënieve njerëzore. Gjithashtu është aprovuar edhe Moratoriumi për Mjetet e Lundrimit, me qëllim organizmin e operacionit “Deti i Qetë”.

##### **b) Marrëveshje Bilaterale/Rajonale.**

Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje për ripranimin e personave dhe lejimin e kalimit tranzit, me këto shtete: Republikën e Italisë, më 11.09.1997; Këshillin FederalZvicerian, më 02.02.2000; Republikën e Hungarisë, më 20.03.2001; Mbretërinë e Belgjikës, më 17.04.2002; Republikën e Bullgarisë, më 07.06.2002; Republikën e Rumanisë, më 07.06.2002; Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, më 15.10.2003 (Hyri në fuqi më 16.08.2005); Republikën e Kroacisë, më 28.01.2003 (hyri në fuqi më 15.06.2005) dhe Këshillin e Evropës, më 14.04.2005. Një marrëveshje është nënshkruar, më 27.02.2006, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktima të trafikimit. Protokollin i Zbatimit të Marrëveshjes së BE-së me Shtetet e Beneluksit (Belgjika, Luksemburgu, Holanda), është nënshkruar më 09.06.2005. Marrëveshja midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit

Federal Zvicerian, mbi bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit është nënshkruar gjithashtu më 21.09.2005.

Të gjitha këto, në kuadër të ndihmës së viktimave dhe reduktimit të pasojave të krimeve mbi ta.

### **c) Plani Kombëtar i Veprimit.**

Kuadri Strategjik dhe Plani Kombëtar i Veprimit për luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore 2005-2007 u hartua, duke u bazuar në përvojën dhe mësimet e nxjerra nga të gjithë institucionet kombëtare përgjegjëse për vënien në zbatim të Strategjisë Kombëtare Anti-Trafikim 2001-2004 të Shqipërisë dhe nga drafti përfundimtar qeveritar të Planit Kombëtar të Veprimit i viteve 2003-2004. Qëllimi i këtij Plani, si edhe Plani Kombëtar i Veprimit i viteve 2003-2004, ishte që të konsolidonte progresin e bërë gjatë periudhës së draftimit të Strategjisë Kombëtare Anti-Trafik të Shqipërisë dhe në të njëjtën kohë të zhvillonte metoda të reja institucionale dhe ligjore, të përshtatura ndaj ndryshimeve të fenomenit të trafikimit dhe gjithashtu të zhvillonte metoda sistematike, të verifikueshme dhe të sakta për të vlerësuar rezultatet.

Plani i Veprimit 2005-2007 mbulon nevojat e Shqipërisë në fushat:

Hetim dhe ndjekje penale e krimeve të trafikimit; Mbështetje dhe mbrojtje e viktimave dhe dëshmitarëve; Parandalim i trafikimit dhe ri-trafikimit; Kuadri bashkërendues.

### **d) Ngritja e Kapaciteteve Njerëzore.**

Duke njohur rolin çelës të Policisë, kurrikula të veçanta në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore janë përfshirë në programin edukativ të Akademisë së Policisë. Kurse trajnimi janë zhvilluar brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe gjithashtu janë organizuar takime rajonale për të diskutuar problemet anti-trafikim, me pjesëmarrjen e policisë, prokurorëve dhe përfaqësuesve të gjykatave. Kurse trainimi janë organizuar për të gjithë forcat policore në të gjithë vendin, me qëllim dhënien e ndihmës ligjore dhe psikologjike për fëmijët, dëshmitarët dhe viktimat. Trajnime të tjera mbi të drejtat e njeriut të viktimave të trafikut janë organizuar edhe për të gjithë nënpunësit e Prokurorive dhe Gjykatave. Kurse trainimi të veçantë janë organizuar për stafin policor

femëror dhe nëpunëset e Prokurorive dhe Gjykatave, në poste pune të veçanta që lidhen me problemet e trafikimit të qënieve njerëzore.

Në nivelin lokal, Urdhëri 139 i Kryeministrit më 19.06.2006, parashikon ngritjen e *Komiteteve Rajonale kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore*. Këto komitete, të kryesuar nga Prefektët përkatës, përbëhen nga përfaqësues të drejtorive të policisë nëpër rrethe, drejtorive arsimore, përfaqësues nga pushteti lokal dhe shërbimeve sociale, prokuroria, zyrat rajonale të SHISH, etj. Në kuadër të funksionimit të Komiteteve Antitrafik në nivel lokal, janë zhvilluar një sërë takimesh, “ëorkshop”-esh dhe trajnimesh, të cilët kanë një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe luftën kundër këtij fenomeni.

Me qëllim shtrirjen e identifikimit, mbrojtjen dhe rolin mbështetës të Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë dhe jashtë vendit dhe në bashkëpunim me autoritetet përkatëse të shteteve kryesore të destinacionit, Ministria ka ndërmarrë masat, në bashkëpunim me organe të tjera zbatuese, *trainimin dhe udhëzimin e nënpunësve konsullorë* në përfaqësitë jashtë vendit, trainimi i cili fokusohet në dhënien e ndihmës viktimave të trafikimit. Ministria, për organizimin e këtyre moduleve të trainimit, ndihmohet nga Akademia e Diplomacisë, por gjithashtu asistohet edhe nga institucione të tjera qeveritare dhe joqeveritare. IOM ka punuar për rritjen e *kapaciteteve të strukturave shtetërore*, të përfaqësuara nga Zyrat Kombëtare të Punësimit për të siguruar informimin mbi rrugët ligjore të migrimit, aktivitetet kundër trafikimit dhe shërbimet e kthimit dhe ri-integrimit për migrantët e kthyer (përfshirë viktimat e trafikimit), si dhe zhvillon kurse trajnim është personelit të zyrave të punësimit të 6 rretheve të përzgjedhura.

#### **e) Analiza, kërkime dhe mekanizma monitorues.**

Një rol të rëndësishëm për studimin e zbatimit të strategjisë luajnë strukturat si në nivel politik dhe në nivel teknik. Këtu mund të përmendim ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore, i kryesuar nga Ministri i Brendshëm, i cili ka në përbërjen e tij përfaqësues të lartë të nivelit politik të institucioneve qëndrore përgjegjës për parandalimin dhe luftën kundër trafikut të qënieve njerëzore në fushat përkatëse. Një *Koordinator Kombëtar*, Zëvendësministrja e Brendshme për Antitrafikimin, është emëruar si pika kyçe për mirëkoordinimin e

përpjekjeve antitrafik në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Bazuar në Urdhërin e Kryeministrit nr. 203, datë 19.12.2005, pranë Koordinatorës Kombëtare për Antitrafikun/Zëvendësministres së Brendshme, është ngritur *Njësia Antitrafik*, për të mbështetur strukturat ekzistuese për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, detyrat kryesore të së cilës janë:

- *Studimi* i aktiviteteve të institucioneve të ngarkuara për zbatimin e Strategjisë Kombëtare;
- *Bashkërendimi i punës* me këto institucione;
- *Mbledhja e informacioneve* dhe të dhënave për çdo çështje që lidhet me këtë fenomen.

Qeveria ka vënë në funksionim të Autoritetit Përgjegjës, *Mekanizmin Kombëtar të Referimit* (MKR) për rastet e viktimave të trafikut në shkallë kombëtare si dhe sigurimin e mbrojtjes së tyre. Ky mekanizëm ka nënshkruar marrëveshje me Autoritetet Përgjegjëse për MKR me vendet kufitare si ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova dhe Mal i Zi, vende të rajonit si dhe me vendet e destinacionit si Itali, Gjermani, Angli.

Gjithashtu, Ministria e Brendshme, e Punëve të Jashtme dhe ajo e Punës si dhe Qendrat e Mbrojtjes së Viktimave të Trafikut kanë ngritur një bazë të dhënash ku stafi i tyre regjistron rastet e viktimave të kthyer, të referuara, të trajtuara dhe të mbrojtura në Shqipëri.

#### **f) Bashkëpunimi dhe rrjeti në rivelet rajonale dhe kombëtare.**

Bashkëpunim i ngushtë është vendosur midis *Qendrës së Linzës* (Qendra Kombëtare për Pritjen e Viktimave të Trafikimit) me *Ministrinë e Brendshme* dhe *Policinë e Shtetit* (Zyrat Anti-Trafikimit dhe Policinë e Kufirit), si dhe me *Prokurorinë* për referimin e rasteve, hapjen e proceseve penale dhe mbrojtjen e viktimave.

Në këtë kuadër, ishte parashikuar ngritja e një regjistri të veçantë për Viktimat e Trafikimit dhe për asistencën që do t'iu ofrohet nga Ministria e Punës së Shqipërisë dhe gjithashtu janë organizuar takime rajonale për të diskutuar problemet anti-trafikim, me pjesëmarrjen e policisë, prokurorëve dhe përfaqësuesve të gjykatave.



#### **g) Mobilizimi i burimeve.**

Momenti i rëndësishëm është edhe pjesa financiare e cila duhet vendosur në dispozicion të qëllimeve primare, përgatitjeve të organave përkatëse për t'u përballur me fenomenin si dhe trajtimin të viktimave. Fondet për aktivitetet anti-trafiking sigurohen nga Shteti dhe OJF-të, ku organizata kryesore ndërkombëtare aktive është OSBE-ja. Specifikisht, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (ODIHR) është në pararojë të përpjekjeve ndërkombëtare për të luftuar dhe parandaluar trafikimin e qënieve njerëzore. Misionet e OSBE-së luajnë një rol jetësor në përpjekjet anti-trafiking në vende pritëse.

Këshilli i Europës dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) janë aktive në fushat e parandalimit, asistencës dhe mbrojtjes. Agjensitë e Kombeve të Bashkuara duke përfshirë United Nations Office of the High Commissioner for Human Rights, United Nations Children's Fund (UNICEF), United Nations Population Fund, United Nations High Commissioner for Refugees, United Nations Development Fund for Women, United Nations Development Program, United Nations Interregional Crime and Justice Research Institute, and United Nations Office on Drugs and Crime. Organizata të tjera janë: the International Labor Organization, International Centre for Migration Policy Development, si dhe Europol.

Gjithashtu USAID, me programet e tij, si dhe qeveritë e huaja si Norvegjia, Greqia, Holanda, Gjermania, Suedia, etj, asistojnë në përpjekjet e përgjithshme për parandalim efektiv, asistencë dhe mbrojtje të viktimave të trafikimit.

#### **h) Sanksionet penale dhe politika kriminale.**

Politika bashkëkohore kriminale, ndonëse gjithnjë e më tepër po orientohet drejt aksionit preventive social dhe risocializimit, nuk heq dorë nga funksioni që u përket sanksioneve penale, dënimeve dhe atyre organeve që i zbatojnë dhe ekzekutojnë këto ligje dhe dënime. Në kushtet e sotme procedimi penal dhe zbatimi i sanksioneve penale janë mjet i domosdoshëm për mbrojtjen e shoqërisë dhe individëve nga sjelljet e rrezikshme shoqërore. Në kuadër të elementeve të politikës ndëshkimore në çdo sistem u kushtohet kujdes i posaçëm dënimeve, të cilat u shqiptohen autorëve të veprave penale. Dënimet janë sanksionet më të vjetra penale, të cilat sot kanë evoluar shumë, por njëkohësisht duhet thënë se kanë ndryshuar edhe qëllimet e shoqërisë në këtë

aspekt. Dënimet përmbajnë elementet represive që u përkasin sanksioneve represive, mirëpo ato sot shërbejnë në radhë të parë për risocializimin e delikuentëve, dhe kështu përmbajnë edhe një dimension – atë të rehabilitimit të theksuar. Duke pasur parasysh këtë, struktura e dënimit është e shumëllojshme, sidomos kur mbahen parasysh sisteme të ndryshme juridiko-penale. Zakonisht në të gjitha sistemet, dënimet ndahen në dënime kryesore dhe dytësore. Sot në botën bashkëkohore në kodet penale dhe ligjet penale pozitive të të gjitha vendeve të botës si mjete dhe metoda apo si sanksione për pengimin e kriminalitetit parashikohen: dënimet, masat siguroese dhe masat edukative, por dënimet më të shpeshta që zbatohen dhe ekzekutohen në praktikën gjyqësore të vendeve bashkëkohore janë dënimet me heqje të lirisë, dënimet me të holla, dënimet me konfiskim të pasurisë dhe dënimi me vdekje. Në disa shtete mund të ketë edhe dënime të tjera, por ato janë më të rralla. Po ashtu në disa kode dhe ligje penale të këtyre shteteve bashkëkohore si sanksione të veçanta parashikohen edhe masat siguroese. Ato në varësi të shtetit dhe rregullimit juridik mund të jenë të llojeve e formave të ndryshme e të shumta. Këto masa kanë të bëjnë me shërimin, ruajtjen dhe mbikqyrjen e personave që janë të rrezikshëm dhe të cilët përsërisin veprat penale. Po ashtu edhe masat e tjera për kategori të caktuara të delikenteve, kanë për qëllim mbrojtjen dhe sigurinë nga aktiviteti kriminal i rrezikshëm i disa personave. Këto mund të jenë p.sh. ndalimi i ushtrimit të profesionit apo mjeshtrisë, ndalimi i paraqitjes publike, dëbimi i të huajve nga vendi etj.

Qëllimi kryesor i caktimit të sanksioneve penale përqëndrohet në luftën kundër veprimeve të rrezikshme shoqërore, me të cilat shkelen ose rrezikohen vlerat shoqërore të mbrojtura nga legjislacioni penal. Duke u nisur nga ky qëllim i përgjithshëm i të gjitha sanksioneve penale, në ligjin penal janë parashikuar edhe qëllime të posaçme për secilin lloj të sanksionit penal. Dënimi për veprën e kryer penale “qëndron” në raport me personin e dënuar, dhe ka funksion të dyfishtë: ndëshkues dhe parandalues. Vetë procesi i zbatimit të përgjegjësive penale dhe caktimi i sanksionit penal, parë në aspektin objektiv përmban edhe elemente të represionit ose ndëshkimit. Të gjitha sanksionet penale janë masa represive, prandaj ç’do person i akuzuar dhe i dënuar duhet t’i përjetojë edhe si represion.

Qëllimi kryesor i dënimit penal është ndëshkimi i fajtorit që ka kryer veprën penale, të ndalojë veprimtarinë e mëtejshme kriminale të tij, si dhe riedukimin e tij për t’u bërë i

dobishëm për shoqërinë në të ardhmen, por nga ana tjetër, dënimi penal është edukimi i shtetasve me ndjenjën e respektimit të ligjeve të shtetit. Ndëshkimi i fajtorit është i pandarë nga parandalimi i përgjithshëm (karakteri edukues i dënimit) dhe të dy së bashku, në unitetin e tyre, përbëjnë qëllimin e dënimit në shtetin ligjor.

Dënimi me burgim është mjet i domosdoshëm në luftën kundër kriminalitetit dhe ka për qëllim riedukimin e të dënuarit si dhe edukimin e anëtarëve të tjerë të shoqërisë më ndjenjën e respektimit të ligjeve.<sup>252</sup>

Dënimi penal nuk mund të konsiderohet si “hakmarrje”<sup>253</sup> ndaj fajtorit që kryen veprën penale, dhe këtu është e nevojshme të dallohet ashpërsia e dënimit nga hakmarrja, e cila është nuk e pajtueshme me parimet e humanizmit.

Në fushën e ekzekutimit të sanksioneve penale, e sidomos të dënimit me heqje të lirisë, qëllimi i hakmarrjes është zbutur dhe si qëllim i fundit zakonisht trajtohet risocializimi i personave të dënuar dhe aftësimi i tyre që të kthehen në liri, si qytetarë të devotshëm.

Masat sigurose paraqesin një lloj të veçantë të sanksioneve penale në sistemin bashkëkohor penitenciar. Në penologjinë moderne, këtyre masave u kushtohet kujdes i veçantë. Karakteri i këtyre masave në radhë të parë është i përcaktuar me rolin parandalues të tyre në luftimin e kriminalitetit.

## **5. Vënia në zbatim e ligjeve anti-trafikim.**

### **5.1. Parandalimi dhe ndërgjegjësimi.**

*Masa parandaluese dhe programe edukuese të rëndësishme janë realizuar me mbështetjen financiare të Qeverisë. Media dhe metoda të tjera informative janë përdorur për të mësuar dhe informuar me efikasitet popullsinë, veçanërisht gratë, fëmijët dhe target grupe të tjera vulnerabël. Në këtë kuadër, në vijim të një bashkëpunimi të mirë ndër-institucional, takime pune janë organizuar me pjesëmarrës të OJF-ve dhe CAAHT, ICPMD, USAID, IOM, Komuniteteve Fetare dhe Koalicionit “Bashkimi Kundrejt Trafikimit të Fëmijëve”.*

---

<sup>252</sup> I. Elezi, S. Kaçupi, M. R. Haxhia, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Geer, Tiranë, 2006, fq. 209.

<sup>253</sup> I. Elezi, S. Kaçupi, M. R. Haxhia, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Geer, Tiranë, 2006, fq. 200.

Qendra e Linzës me mbështetjen e IOM-it ka përgatitur dhe ka shpërndarë *fletëpalosje dygjuhëshe* (shqip dhe anglisht). OJF të tjera kanë bërë të njëjtën gjë, me mbështetjen e donatorëve. Gjithashtu, MPJ ka kontribuar në përgatitjen e fletëpalosjeve anti-trafikim, për shpërndarje në shtetet e destinacionit/tranzitit. Në kuadër të parandalimit të trafikimit, veçanërisht ndaj target grupeve në rrezik, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka nxjerrë më datë 29.03.2006 Udhëzimin nr. 6 “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me çertifikatë lindjeje”.

Të gjithë institucionet shtetërore dhe OJF-të që punojnë me fëmijët organizojnë seminare, shpërndajnë materiale informuese familjeve me probleme sociale, atyre me nivel të ulët edukimi dhe komunitetit rom.

Duhet theksuar që në këtë aspekt afërsisht 600 studentë dhe 200 gra të komuniteteve vulnerable janë informuar mbi fenomenin dhe rreziqet që mbart trafikimi. Aktivitetet kundër trafikimit janë përfshirë në *planet vjetore shkollore* dhe *planet edukative të ç’do klase*. Në plotësim, në bashkëpunim me UNICEF-in, është organizuar *trajnimi i mësuesve*, që punojnë me nxënës të ngjuar. Për të mbështetur këto aktivitete, vizita dhe takime janë organizuar midis zyrtarëve rajonalë të Ministrive të Edukimit dhe Shkencës. Një *mekanizëm vlerësimi* është ngritur për të vlerësuar efektivitetin dhe impaktin e metodologjive të përdorura. Ky mekanizëm do të kontribuojë në konsolidimin e modeleve të sukseshme të parandalimit të trafikimit në shkollat rajonale.

Sipas Urdhërit 34, më 08.12.2004, për vënien në zbatim të projektit “Shansi i Dytë”, vazhdon procesi i edukimit për studentët që kanë braktisur shkollën dhe që janë të ngjuar nga hakmarrja. Në të njëjtën kohë, sipas Urdhërit nr. 394, më 23.02.2004, “Për tarifën në sistemin e edukimit profesional”, i nxjerrë nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ofrohen kurse profesionale falas në qendrat e edukimit profesional publik grave të trafikuar të martuara dhe të pamartuara.

*Vizita studimore* dhe *shkëmbim reciprok eksperiencash* janë organizuar midis përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe misioneve të IOM-it në Shqipëri, Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovës.

Edhe Prokuroria për Krimet e Rënda<sup>254</sup>, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2010, ka bashkëpunuar me disa vende për hetimin e veprave penale të trafikimit procedime penale të qenieve njerëzore për 13 kryesisht për veprën penale të trafikimit të femrave –

---

<sup>254</sup>Raporti për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore Janar-Dhjetor 2010, Tiranë, Shkurt 2011.

neni 114/b i Kodit Penal. Sipas vendeve me të cilët është bashkëpunuar, kemi këto të dhëna:

- 6 proçedime penale me Italinë;
- 3 proçedime penale me Greqinë;
- 2 proçedime penale me Kosovën;
- 1 proçedim penal me Anglinë;
- 1 proçedim penal me Slloveninë.

Gjithashtu, ka filluar zbatimimi i fazës së dytë të projektit rajonal, ILO-Migrant: *Mundësi punësimi, formimi profesional dhe masa politikash migratore për parandalimin dhe reduktimin e trafikimit të grave në Shqipëri, Moldavi dhe Ukrainë*. Ky projekt, ndërmjet të tjerash, ka si qëllim dhënien e mikro-kredive për sipërmarrje private të kontigjentit të grave e vajzave të ish-trafikuar, me qëllim riintegrimin e tyre, por edhe për parandalimin e viktimave potenciale të trafikimit.

## **5.2. Mbrojtja dhe asistenca.**

Shumica e programeve të zbatuara në Shqipëri, të fokusuar mbi parandalimin përfshijnë fushata ndërgjegjësuëse në media, programe edukuese në shkolla, projekte trajnimi për gratë, oficerë të policisë, gjyqtarët, dhe aktivitete në klubet rinore.<sup>255</sup> Qendra e Ri-Integritit, u hap në mes të Janarit 2002 për të dhënë mbrojtje të përkohshme, këshillim psiko-social dhe mjekësor, asistencë për kthim dhe ri-integrim për viktimat shqiptare të trafikimit. Aktivitetet e saj fokusohen kryesisht në referimin dhe projektimin e përfituesve, në akomodimin afat shkurtër dhe afat mesëm deri në përgatitjen e bashkimit familjar ose jetesës së pavarur dhe asistencës riintegruëse për viktimat, duke përfshirë edukim dhe trajnim, si edhe asistencë për punësim dhe ngritje kapacitetesh të organizatave lokale që punojnë në këtë fushë.

Në Korrik 2003, Qeveria mori përsipër administrimin e *Qendrës Kombëtare të Pritjes të Viktimave të Trafikimit (QKPVT)* për viktimë madhoreë dhe fëmijë, e njohur më përpara si *Qendra e Linzës*. Qendra Kombëtare e Pritjes është krijuar në kuadër të Strategjive Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Fëmijëve dhe është

---

<sup>255</sup> I. Ekonomi, E. Gjermani, E. Danaj, E. Lula, dhe L. Beci, *Krijimi i mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat në Shqipëri: Një strategji për parandalimin e trafikimit*, Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim, Tiranë, 2006.

një institucion që vepron nën okelion e Shërbimit Social Shtetëror (MoLSAEO)<sup>256</sup>, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Brendshme dhe IOM-in. Gjithashtu, zbatimi i një metode të kuptueshme për mbrojtjen e viktimave është një prioritet i rëndësishëm. Stafi i QKPVT, bashkëpunon me të gjitha strukturat e referimit të viktimave, si pikat kufitare dhe komisariatet e policisë në mënyrë që të ofrojë akomodim për viktimat. Në të gjitha rastet stafi i qendrës kryen intervista, bazuar në një pyetësor të hartuar me ndihmën e donatorëve ndërkombëtarë dhe vlerësimin e nevojave. Qendra ka vendosur bashkëpunim edhe me nënpunësit e policisë dhe prokurorisë, në mënyrë që viktimat të akomodohen dhe mbrohen. Për shembull, në të gjitha pikat e kalimit kufitar ku të deportuarit rikthehen, oficerët e kufirit i intervistojnë në mënyrë që identifikojnë dhe të mbrojnë viktimat potenciale të trafikimit. Gjithashtu, QKPVT punon në ndërgjegjësimin e viktimave të trafikimit në mënyrë që të arrihet denoncimi i trafikantëve dhe informacioni që iu jepet bazohet në të drejtën e tyre për mbrojtje dhe rreziqet që iu kanosen jetës së tyre. Bazuar në ligjin mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, qendra vazhdon të asistojë viktimat e trafikuar që kanë denoncuar trafikantët e tyre dhe kanë nevojë për mbrojtje, edhe mbas përfundimit të gjyqit.

Gjatë vitit 2005 në Qendrën e Linzës, janë akomoduar dhe asistuar 127 persona (116 raste të reja dhe 11 nga viti 2004). 15 prej tyre kanë denoncuar trafikantët e tyre (të dhëna të marra nga QKPVT).

Duke u rikthyer dhe një herë tek OJF-të, si organizma shumë të rëndësishëm në këtë kuadër, përmendim që Vendimi nr.564 i Këshillit të Ministrave, datë 12.08.2005 “Mbi liçensimin e dhënësve të shërbimeve sociale”, autorizimi i OJF-ve në dhënien e shërbimeve sociale është akoma në proces. Deri më sot, janë rreth 30 OJF të liçensuara, që ofrojnë shërbime parandaluese dhe mbështetëse, rehabilitim dhe ri-integrim. OJF-të më impaktin më të madh në fushën e parandalimit, mbështetjes, rehabilitimit dhe shërbimeve ri-integruese janë:

“Qendra Vatra”, “Tjetër Vizion”, “Të Ndryshëm por të Barabartë”, “Shërbimi Social Ndërkombëtar”, “Terre des Hommes”, “Ndihmë për Fëmijët”, “Qendra Komunitare Ballsh”, “Komisioni Ndërkombëtar Katolik për Emigrimin”, “Save the Children”, “Klinika Ligjore për të Miturit”, “Në Dobi të Gruas Shqiptare”, “Strehëza”,

---

<sup>256</sup> Ministria e Punës, Çështjeve Social e dhe Shanseve të Barabarta.

“Organizata Ndërkombëtare për Migrim”, “Linja e Këshillimit për Gra”, “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, “Koalicioni i OJF-ve” si dhe “Së bashku kundër Trafikimit të Fëmijëve”.

### **5.3. Roli i prokurorisë në anti-trafikim.**

Një nga objektivat kryesorë anti-trafikim është rritja e ndjekjeve penale të rasteve të trafikimit dhe dënimi i trafikantëve. Kjo është arritur duke shtuar bashkëpunimin midis Autoriteteve Policore dhe Prokurorisë. Një prioritet ka qenë vënia në zbatim e një metode të kuptueshme për mbrojtjen e dëshmitarëve, duke dëshmuar kundër trafikuesve të tyre.

Ligji i ri i Mbrojtjes së Dëshmitarëve, synon sigurimin e mbrojtjes së një identiteti ligjor, fizik dhe personal, për të gjithë viktimat/dëshmitarë në proceset gjyqësore, pa marrë parasysh pjesëmarrjen e tyre në Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve. Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave kanë hartuar efektet anësore të ligjit mbi mbrojtjen e dëshmitarëve. Në këtë kuadër, një sektor i mbrojtjes së dëshmitarëve është krijuar në Drejtorinë e Krimit të Organizuar në Ministrinë e Brendshme.

Në kuadër të forcimit ligjor, një hap i rëndësishëm është fillimi i procesit të pajisjes së Gjykatës së Krimeve të Rënda me mjetet kryesore të nevojshme për mbrojtjen dhe sigurinë e kërkuar të viktimave të trafikuar që dëshmojnë gjatë një gjyqi, nëpërmjet “video konferencës”. Përgjatë këtij procesi, hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë për mbrojtjen e identitetit të të gjithë viktimave/dëshmitarë gjatë procedurave ligjore dhe rishikimin e skemës së kompesimit të këtyre viktimave nga pasuritë e konfiskuara. Gjithashtu, miratimi i ligjit mbi të huajt është në proces. Ky ligj përfshin dispozita për leje rezidence të përkohshme për viktimat e trafikimit në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare. Sektori i Emigracionit pranë policisë kufitare lehtëson shpërndarjen e këtyre lejeve.

Duke iu referuar statistikave, përsa i përket programit të mbrojtjes së qytetarëve, mund të thuhet që:

- Gjatë vitit 2005, ka pasur njëmbëdhjetë dëshmitarë që iu janë siguruar masa të veçanta mbrojtjeje, duke përfshirë edhe zhvendosjen. Veç kësaj, masa të përkohshme mbrojtjeje, për një periudhë 1 mujore, janë siguruar për pesëmbëdhjetë

dëshmitarë të tjerë. Përsa i përket specifikisht trafikimit të qenieve njerëzore, ka pasur vetëm një rast të një dëshmitari me masë mbrojtjeje shpërnguljen.

- Gjatë vitit 2005, nëntë dëshmitarë viktime të trafikimit kanë bashkëpunuar me Departamentet Policore dhe kanë denoncuar trafikantët e tyre për ndjekje penale.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet politika e dënimit e ndjekur nga ana e prokurorisë ndaj trafikantëve të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore të cilat kanë shërbyer në përgjithësi në uljen dhe parandalimin e këtij lloj kriminaliteti..

<b>Kërkesat e prokurorit (në vite burg)</b>	7-12 vjet burgim	13-18 vjet burgim	mbi 18 vjet burgim
<b>Numri i personave</b>	20	43	4

Nga tabela rezulton se për numrin më të madh të trafikantëve është kërkuar nga gjykata zbatimi i një sanksioni të ashpër penal dhe konkretisht në rendin e 13-18 vjet burgim.

## **6. Masat represive (ndëshkuese).**

Normat e legjislacionit penal janë instrument i domosdoshëm për luftimin e kriminalitetit. Ligji i procedurës penale përcakton rregullat me të cilat sigurohet që asnjë i pafajshëm të mos dënohet, e që fajtorit t'i jepet sanksioni penal, në kushtet të cilat i parasheh ligji penal dhe në bazë të procedurës së zbatuar në mënyrë ligjore.<sup>257</sup> Politika ndëshkimore bashkëkohore, ndonëse gjithnjë e më tepër po orientohet drej masave preventive dhe risocializimit të personave të dënuar, nuk heq dorë nga funksioni që u përket sanksioneve penale, dënimeve dhe atyre organeve që i zbatojnë dhe ekzekutojnë këto ligje dhe dënime. Në ligjin penal shqiptar janë caktuar për secilën veprë penale të trafikimit të qenieve njerëzore, si sanksionet penale ashtu edhe masat dhe llojet e dënimeve të cilat janë trajtuar në pikat e mësipërme të këtij punimi. Edhe në veprat e rilindasve shqiptarë zë vend edhe trajtimi i institutit të dënimit, natyrisht, jo në kuptimin thjesht juridik, se sa moralo-politiko-shoqëror.<sup>258</sup>

Shteti në thelb ka dy instrumenta në dispozicion për të luftuar kriminalitetin:

<sup>257</sup> V. Latifi, vep.cit., fq. 138.

<sup>258</sup>I.Elezi, *Mendimi Juridik Shqiptar*, Tiranë, 1999, fq.25.



- Shpenzimet publike (për forcimin e policisë dhe gjyqësorit);
- Sanksionet e parashikuara për ç' do vepër penale.

## **7. Arrestimi i menjëhershëm, ruajtja e vendit dhe mbledhja e evidencave.**

Pjesa më e madhe e hetimeve policore për krimet e rënda nisin në skenën ku normalisht ngjarja që ka ndodhur ka lënë shenja të dukshme, p.sh. vrasja ose vjedhja. Sapo të sigurohet skena për të ruajtur evidencat, fillon investigimi kriminal. Krimi i trafikimit të genieve njerëzore është unik sa i takon skenës së krimit, për arsytet më poshtë:

- Skena e krimit nuk është gjithmonë evidente dhe e dallueshme.
- Skena ku ndodh ngjarja mund të ndryshojë nga një vend në një tjetër dhe shpesh rifillon në një shtet tjetër. Shpesh, ajo është vetëm një pjesë e së tërës, e një ngjarje me përmasa më të mëdha.
- Kudo që të ndodhet viktimja, duhet të konsiderohet si skena e parë e krimit.
- Trafikuesi e zhvendos shpesh dhe përherë viktimën e tij nga një vend në tjetrin gjatë fazave të trafikimit dhe për këtë arsye skenat e krimit ndryshojnë vazhdimisht.

Evidencat duhet të mblidhen në të gjitha vendet e ndodhjes së ngjarjes.

Atëherë kur merret një ankim nga një viktimë ose kur merret ndonje sinjalizim nga burimet e tjera, duhet menjëherë të merret masa e sulmit të shpejtë në vendin e sinjalizuar për të shpëtuar viktimat dhe/ose të arrestohen të dyshuarit e trafikimit.

Një rast konkret paraqet më së miri procesin e kallëzimit, arrestimit e deri te dënimi përfundimtar i autorit. Gjykata për Krime të Rënda në gjykimin e proçedimit penal nr.40/11/66, ndër të tjera arsyeton:

*“...Në orën 04<sup>00</sup> të datës 13/11/2003 i pandehuri K.M. dhe e dëmtuara F. K. janë ndaluar në Këlcyrë nga punonjësit e policisë dhe për mungesë të dokumentave të identifikimit janë shoqëruar për në Komisarariatit e Policisë në Përmet. Gjatë rrugës i pandehuri K. e ka kërcënuar të dëmtuarën se do t'i bënte keq familjes së saj nëse nuk do të thoshte se kishte ikur me dëshirën e saj. Fillimisht e dëmtuara ka pranuar se kishte ikur me dëshirën e saj dhe më pas, me mbërritjen e të atit të saj ka bërë kallëzim ndaj të pandehurve”.*<sup>259</sup>

Pas dhënies së dëshmisë nga e dëmtuara, i pandehuri K.M. me datë 13.11.2003, është ndaluar menjëherë nga policia gjyqësore.

Në përfundim të gjykimit është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit K.M. për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të “Trafikimit të femrave për prostitucion”, parashikuar nga Neni 114/b paragrafi i dytë i Kodit Penal dhe dënimi i tij me 15 vjet

<sup>259</sup> *Vendimi nr.3*, datë 19.03.2007, Gjykatës për Krime të Rënda.

burgim. Në aplikim të Nenit 406/1 të Kodit të Proçedurës Penale dënimin e të pandehurit K.M. përfundimisht me 10 (dhjetë) vjet burgim.

### **7.1. Kontrolli dhe kapja.**

Cilësia e proçesit të kërkimit dhe e kapjes së materialeve inkriminuese është me shumë rëndësi për perspektivën e një hetimi të suksesshëm. Herë pas here është vënë në dukje që bindjet arrihen normalisht si rezultat i evidencave të dokumentuara të gjetuara dhe të kapura gjatë fazës së arrestit.

Si masa me të cilat mund të sigurohen provat materiale apo të shtihet në dorë kryesi i veprës penale, ligji parasheh kontrollet e të gjitha llojeve përshtirë këtu edhe kontrollin e personit.<sup>260</sup>

Gjatë këtij proçesi të rëndësishëm, vlen të mbahet parasysh e të respektohet i ashtuquajtimi “Rregulli i artë“. Ky “Rregull i artë” për operacionin e kërkimit është:

“Brenda ligjit, të merret gjithçka që mund të përbëjë provë – në rast se nuk je i sigurtë, përsëri merre, ajo mund të kthehet në vend përsëri më vonë, por po të lihet pa u marrë, atë mund të mos e gjesh më kur të vij koha që të kuptohet rëndësia që mund të ketë patur materiali si provë.“

### **7.2. Hetimi pro-aktiv.**

Opsioni pro-aktiv në kontekstin e trafikimit të qenieve njerëzore ka si objektiv:

Hetimin, arrestimin dhe ndjekjen e suksesshme penale të trafikantëve pa qenë e nevojshme që të mbështeten mbi bashkëpunimin dhe dëshminë e viktimave.

Mbledhja e të dhënave nga shërbimet sekrete, survejimin e njerëzve dhe survejimin teknik, operacionet sekrete dhe teknikat standarde hetimore, kanë si qëllim të identifikojnë trafikuesit dhe ata që ndiqen penalisht për vepra penale të lidhura me çështjen dhe në vendin ku kryhet ky hetim. Kështu, Gjykata për Krime të Rënda, në përfundim të gjykimit të proçedimit penal nr.23/67/2010, ka vendosur:

*“Deklarimin fajtor të të pandehurit M.K. për veprën penale të “Trafikimit të femrave për prostitucion”, parashikuar nga Neni 114/b/1 i Kodit Penal (para ndryshimeve të bëra me Ligjin nr.9188, datë.12.02.2004) dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim”<sup>261</sup>.*

<sup>260</sup> E. Sahiti, *Argumentimi në Proçedurën Penale*. Prishtinë 1999, fq. 159.

<sup>261</sup> *Vendimi nr.38*, date 04.07.2011, Gjykates për Krime të Rënda

Vlen për t'u theksuar se proçedimi penal në ngarkim të të denuarit M.K. nuk është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të të dëmtuarës.

Hetimi pro-aktiv jep mundësinë që organet proçeduese të ndërmarrin hapa për të luftuar trafikantët pa qenë nevoja e ankesës apo të provave të viktimave, megjithatë dëshmia e viktimës do të mbetet gjithmonë një burim parësor për përfitimin e provave cilësore. Një situatë e tillë mund të vijë sidomos në ato raste në të cilën për veprën penale, përveç deklaratës së viktimës nuk ka prova të tjera për të vendosur në proçedurë penale.<sup>262</sup>

Trafikimi i qenieve njerëzore duhet të konsiderohet një lloj si terrorizmi dhe kundër tij duhet të ketë një reagim tepër të fuqishëm. Përvoja tregon që hetimi pro-aktiv është një armë efektive dhe duhet të përdoret kudo që të jetë e mundur.

Çdo punonjës policie i cili është përgjegjës për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të të miturve në gjithë territorin e vendit, ka akses në sistemin MEMEX për të konsultuar të dhëna të cilat kanë të bëjnë me trafikimin e të miturve. Përkatësisht specialisti përkatës i një drejtorie të policisë në një qark ka akses konsultimi të të dhënave në sistemin MEMEX, të dhëna operative apo ngjarje, të dhëna të cilat hidhen nga çdo strukturë e kësaj drejtorie dhe që bëjnë fjalë për individë, grupe apo fenomene të trafikimit të të miturve. Shefi i Seksionit Kundër Trafiqueve të Paligjshme në drejtorinë e policisë në qark ka akses për t'u konsultuar me të dhënat e hedhura për të gjitha llojet e trafiqueve të hedhura nga të gjitha strukturat policore për drejtimet e punës për të cilat është përgjegjës në atë drejtori. Specialistët e Sektorit Kundër Trafiqueve të Paligjshme në nivel qendror, kanë akses për të konsultuar të dhëna në sistemin MEMEX të hedhura nga të gjitha strukturat policore në nivel kombëtar për fushën specifike që ata janë përgjegjës.

### **7.3. Hetimi financiar.**

Hetimi financiar ka një rol shumë të madh në të gjithë hetimin e suksesshëm të krimit të trafikimit dhe kjo ka dy arsye kryesore:

*Së pari*, krimi kryhet vetëm për hir të parasë. Investimi fillestar për të krijuar dhe gjetur personelin e duhur për infrastrukturën e rekrutimit, sigurimin e dokumentacionit dhe vizave për të trafikuar dhe dorëzuar viktimat, menaxhimin e vazhdueshëm të fitimeve nga shfrytëzimi dhe, së fundi pastrimi dhe zhvendosja e përfitimeve.

---

<sup>262</sup> E. Sahiti, vep.cit., fq.247.

Së dyti, trafikimi është një krim që kryhet nga një rrjet i cili do kohë për t'u ndërtuar dhe zhvilluar dhe prandaj shndërrohet në një krim “të mënyrës së jetesës”. Çështje të tilla të mënyrës së jetesës si udhëtimet, shpenzimet për artikuj luksi si shtëpi, apartamente, vetura dhe xhevahire, apo frekuentimi i restoranteve dhe kazinove kërkojnë mjete dhe metoda blerjeje.

Të gjitha këto veprimtari nuk mund të realizohen pa transaksione financiare, prandaj një hetim pro-aktiv i këtyre fushave gjithmonë do të japë rezultat në ndëshkimin e trafikantëve.

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare Antitrafik 2008-2010 dhe planit të saj të veprimit **Ministria e Financave** dhe strukturat e saj të vartësisë kanë punuar kryesisht në drejtim të rritjes së hetimeve financiare dhe përdorimit të tyre në hetimet kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Gjatë periudhës së raportimit nga ana e Njesisë së Inteligjencës Financiare – Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPPP) janë referuar për investime të mëtejshme pranë autoriteteve të zbatimit të ligjit gjithsej 59 raste.

Për sa i përket bashkëpunimit për hetimet financiare midis Njesisë së Inteligjencës financiare, Prokurorisë dhe Drejtorisë kundër Krimit Ekonomik në PSH janë zhvilluar rreth 34 aktivitete trajnuese ku kanë qenë përfitues strukturat e përmendura më sipër dhe Banka e Shqipërisë. Këto aktivitete janë zhvilluar në kuadër të Projektit të binjakëzimit me homologët gjermanë<sup>263</sup>.

Edhe Gjykata për Krime të Rënda, gjatë gjykimit të çështjeve ndaj trafikantëve, ka kryer hetim financiar dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor përveç dënimit të dhënë për trafikantin ka vendosur edhe sekuestrimin e pasurive të luajtshme të fituara si rezultat i veprimtarisë kriminale. Kështu, me Vendimin nr.15, datë 23.04.2010 ka vendosur:

*“Deklarimin fajtor të të pandehurit A.A. për kryerjen e veprës penale të “Trafikimit të femrave për prostitucion” në dëm të shtetases V.K., parashikuar nga Neni 114/b/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim e 4.000.000 (katër milion) lekë gjobë.*

**Provat materiale:** Autoveturë e markës “EolksEagen”, tip “Golf 3”, me numër shasie EEEZZZ1HZNË375894, ngjyrë e zezë, viti i prodhimit 1992, me targë EL 3522 B (së bashku me dokumentacionin e saj), Autoveturë e markës “Benz”, tipi “220 CDI-Clasic”, me numër shasie EDB20300661A097459, me targë të huaj BK 164 YM (së bashku me dokumentacionin e saj), **t'i kalojne shtetit.**“

---

<sup>263</sup>Raporti për Realizimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzor 2008-2010 (Shtator 2008 – Maj 2009).

### 7.3.1. Hetimi reaktiv.

Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore kërkon një hetim të sofistikuar pro-aktiv, megjithatë shumë i rëndësishëm në momente dhe rrethana të caktuara është edhe metoda e hetimit reaktiv. Hetimi reaktiv është krijimi i një sërë rrethanash që kërkojnë një reagim të menjëhershëm të organeve të policisë dhe të prokurorisë.

Nevoja për një përgjigje dhe reagim të shpejtë mund të shkaktohet në një numër rastesh dhe mënyrash:

- Nga viktima, e cila ka shpëtuar veten dhe kërkon ndihmën e zbatueseve të ligjit.<sup>264</sup>
- Nga një viktimë që është zbuluar ose diktuar nga zbatuesit e ligjit gjatë një aksioni të tyre për një rast që nuk lidhet me ndërhyrjen për problemet të trafikimit.
- Nga një organizatë e angazhuar në ndihmë të strehimit të viktimave.

Gjatë punës së tyre organet proceduese ndeshen me viktimat që janë konfuzë, të frikësuar ose të traumatizuara, të cilat fillimisht nuk dinë si të veprojnë. Përgjithësisht ka tre tipe viktimash:

- Viktimë që nuk dëshiron të bashkëpunojë fare;
- Viktimë që dëshiron të japë informacion, por jo prova dhe dëshmi;
- Viktimë që bashkëpunon plotësisht dhe që dëshiron të dëshmojë kundër trafikuesit të saj.

Hetimi reaktiv është ai lloj hetimi, që bazohet mbi bashkëpunimin dhe dëshminë e viktimit, prandaj momenti më kyç që është specifik për këtë hetim është marrja e dëshmisë nga vetë viktima. Duke qënë se viktima ka qënë prezent në shumicën apo për të thënë në të gjitha “skenat” e trafikimit ajo mund të japë informacion apo dëshmi shumë konkrete dhe shumë të rëndësishme. Është fakt se i dëmtuari si dëshmitar okular percepton në mënyrë më të plotë dhe mban mend më fort se sa dëshmitari i rëndomtë.<sup>265</sup> Që kjo dëshmi të jetë e plotë, e saktë dhe që të prekë të gjitha momentet e rëndësishme për procesin, ndërtimi i pyetjeve në mënyrë të saktë profesionale luan rol vendimtar në marrjen e një dëshmie që përfundimisht i vë kriminelet “me shpatulla pas murit”.

---

<sup>264</sup>Mbi bazën e kallëzimit të të dëmtuarës, me Vendimin nr.3, datë 11.01.2011, Gjykata Për Krime të Rënda, ka vendosur: Deklarimin fajtor të të pandehurit H.S. për veprën penale të “*Trafikimit të femrave për prostitucion*”, parashikuar nga neni 114/b/1 i Kodit Penal (shtuar me Ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001) dhe dënimin e tij me 13 (trembëdhjetë vjet) burgim.

<sup>265</sup> E. Sahiti, vep.cit., fq. 247.

Rëndësia e dëshmisë si provë e imponon nevojën që me rastin e marrjes në pyetje asaj t'i qaset me plan paraprak të përgatitur mirë, e të definuar qartë në ndërgjegjen e vet.<sup>266</sup> Ligji përcakton metodikën e marrjes në pyetje, kështu që kjo zbatohet me një rend të caktuar, duke respektuar formën procedurale, sepse vetëm dëshmia e dëshmitarit e fituar, duke respektuar formën procedurale përkatëse ka fuqi provuese.

## **8. Rehabilitimi dhe riintegrimi i viktimave të trafikuar.**<sup>267</sup>

### **8.1. Profili i viktimës së trafikuar dhe shfrytëzuar.**

Sa më shumë që thellohet analiza e trafikimit të grave dhe vajzave, aq më shumë del në pah se procesi social dhe psikologjik i viktimizimit fillon shumë më herët se procesi i trafikimit. Viktima vjen e profilizohet më herët, saqë mund edhe të evidentohen dhe të adresohen nevojat e viktimave aktuale, por edhe atyre potenciale të trafikimit. Ky profil përvijohet si:

- Vlerësim i ulët për veten;
- Ndjenja ankthi;
- Ndjenja faji;
- Ndjenja e braktisjes dhe frika nga braktisja në marrëdhëniet me të tjerët;
- Mungesa e besimit te vetja dhe të tjerët;
- Marrëdhënie varësie;
- Pasiguria dhe mungesa e besimit tek të tjerët dhe tek vlerat njerëzore;
- Ndjenja e largimit dhe të huajimit prej ambientit;
- Të ndjerët i paragjykuar apo frika prej paragjykimit;
- Ndjenjë paaftësie për të kontrolluar veten apo ambientin;
- Paaftësi për të përfituar nga mundësitë që i jepen;
- Negativizëm në perspektivë;
- Paaftësi për të zhvilluar sjellje të reja;

---

<sup>266</sup> E Sahiti, *Dëshmia e Dëshmitarit si Provë në Procedurë Penale*, Prishtinë 1993, fq.156.

<sup>267</sup> Viktimë quhet: “një person që ka pësuar dëmtime fizike ose mendore, vuajtje emocionale ose humbje ekonomike, të shkaktuara direkt nga veprime ose mos-veprime që janë në kundërshtim me ligjin kriminal të Shtetit Anëtar. Neni 1 (a) i Vendimit në Kuadër të Këshillit i 15 Marsit 2001 mbi paraqitjen e viktimave në procedurat kriminale.

- Paqartësi lidhur me marrëdhëniet;
- Vështirësi në marrje dhe ekzekutim vendimesh;
- Ndjenjë destinimi dhe pafuqishmërie për të ndryshuar atë.

Mes rekomandimeve për Shqipërinë, në Raportin e Departamentit të Shtetit për Trafikimin e Njerëzve, thuhet se vendi duhet të vazhdojë të përmirësojë zbatimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, duke bërë të mundur që të ndiqen penalisht punonjësit e zbatimit që ligjit që bashkëpunojnë në trafikimin e njerëzve, të hetojë dhe nxjerrë para drejtësisë autorët e trafikimit dhe të ndihmojë në funksionimin e strukturave kundër trafikut.

Raporti nënvizon se Shqipëria i ka shtuar përpjekjet për zbatimin e ligjeve kundër trafikut në vitin 2010 dhe ka përmirësuar përpjekjet për identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave, por korrupsioni në të gjitha nivelet dhe sektorët vazhdon të pengojë së tepërmi përpjekjet e qeverisë në luftën kundër trafikimit të njerëzve<sup>268</sup>.

**Konformizmi** - Shumica e personave e në veçanti e vajzave dhe grave që janë trafikuar vijnë nga shtresa të ulëta sociale-ekonomike apo grupe shoqërore në gjendje të vështirë ekonomike. Pamundësia ekonomike, izolimi, neglizhenca dhe abuzimi gjinor i bazuar në paragjykimet gjinore rezultojnë tek këto vajza që të ndërpresin shkollimin dhe të jenë të varura nga të tjerët.

Këta faktorë, si dhe mungesa e strukturave për t'i ndihmuar për përmirësimin e pozitës së tyre, lë pasojë, prandaj këta persona e në veçanti gratë dhe vajzat kërkojnë zgjidhjen apo shpëtimin në lidhje apo martesë të hershme apo në largime të rrezikshme të paplanifikuara, duke i dhënë një pozicion shoqëror që nuk përkon me moshën dhe zhvillimin e tyre.

Rezultatja në këtë rast është se ato në moshë të re (fëmijë) bëhen nëna dhe jetojnë e lëvizin në ambiente me ekspozim dhe rrezik të lartë dhune dhe abuzimi. Izolimi shoqëror dhe mungesa e informacionit është një karakteristikë tjetër e ambjentit të rritjes së këtyre vajzave, izolim i cili i vazhduar dhe strukturuar qëllimshëm nga trafikantët, kufizon dhe shtrembëron rrethin e njohjeve dhe mbështetjeve të mundshme shoqërore. Ndarja dhunshëm nga familja prej trafikantëve dhe më pas për shkak të mentalitetit dhe kërcënimeve (edhe me vdekje) të të denoncuarve, i bën këto vajza dhe gra të shkëputura

---

<sup>268</sup>Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për vitin 2010.

dhe të paragjykuara shoqërisht. Varfëria ekonomike është një tjetër karakteristikë e profilit të këtyre vajzave.

Këta persona në shumicën e rasteve janë rritur në ambiente familjare të ç'organizuara, të cilat kanë dështuar në transmetimin e një sërë vlerash universale, besimesh e qëllimesh në jetë. Të shkëputur forcërisht prej këtyre e të detyruar ta konceptojnë veten si të paaftë e pa kontroll mbi ambientin vetë dhe situatën si pa rrugëdalje, kjo mund të rezultojë në ndjesinë që nuk ka arsye të vazhdojnë të jetojnë, gjë që mund të shpjerë (dhe shpesh ndodh) në tentativa për t'i dhënë fund jetës.

Profili fizik i tyre demonstroi që ata/ato janë viktimat të dhunës së vazhdueshme (p.sh. thyerje kockash, plagë plumbi, thikash apo djegiesh cigareje etj.) dhe neglizhencës së tutorëve, dhunës së pësuar prej shfrytëzuesve të tyre dhe mosmarrjes së ndihmës mjekësore në kohën e duhur.

Pjesa më e madhe e vendeve pritëse nuk u njohin viktimave të trafikuar statusin e qëndrimit të ligjshëm. Rrjedhojë e kësaj politike është që viktimat e trafikimit të genieve njerëzore dëbohen ose kthehen vullnetarisht në vendin e tyre të origjinës. Gjatë rrugës së kthimit, viktimat mund të përballen më probleme serioze. Ato shpesh nuk kanë dokumente udhëtimi apo identiteti, dhe për këtë arsye ndeshen me probleme gjatë tranzitimit, dhe me probleme në hyrje të vendit të tyre të origjinës. Dhe më e keqja është se në rast se udhëtojnë vetëm, këta persona mund të bien përsëri në duart e trafikuesve.

Gratë që kanë punuar në industrinë e seksit janë veçanërisht të frikësuar nga ndëshkimet dhe refuzimi i anëtarëve të familjes apo nga shoqëria. Familja si institucion i veçantë shoqëror, përherë ka pasur dhe tani ka funksione dhe detyra të shumfishta në formimin, edukimin, ngritjen, zhvillimin dhe afirmimin e anëtarëve të vet, e sidomos fëmijëve dhe të rinjve.<sup>269</sup> Ato mbeten pa shtëpi dhe kanë nevojë për strehim dhe asistencë financiare. Për këtë arsye, në mënyrë që ato të ndihmohen të integrohen ose të ri-integrohen në tregun e punës, janë të domosdoshme trainimet profesionale, mundësi arsimimi të mëtejshëm, si dhe punësim.

Asistenca ka për synim kryesor që viktimat e trafikuar të marrin veten dhe të ndihen mirë nga ana fizike dhe psikologjike, në mënyrë që të jenë të përgatitura për kthimin në jetën normale dhe të planifikojnë të ardhmen e tyre.<sup>270</sup>

---

<sup>269</sup> V.Latifi, *Politika Kriminale*, Prishtinë 2003, fq. 187.

<sup>270</sup> Në Shqipëri janë një varg organizatash që i kushtojnë një pjesë të madhe të veprimtarisë së tyre parandalimit dhe mbështetjes së grave të dhunuara: Qendra "Vatra e Gruas Vlonjate", me seli në qytetin e



Policia, sektori ONQ-OJF dhe viktimave duhet të punojnë në një atmosferë besimi ndërsa bëhen përgatitjet për riatdhesim. Udhëtimi për në shtëpi duhet të përgatitet me kujdes dhe në këtë proces policia mund të luaj një rol shumë të rëndësishëm.

## **8.2. Riintegrimi i viktimave.**

Proçesi i riintegritit synon të bëjë një rifutje të sigurt, me dinjitet dhe jetëgjatë të viktimës në shoqëri dhe në jetën normale. Ndhima për riintegrimin e viktimave të trafikimit mund të përfshijë një gamë të gjerë shërbimesh, nga ndihma për strehim në qendër ose në vend tjetër, kujdes mjekësor dhe psikologjik, këshillim shoqëror dhe ligjor, deri te futja në shkollë dhe trajnim profesional. Një pjesë e ndihmës jepet drejtpërdrejtë nga organizata pritëse ose nga organizata kryesore që mundëson riintegrimin e viktimës. Megjithatë, shumë shërbime mund të kryhen dhe administrohen në vendin ku jeton viktimave nga OJQ dhe partnerë të tjerë qeveritarë. Të gjitha shërbimet dhe ndihma për riintegrim i duhet ofruar viktimës vetëm nëse ajo dëshiron. IOM-i rekomandon që organizatat, të cilat ofrojnë shërbime, duhet të miratojnë politika që e detyrojnë personelin t'i shpjegojë viktimës pasojat dhe domethëniet e mundshme të ndihmës që ofrohet. Shërbimet duhet të ofrohen vetëm me pëlqimin dhe pas një mirëinformimi të viktimës, duke respektuar të drejtën e saj për intimitet dhe në konfidencialitet të plotë.

### *8.2.1. Vlerësimi dhe plani i riintegritit.*

Vlerësimi i riintegritit është i rëndësishëm për hartimin e planit të riintegritit për secilën viktimë. Për secilën prej viktimave duhet të kryhen dy lloje vlerësimesh:

- Vlerësimi individual, i cili përqëndrohet te faktorët që lidhen drejtpërdrejt me viktimën;
- Vlerësimi i gjendjes që përqëndrohet te gjendja e pavarur e mjedisit ku ndodhet viktimave, për shembull gjendja e veçantë social-ekonomike dhe infrastruktura e

---

Vlorës; “Strehëza” për gra dhe vajza të huaja e shqipëtare të trafikuar, me seli në Tiranë, themeluar dhe në administrim të ICMC-së dhe IOM-it; Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza, me seli në Tiranë dhe me degë në Shkodër, Pogradec, Berat, e cila drejtohet me sukses nga psikologja Silvana Mirija dhe Qendra Avokatore për Gratë, me seli në Tiranë dhe me degë të saj në qytetin e Shkodrës, themeluar nga Shoqata e Grave Juriste etj.

ndihmës për riintegrim në vendin dhe/ose rajonin në të cilin është kthyer viktima.

Planet e riintegritit duhet të hartohen vetëm në vendin pritës dhe jo në vendin referues, pasi organizata në vendin referues nuk mund të kryejë vlerësimin e duhur të gjëndjes në vendin pritës ose të parandalojë keqinterpretimin nga ana e viktimës të atyre që thotë organizata dhe kuptimin e tyre si premtime për mundësitë specifike të riintegritit. Në vend të kësaj, organizata referuese duhet ta informojë viktimën se plani përfundimtar i riintegritit do të përcaktohet në vendin pritës. Megjithatë, organizata referuese duhet të kryejë një vlerësim të thjeshtë individual të nevojave dhe dëshirave të viktimës dhe t'ia dërgojë atë organizatës pritëse bashkë me lajmërimin para nisjes.

Mirëqenia imediate e viktimës duhet të zërë gjithmonë vendin kryesor në procesin e riintegritit, prandaj, zakonisht iu jepet përparësi çështjeve të sigurisë dhe shëndetit, sidomos kur ka burime të kufizuara njerëzore dhe financiare dhe pak kohë në dispozicion.

#### *8.2.2. Plani i riintegritit.*

Duke u mbështetur te vlerësimet individuale dhe në gjëndjen e viktimës, mund të hartohet një plan i gjithanshëm për riintegrimin. Gjatë hartimit të planit të riintegritit, organizata që ofron shërbime ose një OJQ partnere, duhet t'i ndihmojë viktimat të caktojnë objektiva realiste që i përshtaten jo vetëm nevojave, aftësive dhe kualifikimeve vetjake, por edhe mundësive që ofron vendi, rajoni dhe vendbanimi, ku do të bëhet riintegrimi, në përputhjen me vlerësimin e riintegritit. Për më tepër, plani i riintegritit duhet të bazohet në shërbimet që mund të ofrojnë programet e organizatës ose të partnerëve të saj aktualë. Kjo duhet të përfshihet në vlerësimin e riintegritit.

Edhe në qoftë se do të ketë nevojë për ndryshime në të ardhmen, është e rekomandueshme që të hartohet një plan riintegriti me shkrim midis organizatave që ofrojnë ndihmë (për shembull ONQ, OJQ, autoritete shtetërore) dhe viktimës. Format i tij specifik ndyshon nga një vend në tjetrin dhe nga një organizatë te tjetra, por zakonisht ai përfshin dhe merret me komponentët e mëposhtëm, sipas përshtatshmërisë:

- Ndërmjetësimi/bashkimi me familjen;
- Shërbime shëndetësore/mjekësore;

- Shërbime financiare (grante për rivendosje, grante për mbështetjen e familjes, vartësve).
- Shërbime ligjore;
- Mundësi arsimimi/trajnimi profesional /praktika;
- Përfshirje në veprimtari që sjellin të ardhura;
- Siguria.

### 8.2.3. *Vlerësimi i procesit të riintegrit, vetëvlerësimi dhe vlerësimi i jashtëm.*

Organizata që ofron shërbime duhet të rishikojë, të vlerësojë dhe të përshtasë (kur është e nevojshme) në mënyrë të vazhdueshme procedurat e veta të ndihmës për riintegrim.

Metodat e vlerësimit që vijojnë mund të jenë të dobishme:

- Vlerësim i viktimës;
- Vetëvlerësim;
- Vlerësim i jashtëm;
- Vlerësim i donatorëve;
- Vlerësim si pjesë e procesit të studimit të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit;

Reagimi i përfituesve të ndihmës për riintegrim mund të jetë një tregues i mirë i pikave të forta dhe të dobëta të projektit dhe të nivelit të plotësimit të nevojave mjekësore, psikologjike, financiare, sociale dhe ligjore. Ai mund të ndihmojë, gjithashtu, në përcaktimin e nevojave të tjera që duhen marrë në konsideratë në projekte të ardhshme. Organizata që ofron shërbime mund të krijojë një formular vlerësimi që plotësohet në mënyrë anonime (nëse është e mundur) nga secila viktimë që ndihmohet. Ky formular duhet të përfshijë të gjitha fazat e procesit të riintegrit, si për shembull ndihmën e marrë në vendin referues, në nisje dhe mbërritje, ndihmën mjekësore dhe psikologjike, grantet për riintegrimin, programet dhe trajnimet profesionale, ndihmën ligjore dhe forma të tjera ndihme.

Vetëvlerësimi i vazhdueshëm do të bëjë të mundur studimin nga brenda vendit të pikave të forta dhe të dobëta të situatës aktuale të riintegrit dhe do të rrisë njohuritë institucionale të organizatës për planifikimin dhe përfshirjen e elementeve më të dobishme për riintegrimin.

Për të pasur një vlerësim të drejtë të procedurave të saj të riintegrit, organizata që ofron shërbime mund të përdorë agjenci të jashtme për kryerjen e vlerësimit dhe të raportimit të pikave të forta dhe të dobëta të programeve të saj dhe për të bërë sugjerime për përmirësime të nevojshme.

## **9. Standardet ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e viktimave.**

Standartet ndërkombëtare e njohin në mënyrë të qartë faktin që proçesi i drejtësisë kriminale jo vetëm që duhet të tregohet i drejtë me të akuzuarit por edhe me viktimat e krimit. Gur themeli për këtë zhvillim ishte miratimi i Deklaratës së Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe për Abuzimin e Pushtetit nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në vitin 1985.

Deklarata e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe për Abuzimin e Pushtetit<sup>271</sup> përvijon një katalog me parimet bazë për viktimat e krimit në lidhje me të drejtën që atyre duhet t'u njihet për drejtësi dhe trajtim të rregullt, restituim, kompensim dhe asistencë. Kjo deklaratë u miratua me konsensus nga Asambleja e Përgjithshme e OKB dhe kështu pasqyron dëshirën kolektive të komunitetit ndërkombëtar për të rivendosur drejtpeshimin midis të drejtave themelore të të dyshuarve dhe shkelësve, dhe të drejtave dhe interesave të viktimave.

**UN – TOCC<sup>272</sup> dhe UN – TrafProt.<sup>273</sup>** Këto dy instrumenta përbëjnë ngjarje të shënuar në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e viktimave. Hyrja në fuqi e tyre do të transformojë shumë dispozita të Deklaratës së OKB të Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe të Abuzimit të Pushtetit duke kaluar kështu nga një ligj i butë në instrumente ligjore detyruese. Si rezultat i detyrueshmërisë së tyre, edhe efektiviteti i mbrojtjes së të drejtave të viktimave do të jetë më i lartë.

Në Maj të vitit 2002, si një rrjedhojë e Protokollit të Trafikimit të OKB, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, botoi “Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara mbi të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin Njerëzor”.<sup>274</sup>

---

<sup>271</sup> *Deklarata e OKB e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit*, e miratuar nëpërmjet një rezolute të Asamblesë Përgjithshme nr. 40/34 e 29 Nëntorit 1985.

<sup>272</sup> *Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Trans-Nacional*.

<sup>273</sup> *Protokolli i Kombeve të Bashkuara për të Parandaluar, Shtypur dhe Dënuar Trafikimin e Personave, Veçanërisht të Grave dhe të Fëmijëve*.

<sup>274</sup> E/2002/68/Add. 1, 20 Maj 2002.

Ky dokument është i një rëndësie specifike për interpretimin e të drejtave të viktimave të trafikimit.

### **9.1. E drejta për informim.**

Informimi i viktimave mbi të drejtat ligjore përbën një komponent shumë të rëndësishëm që i jep viktimës siguri dhe e bën të kuptojë se ka mjete ligjore dhe sociale që mund t'i përdorë në favor të saj. Nevojiten masa legjislative që t'i garantojnë viktimës së trafikimit të qënieve njerëzore informim ligjor që në momentin e kallëzimit, hetimit dhe gjykimit të çështjes.

Profesionistët e sistemit të drejtësisë shpesh kanë informuar ose referuar viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore pranë Qendrës Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit si edhe të gjitha qendrave të tjera të licensuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të cilat ofrojnë shërbime pritje, akomodimi ose reabilitimi.

Nevojitet marrja e masave për të siguruar që viktimat e krimit, përfshirë viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore, informohen në lidhje me të drejtat e tyre dhe përfitojnë asistencë që në kontaktin e tyre të parë me organet e policisë dhe prokurorisë si dhe përgjatë procedurave gjyqësore. Kuadri ligjor dhe praktik i sistemit gjyqësor duhet të rishikohet me qëllim përcaktimin e detyrimeve të qarta për aktorët e tij dhe për mundësimin e aksesit të viktimave të krimit në informacion në lidhje me të drejtat e tyre (si p.sh. përmes dispozitave në Kodin e Procedurës Penale, udhëzimeve për oficerët e policisë, prokurorët etj.).

### **9.2. E drejta për ndihmë ligjore.**

Mbrojtje ligjore falas garanton Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë për çdo shtetas, i cili gjykohet në një proces penal dhe nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar një avokat. Neni 31, gërma ç sanksionon se:

*“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme”.*<sup>275</sup>

---

<sup>275</sup>Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998.

Në të njëjtën frymë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në pikën 7 të Nenit 49 të Kodit të Proçedurës Penale, është sanksionuar detyrimi i shtetit për të paguar shpenzimet e bëra për mbrojtjen vetëm ndaj të pandehurit, kur ky i fundit, nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar një avokat<sup>276</sup>. Ndërsa, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, në një proçes gjyqësor penal ka vetëm pozitën e dëshmitares, në këto kushte organi procedues dhe ai i gjykimit nuk kanë detyrimin ligjor për t'i siguruar asaj (viktimës) avokat mbrojtës.

E drejta për t'u mbrojtur me avokat i mundësohet viktimës së trafikimit vetëm në rastet kur merr pjesë në proçesin penal me statusin e paditëses civile për të kërkuar dëmshpërblimin nga autori i veprës penale, në bazë të nenit 61 e 62 të Kodit të Proçedurës Penale. Edhe në këtë rast shteti nuk garanton shërbim ligjor falas për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

Në këto kushte, Organizatat Jofitimprurëse të licensuara, në Tiranë dhe rrethe kanë ofruar shërbime ligjore dhe të tjera<sup>277</sup> falas për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, në kuadrin e projekteve të ndryshme që mbështeten nga donatorë të huaj. Kontributi i tyre në ofrimin e shërbimeve ligjore falas në Shqipëri ka mundësuar trajtimin e shumë problemeve me natyrë ligjore duke përbërë mënyrën e vetme që mundëson mbrojtjen e të drejtave të personave me të ardhura të pamjaftueshme dhe të grupeve në nevojë.

Në kuadrin e përmbushjes së standardeve ndërkombëtare dhe detyrimeve që burojnë prej tyre për Shtetet Palë, Shteti Shqiptar ka bërë përpjekje serioze për të garantuar të drejtën e shtetasve për shërbim ligjor falas.

Miratimi i Ligjit nr.10039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike" përbën një zhvillim të rëndësishëm në kuadrin ligjor në lidhje me garantimin e të drejtës për mbrojtjen ligjore falas.

Është një sfidë për Organizatat Jofitimprurëse që adresojnë trafikimin e qenieve njerëzore që të krijohen organet përgjegjëse në zbatim të këtij ligji dhe të llobojnë në organet përkatëse për zbatimin e këtij ligji, me synim që viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore të jenë subjekt që përfitojnë asistencë ligjore falas.

---

<sup>276</sup>K.Pr.Penale të R.Sh., Tiranë, 2001.

<sup>277</sup>Ja si e vlerëson *Raporti i OSBE-ODHIR-it* (Barcelonë 2007) për Shqipërinë këtë ndihmë të ofruar nga OJF-të: "Së paku një OJF, CLCI, ofron këshillime ligjore për viktimat e trafikimit, por kjo gjë nuk duket të jetë pjesë e mekanizmave të referimit në shtet. IOM ofron asistencë ligjore falas për Qendrën shtetërore të pritjes dhe NGI menaxhon një strehëz, "Diferent and Equal". Në përgjithësi, strehëzat bashkëpunojnë me OJF-të si CLCI dhe Klinikën ligjore për të miturit. Cilësia e shërbimeve të ofruara prej tyre ka një reputacion të mirë si eksperte në këshillimet ligjore...".

### **9.3. E drejta për mbrojtje/siguri fizike.**

Një detyrim i qenësishëm, që buron nga aktet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Shqipëria konsiston në përmirësimin e statusit të viktimës dhe ofrimin e asistencës për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, duke nënvizuar se, fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore mund të parandalohet dhe goditet me efektivitet, vetëm kur në qendër të masave që merren është viktimja. Këto detyrime përfshijnë jo vetëm marrjen e masave legislative dhe/ose administrative që u sigurojnë viktimave informacion në lidhje me procedurat gjyqësore dhe administrative, por edhe asistencën, lehtësimin dhe pranimin, kthimin e personit të trafikuar pa vonesa të paarsyeshme, garantimin e sigurisë fizike të viktimave të trafikut, si dhe përfshirjen në sistemin ligjor të atyre masave që ju ofrojnë viktimave të trafikimit mundësinë e kompensimit për dëmin që u është shkaktuar.

Pra, një komponent shumë i rëndësishëm është siguria fizike e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore pa garantimin e të cilës ato nuk mund të gëzonin të drejta të tjera të rëndësishme si e drejta për kompensim, e drejta për tu informuar, e drejta për asistencë ligjore, etj.

Në këtë kuadër paraqet interes rrethi i masave mbrojtëse që parashikohen në Kodin e Proçedurës Penale për dëshmitarët, në pozitën e të cilëve ndodhen shpesh viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

Në Kodin e Proçedurës Penale (ndryshimet e parashikuara me Ligjin nr. 9276, datë 16.09.2004, në Nenin 361 pika 7), parashikohet që dëshmitari të pyetet në distancë, brenda ose jashtë vendit, me anë të lidhjes audiovizive. Ky ndryshim lindi si nevojë e domosdoshme për sigurimin e efikasitetit në punën e organeve të proçedimit penal dhe sistemit gjyqësor për goditjen e autorëve të krimit të organizuar, sigurimin dhe mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave të trafikimit nga kërcënimet serioze të të pandehurve dhe personave të tjerë të lidhur me ta, të cilat pengojnë seriozisht dhe krijojnë vështirësi për vërtetimin e fajësisë dhe ndëshkimin e tyre.

Neni 316 germa “a” i Kodit të Proçedurës Penale (i shtuar me Ligjin nr.9276, datë 16.09.2004), parashikon pyetjen e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe të dëshmitarëve të mbrojtur nën masa të veçanta mbrojtjeje. Përveç mundësisë së marrjes në pyetje në distancë të tyre me anë të lidhjes audiovizive, gjykata, kur është vendosur ndryshimi i identitetit, urdhëron marrjen e masave të përshtatshme për të bërë të mundur që fytyra

dhe zëri të mos jenë të dallueshëm. Kjo dispozitë përbën një arritje edhe në rastin kur në këtë pozitë mund të ndodhen viktimat e trafikimit.

Sigurimi i provës gjatë hetimeve paraprake, në raste të caktuara (siç parashikohet në nenin 316 të Kodit të Proçedurës Penale) rrit sigurinë e viktimës dhe shkurton kohën e proçedurave gjyqësore. Përveç prokurorit, edhe personi i dëmtuar apo viktimat e trafikimit mund të paraqesë kërkesë për ndjekjen e kësaj proçedure.

Ligjvënësi ka treguar një kujdes të veçantë lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve të mitur. Kodi i Proçedurës Penale ka parashikuar pyetjen e dëshmitarëve të mitur nga kryetari i trupit gjykues në lidhje me kërkesat dhe kundërshtimet e palëve, me qëllim mbrojtjen e të miturve nga riviktimizimi. Kjo është një masë e përshtatshme pasi përballja e të miturit me të akuzuarin për kryerjen e këtyre veprave penale, do të rrezikonte mirëqenien fizike dhe mendore të tij.

Ligji nr. 9110, datë 24.07.2003 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave të Krimeve të Rënda", në nenin 7 të tij parashikon rregulla të veçanta proçedurale dhe parashikon se gjykimi i çështjeve nga Gjykatat për Krime të Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda bëhet me dyer të mbyllura kur një gjë e tillë çmohet e domosdoshme për çështjen që gjykohet ose për proçedime të tjera, në interes të sigurimit kombëtar, rendit publik, të drejtësisë dhe të mbrojtjes së pjesëmarrësve në proçes. Në lidhje me pyetjen e dëshmitarëve ky ligj në Nenin 8 të tij parashikon që gjykatat për krime të rënda të lejojnë që pyetja e dëshmitarit, si dhe ballafaqimet dhe leximet e lejueshme të bëhen duke zbatuar, bashkërisht ose veçmas, rregullat vijuese:

- a) Në praninë e të pandehurit dhe mbrojtësit, por pa kontakt vizual;
- b) Pa i komunikuar të pandehurit dhe mbrojtësit identitetin e dëshmitarit;
- c) Në raste dhe mënyra të tjera të caktuara, sipas legjislacionit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Këto dispozita paraqesin një rëndësi të veçantë në rastet kur viktimat e trafikimit të genieve njerëzore, merr pjesë në proçes si në rastet kur ajo është me cilësinë e dëshmitares ashtu dhe në rastet kur paraqitet si paditëse civile në proçesin penal për kërkimin e dëmshpërblimit nga autori i veprës penale.

Përveç dispozitave të parashikuara nga ligjet e mësipërme, në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve, Ligji nr.9205, datë 15.03.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë" përfaqëson një akt tjetër të rëndësishëm. Ky ligj,



përcakton në mënyrë të hollësishme masat e posaçme, mënyrën dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara me propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes. Ligji ndihmon në plotësimin e kuadrit ligjor për përmirësimin e punës në parandalimin dhe goditjen e veprave penale të trafikimit. Mbrojtja e dëshmitarëve, pra edhe mbrojtja e dëshmitarit të dëmtuar nga vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore (viktimitës së trafikimit) përbën një garanci jo vetëm në ndjekjen penale të autorëve të këtyre veprave, por edhe në sigurinë e nevojshme ndaj viktimave, për ushtrimin e të drejtave ligjore.

**Zbatimi në praktikë:** Gjatë vitit 2006 janë marrë masa të posaçme mbrojtjeje në bazë të këtij ligji, vetëm për një dëshmitare të drejtësisë, në bazë të propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm. Bashkëpunëtorja e drejtësisë ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë për veprën penale të trafikimit. Në këtë proces, personi që ka fituar statusin, ka qenë dëshmitar kryesor dhe viktimë e trafikimit. Mbi bazë të dëshmisë së saj janë akuzuar 4 shtetas, akuzat ndaj të cilëve janë vërtetuar në proces dhe janë dënuar nga gjykata me 9 vjet burg.<sup>278</sup>

#### **9.4. E drejta për rehabilitim e viktimave.**

Qëndrimi profesional dhe i ndjeshëm i gjyqtarëve, prokurorëve dhe punonjësve të policisë ndaj viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore përbën një komponent të rëndësishëm, i cili jo vetëm lehtëson procesin hetimor dhe gjyqësor, por në të njëjtën kohë ndihmon në rehabilitimin e viktimave.

Gjyqtarët, prokurorët, punonjësit e policisë dhe avokatët reflektojnë në disa raste qëndrime jo të ndjeshme ndaj nevojave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Shpesh profesionistët e sistemit të drejtësisë i kushtojnë vëmendjen e duhur mbledhjes së provave me qëllim ndëshkimin e autorit të veprës penale, por nuk njohin drejtësinë restauruese dhe rëndësinë e saj për viktimat.

Ka raste në të cilat gjuha e profesionistëve të sistemit të drejtësisë është diskriminuese ndaj viktimave duke përdorur terma të tillë si “prostitutë”, “industri e qejfit” etj. Kjo nuk është në përputhje me standardet dhe e riviktimizon viktimën.<sup>279</sup>

---

<sup>278</sup> Njësia Antitrafik, Ministria e Brendshme, “Raporti për realizimin e strategjisë kombëtare shqiptare të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Janar – Dhjetor 2006”, Mars 2007.

<sup>279</sup> Shih Vendimin nr.29, datë 06.10.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Në mbështetjen dhe restaurimin e viktimës një rol të rëndësishëm luan edhe mbështetja psikologjike e saj. Mendojmë se ky trajtim, si aspekt i rëndësishëm i praktikës gjyqësore është problematik dhe meriton vëmendje të veçantë.

Nga analiza e vendimeve të Gjykatës së Tiranës për periudhën 2001-2013, në një rast<sup>280</sup> rezulton se gjykata ka kërkuar pjesëmarrjen e një eksperti psikolog për të asistuar viktimën e trafikimit. Ndërsa, në një rast tjetër<sup>281</sup> (nga pjesa arsyetuese e vendimit), rezulton se viktima është pyetur nga një psikologe, për shkak të moshës së saj të mitur. Siguria e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, mbështetja psiko-sociale në çdo hap, rritja e nivelit të tyre të ndërgjegjësimit mbi të drejtat ligjore dhe sociale, këshillimi ligjor, përfaqësimi i çështjeve në gjykatat e shkallëve të ndryshme, asistenca ligjore për kërkimin e dëmshpërblimit nga shteti ose autori i këtyre veprave penale, ofrimi i shërbimeve ligjore për çështje familjare dhe të tjera për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, të lidhura ngushtë me njëra tjetrën konsiderohen komponentë të rëndësishëm që mund të bëjnë realitet rehabilitimin dhe integrimin e këtij target grupi në shoqëri.

#### **10. Të dhëna lidhur me viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore bazuar në studimin e çështjeve penale gjyqësore (mbi trafikimin e qenieve njerëzore) në Shqipëri për periudhën 2004 -2014.**

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare nëpërmjet studimit të kryer të vendimeve gjyqësore penale për periudhën 2004-2007 dhe studimit të seancave gjyqësore pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda gjatë vitit 2007, ka konstatuar se pothuajse në çdo rast të gjykimit të çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore, dëshmia e viktimës së trafikimit është realizuar në bazë të Nenit 316 e vijues të Kodit të Proedurës Penale me sigurim prove, si dhe bazuar në Nenin 361/7, me pyetje në distancë.

Gjatë vitit 2007 vihet re një tendencë në rritje e dëshmive në sallë të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Si rezultat i një politike agresive ndaj këtij fenomeni, e shoqëruar kjo me dënime të rënda dhe me konfiskim të pasurive të autorëve të krimit, fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore është ulur ndjeshëm. Sipas statistikave të Raportit të Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007, trafikimi si i femrave dhe i fëmijëve është në ulje. Kështu, për vitin 2005 ka

<sup>280</sup> *Vendim i datës 12.11.2004* (Gjykim lidhur me Nenin 101 të Kodit Penal).

<sup>281</sup> *Vendim i datës 09.05.2006* (Gjykim lidhur me Nenin 101 të Kodit Penal).

pasur 30 femra viktima të trafikimit dhe 7 fëmijë; në vitin 2006 ka pasur 25 femra dhe 4 fëmijë viktima të trafikimit dhe në vitin 2007 ka pasur vetëm 12 femra dhe 3 fëmijë viktima të trafikimit.

Rezulton se kemi një numër të ulët të viktimave të trafikimit që deklarojnë dëshminë e tyre edhe në proceset gjyqësore. Parë në këtë këndvështrim, si dhe në kuadër të detyrimeve për unifikimin e legjislacionit dhe praktikave me standardet ndërkombëtare, organet e drejtësisë e kane konsideruar si një prioritet sigurinë dhe mirëqenien e viktimës.

Bashkëpunimi i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore me organet e drejtësisë vlerësohet si mjaft i rëndësishëm për ndjekjen penale të autorëve, për shkak të elementëve të këtyre veprave dhe mënyrave se si kryhet trafikimi i qenieve njerëzore.

Me qëllim zbehjen e bashkëpunimit të viktimave me organet e drejtësisë, trafikantët ushtrojnë presione në formën e kërcënimeve për jetën e viktimave dhe të familjarëve të tyre. Në këto kushte ato hezitojnë të bashkëpunojnë me organet e drejtësisë, edhe gjatë proceseve gjyqësore. Mbrojtja e viktimave, ruajtja e anonimatit, dhe garantimi i sigurisë së viktimave përbën një domosdoshmëri, për ndjekjen penale të autorëve të këtyre veprave.<sup>282</sup> Në ndonjë rast, nga organet e drejtësisë nuk është ofruar siguria dhe mjedisi i përshtatshëm me qëllim që viktima të bashkëpunojë me këto organe. Ky qëndrim ka sjellë dhe raste të gjykimit dhe dënimit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore me akuzën e “dëshmisë së rreme”, sipas Nenit 306/1 i Kodit Penal.<sup>283</sup>

Qëndrime të pakujdesshme, madje në ndonjë rast të veçantë edhe veprime në kundërshtim me ligjin nga ana e organit të akuzës, kanë krijuar mundësi për ritrafikimin e viktimës. Kështu, në Vendimin nr.3, datë 17.01.2006 të Gjykatës së Krimeve të rënda, arsyetohet se: “E dëmtuara, e mashtruar si dhe nën presionin edhe të prindërve të saj, ka tërhequr kallëzimin dhe Prokuroria e Rrethit Bulqizë, ndonëse vepra penale që rezulton nga materiali kallëzues nuk përfshihet në ato të parashikuara nga Neni 284 të

---

<sup>282</sup>Përbushja e kësaj domosdoshmërie përbën një detyrim që buron nga neni 25/1 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, i cili kërkon që shteti shqiptar të marrë masat e duhura për të siguruar ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, veçanërisht në rastet e kërcënimit për hakmarrje ose terrorizimin e tyre. Ky detyrim përforcohet edhe nga Rekomandimet e Komitetit CEDAË, në Janar të vitit 2003, i cili i kërkon Palës Shtetërore të sigurojë që gratë dhe vajzat e trafikuar kanë mbrojtjen dhe mbështetjen për të cilën kanë nevojë që t'i mundësojë të dëshmojnë kundër trafikantëve.

<sup>283</sup>Vendimi nr.29, datë 06.10.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

K.Pr.Penale, ka vendosur mosfillimin e çështjes penale ndaj të pandehurit A.” Në vijim të këtij qëndrimi, e dëmtuara u ritrafikua.

### 10.1. Format e ndjekura nga trafikantët për tërheqjen e viktimës në trafik.

Gjatë periudhës kohore prej vitit 2004 deri në vitin 2014 (6-mujori i I-rë), rezultojnë të jenë ndjekur këto forma të rekrutimit:

#### a) Mashtrimi për martesë dhe mashtrimi për punë.

<b>Format e mashtrimit gjatë vite</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>
Mashtrimi për martesë	5 raste	6 raste	5 raste	5 raste
Mashtrimi për punë	4 raste	-	2 raste	1 rast

Në bazë të tabelës së mësipërme, forma e tërheqjes së viktimës dhe konkretisht ajo e mashtrimit për martesë është më e përhapura. Këto dy forma të mashtrimit janë paraqitur në këtë tabelë në këto raste:


- Gjatë vitit 2004, në 5 raste të akuzuarit kanë përdorur formën e mashtrimit për martesë dhe në 4 raste mashtrimin për punë.
- Gjatë vitit 2005, në 6 raste është përdorur forma e mashtrimit për martesë.
- Gjatë vitit 2006, në 5 raste është përdorur mashtrimi për martesë dhe në dy raste mashtrimi për punë.
- Gjatë vitit 2007, në 5 raste trafikantët kanë përdorur mashtrimin për martesë dhe në një rast mashtrimin për punë.

<b>Format e mashtrimit gjate viteve</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>
Mashtrimi per martese	10 raste	2 rate	2 raste	4 raste	2 raste	1 rast	3 rast
Mashtrimi per pune	4 raste	2 raste	3 raste	3 raste	-	-	2

Edhe në bazë të kësaj tablele për vitet objekt hulumtimi forma e tërheqjes së viktimës dhe konkretisht ajo e mashtrimit për martesë është më e përhapura dhe janë paraqitur në këto raste:

- Gjatë vitit 2008, në 10 raste trafikantët kanë përdorur mashtrimin për martesë dhe në 4 raste rast mashtrimit për punë.
- Gjatë vitit 2009, në 2 raste trafikantët kanë përdorur mashtrimin për martesë dhe në 2 raste rast mashtrimit për punë.
- Gjatë vitit 2010, në 2 raste trafikantët kanë përdorur mashtrimin për martesë dhe në 3 raste rast mashtrimit për punë.
- Gjatë vitit 2011, në 4 raste trafikantët kanë përdorur mashtrimin për martesë dhe në 2 raste rast mashtrimit për punë.
- Gjatë vitit 2012, në 2 raste është përdorur forma e mashtrimit për martesë.
- Gjatë vitit 2013, në 1 rast është përdorur forma e mashtrimit për martesë.
- Gjatë vitit 2014 (6-mujori i I-rë), në 1 rast është përdorur forma e mashtrimit për martesë.

**b) Problemet social-ekonomike, dhuna dhe tortura me të cilat është përballur viktimat:**



Grafiku i mësipërm pasqyron në përqindje dhe përgjatë periudhës kohore 2004-2007 format kryesore të ndjekura nga trafikuesit ndaj viktimave të tyre<sup>284</sup>. Vihet re që ushtrimi i dhunës është forma kryesore vazhdimisht e përdorur për nënshtim. Këto të dhëna paraqiten edhe në vijim :


- Gjatë vitit 2004, në 15.3% të çështjeve të gjykuara kanë rezultuar probleme të mprehta ekonomike, në 30.7% të tyre kanë rezultuar probleme familjare, në 46.1 % të tyre është

<sup>284</sup> Të dhënat e grafikut kanë dalë nga vendimet e Gjykatës për Krime të Rënda për vitet 2004-2007

ushtruar dhunë e formave të ndryshme dhe në 7.6% të tyre është ushtruar torturë mbi viktimën e trafikimit të qenieve njerëzore.

- Gjatë vitit 2005, në 66.6% të rasteve ka rezultuar dhunë e të gjitha formave, në 22.2% të rasteve kanë rezultuar probleme ekonomike dhe familjare dhe në 11.1% të rasteve është ushtruar torturë mbi viktimën e trafikimit të qenieve njerëzore.

- Gjatë vitit 2006, në 25% të rasteve, problemet ekonomike dhe familjare janë prezentë, në 62.5% të tyre dhuna e formave të ndryshme është prezentë dhe në 12.5% të rasteve është ushtruar torturë mbi viktimën e trafikimit të qenieve njerëzore.



Grafiku i mësipërm pasqyron, sipas vendimeve gjatë periudhës kohore 2007-2014, numrin e rasteve për format kryesore të ndjekura nga trafikuesit ndaj viktimave të tyre. Vihet re që edhe në këtë periudhë kohore të hulumtuar ushtrimi i dhunës është forma kryesore vazhdimisht e përdorur për nënshtrim.

Duke u ndalur edhe një herë të dhuna si forma në e shpeshtë e ndjekur nga trafikuesit përballë viktimave të tyre, këto forma të ashpra dhune me të cilat janë përballur viktimat e trafikimit janë: detyrimi për ndërprerjen e shtatzënisë, tentativa për mbytje të viktimës, goditje me shkelma dhe grushte, kërcënim për prerje damarësh, rrahje egërsisht me mjete të forta, kërcënim për vrasje<sup>285</sup>, kërcënim me vdekje nëse nuk tërheq kallëzimin, kërcënim për të mos parë më anëtarët e familjes, rrahje sa për dy ditë viktimat nuk është ngritur nga shtrati,<sup>286</sup> kërcënim se do i presin kokën e forma të tjera ç’njerëzore. Në disa raste viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore është kërcënuar me vdekje në rast të mos tërheqjes së kallëzimit ose i janë premtuar para për tërheqjen e denoncimit. Në rastin e gjyqimit të veprës penale të trafikimit të fëmijëve kemi konstatuar detyrimin e fëmijëve

<sup>285</sup>Vendimi nr.73 akti, datë 14.09.2006, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

<sup>286</sup>Vendimi nr.29, datë 11.06.2007, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

të lypin në semaforët e Athinës, të shesin lule e kartopiceta në llogari të trafikantëve, të kërcënohen etj.<sup>287</sup>

Në rastin e gjykimit të veprës penale të trafikimit të njerëzve kemi konstatuar detyrimin e viktimave nën kërcënimin e armës për transport lëndësh narkotike në shtetin grek.

Kështu në vendimin nr.74, Gjykata per Krime të Rënda ndë të tjera shprehet:

*„...në datë 25.11.2005, një person i identifikuar si I.T., lindur në Fratar, Fier, me banim të përkohshëm në Sarandë, së bashku me një shtetas me emrin Tiku dhe një person me emrin Skënder, që nga hetimi dyshohej të ishte lidhje familjare e I.T., kanë marrë një grup personash që donin të iknin klandestinë në Greqi, me qëllim transportin e lëndëve narkotike në drejtim të Greqisë kundrejt pagesës. Ndër këta persona ishte dhe viktima A.N.. Siç edhe rezulton nga deklaratimet e shtetasve S.S., Gj.S. e B.K., shtetasi I.T., pasi i rekrutonte klandestinët ju jepte atyre nga një çantë rreth 30 kg sejcila, e cila dyshohet të ishte me bimë narkotike dhe merrnin rrugën në këmbë për të kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin, duke transportuar lëndë narkotike në drejtim të Greqisë. Ky transport kryhej nga këta shtetas nën kërcënimin e vazhdueshëm me armë që iu bënte atyre I.T. së bashku me dy shtetas të tjerë.“<sup>288</sup>*

Në një përqindje shumë të lartë të rasteve viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore përballen me braktisjen e familjarëve të tyre. Në disa raste viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore nuk gëzojnë të drejtat e tyre ligjore edhe për shkak të mos gjykimit të çështjes penale me ndjeshmëri sociale nga pikëpamja gjinore. Kështu në Vendimin nr.40/11/66, datë 19.03.2007, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në arsyetimin e saj në lidhje me akuzën e kryerjes nga i pandehuri K.M. të veprës penale të kryerjes së marrëdhënies seksuale me dhunë me të mitura të moshës 14-18 vjeç argumenton se :

*„...Lidhur me akuzën e kryerjes nga i pandehuri K.M. të veprës penale të “marrëdhënies seksuale me dhunë me të mitura të moshës 14-18 vjeç”, të parashikuar nga neni 101/1 i Kodit Penal, kjo gjykatë pas shqyrtimit në tërësi të provave të këtij gjykimi konkludon se provohet fakti që e dëmtuara F.K. të ketë kryer marrëdhënie seksuale me të pandehurin K.M. në mbrëmjen e datës 09/11/2003, pasi dëshmohej nga e dëmtuara dhe konfirmohet me deklaratimet e vetë të pandehurit, por nuk provohet elementi “dhunë” fizike ose psikike për të realizuar kryerjen e tyre. Shpjegimet e dhëna nga e dëmtuara në dëshminë e saj për këtë fakt si “ai me tha zhvishu...Pastaj më mbylli gojën dhe më përdhunoi. Me zhveshi, me mbylli gojën...”kjo gjykatë çmon se nuk provojnë faktin e pretenduar, që i pandehuri të ketë kryer veprime që kanë shkaktuar dhimbje ose dëmtime fizike të të dëmtuarës (koncepti i dhunës fizike) dhe as që të ketë përdorur presion psikik, kanosje për vrasje ose plagosje të rëndë (kuptimi në ligjin penal i dhunës psikike) për të kryer marrëdhënie seksuale me të. Në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor, nr. 412, datë 16/11/2003 ekspertët kanë pasqyruar konkuzionin e arritur pas ekspertimit fizik të të dëmtuarës, sipas të cilit e dëmtuara ka arritur pjekurinë seksuale dhe është e defloruar, por pa përcaktuar datën e saktë të ndodhjes së këtij fakti. Po ashtu ekspertët nuk kanë konstatuar asnjë gjurmë, shenjë dëmtimi të lënë në trupin e të dëmtuarës. Pra në vlerësim të këtij akti ekspertimi nisur nga të dhënat e tij, kjo gjykatë çmon se nuk provohet që i pandehuri të ketë kryer veprime që kanë cënuar fizikisht të dëmtuarën, pasi në trupin e saj nuk konstatohen dëmtime të indeve (hematoma të lehta) ose dëmtime të tjera më të rënda. Duke vlerësuar në lidhje me njëra-tjetrën provat si dëshminë e të dëmtuarës, aktin e ekspertimit mjeko-ligjor*

<sup>287</sup> Vendimi nr.03, datë 16.01.2007, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

<sup>288</sup> Vendimi nr.74, datë 24.06.2014, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

*dhe deklarimet e dhëna nga i pandehuri kjo gjykatë vlerëson se edhe pse e dëmtuara përdor në dëshminë e saj shprehjen “përdhunim” veprimet konkrete të kryera nga i pandehuri K. M. gjatë kryerjes së mardhënieve seksuale me të dëmtuarën F. nuk provohet që të kenë elementin dhunë të kërkuar nga neni 101/1 i Kodit Penal për tu quajtur e kryer vepra penale e “mardhënieve seksuale me të mitur të moshës 14-18 vjeç”.*

Ky arsyetim nuk është në logjikën e një fryme të re që është përcjellë në vendimet e Gjykatës Evropiane të Strasburgut, e cila ka konsideruar veçoritë specifike dhe psikologjike të reagimit të një të miture gjatë kryerjes së marrëdhënieve seksuale me dhunë (M.C kundër Bullgarisë).

## **11. Dëmshpërblimi i viktimave të trafikimit.**

### **11.1. Një vështrim i përgjithshëm i dëmshpërblimit të viktimave të trafikimit.**

Ekzistojnë një sërë instrumentesh ndërkombëtare që mund të përdoren për të mbrojtur të drejtat e personave të trafikuar dhe të shfrytëzuar. Këto standarde tregojnë se, së bashku me praktikën vendase në rritje, e drejta për dëmshpërblim, ashtu si dhe të drejta të tjera ndihmëse si ajo e ndihmës ligjore, po njihen më gjerësisht. Zbatimi i së drejtës në një shtet në veçanti varet nëse ai shtet ka ratifikuar konventën përkatëse. Megjithatë, është e rëndësishme për t’u mbajtur mend se këto janë standarde minimale që duhen respektuar dhe se shtetet janë të lira të përfshijnë dispozita të zgjeruara, duke parashikuar rregulla më të gjera dhe më të detajuara.

Shtetet palë të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (KKBKON)<sup>289</sup> dhe Protokolli i Trafikimit,<sup>290</sup> janë të detyruara të sigurojnë që të paktën një lloj procedure ligjore është në dispozicion të personave të trafikuar me të cilën mund të përfitohet dëmshpërblimi. Shtetet gjithashtu janë të detyruara të sigurojnë që viktimave u jepet informacioni për këtë mundësi. Sipas KKBKON-së, mundësia e dëmshpërblimit duhet nxitur përtej kufijve.

E drejta e personave të trafikuar për dëmshpërblim përforcohet nga Konventa e Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (KKEVTQNj),<sup>291</sup> e cila parashikon të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim nga trafikanti si për dëmin moral, ashtu edhe për atë material. Ajo gjithashtu parashikon të drejtën e përfitimit nga

<sup>289</sup> Miratuar më 15 Nëntor 2000, hyri në fuqi më 29 Shtator 2003.

<sup>290</sup> Protokolli për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve, plotësues i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Protokolli i Trafikimit). Miratuar më 15 Nëntor 2000, hyri në fuqi më 29 Shtator 2003.

<sup>291</sup> Miratuar më 16 Maj 2005, hyri në fuqi më 1 Shkurt 2008.



një skemë shtetërore dëmshpërblimi, duke iu referuar modelit të paraqitur nga Konventa Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme (KEDVKDh).<sup>292</sup> Vihet më shumë theksi tek të drejtat ndihmëse, si ndihma ligjore falas, të cilat e bëjnë dëmshpërblimin një mundësi efektive dhe praktike.

E drejta për dëmshpërblim nga trafikanti dhe shteti mbështetet nga disa instrumente politikisht detyruese (ose “ligje të buta”), ku spikasin Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit dhe legjislacioni i Bashkimit Evropian si Direktiva e Këshillit të BE-së për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimit.

Megjithatë, e drejta për dëmshpërblim nga shteti është e kufizuar dhe jepet vetëm në rrethana të caktuara. KKEVTQNj e kufizon dëmshpërblimin nga shteti vetëm për rastet e dëmit *material* ku vepra penale ka qenë veprim i qëllimshëm dhune që ka rezultuar në dëmtime fizike ose mendore. Ekzistojnë kufizime edhe në lidhje me legjitimitimin për të përfituar nga skema, ku përfshihen kërkesa për të qenë viktimë e krimeve të caktuara, llojet e dhunës dhe llojet e dëmit, si dhe plotësimi i kriterëve të “karakterit të mirë” dhe statusit të emigrimit. Këto faktorë bëjnë që një person i trafikuar mund të mos ketë të drejtë të përfitojë nga dëmshpërblimi sipas kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu, standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së kufizojnë të drejtën e dëmshpërblimit nga shteti për krime që kanë shkaktuar dëme serioze dhe për krimet e dhunshme.

Në çdo rast, të gjithë anëtarët e Këshillit të Evropës janë politikisht të detyruar nga Rekomandimet e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës, për shembull *Rekomandimi R (2006) 8 - Mbi ndihmën ndaj viktimave të krimit*, i cili jep informacione të hollësishme mbi këtë të drejtë dhe mbi çështjet e lidhura. Ka gjithashtu detyrime të tjera të ngjashme për të gjitha vendet anëtare të BE-së, dhe të gjitha shtetet pjesëmarrëse në OSBE janë subjekt i angazhimeve politike detyruese të OSBE-së. Të gjitha këto përforcojnë të drejtën për dëmshpërblim nga trafikanti dhe shpërblim nga shteti në rastet e dhunës ose të dëmtimeve serioze.

Standardet ndërkombëtare të punësimit gjithashtu konfirmojnë të drejtën për mjetet riparuese të dëmit, përfshi dëmshpërblimin në rastet e punës së detyruar dhe kur janë

---

<sup>292</sup> Për më shumë informacion për këtë konventë dhe kufizimet e saj, shih në vijim dhe Shtojcën III.

shkelur të drejtat e punëtorëve dhe të migrantëve.<sup>293</sup> Sipas tyre, në çdo vend është e nevojshme që të ekzistojnë standarde ligjore të punës për të siguruar kryerjen e pagave<sup>294</sup> dhe rregullimin e agjencive private,<sup>295</sup> në mënyrë që të mbrohen të drejtat e punëtorëve. Kjo përfshin sigurimin e “mjeteve mbrojtëse të përshtatshme” për punëtorët të cilëve u janë shkelur këto të drejta.

## **12. Rasti i Shqipërisë.**

### **12.1. Kuadri ligjor dhe institucional.**

Shqipëria është palë në konventat kryesore ndërkombëtare mbi trafikimin, punën e detyruar dhe emigracionin (përveç Konventës së OKB-së mbi Emigracionin). Shqipëria gjithashtu ka nënshkruar Konventën Evropiane kundër Trafikimit dhe Konventën Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme.

Në vitin 2001 qeveria ngriti një grup pune ndërministror për hartimin e planit kombëtar kundër trafikimit. Ekziston Komiteti Shtetëror, dhe në Nëntor të vitit 2005 u krijua zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Ministrinë e Brendshme, e mbështetur nga Njësia Antitrafik.<sup>296</sup> Është miratuar edhe Strategjia Kombëtare 2005-2007 dhe Mekanizmi Kombëtar i Referimit, i miratuar në vitin 2005.<sup>297</sup> Po në vitin 2005, me anë të një urdhri të përbashkët ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, u krijua Autoriteti Përgjegjës, një organizëm i përbashkët përgjegjës për koordinimin dhe studimin e procesit të referimit për asistencën, mbrojtjes dhe riintegrimin të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, regjistrimit të tyre dhe raportimit periodik të të dhënave.

Në Qershor të vitit 2006, u krijuan Komitetet Rajonale Antitrafik, që përbëhen nga përfaqësues të policisë, shërbimeve sociale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore,

---

<sup>293</sup> *Konventat e ILO-s 29 e vitit 1930 dhe 105 e vitit 1957 dhe dokumentet e lidhura si dhe Konventa 97 e ILO-s ‘Migracioni për Punësim’ (1949) dhe Konventa 143 ‘Punëtorët Migrantë’ (Dispozita Shtesë) (1975).*

<sup>294</sup> *Konventa 95 e ILO-s mbi Mbrojtjen e Pagave.*

<sup>295</sup> *Konventa 181 e ILO-s mbi Agjencitë Private të Punësimit.*

<sup>296</sup> Urdhër i Kryeministrit nr.203, datë 19.12.2005.

<sup>297</sup> *Marrëveshje Bashkëpunimi për Krijimin e një Mekanizmi Kombëtar Referues për Identifikim dhe Ndihmë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qenieve Njerëzore (2005) midis: Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Qendrës Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Punëve të Jashtme, VATRA, Vizion Tjetër (Another Vision) dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin – IOM.*

pushtetit vendor dhe aktorë të tjerë që kanë lidhje me fushën.<sup>298</sup> Në Tetor 2006, nisi funksionimi linja telefonike kombëtare falas për raportimin e rasteve të trafikimit. Në lidhje me trafikimin e fëmijëve është miratuar një strategji e veçantë dhe është firmosur me Greqinë një marrëveshje e posaçme.<sup>299</sup>

Trafikimi i qenieve njerëzore është parashikuar si vepër penale në vitin 2001,<sup>300</sup> dhe më vonë u përfshi në Kodin Penal si Neni 110. Ekzistojnë dhe dispozita të tjera në lidhje me trafikimin e femrave dhe të fëmijëve,<sup>301</sup> ndërsa në vitin 2004 këto përkufizime u ndryshuan.<sup>302</sup> Sipas Kodit Penal, përbën vepër penale si trafikimi për shfrytëzim prostitucioni, ashtu edhe ai i punës. Po në vitin 2004, u krijua një gjykatë për krimet e rënda dhe u miratuan ligje për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe luftën kundër krimit të organizuar që përqendrohet në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë (shih më poshtë).<sup>303</sup>

Ekzistojnë edhe shumë OJF që ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për shqiptarët e trafikuar, ku përfshihen Qendra Psiko-Sociale Vatra, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, “Të Ndryshëm por të Barabartë” dhe një qendër shtetërore për referimin e viktimave. Sipas raporteve, bashkëpunimi midis OJF-ve dhe autoriteteve zbatuese të ligjeve mbi identifikimin dhe ndihmën ndaj personave të trafikuar është në përmirësim.<sup>304</sup>

## **12.2. Skemat e dëmshpërblimit dhe të dëmeve.**

### **a) Skemat shtetërore të dëmshpërblimit. Dëmshpërblimi nga gjykatat civile, penale dhe të punës.**

Pavarësisht nga ratifikimi i KEDVKDh-së, në kohën e hartimit të këtij raporti nuk ka të dhëna në lidhje me ekzistencën ose planet për krijimin e ndonjë skeme shtetërore për dëmshpërblimin.<sup>305</sup> Megjithatë, shih pjesën me poshtë mbi sekuestrimin e pasurisë, në

---

<sup>298</sup> Urdhër për Krijimin e Komiteteve Rajonale Anti-Trafik për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Nivel Qarku, 2006.

<sup>299</sup> Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit, 2005 dhe Marrëveshja midis Qeverisë së Republikës Greke dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Fëmijëve Viktima të Trafikimit, 2006.

<sup>300</sup> Ligji nr. 8733, datë 24 Janar 2001.

<sup>301</sup> Nenet 114/b dhe 128/b përkatësisht.

<sup>302</sup> Ndryshuar me Ligjin nr.9188, datë 12.02.2004.

<sup>303</sup> Ligji nr. 9205 “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë”, 2004 dhe Ligji nr. 9284 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar” 2004.

<sup>304</sup> Shih “Vajzat dhe Trafikimi: Studim mbi zhvillimin e trafikimit të grave në Shqipëri”, Vatra, 2005.

<sup>305</sup> Korrik 2007.

lidhje me një skemë shtetërore të sapolindur për dëmshpërblimin nga pasuritë e trafikantëve.

Legjislacioni shqiptar krijon mundësinë e dëmshpërblimit nëpërmjet padisë civile në procesin penal ose padisë civile të pavarur sipas procedurave civile. Ndryshimi kryesor midis të dyjave është se nuk mund të kërkohej dëmi moral me anë të padisë në çështjen penale. Kjo mund të dekurajojë personat e trafikuar në bërjen e kërkesave, duke qenë se në shumicën e rasteve padia e tyre është për dëme morale, dhe në këtë rast ajo duhet ngritur në gjykatën civile ku ka probleme të shpenzimeve, kohës dhe rezultateve të paqarta. Kjo në vetvete ka ulur numrin e kërkesave për shpërblim të dëmit në Shqipëri. Neni 58 i Kodit të Procedurës Penale u jep viktimave të krimit të drejtën “të kërkojnë procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit.”<sup>306</sup> Sipas Nenit 61 “Ai që ka pësuar një dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit.”

Kështu, viktima bëhet “paditësi civil” në procesin penal dhe mund të përfaqësohet me përfaqësues ligjor.<sup>307</sup> Në përfundim të çështjes, dhe kur merret me dënimin dhe shpenzimet, gjykata duhet të merret gjithashtu me padinë për dëmshpërblimin, duke e pranuar atë tërësisht apo pjesërisht ose duke e rrëzuar.<sup>308</sup> Gjykata mund të vendosë veçimin e padisë civile dhe dërgimin e saj në gjykatën civile nëse gjykimi i saj “vështirëson ose zvarrit” procesin penal.<sup>309</sup> “Kur provat e marra nuk mundësojnë saktësimin e dëmit, gjykata disponon për të drejtën e shpërblimit të dëmit në tërësi dhe ia dërgon aktet gjykatës civile...”<sup>310</sup>

Kjo është bërë një praktikë e njohur, pavarësisht nga justifikimi ligjor, ndonëse në raportet e kohëve të fundit të OJF-ve shqiptare, thuhet se ata besojnë se ratifikimi i KEDVKDh-së mund të ketë pasur ndikim në praktikën gjyqësore, sepse një gjykatë në Tiranë ka pranuar së fundi padinë civile në procesin penal në një çështje “shfrytëzim prostitucioni.”<sup>311</sup> Megjithatë, nëse padia civile rrëzohet në procesin penal, ajo nuk mund

---

<sup>306</sup>Këtu krijohet paqartësi për shkak se dëmit i referohet vetëm Neni 58.

<sup>307</sup>Neni 67 i K.Pr.Penale.

<sup>308</sup>Neni 68 i K.Pr.Penale.

<sup>309</sup>Neni 62 i K.Pr.Penale.

<sup>310</sup> Neni 395 i K.Pr.Penale.

<sup>311</sup>Me sa duket në këtë çështje gjykata vendosi që paditësit (viktimës) t'i jepej shuma prej 2 milion Lek (rreth 16 000 EUR) si shpërblim i dëmit material për fitimin e munguar, ndonëse shfrytëzimisexual normalisht do të konsiderohej si “punë e paligjshme.” Vendimi u ankimua, por u la në fuqi nga Gjykata e

të ngrihet përsëri në gjykatën civile.<sup>312</sup> E vetmja mënyrë e riparimit të dëmit moral nga gjykata penale, me kërkesë të paditësit civil, është botimi i dënimit të autorit të veprës penale në gazetë.<sup>313</sup>

Sipas Raportit të OSBE-së në kuadër të Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë, fusha e së drejtës për dëmshpërblim në Shqipëri është mjaft e pazhvilluar, sepse në asnjë prej çështjeve penale të ndjekura nuk ishin paraqitur kërkesa për dëmshpërblim.<sup>314</sup> Një studim tjetër, i kryer nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, e cila analizon 54 çështje penale trafikimi gjatë periudhës 2001-2003, nuk ka hasur asnjë rast ku të jetë paraqitur kërkesa për dëmshpërblim.<sup>315</sup> Arsyet që jepen për këtë janë: mungesa e ndihmës ligjore falas për viktimat e trafikimit; niveli i ulët i ndërgjegjësimit nga ana e viktimave të trafikimit mbi të drejtat e tyre ligjore; fakti që avokatët nuk i këshillojnë siç duhet klientët e tyre; dhe fakti që personat e trafikuar kanë frikë të kërkojnë shpërblimin e dëmit, sepse rrezikojnë hakmarrjen ose ritrafikimin.<sup>316</sup> Sipas Kryetarit të Gjykatës për Krime të Rënda (ku gjykohen çështjet e trafikimit), nuk ka pasur kurrë padi për dëmshpërblim.<sup>317</sup>

Për shkak të kufizimeve të procesit civil për të kërkuar dëmet materiale, personat e trafikuar ka pak të ngjarë të ngrenë padi, përveç rasteve kur mund të provojnë humbjen e të ardhurave si në rastin e lartpërmendur (shih shënimin 101). Ata mund të mos kenë pësuar dëm material ose mund të kenë aq shumë vështirësi për të provuar humbjen me anë të dokumenteve, saqë padia do të ishte e pavlerë. Gjithashtu, organet e policisë dhe të prokurorisë nuk kanë detyrim të informojnë viktimat mbi të drejtën e tyre për dëmshpërblim, dhe si rrjedhojë, njohja e kësaj të drejte nga ana e viktimave dhe mbështetja që kanë, varet nga fakti nëse ato këshillohen nga OJF-të. Është e nevojshme që viktimat t'i njohin të drejtat e tyre sa më parë të jetë e mundur, në mënyrë që të

---

Apelit. Megjithatë, vendimi nuk është zbatuar ende. Informacion i dhënë nga QNLQ nëseminarin e ODIHR-it në Barcelonë, dhjetor 2007, shih shënimin 43.

<sup>312</sup>Neni 68 i Kodit të Proçedurës Penale.

<sup>313</sup>Neni 399 i Kodit të Proçedurës Penale.

<sup>314</sup>*Analysis of the Criminal Justice System of Albania* (Analizë e Sistemit të Drejtësisë Penale në Shqipëri), OSBE 2006, faqe 131.

<sup>315</sup>*Monitoring of the court decisions related to THB in the District Courts of Tirana, Vlora, Shkodra for the period 2001 – 2003* (Studimi i vendimeve gjyqësore në lidhje me Trafikimin e Qenieve Njerëzore në gjykatat e shkallës së parë Tiranë, Vlorë, Shkodër për periudhën 2001-2003), CLCI(QNLQ), 2003.

<sup>316</sup>Korrespondenca me postë elektronike midis hartueses së studimit dhe avokatëve që QNLQ-së, 15 Prill 2007.

<sup>317</sup>Informacion i marrë nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, dhënë hartueses së studimit më 20 Prill 2007.

merren masat për të hartuar kërkesëpadi të vlefshme. Pavarësisht nga kufizimet aktuale të dëmeve që mund të kërkoen, viktimë mund të paraqesë kërkesë, p.sh. për fitimet “e fituara padrejtësisht” nga trafikanti, për të cilat ajo nuk ka qenë në dijeni.

Kodi i Proçedurës Penale nuk i atribuon të drejta të qarta viktimës. Vetëm nëse merr statusin e paditësit civil në proçesin penal, ajo ka të drejtë të përfaqësohet. Si rrjedhojë, njohja e përgjithshme dhe roli i viktimës në proçesin penal është i mangët (p.sh. nuk ka të drejtë t’u drejtojë pyetje dëshmitarëve) dhe kjo mund të sjellë pasoja në praktikë ku të drejtat e viktimës nuk merren seriozisht nga policia, nga prokuroria ose nga vetë gjykata. Edhe në rastet kur viktimë ka përfaqësim ligjor, përfaqësuesit kanë shumë pak të drejta ligjore për të kërkuar në emrin e klientëve.

Në kushtet e mungesës së informacionit në lidhje me paditë civile në proçesin penal, është e pamundur që të bëhet një vlerësim i nivelit të ekzekutimit të vendimeve. Megjithatë, duke pasur parasysh dobësitë në garantimin e gjykimit efektiv të padisë civile, ka të ngjarë që dhe mekanizmat e ekzekutimit të vendimeve të jenë po aq të dobët.

Kodi Civil parashikon ngritjen e padisë civile në proçesin penal në rastet kur individi është dëmtuar nga vepra penale.<sup>318</sup> Të drejtën për t’u drejtuar gjykatës civile e kanë dhe të huajt.<sup>319</sup>

E drejta për shpërblim të dëmit material (pasuror) në dukje përbëhet si vijon:<sup>320</sup>

- I pandehuri shpërblen “dëmin e pësuar” dhe “fitimin e munguar”;
- Shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur dëmin ose për të pakësuar atë;
- Shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore;
- Detyrimi të shpërblejë dëmin që i pandehuri ka shkaktuar ndaj shëndetit të tjetrit, duke pasur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë të të dëmtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij si dhe shpenzime të tjera që janë bërë në lidhje me dëmin e shkaktuar” (Sipas Nenit 641 dhe Nenit 642, duket se masa e shpërblimit të dëmit mund të rritet në të ardhmen në rast të rëndimit të shëndetit);

---

<sup>318</sup>Neni 608 i Kodit Civil.

<sup>319</sup>Neni 3 i Kodit Civil.

<sup>320</sup>Nenet 640-644 të Kodit Civil.

- Kur është shkaktuar vdekja e një personi, dëmet që duhet të shpërblehen përbëhen nga: shpenzime për ushqim e jetesë të fëmijëve të tij të mitur, bashkëshortit dhe personave të tjerë në ngarkim, shpenzimet për varrimin e të vdekurit;
- Neni 644 vendos të drejtën për të kërkuar përfitimet e padrejta kur i pandehuri i ka shkaktuar dëm viktimës.”

Neni 625 i Kodit Civil sanksionon se personi që pëson një dëm të ndryshëm nga ai material (d.m.th. dëm moral), ka të drejtë të shpërblehet kur:

- Ka pësuar dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetit të tij;
- Kur është fyer kujtimi i një të vdekuri, dhe kërkohet nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes, ose nga të afërmit e tij deri në shkallën e dytë, përveç kur fyerja është kryer kur i vdekuri ka qenë gjallë dhe i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit për fyerjen e bërë.”

Kodi i Punës i Shqipërisë trajton vetëm marrëdhëniet “ligjore” ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit. Nëse kryhet punë e pavullnetshme, kjo do të përbënte shkelje të parimeve bazë të Kodit dhe duhet trajtuar nëpërmjet instrumenteve të tjera ligjore në Shqipëri (p.sh. Kodi Civil, Kodi Penal), sepse lidhja punëdhënës-punëmarrës nuk konsiderohet që ka ekzistuar. Neni 8 i Kodit të Punës e ndalon punën e detyruar, por sipas QNLQ-së<sup>321</sup> për këto raste nuk parashikohen dënime. Me sa duket, e vetmja masë është urdhri për ndalimin e veprimtarisë së paligjshme dhe përgjegjësia ligjore civile sipas Kodit Civil.

#### **b) Sekuestrimi i pasurisë.**

Kodi i Proçedurës Penale parashikon sekuestrimin e pasurisë në rastet kur është ngritur padia civile.<sup>322</sup> Gjithashtu, Ligji nr. 9284 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar” u jep autoritet policisë dhe prokurorisë të gjurmojnë, identifikojnë, hetojnë dhe sekuestrojnë pasuritë e paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës, ndër të tjera, në trafikim e personave, të bashkëshortëve dhe familjarëve të tyre.<sup>323</sup> Më pas,

<sup>321</sup>Korrespondencë me postë elektronike midis QNLQ-së dhe hartueses së studimit më 15 Prill 2007.

<sup>322</sup>Neni 63 i Kodit Civil.

<sup>323</sup> Neni 3i Kodit Civil.

gjykata mund të vendosë për konfiskimin e pasurisë, e cila i kalon shtetit.<sup>324</sup> Kreu 7 i të njëjtit ligj thotë se pasuria mund të shitet dhe, ndër të tjera, mund të përdoret për “zhdëmtimin e viktimave”<sup>325</sup> dhe qëllime sociale “për qendrat e asistencës për rehabilitimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.”<sup>326</sup> Duhet të themi këtu se deri tani një gjë e tillë nuk është kryer.

Në raportin vjetor të Koordinatorit Kombëtar, botuar në Shkurt 2006, thuhet se “skema për dëmshpërblimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit, bazuar, ndër të tjera, në pasuritë e konfiskuara të trafikantëve.. do të krijohet së shpejti.”<sup>327</sup> Megjithatë, deri në Dhjetor 2006, nuk ka pasur raste kur pasuritë e konfiskuara të jenë përdorur për dëmshpërblimin e personave të trafikuar, dhe përfaqësuesit e qeverisë u shprehën se Këshilli i Ministrave pritet të nxjerrë një vendim tjetër në lidhje me këtë çështje.<sup>328</sup> Ndër prioritetet e Koordinatorit Kombëtar për 6-mujorin e parë të vitit 2007 është edhe:

“Sigurimi i dëmshpërblimit të viktimave me anë të përdorimit të pasurisë së trafikantëve si rezultat i veprimtarisë kriminale, dhe hartimi i një vendimi qeverie mbi përdorimin e pasurisë së konfiskuar nga grupet e organizuara kriminale. Do të ngrihet një grup i gjerë pune për të vendosur mbi çdo pasuri dhe ndarjen e saj për qëllime sociale, pushtetit vendor dhe agjencive zbatuese të ligjeve, si dhe për dëmshpërblimin e viktimave deri në 40% të pasurisë së konfiskuar.”<sup>329</sup>

Mbetet ende për t’u parë si do të funksionojë ky sistem, si do të përcaktohen “viktimat” dhe si do të shpërndahen pasuritë. Mbetet gjithashtu e paqartë cila është shuma e parave në dispozicion të një fondi të tillë, dhe ka mundësi që do të ketë nevojë për subvencionim shtetëror plotësues. Duhet theksuar se një skemë e tillë nuk është në përputhje me detyrimet e Konventës Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme të ratifikuar nga Shqipëria, e cila kërkon krijimin e një skeme shtetërore për të gjitha viktimat e krimeve të dhunshme.

---

<sup>324</sup> Nenet 25 dhe 30 të Ligjit nr. 9284.

<sup>325</sup> Neni 34 (1).

<sup>326</sup> Neni 34 (2).

<sup>327</sup> Faqe 12.

<sup>328</sup> Sipas Ligjit nr.9284 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar,” kjo është përgjegjësi e Ministrisë së Financave. Megjithatë, Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore thekson se përveç Ministrisë së Financave, kjo është përgjegjësi edhe e Ministrisë së Brendshme, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>329</sup> Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore “Prioritetet afatshkurtrpër parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe disa arritje kryesore në 2006,” Arkivi i ODIHR-it.



### 12.3. Ndhimja për viktimat.

Policia, prokuroria dhe gjykata nuk kanë detyrim të informojnë dhe të këshillojnë viktimat e krimit në lidhje me të drejtat e tyre. Kur viktimat merr pjesë në procesin penal si paditës civil, ka të drejtë të përfaqësohet nga një avokat mbrojtës, duke qenë se është palë në proces.<sup>330</sup> Megjithatë, fakti që nuk ka asistencë ligjore të paguar ose të subvencionuar mund të ndalojë përdorimin e përfaqësimit ligjor nga viktimat, përveç rasteve kur ofrohet vullnetarisht nga OJF-të.

Të paktën një OJF, QNLQ, merret me këshillimin e personave të trafikuar, por kjo nuk është pjesë e një sistemi referimi të sanksionuar nga shteti. IOM-i ofron asistencë ligjore falas në qendrën kombëtare pritëse, dhe OJF-ja “Të Ndryshëm dhe të Barabartë” drejton një strehëz. Në përgjithësi, strehëzat bashkëpunojnë me OJF-të si QNLQ apo Klinika Ligjore për të Mitur. Për këto dy organizata, thuhet se ofrojnë shërbim cilësor meqenëse të dyja kanë përvojë në këshillim ligjor. Është shumë e rëndësishme që ndihma ligjore të përfshijë edhe përfaqësimin ligjor dhe që kjo e drejtë të pasqyrohet në Kodin e Proedurës Penale.

#### *12.3.1. Masa ligjore në drejtim të ndihmës ekonomike dhe sociale të viktimave të trafikimit.*

- Ligji për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.

Ligji për ndihmën dhe shërbimet shoqërore i vitit 2005, parashikon ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore. Ky ligj gjithashtu parashikon edhe përfituesit e ndihmës ekonomike, ndër të cilët nuk bëjnë pjesë viktimat e trafikimit.<sup>331</sup>

---

<sup>330</sup>Neni 67 i K.Pr.Penale.

<sup>331</sup>Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, *Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore”*, [www.ligjet.org](http://www.ligjet.org).

Në vitin 2010, me një ndryshim në ligjin ekzistues për ndihmën ekonomike dhe shoqërore, parashikohen dy ndryshime shumë të rëndësishme në lidhje me këtë kategori.<sup>332</sup> Së pari ky ligj, përcakton nëpërmjet përkufizimit se:

*"Viktimë e trafikimit", nënkupton personin fizik, që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, sipas përkufizimit të shkronjës "e" të nenit 4 të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore".*

Dhe më tej e shton katëgorinë e viktimave të trafikimit si grupe që përfiton ndihmë ekonomike dhe shoqërore prej këtij ligjit bazë të ndryshuar: *"Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre."*

Kreu i Shërbimit Social, Mihal Naço, është shprehur në atë kohë se ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror (Institucionet e Përkujdesit Shoqëror–IPSH) për viktimat e trafikimit (VoT) ose personave rrezik trafikimi, të ngritura nga OJF-të dhe të financuara nga donatorë të ndryshëm, do të mbështeten nga shteti si në planin financiar ashtu dhe atë administrativ. Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të ligjit bazë për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore, janë ngritur njësitë mbikëqyrëse të administrimit të shërbimeve, për këtë kategori në nevojë, të cilat duhet të kryejnë aktivitetin e tyre pranë katër IPSH-ve, në Tiranë, Vlorë, Elbasan dhe Gjirokastrë. Sipas propozimeve të bëra nga Shërbimi Social për këto probleme, të cilat janë marrë parasysh gjatë procesit të hartimit të projektligjit "Për disa shtesa në Ligjin nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", viktimat e trafikimit do të jenë përfituese të ndihmës ekonomike, pasi ato të dalin nga qendrat rezidenciale të shërbimeve të përkujdesit social.<sup>333</sup>

### *12.3.2. Masa të tjera ligjore.*

Në vitin 2008, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, përfaqësues të organizatave që ofrojnë shërbime për personat e trafikuar, përfaqësues të institucioneve rezidenciale, të

<sup>332</sup> Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, *Ligji nr. 10 252, datë 11.03.2010 "Për disa shtesa në Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, [www.ligjet.org](http://www.ligjet.org)*

<sup>333</sup>J. Tashi, *Ligji I ri, viktimat e trafikimit do të përfitojnë ndihmë ekonomike*, 09.02.2010, [http://lajme.parajsa.com/Shqiperia/id\\_152170/](http://lajme.parajsa.com/Shqiperia/id_152170/).

Bashkive dhe të organizatave ndërkombëtare, etj, hartoi Standardet e Shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale.

Këto standarde synojnë përmirësimin e jetës së personave të trafikuar apo në rrezik trafikimi. Ato reflektojnë parimet e njohura të barazisë, respektimin dhe garantimin e vlerave dhe të personalitetit të individit, të drejtat për të përfituar dhe për të qenë i mbrojtur, mosdiskriminimin, ruajtjen e konfidencialitetit të jetës private, të dinjitetit dhe të sigurisë, partneritetin, integrimin shoqëror dhe pjesëmarrjen në jetën e komunitetit.

Disa prej këtyre standardeve janë:

- Qëllimi dhe llojet e shërbimeve: “Ofruesi i shërbimeve ofron një paketë të plotë dhe efikase shërbimesh, në përputhje me nevojat komplekse të përfituesve, në bashkëpunim me ofruesit primarë dhe alternativ, për të mundësuar mbrojtjen e personave në rrezik trafikimi si dhe rehabilitim dhe riintegrim për ata të cilët janë tashmë viktima të trafikimit.”<sup>334</sup>

- Të dhënat personale të përfituesit dhe mënyra e menaxhimit të tyre: “Ofruesi i shërbimit mbledh dhe ruan të dhënat personale të përfituesit duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë profesionale dhe të kujdesshme. Ofruesi i shërbimeve krijon kushte që menaxhimi i të dhënave të bëhet sipas normave ligjore dhe bazuar në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit.”<sup>335</sup>

Qeveria Shqiptare, vëmendje i ka kushtuar edhe punëkërkueseve femra si kategori e cila haset me më shumë vështësi në procesin e riintegrit social. Programi për promovimin e punësimit për punëkërkuaset femra është miratuar me VKM, nr. 632, më 18 Shtator 2003. Një prej masave të parashikuara nga ky program paraqitet si më poshtë:

“Nëse punësohen femra të trafikuar, rome, femra me aftësi të kufizuara, nëna pa bashkëshortë, gra të divorcuara dhe gra me probleme shoqërore dhe financiare...., punëdhënësi përfiton një financim mujor të barabartë me 4, 6 dhe 8 paga mujore të gruas së punësuar, respektivisht.”<sup>336</sup> Përveç programit të sipërpërmendur ka edhe hapa të tjerë pozitivë të ndërmarrë nga qeveria shqiptare me qëllim që të mbështeten

---

<sup>334</sup> Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Standardet për shërbimet e përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale. Tiranë, 2008.

<sup>335</sup> Po aty.

<sup>336</sup> Metani, A. dhe Omari, S. Drejt rrugës për në BE; Studimi i shanseve të barabarta për gratë dhe burrat në Shqipëri. Instituti Shoqëria e Hapur dhe Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim, Tiranë, 2006.

punëkërkuarit përmes ofrimit të trajnimeve personale dhe nëpërmjet ndërmjetësimit për vende pune.<sup>337</sup> Këto masa të programuara synojnë fuqizimin dhe rritjen ekonomike të grave, duke u përqendruar kryesisht tek gratë në nevojë, potencial për trafikim në të ardhmen. Ato janë hartuar bazuar në parimin se lufta kundër fenomeneve kriminale si trafikimi i qenieve njerëzore është efikase në terma afatgjatë kur përpjekjet orientohen drejt shkaqeve që çojnë në lindjen e këtij fenomeni. Disa prej shkaqeve të verifikuara deri tani, ndaj të cilëve edhe janë marrë këto masa, janë: varfëria gjinore, diskriminimi gjinor, përkatësia në grupe/komunitete pakicash që shkakton diskriminim të dyfishtë, etj.

Megjithatë, çdo grup i kategorisë së të trafikuarve apo në rrezik trafikimi ka nevojë për ndihmë të posaçme në përputhje me specifikat e moshës, gjinisë, kushteve familjare, vendit dhe komunitetit nga vijnë, kushteve arsimore, fizike etj., dhe në kushtet ku jemi skemat e ndihmës, duhet të zhvillohen ende e të bëhen më të prekshme dhe të aplikohen në kohën e duhur.

### *12.3.3. Strategjitë antitrafik.*

Kuadri Strategjik dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore janë hartuar në bazë të përvojave dhe mësimave të nxjerra nga të gjitha institucionet kombëtare përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Anti-Trafikun 2001- 2004 të Shqipërisë, si dhe të Planit Kombëtar të Veprimit të fundit të Qeverisë, për periudhën 2005-2007.

Qëllimi i këtij Plani të fundit, si ai i Planit Kombëtar të Veprimit të vitit 2003-2004, është të konsolidojë përparimin e bërë që nga momenti i hartimit të Strategjisë Kombëtare Anti-Trafik 2000- 2001 të Shqipërisë, dhe në të njëjtën kohë të zhvillojë metoda të reja ligjore e institucionale për t'iu pershtatur karakterit në ndryshim të fenomenit të trafikimit, si dhe të zhvillojë mënyra më sistematike, të besueshme e verifikueshme statistikore për të matur rezultatet.

#### **a) Strategjitë antitrafik të hartuara nga shteti Shqiptar, në bashkëpunim me aktorë të tjerë kryesorë janë:**

1. Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Plani i saj i Veprimit 2005-2007;

---

<sup>337</sup> Po aty.

2. Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit 2005-2007;

3. Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit për Periudhën Janar-Dhjetor 2005.<sup>338</sup>

Këtu jemi thjesht në kuadrin e përmendjes së këtyre strategjive, të cilat nuk do shtjellohen për faktin që u ka përfunduar afati kohor.

Të tjera strategji që ndikojnë në parandalimin e trafikimit janë:

1. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2007-2010;

2. Strategjia e Shërbimeve Shoqërore 2005-2010 dhe Plani i saj i Veprimit;

3. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013;

4. Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013;

5. Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale 2007-2013.

#### **b) Strategjitë parandaluese.**

Në mënyrë specifike, për sa i përket parandalimit, duhet pranuar që është e Qeverisë përgjegjësia për të nxitur më shumë përfshirjen sociale dhe alternativat përkundrejt migrimit të paligjshëm dhe trafikimit, nëpërmjet harmonizimit të nismave për uljen e varfërisë, barazi gjinore, arsimim dhe krijim të vendeve të punës.

Strategjia e zbatuar deri tani ka qenë e fokusuar në tre drejtime kryesore:

1. Hetimi dhe ndjekja penale e veprave penale të trafikimit në njerëz;
2. Mbështetja dhe mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve;
3. Parandalimi i trafikimit dhe ritrafikimit.

Kjo strategji mbështetet në parimet e mëposhtme:

1. Përgjegjësia kryesore është e qeverisë.
2. Përfshirja e shoqërisë civile është e rëndësishme.
3. Viktimat e trafikimit duhen trajtuar bazuar në parimet e të drejtave të njeriut.
4. Aktivitetet anti-trafik duhen bashkërenduar mes fushave e sektorëve të ndryshëm në nivel ministror e zyrtar, si dhe mes qeverisë e organizatave ndërkombëtare dhe OJF-ve.
5. Vlerësimi sistematik dhe vazhdueshmëria.

---

<sup>338</sup> Për më tepër informacion shih <http://www.mpcs.gov.al/legjislacioni/strategji-standarte>.

Vlerësimet statistikore kombëtare e ndërkombëtare kanë theksuar se kjo Strategji ka kryer arritjet e mëposhtme:

1. Megjithëse akoma një vend burimi për trafikun, Shqipëria nuk është më një vend i rëndësishëm tranziti apo destinacioni.
2. Janë miratuar ligje anti-trafik, bazuar në standardet ndërkombëtare, përfshirë këtu amendamentet në Kodin Penal, Ligjin Për Mbrojtjen e Dëshmitareve dhe atë Anti-Mafia.
3. Është ngritur një Gjykatë për Krimet e Rënda dhe Task Forca Rajonale për Krimin e Organizuar, për të trajtuar, ndërmjet të tjerash, çështjet më të rënda të trafikimit të qenieve njerëzore.

Ndër strategjitë e tjera, të cilat me anë të masave që kanë parashikuar parandalimin e fenomenit të trafikimit, si dhe mbrojtjen e viktimat të këtij fenomeni, përmendim Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, 2007-2010, dhe Planin e saj të Veprimit<sup>339</sup>, i cili është hartuar në përputhje me ligjin kundër dhunës në familje dhe parashikon masa sociale në ndihmë të grave dhe vajzave të trafikuar apo që janë tepër të cënueshme prej trafikimit.

Një aspekt i rëndësishëm i kësaj strategjie në lidhje me fenomenin e trafikimit është masa e parashikuar për “ndërtimin e programeve me subvencionim të pagës për kategori të përjashtuara grash, si gra e vajza të trafikuar e të dhunuara, afër moshës së pensionit, invalidë ose me aftësi të kufizuara (gra në rrezik)”, masë e parashikuar në kuadrin e fuqizimit ekonomik, si një ndër kushtet themelore për arritjen e barazisë gjinore dhe eliminimin e rrezikut që kërcënon gratë si grup potencial trafikimi. Sipas kësaj strategjie, gratë po bëhen gjithnjë e më të varfra se burrat. Në mënyrë të veçantë papunësia dhe varfëria po ndikojnë negativisht në statusin social të grave shqiptare. Të dhënat mbi varfërinë në Shqipëri, tregojnë për një feminizim të varfërisë dhe rritje të peshës së grave në grupin e të varfërve. Gjeografikisht kemi ritme më të ulta të reduktimit të varfërisë në këto grup-popullata në zonat rurale, ku përveç shumë faktorëve që prodhojnë varfëri, inferioriteti ekonomik e social i gruas ndikon fuqishëm.

---

<sup>339</sup> *Vendim i Këshillit të Ministrave* Nr. 913, datë 19.12.2007 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, 2007-2010, dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

Për më tepër, gratë në Shqipëri kanë më pak akses se burrat për të filluar një punë, për pasojë niveli i papunësisë tek ato është më i lartë. Megjithatë akses i gruas në arsimim është i barabartë me burrat, kjo nuk u siguron grave të njëjtat mundësi në tregun e punës.<sup>340</sup>

Një nga objektivat e planit të veprimit të kësaj strategjie, me qëllim fuqizimin ekonomik të gruas dhe rritjen e mundësive të saj për punësim dhe kualifikim profesional, është edhe rritja e numrit të projekteve apo programeve të cilat nxisin formimin profesional dhe punësimin e grave, si dhe shtrirja e këtyre projekteve edhe në zonat rurale. Gjithashtu është planifikuar edhe ngritja e programeve të kreditimit të grave, sidomos të atyre në zonat sub-urbane dhe rurale për nxitjen e sipërmarrjes.

Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe dhunën në familje 2007-2010 u referohet disa akteve ligjore të cilat favorizojnë grupe shoqërore në rrezik, ku përfshihen edhe gratë e trafikuar. Vlen të përmendet këtu kuadri ligjor në lidhje me arsimin dhe formimin profesional, në mënyrë specifike masa e marrë për tarifën e regjistrimit për kategoritë: komuniteti rom, vajzat dhe gratë e trafikuar, etj, të cilat është vendosur të ofrohen falas për kurset e profesioneve të ofruara nga Qendrat Publike të Formimit Profesional.<sup>341</sup>

Një strategji tjetër e rëndësishme po në këtë linjë është edhe Strategjia e Shërbimeve Shoqërore 2005-2012<sup>342</sup>. Në këtë strategji një vend të veçantë zënë shërbimet sociale që ofrohen për grupet në rrezik, si: fëmijët e gratë e trafikuar, gratë e dhunuara, romët etj. Për sa i takon fëmijëve të trafikuar, kjo Strategji kontribuon në evidentimin e problemeve shoqërore të cilat shpesh në trafikimin e fëmijëve. Këto probleme janë:

- Sisteme të pamjaftueshme shërbimesh për mbrojtjen e fëmijëve, përgjegjës për identifikimin dhe ofrimin e ndihmës së duhur psiko-sociale dhe socio-ekonomike për fëmijët në rrezik dhe familjet e tyre.
- Varfëria, përjashtimi social dhe mundësitë e kufizuara të familjeve për të siguruar ardhura, duke kërkuar që ato të sigurohen edhe me punën e fëmijëve.

---

<sup>340</sup> INSTAT. *Perspektivat gjinore në Shqipëri*. Tiranë, 2004.

<sup>341</sup> Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. *Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2007-2010*. Urdhri Nr. 394 datë 23.02.2004 i Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale “Për tarifën e Sistemit të Formimit Profesional”.

<sup>342</sup> Në vitin 2002 u hartua Strategjia e Shërbimeve Shoqërore 2003-2007, e cila u rishikua në përputhje me ndryshimet legislative dhe në prill 2005 u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 265, 28.4.2005 “Për miratimin e Strategjisë së Shërbimeve Shoqërore (2005-2010)”.

- Mundësitë e kufizuara për punësim brenda vendit dhe rrugët e pakta për emigrim legal, shtynë fëmijët dhe familjet e tyre për të ndërmarrë rrugëzgjidhje të rrezikshme.
- Pamundësi të fëmijëve dhe familjeve në rrezik për të vlerësuar situatat e mundshme për shfrytëzim.
- Mungesa e marrëveshjeve të bashkëpunimit me vendet pritëse të fëmijëve, viktima të trafikimit.<sup>343</sup>

Më tej, kjo Strategji liston masat që do të merren në të ardhmen, me fokus në parandalimin e fenomenit të trafikimit:

- Implementimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të fëmijëve, i cili do të paraqesë një politikë që adresohet drejt parandalimit, mbrojtjes, kthimit vullnetar të asistuar, riatdhesimit dhe riintegrit të fëmijëve të trafikuar.
- Krijimi i mekanizmave shumë-sektoriale të identifikimit të viktimave të trafikimit dhe veçanërisht të fëmijëve të trafikuar.
- Bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet institucioneve dhe partnerëve që punojnë në fushën e trafikimit të fëmijëve.
- Rikthimin në shkollë të fëmijëve të trafikuar dhe në rrezik trafikimi, që nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm dhe ofrimin e alternativave për formim profesional për të rinjtë në moshë pune.<sup>344</sup>

Po kështu, për gratë e trafikuar kjo Strategji rithekson nevojën e masave parandaluese. Konkretisht, përmendet nevoja e më shumë shërbimeve për parandalimin e fenomenit dhe zgjidhjen e problemeve ekonomike të grave e vajzave, programeve për sensibilizimin e grave e vajzave, si dhe riintegrimi i tyre në strukturat e shërbimeve sociale.<sup>345</sup>

Një tjetër strategji e rëndësishme në parandalimin e fenomenit të trafikimit është edhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013. Kjo është një nga strategjitë më të fundme, e Marsit të 2008-s, e cila harmonizon në një dokument të vetëm strategjik axhendën për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e social me axhendën

<sup>343</sup> Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. *Strategjia e Shërbimeve Shoqërore 2005-2010*.

<sup>344</sup> Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. *Strategjia e Shërbimeve Shoqërore 2005-2010*.

<sup>345</sup> Po aty.



e integritit në Bashkimin Europian dhe në strukturat e NATO-s, si dhe me atë të realizimit të Objektivave të Mijëvjeçarit.

Në vazhden e zbatimit të MSA-së, në lidhje me krimin e organizuar, terrorizmin dhe trafikimin, përcaktohen ende si sfidë për shtetin shqiptar dhe aktorët e tjerë kryesorë veprat penale që lidhen me trafikimi ne qenieve njerëzore, siç janë ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve apo shfrytëzim për prostitucion dhe keqtrajtimi i të miturve, megjithëse kontrolli për lëvizjet e skafeve ka vazhduar, sikurse dhe ndjekjet penale dhe dënimet e trafikantëve.<sup>346</sup>

Vizioni i kësaj strategjie në lidhje me rimin e organizuar, terrorizmin dhe trafikimin është një shoqëri pa kërcënime nga krimi i organizuar, në paqe dhe në përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve/eve, duke krijuar në këtë mënyrë imazhin e një vendi të qetë e me standarde të larta të sigurisë. Disa nga përparësitë strategjike dhe politikat që do të ndihmojnë në arritjen e këtij vizioni për sa i përket trafikimit në përgjithësi e parandalimit të tij në veçanti, të përcaktuara në strategjinë ndërsektoriale për luftën kundër krimin të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit janë:

- Sensibilizimi i qytetarëve në lidhje me pasojat e krimin të organizuar mbi destabilizimin e shoqërisë dhe ekonomisë së vendit.
- Zbatimi i detyrimeve nga marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore me organizatat ndërkombëtare.
- Fuqizimi i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë përpara, gjatë dhe pas procesit gjyqësor nëpërmjet zbatimit rigoroz të ligjit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, përmirësimi të bashkëpunimit midis strukturave përgjegjëse, qofshin këto shtetërore, të pavarura apo organizata ndërkombëtare, si dhe nëpërmjet rritjes së besimit të qytetarëve tek forcat e zbatimit të ligjit dhe gjyqësori.
- Kryerja e hetimeve me qëllim shkatërrimin e plotë të rrjeteve kriminale, organizatave kriminale apo grupeve të strukturuar, për të gjitha format e krimin, etj.

Këto përparësi shërbejnë edhe në ruajtjen e rendit publik, ku për arritjen e tyre parashikohet kryesisht menaxhimi i integruar i kufijve, përmirësimi i menaxhimit të

---

<sup>346</sup> Këshilli i Ministrave. *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013*.

policisë, trajnimi i punonjësve të policisë e të shërbimit të inteligjencës në përdorimin e të dhënave informative, etj.<sup>347</sup>

Përtej temave të mësipërme, kjo strategji e trajton trafikimin edhe në aspektin e barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës në familje. Kështu, përparësi mbetet mbështetja për gratë dhe vajzat e pambrojtura përmes fuqizimit të strukturave publike, të cilat trajtojnë viktimat e dhunës dhe të trafikimit, sidomos në fshat, dhe të programeve të cilat synojnë t'i integrojnë këto viktimat.

Të tjera masa, të cilat në mënyrë të tërthortë por efektive ndikojnë në parandalimin e trafikimit me anë të fuqizimit të rolit të gruas në shoqëri janë:

- Fuqizimi ekonomik i grave përmes rritjes së numrit të tyre si sipërmarrëse, duke u dhënë më shumë mundësi për të pasur pronë, kapital dhe kreditime, sidomos për ato të zonave rurale, dhe përmes programeve të posaçme të nxitjes së punësimit të grave.
- Rritja e përfaqësimit të grave e vajzave në proceset vendimmarrëse përmes ndryshimeve në ligjin zgjedhor, si dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë shqiptare për pjesëmarrjen aktive të grave në strukturat politike dhe ekzekutive.
- Parandalimi i dhunës në familje nëpërmjet edukimit të fëmijëve, të rinjve dhe publikut të gjerë, përmirësimit të programeve të lëndëve mësimore, të teksteve shkollore e jashtëshkollore, trajnimit të profesionistëve të shërbimeve shëndetësore, sociale dhe të arsimit për të identifikuar viktimat e abuzimit sa më herët dhe për të ofruar mbështetje, etj.<sup>348</sup>

Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013 gjithashtu parashtron masa të rëndësishme për parandalimin e fenomenit të trafikimit. E hartuar si një komponent i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, ajo fokusohet në varfërinë dhe përjashtimin social. Përveç varfërisë si shkak kryesor të përjashtimit social, kjo strategji trajton edhe rrezikun e deprivimit apo barrierave të cilat nuk lejojnë që grupe apo individë të caktuar të marrin pjesë plotësisht në shoqëri. Që politikat të jenë efektive duhet që të marrin parasysh edhe këto nevoja.<sup>349</sup>

Ashtu si në gjithë strategjitë e tjera, rol i rëndësishëm i ngarkohet mekanizmave vendorë, të cilët do të veprojnë menjëherë pas fillimit të decentralizimit. Pushteti lokal

---

<sup>347</sup> Këshilli i Ministrave. *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013*.

<sup>348</sup> Po aty.

<sup>349</sup> Këshilli i Ministrave. *Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013*.

është menduar të punojë për përmirësimin e aksesit në shërbime dhe në sigurimin e integritetit të grupeve minoritare. Për këtë nevojitet partneritet me OJF-të dhe donatorët për zhvillimin e politikave dhe monitorim, për financime dhe ofrimin e shërbimeve. Lufta kundër varfërisë dhe përjashtimit duhet të jetë pjesë e të gjitha politikave të qeverisë dhe të pranohet nga shoqëria.

Në mënyrë të veçantë parashikohen masa për rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, prej të cilave përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë viktimat e trafikimit. Kështu, politikat e veçanta të përfshira në Strategjinë e Sektorit të Punësimit (në proces) që reflektojnë angazhimin për barazi dhe mos-diskriminim në favor të grupeve në nevojë, përcaktojnë edhe reduktimin e tarifave të kurseve për grupet specifike që kanë qenë të përjashtuar nga tregu i punës në momentin që regjistrohen si të papunë. Këto përfshijnë: PAK, të rinj në nevojë, viktimat e trafikimit, ish të burgosur dhe gratë Rome dhe/ose Egjiptiane.<sup>350</sup>

Gjithashtu, kjo strategji parashtron masa për luftën kundër ose parandalimin e trafikimit të grupeve të tjera në rrezik si fëmijët, vajzat e reja dhe komuniteti Rom me anë të fuqizimit të shërbimeve e politikave për këto grupe. Për shembull, përcaktohen masa për përmirësimin e aksesit në drejtësi dhe rendin publik nëpërmjet rekrutimit të Romëve si policë dhe parandalimit të trafikimit.<sup>351</sup>

Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013 përmbledh ndër të tjera axhendën e politikave për mundësi të barabarta, të reflektuar në disa dokumente strategjike ndërsektoriale të përgatitur vitet e fundit për fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, komunitetin rom, luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe barazinë gjinore. Kjo strategji është një komponent i rëndësishëm i Strategjisë ndërsektoriale të Përfshirjes Sociale si dhe pjesë e pandarë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Kjo Strategji parashtron objektiva konkrete për reduktimin e varfërisë dhe ofrimin e shërbimeve për grupet në nevojë, në kuadrin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Për më tepër, ajo mbështetet në prioritetet e Programit të Qeverisë për politikat sociale, reduktimin e varfërisë, përmirësimin e cilësisë së jetës së grupeve. Më poshtë përmendim disa nga masat parësore për mbështetjen dhe mbrojtjen e tre grupeve të rrezikuara nga trafikimi: Parandalimi i trafikimit të fëmijëve nëpërmjet

---

<sup>350</sup> DCM - Sistemi i Tarifave të Formimit Profesional, 4.04.2006. Cituar në *Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013*.

<sup>351</sup> Këshilli i Ministrave. *Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013*.

bashkëpunimit më të ngushtë me institucionet e tjera publike dhe mbrojtja e ri-integrimit i viktimave nëpërmjet sistemit të referimit.<sup>352</sup> Rritja e numrit të grave në vendimmarrjen publike.<sup>353</sup> Rritja e aksesit për kategoritë e grave në nevojë për t'u informuar mbi bazën ligjore dhe programet që sigurojnë mbrojtjen sociale si dhe institucionet që ofrojnë këto shërbime.<sup>354</sup>

Integrimi i fëmijëve rom të rrugës në jetën normale. Për integrimin e këtij grupi fëmijësh është menduar ngritja e qendrave ditore të cilat do të shërbejnë si strehë dhe shkolle, që do të realizohen në bashkëpunim me donatorë vendas dhe të huaj nëpërmjet OJF-ve që zbatojnë projekte në edukimin dhe zhvillimin e kësaj kategorie fëmijësh. Institucione shtetërore si Inspektorati Shtetëror i Punës do të ushtrojë kontrolle sistematike lidhur me punën e zezë të fëmijëve rome<sup>355</sup> etj.

**a) Disa zhvillime ligjore në Ballkan për mbrojtjen e viktimave të trafikimit.**

Në vijim, parashtrohen për disa vende të rajonit, qëndrimi i tyre mbi viktimat e trafikimit.

**Bosnje Hercegovina.**<sup>356</sup> Në bazë të Rregullores për mbrojtjen e viktimave të huaja të trafikimit të qenieve njerëzore të miratuar nga Ministria e Sigurisë, 22 Korrik 2004, parashikohen dy pika të rëndësishme në lidhje me viktimat e huaja të trafikimit:

- Viktima e trafikimit ka të drejtën e qëndrimit të përkohshëm deri në tre muaj (me mundësi rinovimi) për arsye humanitare, me qëllim mbrojtjen dhe ndihmën për rikuperim, dhe kthimin në vendin e origjinës;
- Viktimës i sigurohet strehim, asistencë mjeksore, këshillim dhe ndihmë ligjore, si dhe ofrohet akses i mundshëm në programe trajnimi dhe arsimimi.

**Kroacia.** Në rastin e Kroacisë, është Ligji mbi të huajt ai që parashikon direktiva që përcaktojnë statusin dhe rezidencën e përkoshme të viktimave të trafikimit.<sup>357</sup> Gjithashtu, Udhëzimi i Dhjetorit të vitit 2004, mbi procedurat e përcaktimit të

---

<sup>352</sup> Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. *Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013*.

<sup>353</sup> Po aty.

<sup>354</sup> Po aty.

<sup>355</sup> Po aty.

<sup>356</sup> Deklarata e angazhimeve e Tiranës, *Mbi legalizimin e statusit të viktimës së trafikuar*, 11.12.2002, Nenet 6 dhe 14.

<sup>357</sup> Po aty, Neni 37.

rezidences së viktimës së trafikimit, në kuadër të Ministrisë së Brendshme të këtij shteti, parashikon për këto viktima:

- Leje Qëndrimi të përkoshme deri në një vit (pët viktimat e huaja të trafikimit);
- Klauzola të tjera për mbrojtjen e viktimave të trafikimit (që janë me kombësi Kroate).

**Rumania.** Në Rumani akte të cilat parashikojnë rregullime për trajtimin e viktimave të trafikimit janë Rregullorja e emergjencës për të huaj dhe Ligji 678/2001 mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Rregullorja e emergjencës për të huaj në Rumani (27 Dhjetor 2002) siguron tolerancë në lejjimin e qëndrimit në territorin e Rumanisë të të huajve për të cilët ka arsye të konsiderohen se janë viktima të trafikimit. Periudha e qëndrimit është gjashtë mujore dhe mund të rinovohet.<sup>358</sup> Gjithashtu, edhe Ligji 678/2001 mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, siguron mbrojtje dhe asistencë për viktimat e trafikimit.

**Serbia.** Trafikimi i qenieve njerëzore është një problem serioz dhe kompleks në Serbi. Është e vështirë për të përcaktuar ekzaktësisht karakteristikat e këtij fenomeni sepse është një numër shumë i vogël i viktimave të trafikimit që i janë drejtuar për ndihmë organeve të policisë apo organizatave që mbrojnë viktimat e trafikimit. Përderisa nuk ekziston një sistem unik i studimit dhe analizimit janë shifra të ndryshme të ofruara nga burime të ndryshme qeveritare, jo-qeveritare dhe organizma ndërkombëtare. Mbledhja e të dhënave të mundshme për sa i përket trafikimit të grave, fëmijëve dhe burrave janë sporadike dhe të pamjaftueshme për të arritur në një konkluzion të përgjithshëm.

Serbia është më së shumti një vend tranzit, origjine dhe qëndrimi të përkohshëm ose të përhershëm, për viktimat e trafikimit, kjo varet nëse viktima është grua, fëmijë ose burrë.

Akti për Lëvizjen dhe Qëndrimin e të Huajve (Neni 34(4) SI, list SRJ, 68/02) nuk përmban ndonjë parashikim për lejjimin e qëndrimit të përkohshëm të viktimave të trafikimit, ndonëse grandet për rezidencat e tyre rregullohen nga ligji që prej vitit 2004. Megjithatë, legjislacioni për të huajt dhe azilkërkuesit është e nevojshme të

---

<sup>358</sup> Po aty, Neni 99.

modernizohet dhe të përafrohet me standardet ndërkombëtare për të siguruar një shkallë më të lartë për mbrojtjen e tyre<sup>359</sup>.

**Republika e Kosovës.** Edhe shteti më i ri në Ballkan, Kosova, është përfshirë nga fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore, ku arsyeja kryesore dhe tipike është ajo për shfrytëzim seksual. Pjesa më e madhe e viktimave janë femra, por edhe meshkuj ku përfshihen minorenët bëjnë pjesë në këtë kategori.<sup>360</sup>

Numri i personave të trafikuar rritet nga viti në vit. Në një raport nga organizata e njohur IOM, konstatohet se 70 % e viktimave të trafikimit kalonin transit në Kosovë dhe se disa prej viktimave mbeteshin duke u shitur nga 700 deri në 2500 Euro. Ndërsa, në një tribunë publike të mbajtur në Gjakovë para disa vitesh, u tha se 150 femra ishin sjellë nga shtetet e Evropës Lindore, të cilat gjoja punonin si kameriere dhe valltare, por që në fakt ishin objekte të skllavërimit seksual, ndërkohë që numri i vajzave shqiptare që ushtrojnë prostitucionin në Kosovë, sipas të dhënave të fundit, ka arritur 85, e sa për ato të trafikuar jashtë vendit, ende nuk ka të dhëna të sakta dhe konkrete.

Njësia e Investigimit të Trafikimit dhe Prostitucionit (TPIU) mban një sistem të dhënash të të gjitha grave të huaja të cilat kontaktojnë policinë, shpeshherë, gjatë kontrolleve në bare. Gjatë 2001 sipas të njëjtit burim numri i viktimave u rrit. Por, në 2002 pati një ndryshim të vogël të mënyrës së trafikimit të viktimave në Kosovë<sup>361</sup>. TPIU thotë se

---

<sup>359</sup>Vepra “Për kalim të paligjshëm të kufirit” (neni 350§1 KP) parashikon maksimum deri në 1 vit burgim për personat të cilët kalojnë kufirin pa u pajisur me dokumentudhëtimi, edhe ata që janë të armatosur ose janë të dhunshëm. Kodi i ri dënonkontrabandën e qenieve njerëzore (neni 350§2 KP), dënohet çdokush i cili përqëlme përfitimi i krijon mundësinë çdo personi i cili nuk është qytetar i S&M, për tëhyrë ilegalisht, qëndruar apo transit në S&M mund të dënohet me burgim 3muaj -6vjet. Rrezikimi i jetës ose shëndetit së emigrantëve ilegal përcaktohet si rrethanë rënduese dhe dënohet 1-10 vjet burgim (neni 350§3 KP), Kodi i Ri nuk e merr në konsideratë këtë të fundit duke bërë një devijim nga standardet ndërkombëtare.

<sup>360</sup> R. Surtees, *Second Annual Report on Victims of Trafficking in South-Eastern Europe*, IOM, 2005, fq. 248.

<sup>361</sup>TPIU ka identifikuar 391 raste. Sipas të dhënave të TPIU në 2001 janë identifikuar 5 viktima Kosovare dhe 167 viktima me nënshtetësi të huaj; në 2002 janë identifikuar 3 viktima Kosovare dhe 86 viktima me nënshtetësi të huaj në 2003 nuk është identifikuar asnjë viktima kosovare ndërkohë që numri i viktimave të huaj ishte 34; në 2004 janë identifikuar 12 viktima kosovare dhe 35 të huaja; dhe në 2005 janë identifikuar 18 viktima kosovare dhe 31 të huaja. Sipas të të njëjtit burim trafikantët e arrestuar në 2004 ishin: 43 Kosovar, 20 Shqipatërë, 4 Bulgar, 1 Moldav, 1 Rumun, dhe 1 me kombësi të paidentifikuar. Në 2005 trafikantët e arrestuar ishin: 45 Kosovar, 31 Shqiptarë, 3 Bulgar, 2 Moldav, 4 Ukrainas, 2 Rumun, 1 Serb dhe 2 me kombësi të tjera. Sipas IOM në 1999 janë identifikuar vetëm dy viktima; në 2000 janë identifikuar 114 viktima; në 2001, 136 viktima; në 2002, 85 viktima; në 2003, 44; në 2004, 34, dhe deri më qeshor 2005 janë identifikuar vetëm 6 viktima.

biznesi i trafikimit i ka transferuar aktivitetet nga vëndet publike në vendbanime privatë. Në të njëjtën kohë thotë se medohet se gratë e intervistuar marrin pagesa të mira, gëzojnë kushte të mira jetese.

Me qëllim zvogëlimin e pasojave të dëmshme të trafikimit, Kosova në kornizën e saj ligjore ka parashikuar edhe rregullimin në kuadër të trafikimit, luftimit dhe parandalimit të tij, si dhe mbrojtjen e viktimave.

Kështu, Ligji i vitit 2013 “Për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit” përcakton si objektiv të tij:

- Parandalimin dhe luftimin trafikimit me njerëz në të gjitha format e tij; si dhe
- Mbrojtjen e viktimave të trafikuar, përfshirë sigurimin e të drejtave, si ndihmë juridike, ndihmë mjekësore, mbështetje psiko- sociale, sigurimi i kompensimit dhe të drejtave të tjera, për të gjithë personat që supozohen të jenë ose që identifkohen si të trafikuar, pavarësisht gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale racës, pronës, lindjes ose statuseve tjera, përmes një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, në përputhje të plotë me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe standardeve.<sup>362</sup>

Gjithashtu, ky ligj parashikon dhe bën pjesë të mbrojtjes edhe „viktimën e supozuar“, e cila është çdo „person që supozohet të jetë viktimë e trafikimit me njerëz, por që nuk është identifikuar formalisht nga autoritetet relevante, ose që ka refuzuar të identifikohet formalisht si e tillë. Një person i supozuar si i trafikuar gëzon të njëjtat të drejta dhe trajtim si edhe viktimat e identifikuar që nga fillimi i procesit identifikues.“<sup>363</sup>

---

<sup>362</sup> Ligji nr. 04/L-218, *Për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 34, 4 Shtator 2013, Prishtinë.

<sup>363</sup>Po aty, Neni 1.17.

### **Përfundime dhe rekomandime.**

Të trafikosh do të thotë të blesh ose të shesësh duke realizuar të ardhura jo të ligjshme, në formë të fshehtë dhe me mjete të paligjshme. Trafikimi, si një fenomen i ri i shfaqur në Shqipëri pas viteve '90, njohu një përhapje të gjerë, e favorizuar kjo sidomos në fillimet e kësaj periudhe edhe nga pamundësia e institucioneve shtetërore për ta luftuar efektivisht atë, kryesisht nisur nga mungesa e parashikimit ligjor dhe kaosit socio-politik. Pozicioni gjeografik i Shqipërisë si urë kalimi për vendet lindore, e ka transformuar atë në një vend tranziti për në perëndim, përveç se origjine për trafikimin e qenieve njerëzore. Krimi i trafikimit funksionon vetëm sepse ekziston një furnizim real me viktima që në nisje të zinxhirit, të cilat kanë dëshirë të shohin migrimin si një mjet për të përmirësuar kushtet e jetesës në vendin e origjinës. Ndërkohë që dukuria kriminale e trafikimit të qenieve njerëzore bazohet mbi një ekuacion të thjeshtë ekonomik të “kërkesës dhe ofertës”, shkaqet e vërteta dhe karakteristikat e këtij krimi janë shumë më komplekse.

Në finalizim të këtij studimi, është arritur në përfundimin se trafikimi i qenieve njerëzore, si një ndër krimet më të rënda që cënon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe grupeve më vulnerabël e të pambrojtur, ka marrë vazhdimisht një vëmendje të lartë të institucioneve ligjberëse dhe ligjzbatuese në luftimin, parandalimin dhe rregullimin e pasojave të viktimat, si në kuadër të hartimit dhe amendimit ligjor, ashtu edhe në kuadër të hartimit dhe zbatimit të strategjive kombëtare dhe zbatimit të rekomandimeve dhe detyrimeve të marra përsipër në nivel ndërkombëtar.

Në kushtet ku është zgjeruar fusha e studimit (duke përfshirë Gjykatën e Krimeve të Rënda e cila gjykon të gjitha veprat penale objekt hulumtimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë) si dhe rrethi i veprave të monitoruara, është arritur një trajtim i gjerë dhe cilësor, nëpërmjet studimit dhe analizimit të vendimeve të gjykatave dhe të praktikave të organeve të drejtësisë, në lidhje me këto vepra dhe me autorët dhe viktimat, për periudhën e hulumtuar 2001-2014, duke arritur kështu në konkluzione dhe rekomandime konkrete, si në vijim.

Trafikimi i qenieve njerëzore në Shqipëri haset në këto forma: trafikim i njerëzve, trafikim i femrave dhe trafikim i fëmijëve, ku trafikimi i femrave është më i përhapuri ndër trafiqet dhe arsyeja kryesore është ajo e prostitucionit, si një ndër bizneset më fitimprurëse në botën e veprimtarive të jashtëligjshme. Trafikimi i femrave për



prostitucion është gjithashtu një nga format më të ashpra të krimit të organizuar të qenieve njerëzore.

Studimi ka trajtuar vëllimin dhe etapat e trafikimit njerëzor, llojet kryesore të shfrytëzimit si dhe karakteristikat bazë që përbëjnë profilin autorit dhe të viktimës së trafikimit në Shqipëri për periudhën kohore të caktuar.

Kështu, viktima të trafikimit janë persona të moshave të ndryshme dhe të të dyja gjinive, ku më të preferuarit janë femrat për prostitucion dhe fëmijët gjithashtu për prostitucion dhe heqje organesh dhe shfrytëzim për punë të ndryshme. Pjesa më e madhe e fëmijëve trafikohet me qëllimin për t'i shfrytëzuar seksualisht. Ata përdoren dhe për të kryer punë të ndryshme si shërbime shtëpiake, përfshirja në konflikte të armatosura, shërbime restoranti, bari, në fabrika, bujqësi, ndërtim dhe lypje.

Studimi ka nxjerrë në pah faktorët nxitës dhe shtytës në trafikim. Faktorët që kanë shtyrë në trafikim kanë qënë kryesisht ata ekonomikë, por edhe socialë dhe kulturorë. Mungesa e mbrojtjes efektive të qytetarit nga shteti dhe mekanizmat e tij, padijenja dhe mungesa e informacionit, si dhe zakonet relike që sundonin në disa zona të thella rurale të Shqipërisë gjithashtu kanë patur shumë ndikim. Korrupsioni, mungesa e efikasitetit në radhët e organeve policore dhe hetimore, si dhe mungesa e kontrollit në levizjet e emigrantëve përbëjnë lehtësi dhe kane krijuar kushte dhe premisa për të trafikuar dhe për të rënë pre e trafikimit.

Llogaritet që të paktën 3.000 fëmijë shqiptarë janë dërguar në Greqi dhe Itali për të kërkuar lëmoshë në vitin 2001 dhe 3.000-4.000 fëmijë në vitin 2003 rezultojnë të endeshin për lëmoshë në Greqi. Që nga vendi i nisjes, zonat tranzite dhe vendi i destinacionit përfundimtar, përgjithësisht marrin pjesë shumë aktorë të ndryshëm. Prandaj ndërhyrjet kundër trafikut nuk mund të shtrihen vetëm mbi fëmijët.

Vëmendje i duhet kushtuar familjeve, komuniteteve të origjinës, rekrutuesve, ndërmjetësve, personave që sigurojnë dokumentet, transportuesve, funksionarëve të korruptuar, punëdhënësve dhe klientëve. Sërish faktorët janë të natyrës kulturore, ekonomike, mungesë ligjesh dhe moskontroll të lëvizjeve migruese.

Pavarësisht nga numri i vogël i gjykimeve në lidhje me të dënuarit për veprën penale të trafikimit të fëmijëve, karakteristikë e tyre është se shumica e të trafikuarve për të lypur dhe punë të detyruar i përkasin minoritetit të grupeve “evgjite” dhe “rome”. 90% e fëmijëve të trafikuar në Greqi janë evgjitë, ndërsa 10% janë ose rom ose shqiptarë të

bardhë. Shumica vijnë nga Elbasani, Korça, Berati dhe Tirana ku ka një numër të madh evgjitësh dhe romësh. Është vlerësuar se 80% e fëmijëve janë të rekrutuar prej trafikantëve, ndërsa 20% janë të dërguar nga familjet e tyre.

Rezulton se trafikimi i qenieve njerëzore nuk është në grupin e figurave të veprave penale më të proceduara dhe me prirje numerike në rritje. Nga krahasimi me vëllimin total të çështjeve të proceduara nga Gjykata për Krime të Rënda ndër vite shohim se krimet e trafikimit të qenieve njerëzore janë pakësuar ndjeshëm, dhe për më tepër, ato përbëjnë të vetmin grup krimesh që ka pësuar rënie. Më tej, evidentohet fakti që vepra penale me frekuencë më të lartë midis grupit të veprave penale objekt hulumtimi është trafikimi i femrave për prostitucion, parashikuar nga neni 114/b të Kodit Penal (nga 121 krime të trafikimit të qenieve njerëzore të proceduara në periudhën e hulumtimit, 84 prej tyre janë krime të trafikimit të femrave). Ndërsa krimet më të pakta në numër për periudhën e hulumtimit janë ato të trafikimit të personave, parashikuar nga neni 110/a të Kodit Penal, me respektivisht 11 çështje penale të proceduara.

Lidhur me trafikimin e femrave, problematik shfaqet edhe fakti që trafikimi i femrave konstatohet se kryhet në rrethana rënduese, me numër të madh viktimash dhe në forma të rënda bashkëpunimi. Megjithatë duhet theksuar se për çështjet e gjykuara është rritur cilësia dhe efektiviteti i punës në drejtim të dënimit të trafikantëve si dhe realizimit të proceseve gjyqësore të drejta bazuar në ligj dhe të drejtat e njeriut përfshirë edhe atë për një proces të rregullt gjyqësor. Gjatë zhvillimit të procesit është treguar një kujdes i veçantë për viktimat e trafikimit sidomos për ato që kanë bashkëpunuar me organet e drejtësisë.

Në këtë studim, përmes etiologjisë kriminale, janë studiuar dhe hulumtuar shkaqet dhe rrethanat që kanë të bëjnë me të gjitha sjelljet kriminale dhe dukuritë e tjera në shoqëri. Rolin kryesor e luajnë faktorët ekonomiko-shoqëror, më pas vijnë faktorët ideo-politikë, faktorët mikro-grupor, ku rolin kryesor e luan familja si faktor kriminogjen. Nuk ngelen pa ndikim këtu edhe faktorët socio-patologjik të këtij lloj kriminaliteti. Nga vëzhgimi dhe studimi i vendimeve të formës prerë, të dhëna nga gjykata del se, për veprat penale të trafikimit të personave faktori kryesor kriminogjen i pranishëm është varfëria si rezultat i papunësisë.

Studimi i regjistrave të Gjykatës për Krime të Rënda, Prokurorisë për Krime të Rënda, Policisë së Shtetit, kanë nxjerrë në pah karakteristikat kryesore të autorëve të

trafikimit të njerëzve, që janë: gjinia, moshë, vendi nga vijnë, statusi familjar, statusi gjyqësor, marrëdhëniet me viktimën dhe arsimimi. Numri i të pandehurve mbi të cilët është disponuar me vendim nga Gjykata për Krime të Rënda është i konsiderueshëm. Për periudhën 2004-2014, ai arrin në mbi rreth 3.200, dhe moshë rezulton të jetë 25–35 vjeç. Nga të dhënat e parashtruara mbi vëllimin e trafikimit të qenieve njerëzore, është konstatuar se ky lloj kriminaliteti është kryer nga persona madhorë dhe pjesëmarrja e personave të mitur dhe femra është e papërfillshme. Lidhur me arsimimin e trafikantëve, pjesa dërrmuese e tyre janë maksimumi me arsim të mesëm. Nga vëzhgimi i vendimeve gjyqësore rezulton se vetëm në disa raste autorët e veprës penale kanë pasur marrëdhënie familjare me viktimën.

Nga ky studim, konkludohet se format e përdorura nga trafikantët për t'i detyruar femrat për të ushtruar prostitucion kanë qenë:

- Mashtrimet për t'u martuar dhe për të jetuar jashtë shtetit;
- Mashtrimet për sigurim pune e kushte jetese jashtë shtetit;
- Mashtrimet duke përdorur femra ndërmjetëse;
- Kërcënimet për jetën e familjen e saj;
- Shitblerja e femrave;
- Kompromentimet me anën e dhuratave, parave e duke krijuar detyrime të tjera materiale.

Është arritur edhe kryerja e analizës së faktorëve kriminogjenë (objektivë dhe subjektivë) të personave të dënuar. Moshë e personave të dënuar (relativisht e re) është një ndër kriteret kryesore për klasifikimin dhe grupimin e të dënuarve në institucionet për ekzekutimin e dënimit me burgim. Sipas kërkimeve krimnologjike të bëra në shumë vende të botës edhe femrat, gjithnjë e më tepër, po marrin pjesë në kryerjen e sjelljeve të llojllojshme kriminale. Sipas disa të dhënave statistikore, nga literatura krimnologjike, në vendet e ndryshme, përqindja e pjesëmarrjes në kriminalitet të përgjithshëm e personave të gjinisë femrore, sillet nga 8-10% të të gjithë pjesëmarrësve.

Ndërkohë në botën bashkëkohore, në kryerjen e disa sjelljeve kriminale po rritet pjesëmarrja e personave me arsim të lartë. Ndikimi i arsimimit në sjelljet e ndryshme kriminale duhet parë nga aspekti relativ e jo të përgjithësohet ky faktor. Megjithatë, rezulton se për vitet 2001-2014, pjesa dërrmuese e të dënuarve janë me arsim 8-vjeçar dhe të mesëm dhe një pjesë e vogël e tyre është pa arsim dhe me arsim fillor. Gjithashtu,

nisur nga gjendja martesore, statusi familjar dhe regional në hulumtimin e bërë për veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore gjatë periudhës së përmendur kohore del se numri i personave të dënuar është më i madh në regjionet qytetare, ndërsa në fshat pjesëmarrja është më e ulët. Ajo që vihet në dukje në territorin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është se statusi familjar i kryesëve të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore është ‘I martuar’ në pjesën më të madhe. Një paraqitje e tillë si shkak kryesor ka varfërinë dhe papunësinë e këtyre personave që kryejnë veprat penale të trafikimit. Sa i takon statusit gjyqësor të autorëve, rezulton se përqindja më e madhe e autorëve të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore janë me status gjyqësor të pa dënuar më parë.

Faktorët subjektivë (karakteri dhe sjellja kriminale e trafikantëve) të studiuar, kanë treguar se trafikantët e dënuar kanë karakter të dobët, dhe kjo duket qartë në arsyetimet e vendimeve të formës së prerë të gjykatës, megjithatë rezultojnë edhe mangësi përshkrimi në vendime gjyqësore lidhur me temperamentin dhe nivelin e inteligjencës.

Krahas analizimit të personave të dënuar për trafikim, studimi nxjerr përfundime edhe lidhur me viktimat e trafikimit dhe karakteristikat e tyre. Rezulton se moshën dominuese e tyre është 18 – 25 vjeç, ndërsa në vend të dytë janë grupmoshat 14 – 18 vjeç. Nga këto, numri më i madh (41%) i përket moshës 20-25 vjeç. Përveç këtyre, rezulton se në prostitucionin shqiptar janë përfshirë kryesisht vajza minorene të moshës 13-14 vjeç.

Është arritur në përfundimin se si rezultat i një politike agresive ndaj këtij fenomeni, e shoqëruar kjo me dënime të rënda dhe me konfiskim të pasurive të autorëve të krimit, fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore është ulur ndjeshëm.

Bashkëpunimi i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore me organet e drejtësisë vlerësohet si mjaft i rëndësishëm për ndjekjen penale të autorëve, për shkak të elementëve të këtyre veprave dhe mënyrave se si kryhet trafikimi i qenieve njerëzore. Kështu, në vitin 2007 vihet re një tendencë në rritje e dëshmive në sallë të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Studimi ndalet dhe prej tij nxirren përfundime edhe lidhur me politikat ndëshkuese dhe parandaluese ndaj personave fajtorë, ku parandalimi i kriminalitetit paraqitet si i përgjithshëm dhe i vecantë e deri te ai individual, politika këto të cilat veprojnë drejtpërdrejtë në mënjanimin e shkaqeve e të kushteve favorizuese të kriminalitetit. Më

tej akoma, efektiviteti i parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar plotëson edhe një kërkesë të Bashkimit European për integrimin e Shqipërisë në të.

Një aspekt i rëndësishëm në parandalimin e krimit është ndërgjegjësimi i qytetarëve nga sjelljet negative nëpërmjet denoncimeve dhe në këtë kuadër gjithnjë e më shumë po i jepet përparësi parandalimit social (në gjirin e shoqërisë), ndikuar nga mosefikasiteti deri diku në luftimin e kriminalitetit në këndvështrimin juridiko-penal. Lidhur me parandalimin juridiko – penal dhe ashpërsimin e dënimit penal, në Shqipëri ende nuk mund të bëhet një studim lidhur me ndikimin që kanë dënimet në recidivizëm, dhe kjo për shkak se sistemi i dënimeve ndryshon herë pas herë dhe për këtë dëshmon edhe reforma e fundit e vitit 2013. Një studim i tillë kërkon edhe krijimin e një baze të dhënash kompjuterike për të dënuarit, ku secili prej tyre të identifikohet menjëherë në rast se rikthehet si recidivist në institucionin e vuajtjes së dënimit.

Masat e dënimit janë të ashpra dhe secila prej këtyre dispozitave parashikon edhe rrethanat cilësuese si raste kur dënimi është më i rëndë për shkak të rrethanave specifike në të cilat krimi ndodh. Rritja e maksimumit në 35 vjet me reformën e vitit 2013 nuk mund të ketë më shumë rol parandalues sesa burgimi i përjetshëm. Çështja kryesore mendoj se nuk qëndron në ndryshime të panevojshme e të paarsyetuara, por në zbatimin korrekt të ligjit penal dhe në parandalimin e vrasjeve për gjakmarrje si më kryesorja. Me qëllim që të zbatohet një politikë e arsyeshme dhe efikase e dënimit penal duhet të plotësohen disa kërkesa, si krijimi i një game më të gjerë të sanksioneve penale, të cilat gjykata do të mund t'i caktonte në çdo rast konkret, duke u nisur nga qëllimi që duhet të arrihet, dhe individualizimi i dënimit gjatë caktimit të dënimit nga gjykata, duke mbajtur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese e rënduese të kryerjes së veprës penale si dhe veçmas personalitetin e subjektit të saj.

Ndërmarrja e masave për parandalimin e veçantë është në dorë të të gjitha organeve shtetërore, nga ato qendrore deri tek ato vendore. Roli dhe përgjegjësia e gjykatës nuk ka pse të kufizohen vetëm në shqyrtimin gjyqësor dhe vendimin përfundimtar të çështjes për të dënuar ose jo të pandehurin, pasi mundësitë e gjykatave janë të gjera edhe në rekomandimet për masat parandaluese të krimit. Natyrisht, si prokuroria ashtu dhe gjykata, mund të luajnë rolin që u takon në parandalimin e kriminalitetit, duke bashkëvepruar e bashkëpunuar midis tyre si dhe me policinë e organet e tjera të pushtetit e të administratës, si dhe me OJF-të e shoqërinë civile në tërësi. Ky

bashkëpunim e bashkëveprim kushtëzohet nga fakti se “lufta kundër krimit është çështje e të gjithëve”.

Në kushtet e sotme për të parandaluar krimin e organizuar kushti themelor është bashkëpunimi i veprimtarisë së agjencive ndërmjet tyre, si dhe i këtyre me Prokurorinë e Përgjithshme, e cila ka në qendër të objektivave të saj luftimin e krimit të organizuar në të gjitha format që ai shfaqet. Bashkëpunimi i agjencive të ndryshme është i domosdoshëm jo vetëm brenda vendit, por edhe me organet përkatëse të shteteve të tjerë, posaçërisht me ata fqinjë dhe me ata rajonalë. Sa më efektiv të jetë ky bashkëpunim në shkallë vendi dhe jashtë tij, aq më efektiv do të bëhet parandalimi i krimit të organizuar që ka avantazhe të mëdha politike, ekonomike, shoqërore, sepse mënjanohen pasojat e rënda të tij për shoqërinë dhe shtetin dhe për mirëqënien e njerëzve.

Masë shumë e rëndësishme në kuadër të masave preventive është edhe sekuestrimi dhe konfiskimi i çfarëdo mjeti që përdor një organizatë kriminale për të kryer veprimtarinë e saj kriminale si llogaritë bankare, materialet e përdorura për rekrutim, mjetet e transportimit, të telekomunikacionit, etj. Këtij momenti i është kushtuar vëmendje, sa i takon hartimit dhe amendimit legjislativ, megjithatë mbetet për vlerësim zbatimi i këtyre ligjeve në praktikë dhe cilësia e zbatimit gjithashtu.

Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një sërë masash në luftimin dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, duke përfshirë këtu dhe strategjitë përkatëse. Që nga Qershori 2001, sipas Legjislacionit Shqiptar, të gjithë personat e trafikuar, gra dhe fëmijë, konsiderohen si viktima të trafikimit dhe nuk dënohen, edhe në rastet kur kanë kryer një veprim kriminal lidhur me të qënurit i trafikuar si: prostitucioni, kalimi ilegal i kufijve, etj. Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje me shumë shtete dhe të gjitha këto, në kuadër të ndihmës së viktimave dhe reduktimit të pasojave të krimeve mbi ta.

Në mënyrë që të ulë rrezikun e trafikimit, Qeveria ka synuar të rrisë ndërgjegjësimin publik mbi rrugët e rregullta të migrimit, me qëllim që kushdo që kërkon të migrojë, të dijë se si duhet të veprojë në mënyrë që të mos bjerë viktimë e rekrutuesve, shoqëruesve apo pritësve trafikues. Për këtë, në projektligjin e ri mbi migrimin janë parashikuar dispozita mbi rreziqet e migrimit të parregullt, me qëllim parandalimin e trafikimit.

Roli i policisë, prokurorisë, gjykatave është shumë i rëndësishëm. Hetimi proaktiv, reaktiv dhe ai financiar është një armë efektive dhe duhet të përdoret kudo që të jetë e

mundur. Duhet theksuar se qëndrime të pakujdesshme, madje në ndonjë rast të veçantë edhe veprime në kundërshtim me ligjin nga ana e organit të akuzës, kanë krijuar mundësi për ritrafikimin e viktimës.

Qëllim kryesor i strategjive është procesi i riintegrit, që synon të bëjë një rifutje të sigurt, me dinjitet dhe jetëgjatë të viktimës në shoqëri dhe në jetën normale, mbi bazën e vlerësimeve individuale të viktimave dhe konkludimin në hartimin e një plani të gjithanshëm për riintegrimin, duke i njohur viktimës të drejtën e informimit, mbrojtjes ligjore dhe asaj fizike. Së bashku me praktikën vendase në rritje, e drejta për dëmshpërblim (financiar dhe moral), ashtu si dhe të drejta të tjera si ajo e ndihmës ligjore, po njihen më gjerësisht.

Ende si problem mbetet çështja e kompensimit të drejtë të viktimave të trafikimit, aplikimi më i gjerë i padisë civile në procesin penal dhe njohja e viktimave me këtë të drejtë të tyre, krijimi i skemës shtetërore/fondit të posaçëm të kompensimit në zbatim të ligjit që ka hyrë në fuqi, si dhe përmirësimi i programit dhe masave për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Ligji për ndihmën dhe shërbimet shoqërore të ndryshuar, ka mundësuar për viktimat e trafikimit, që të përfitojnë ndihmë ekonomike pasi të dalin nga qendrat rezidenciale të shërbimit shoqërorë në sistemimin e tyre në punë.

Si pjesë e krimit të organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar, trafikantët e njerëzve në përgjithësi dhe të femrave në vecanti janë Shqipëria nga një vend që fillimisht siguronte vetëm prostituta, aktualisht luan rol të dyfishtë duke u përfshirë në kalimin ndërkombëtar të një trafiku të tillë. Sipas të dhënave, zonat më të goditura janë Azia e Jugut, Azia Juglindore, Afrika dhe Europa Lindore.

Ashtu si është organizimi i trafikimit, i mirëpërcaktuar dhe i kryer nga organizata kriminale me tiparet e tyre karakteristike (duke përbërë një zinxhir të gjerë kriminal në Evropën Lindore duke mashtruar, blerë e rrëmbyer vajza në moshë të re nga rajonet e Rumanisë, Ukrainës, Moldavisë dhe Bullgarisë dhe nëpërmjet Malit të Zi i trafikojnë për në Itali), ashtu duhet të jetë dhe përgjigja dhe lufta kundër këtij fenomeni kriminal. Një luftë e mirëorganizuar dhe e ndërtuar mbi ligjin teorik dhe ekzekutimin e tij praktik, është elementi bazë për efektivitetin në ndalimin dhe parandalimin e fenomenit, si dhe në zbutjen e pasojave si ndaj individit, edhe ndaj shoqërisë dhe vetë shtetit.

## Bibliografia

### A. Literaturë

- Amato G. (2003) “Dubbio aggravante për le associazioni a delinquere”, in *Guida al diritto*, Nr..35.
- Anthoni G. (1998) “Sociologjia”, Tiranë.
- Arlecchi P. (2000) « Skllavet e Perëndimit. Pas gjurmëve të tregtarëve të Mishit Bardhë », Tiranë.
- Bodin C. B. (2001) “Krimi & Skllavërimi: Një ekspozë e trafikut të grave për prostitucion nga Shtetet e Reja të Pavarura, Global Survival Network, 1997, UNHCR 2000; Faktorët social-ekonomik faktorë të përfshirjes së grave moldave në prostitucion, trafikim dhe skllavërinë e seksit, UNHCR.
- Coonan T. (2006) “The Trafficking Victims Protection Act: A work in Progress”, *Intercultural Human Rights Laë Revieë*, vol.1.
- De Zulueta T. (2001) Komiteti Antimafia i Parlamentit Italian, « Raport i AP (Romë) », Janar. Gendreau P., Little T., Goggin C. (1996) “A Meta-Analysis of Adult Offender Recidivism: What Works!”, *Criminology*, 34(3):575-607.
- Eyesenck H.J., Gudjonsson G. H. “The causes and cures of criminality”, Plenum Press, New York.
- Elezi I. (2005) « E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme », Tiranë.
- Elezi I. „Rrethana veçanërisht e cilësuar e veprës“
- Elezi I. (2007) “E Drejta Penale-Pjesa e Posaçme”, Ribotim, Shtëpia Botuese “P.SH 2015”, Tiranë.
- Elezi I. (2004) “Komentari i shtesave dhe ndryshimeve ne Kodin Penal”, Albin, Tiranë.
- Elezi I., S.Kaçupi, M.Haxhia (2006) “Komentar i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, GEER, Tiranë.
- Elezi I., V. Hysi (2006) “Politika Kriminale” PEGI, Tiranë.
- Elezi I. (1999) « Mendimi Juridik Shqiptar », Tiranë.
- Fiandaca G., Musco E. (2001) “Diritto penale. Parte Generale Criminal Laë, General Part“, Edition Zanichelli, Bologna.



- Fletcher B. (2003), *Zëdhënës i policisë ndërkombëtare në Prishtinë, Radio "Zëri i Amerikës"*, 9 Tetor, Linda Karadaku.
- Gendreau P., Goggin C., Cullen F. T. (1999) *"The Effects of Prison Sentences on Recidivism"* Ottaëa, Ontario, Canada: Public Works and Government Services Canada.
- Gassin R. (1996) *"Criminologie"*, Paris.
- Gashi R. (2001) *"Ekzekutimi i Dënimit me Burgim në Shqipëri"*, Prishtinë.
- Gashi R. (2003) *"Politika Ndëshkimore Ndaj Delikteve të Gjakut në Kosovë gjatë periudhës 1980 – 1989"*, Prishtinë.
- Grup autorësh (2007) *"Kërkim Studimor mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore"*, Kosovë.
- Grup autorësh (2002) *"Procedurat Investigative Policore Shqiptare mbi Trafikimin e Qenieve njerëzore"*, botuar nga IOM, Tiranë.
- Gjermani E., Danaj E., Lula E., dhe Beci L. (2006) *"Krijimi i mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat në Shqipëri: Një strategji për parandalimin e trafikimit, Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim"*, Tiranë.
- Hysi V. (2000) *"Hyrje në kriminologji dhe penologji"*, botim i Ilar, Tiranë.
- Hysi V., *"Kriminologjia"*, Tiranë.
- Halili R. (2002) *"Kriminologjia"*, Prishtinë.
- Jaçellari A. (2003), *Drejtor për anti-trafikimin në Ministrinë e Rendit në Tiranë, Radio "Zëri i Amerikës"*, 9 Tetor, Linda Karadaku.
- Kallaba I. (2002) *« Zyrtarë të lartë malazezë trafikantë prostitutash »*. *Gazeta Panorama*, 16 Dhjetor.
- Leskoviku M. (2002) *"Njohja me legjislacionin shqiptar mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe disa probleme që dalin në praktikën gjyqësore"*, *Revista Juridike, Fakulteti i Drejtësisë, UT, Tiranë, Nr..2, 2005* Skender Begeja, *"Mesdheu Deti i Krimin të Organizuar dhe i Trafikimit të Jashtëligjshëm"*, *Revista E Drejta, Prishtinë*.
- Latifi V. (2003) *« Politika Kriminale »*, Prishtinë.
- Latifi V. (2001) *"Kriminalistika"*, Prishtinë.
- Levin M. A. (1971) *"Policy Evaluation and Recidivism," Law and Society Review*, 6(1):17-46.

- *Lettieri N. dhe Serafini A. (2002) « Criminal Justice I, Programi kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në Europën Jug – Lindore », Tiranë, Mars.*
- *Leskaj V., Dragoti E., Kara Th., Thodhri F. (2004) “Shoqëria Shqipëtare përballë sfidave të trafikut të grave dhe vajzave”, Tiranë.*
- *Muci Sh. (2007) “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Dudaj.*
- *Mandro A. (2011) “E Drejta Romake”, Ribotim i Trete, Emal, Tirane.*
- *Metani A., dhe Omari S. (2006) “Drejt rrugës për në BE; Studimi i shanseve të barabarta për gratë dhe burrat në Shqipëri. Instituti Shoqëria e Hapur dhe Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim”, Tiranë.*
- *McGinn Th. (2003) “Prostitution, Sexuality, and the Law in Ancient Rom”, Oxford University Press, January.*
- *Nagin D., Pogarsky G. (2001) “Integrating Celerity, Impulsivity, and Extralegal Sanction Threats into a Model of General Deterrence: Theory and Evidence,” Criminology, 39(4).*
- *Nicola Z. (1970) “Vocabolario della lingua italiana”, Zanichedi SPA, Bologna.*
- *Novicki M. Antoni (1999) “Gurët udhërrëfyes, Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut”, Tiranë.*
- *Omari L. (1949) “Parime dhe Institucione të së Drejtës Publike”, Botim i tetë, Botimet “Elena Gjika”, Tiranë, 2004.*
- *Omari L. (2000) « Sistemi Parlamentar », Tiranë.*
- *Papandile J., Mandro I. (2002) “Kriminologji-Penalogji”.*
- *Puto A. (1986) “E Drejta Ndërkombëtare Publike, Pjesa II”, Tiranë.*
- *Qosaj Mustafa A. (2003), Këshilltare ligjore në zyrën e OSBE-së në Prishtinë, Radio “Zëri i Amerikës”, 9 Tetor, Linda Karadaku.*
- *Schinina G. (2003), Drejtues i njësisë për ndihmën për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore në zyrën e IOM-it në Shkup, Radio “Zëri i Amerikës”, 9 Tetor, Linda Karadaku .*
- *Sokoli L., Gërdeshi I. (2006) “Trafikimi Rasti i Shqipërisë”, IS & Rinia, Tiranë.*

- Sokoli L. (2005) “Prostitucioni profesionist në Shqipëri dhe debatet rreth (keq) vlerësimit ‘prostitucioni është një fenomen tipik shqiptar’. Revista “Të drejtat e njeriut”. Nr..2(42).
- Salihu I. (1995) “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Prishtinë.
- Salihu I. (2003) “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Prishtinë .
- Sahiti E. (1999) “Argumentimi në Procedurën Penale”, Prishtinë.
- Sahiti E. (1993) “Dëshmia e Dëshmitarit si Provë në Proçedurë Penale”, Prishtinë.
- Renton D. (2001) “Trafikimi i Fëmijëve në Shqipëri”, ”Save the Children”, Tiranë, Korrik.
- Song L., Lieb R. (1993) “Recidivism: The Effect of Incarceration and Length of Time Served,” Olympia, WA: Èashington State Institute of Public Policy.
- Surtees R. (2005) “Second Annual Report on Victims of Trafficking in South-Eastern Europe”, IOM.
- Shala Xh. (2003) „Siguria Kombëtare dhe Sfidat e Integritimit“, Tiranë.
- Wright V. (2010) “Deterrence in Criminal Justice. Evaluating Certainty vs. Severity of Punishment, Research and Advocacy for reform”, Nëntor .
- Zëri i Amerikës (2005) “100 Ditët e Para të Qeverisë Berisha. Intervistë me Kryeministrin Shqiptar Sali Berisha”, 21 Dhjetor.

## **B. Burime Parësore**

### **Akte normative të brendshme dhe ndërkombëtare**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Kodi Penal i Kosovës
- Kodi i Përkohshëm Penal të Kosovës. UNMIK/RReg/2003/25, 6 Korrik 2003, ndryshuar me Ligjin Nr. 03/ 002 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës Nr. 2003/25

- *Kodi Penal i Italise*
- *Kodi Penal Zvicërian*
- *Kodi Penal Austriak*
- *Kodi Penal Gjerman*
- *Ligji për trafikimin në Sh.B.A*
- *Kodi Penal Belg*
- *Kodi Penal Hollandez*
- *Ligji për trafikimin në Finlande*
  
- *Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 3 Maj 2005*
- *Konventa e OKB-së për Parandalimin e Trafikut me persona dhe të shfrytëzimit të prostitucionit të tjerëve”, 1949*
- *Konventa Evropiane kundër Trafikimit, 2005*
- *Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Femrave (CEDAË)*
- *Konventa e OKB-së “Për statusin e refugjatëve”, 1951*
- *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)*
- *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (ICESCPR)*
- *Konventa për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD)*
- *Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (Konventa Kundër Torturës).*
- *Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punonjësve Migrues dhe të Anëtarëve të Familjeve të Tyre (Konventa për Punëtorët Migrues)*
- *Konventa Evropiane për parandalimin e torturës dhe të trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues*
- *Marrëveshja Ndërkombëtare për Shtypjen e Tregut të Skllëvërve të Bardhë, 18 Maj 1904*
- *Konventa për Shtypjen e Trafikut të Skllëvërve të Bardhë, 4 Maj 1910*

- *Konventa për Shtypjen e Trafikut të Grave dhe Fëmijëve, 30 Shtator 1921*
- *Konventa për Shtypjen e Trafikut të Grave në Moshë Madhore, 11 Tetor 1933.*
- *Konventa e Lidhjes së Kombeve për shtypjen e Trafikimit të Personave dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të tjerëve, 2 Dhjetor 1949.*
- *Konventa Nderkombëtare mbi të Drejtat Civile e Politike, 16 Qershor 1966*
- *Konventa Nderkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 1966*
- *Parimet dhe udhëzuesit e rekomanduar nga OKB-ja për të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore, 2002*
- *Konventa kundër Torturës dhe trajtimeve apo Dënimeve të tjera mizore, ç'njerëzore apo Degraduese, 10 Dhjetor 1984*
- *Konventa mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve, Migrantëve dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre, 18 Dhjetor 1990*
- *Konventa mbi Skllavërinë, 25 Shtator 1926*
- *Konventa Shtesë mbi Zhdukjen e Skllavërisë, Tregtimit të Skllavëve, të Instituteve e Praktikave të Ngjashme me Skllavërinë, 7 Shtator 1956*
- *Konventa Europiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe Karta e BE mbi të Drejtat Themelore, 4 Nëntor 1950*
- *Konventa mbi Zhdukjen e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, 3 Shtator 1981*
- *Konventa 29 e ILO-s e vitit 1930*
- *Konventa 105 e ILOs e vitit 1957*
- *Konventa 97 e ILO-s 'Migracioni për Punësim' e vitit 1949*
- *Konventa 143 'Punëtorët Migrantë' e vitit 1975*
- *Konventa 95 e ILO-s mbi Mbrojtjen e Pagave*
- *Konventa 181 e ILO-s mbi Agjencitë Private të Punësimit*
- *Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Trans-Nacional.*
- *Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve (CRC)*
- *Konventa e OKB-së kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC)*

- *IOM, Marrëveshje Bashkëpunimi për Krijimin e një Mekanizmi Kombëtar Referues për Identifikim dhe Ndihmë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qenieve Njerëzore (2005) midis: Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Qendrës Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Punëve të Jashtme, VATRA, Vizion Tjetër (Another Vision) dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin*
- *Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale*
- *Protokolli kundër Kontrabandimit të Emigrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri*
- *Protokolli i Kombeve të Bashkuara për të Parandaluar, Shtypur dhe Dënuar Trafikimin e Personave, Veçanërisht të Grave dhe të Fëmijëve.*
- *Protokolli i Palermos për Trafikimin, 15 Dhjetor 2000*
- *Protokolli i OKB-së për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve, plotësues i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Protokolli i Trafikimit), 15 Nëntor 2000*
- *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut në kuadër të OKB-së, 10 Dhjetor 1948*
- *OSCE Ministerial Council, Declaration on Trafficking in Human Beings, MC(10) JOUR/2 (Porto, 7 December 2002), Annex 2, Section II, para.*
- *Protokolli i OKB-së për Parandalimin, Ndalimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, sidomos të Grave dhe Fëmijëve*
- *Protokolli i OKB-së kundër Kalimit Kontrabandë të Migruesve me Tokë, Det dhe Ajër*
- *Ligj, Nr .98, date 31.07.2014“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*
- *Ligj, Nr. 144/2013, date 02.05.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*
- *Ligj, Nr. 23/2012, date 01.03.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*

- *Ligj, Nr. 10023, date 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*
- *Ligj, Nr. 9859, date 21.01.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*
- *Ligj, Nr. 9686, date 26.02.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*
- *Ligj, Nr. 9275, date 16.09.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*
- *Ligj, Nr. 9188, date 12.02.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*
- *Ligj, Nr. 9086, date 19.06.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*
- *Ligj, Nr. 9017, date 06.03.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*
- *Ligj, Nr. 8733, date 24.01.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*
- *Ligj, Nr. 8279, date 15.01.1998 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*
- *Ligj, Nr. 8204, date 10.04.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*
- *Ligj, Nr. 8175, date 23.12.1996 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*
- *Ligji Nr. 9509, datë 3.4.2006 “Për shpalljen e Moratoriumit për mjetet motorrike lundruese te Republikës së Shqipërisë”.*
- *Ligji Nr. 10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë” shfuqizoi Ligjin Nr..9205, datë 15.03.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.*
- *Ligji Nr. 10192, date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nepërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*
- *Ligji Nr. 04/L-218 “Për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 34, 4 Shtator 2013, Prishtinë.*
- *Ligji Nr. 9284 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar” 2004*

- *Ligji Nr. 9276, datë 16.09.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr..7905, dt. 21.03.1995 Kodi i Procedurës Penale të Republikës Penale të Shqipërisë, i ndryshuar”*
- *Ligji Nr. 9284, date 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”*
- *Ligj Nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*
- *Ligj, Nr. 24, data 20.03.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin [Nr..10](#) 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*
- *Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore”*
- *Ligji Nr. 10 252, datë 11.03.2010 “Për disa shtesa në Ligjin Nr..9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar*
- *Përmbledhje legjislacioni për sistemin e drejtësisë, Botimi i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Tiranë, 2004.*
- *Vendim i Këshillit të Ministrave Nr..913, datë 19.12.2007 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, 2007-2010, dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.*
- *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr..265, 28.4.2005 “Për miratimin e Strategjisë së Shërbimeve Shoqërore (2005-2010)”.*
- *BE, Direktiva 2011/36/EU*
- *OSCE Permanent Council, Decision No. 557/Rev. 1 OSCE Action Plan to Combat Trafficking in Human Beings, PC.DEC/557/Rev.1 (Vienna, 7 July 2005), Chapter IV, para. 5.2*

## **Raporte**

- *Raporti i DASH për vitin 2012.*
- *Raporti për Realizimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzor 2008-2010 (Shtator 2008 – Maj 2009).*



- *Raporti mbi analizën e veprimtarisë së Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda, viti 2011.*
- *Raporti mbi analizën e veprimtarisë së Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, viti 2011*
- *Raporti mbi analizën e veprimtarisë së Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda, viti 2012. Prokuroria e Krimeve të Rënda, “Raport Analiza Vjetore e vitit 2013”*
- *Raporti për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave, Janar-Dhjetor 2011. Tiranë, Shkurt 2012*
- *Raporti për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Janar-Dhjetor 2010, Tiranë, Shkurt 2011.*
- *Raport Vlerësimi për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2005-2007, Tiranë Mars, 2008*
- *Seventh Report of the Dutch National, Rapporteur “Dutch National Rapporteur on Trafficking in Human Beings, Trafficking in human beings, 2010 Strategji*
- *Raporti për Realizimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzor 2008-2010 (Shtator 2008 – Maj 2009).*
- *Raporti i Departamentit Amerikan te Shtetit per vitin 2010.*
- *OKB, Deklarata e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit, e miratuar nëpërmjet një rezolute të Asamblesë Përgjithshme Nr. 40/34 e 29 Nëntorit 1985*
- *E/2002/68/Add. 1, 20 Maj 2002.*
- *OSBE-ODHIR, Raport, Barcelonë 2007*

### **Strategji**

- *Këshilli i Ministrave. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013*
- *Këshilli i Ministrave. Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013*
- *Urdhër i Kryeministrit Nr. 203, datë 19.12.2005*
- *Urdhër për Krijimin e Komiteteve Rajonale Anti-Trafik për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Nivel Qarku, 2006*
- *INSTAT. Perspektivat gjinore në Shqipëri. Tiranë, 2004.*

- *Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2007-2010. Urdhri Nr..394 datë 23.02.2004 i Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale “Për tarifaf e Sistemit të Formimit Profesional”.*
- *Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013.*
- *Deklarata e angazhimeve e Tiranës, Mbi legalizimin e statusit të viktimës së trafikuar, 11.12.2002, Nenet 6 dhe 14.*
- *Njësia Antitrafik, Ministria e Brendshme, “Raporti për realizimin e strategjisë kombëtare shqiptare të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore, Janar – Dhjetor 2006”, Mars 2007*
- *BE, "Strategjia e BE-së në drejtim të ç'rrënjosjes së Trafikimit të qenieve njerëzore 2012-2016", Qershor 2012*
- *Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima tëTrafikimit, 2005 dhe Marrëveshja midis Qeverisë së Republikës Greke dhe Këshillit të Ministrave tëRepublikës së Shqipërisë për Mbrojtjen dhe Ndhimën e Fëmijëve Viktima të Trafikimit, 2006.*
- *Vatra, “Vajzat dhe Trafikimi: Studim mbi zhvillimin e trafikimit të grave në Shqipëri”, 2005.*
- *Analysis of the Criminal Justice System of Albania (Analizë e Sistemit të Drejtësisë Penale në Shqipëri), OSBE 2006*
- *Monitoring of the court decisions related to THB in the District Courts of Tirana, Vlora, Shkodra for the period 2001 – 2003 (Studimi i vendimeve gjyqësore në lidhje me Trafikimin e Qenieve Njerëzore në gjykatat e shkallës së parë Tiranë, Vlorë, Shkodër për periudhën 2001-2003), CLCI(QNLQ), 2003.*
- *Korrespondenca me postë elektronike midis hartueses së studimit dhe avokatëve që QNLQ-së, 15 Prill 2007.*
- *Informacion i marrë nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, dhënë hartueses së studimit më 20 Prill2007.*
- *ODIHR, Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore “Prioritetet afatshkurtra për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe disa arritje kryesorenë 2006,”*

## **C. Burime dytësore**

### **Praktika gjyqësore**

- *Gjykata e Lartë, Vendimi Nr. 615, dt. 10.12.2003*
- *Gjykata e Lartë, Vendimi Nr. 502, datë 14.10.2009*
- *Gjykata e Lartë, Vendimi Nr.92, datë 04.03.2009*
- *Kolegjit Penal të Gjykatës Lartë, Vendimi Nr. 485, date 24.09.2001*
- *Gjykata e Apelit, Vendimi Nr. 799, datë 20.09.2013*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendim Nr. 57, dt. 01.11.2005*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr. 26, dt.29.09.2005*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr. 6, dt. 03.02.2005*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr. , dt.05.04.2006.*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr., dt.26.06.2008.*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr., dt.14.11.2008.*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr.15, date 12.03.2012*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr. 39, date 12.07.2011*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimin Nr.18 dhe Nr. 39 akti, datë 23. 03. 2005*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr. 29, datë 6 Tetor 2004.*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr. 3 dhe Nr. 4/22 Akti, date 18.01.2005.*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr. 3, datë 19.03.2007*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr .38, date 04.07.2011*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr. 3, datë 11.01.2011*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr. 29, datë 06.10.2004*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr. 73 akti, datë 14.09.2006*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr. 29, datë 11.06.2007*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr. 03, datë 16.01.2007*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr. 74, datë 24.06.2014*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi Nr. 29, datë 06.10.2004*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimi i datës 12.11.2004*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendim i datës 09.05.2006*
- *Gjykata e Krimeve të Rënda, Vendimin Nr. 3, datë 28.04.2004*

- *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, Vendim Nr. 587, Qershor 2003*
- *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr. 587, date 16.06.2003.*

**website**

- *J. Tashi, Ligji i ri, viktimat e trafikimit do të përfitojnë ndihmë ekonomike, 09.02.2010, [http://lajme.parajsa.com/Shqiperia/id\\_152170/](http://lajme.parajsa.com/Shqiperia/id_152170/)*
- *Fjalori latinisht-shqip, viti 1966*
- *Broken windows theory, [http://en.wikipedia.org/wiki/Broken\\_windows\\_theory](http://en.wikipedia.org/wiki/Broken_windows_theory)*
- *Revista “Të drejtat e njeriut”, Nr.3, Shndërrimi i policisë nga forcë policore në shërbim policor është një aspekt themelor për zhvillimin dhe forcimin e shoqërisë demokratike. Marrë nga Tiranë, 2002*
- *Crime Theories, An introduction to Criminology, [http://ekunëe.net/intro\\_criminology.htm](http://ekunëe.net/intro_criminology.htm)*
- *Revista “Ligji, mundësi zhvillimi për Gratë”, Tiranë, 2005*
- *<http://www.mpcs.gov.al/legjislacioni/strategji-standarte>*
- *<http://www.lajm-shqip.com/2014/06/raporto-dhe-shpeto-prezantohet-nisma-e-re-kunder-trafikut-te-qenieve-njerezore-burimi-shekulli-com-ëëë-shekulli-com-al/>, aksesuar më 16.06.2014.*